



Qeveria e Kosovës  
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

# PLANI HAPËSINOR

Zona me Interes të Veçantë  
“Fusha e Mihjes së Re”




Instituti për Planifikim Hapësinor





**Qeveria e Republikës së Kosovës**  
**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**



# **PLANI HAPËSINOR**

## **2010 - 2020+**

Zona me Interes të Veçantë Ekonomik  
**"Fusha e Mihjes së Re"**



**Instituti për Planifikim Hapësinor**

Prishtinë,  
Mars, 2011



## HARTUES TË PLANIT

### Instituti për Planifikim Hapësinor (IPH):

**Drejtor:** Luan Nushi,

**Koordinator i projektit:** Faton Deva,

**Planer dhe hulumtues të fushave përkatëse:** Faton Deva, Elvida Pallaska, Arbën Rrecaj, Zana Mehmeti, Besim Gollopeni, Luan Nushi, Festa Nela, Shpend Agaj, Nexhmije Kamberi, Rizah Murseli dhe Gëzime Grajqevci.

**Përpunimi i hartave:** IPH - Njësia e GIS-it: Ismail Gagica, Rizah Murseli dhe Festa Nela

**Përgatitja teknike:** Instituti për Planifikim Hapësinor

### Grupi Punues Ndër-Ministor:

**Koordinator Udhëheqë -** Faton Deva nga IPH / MMPH;

**Bashkë Koordinator -** Ardiana Zhuri nga PATEL / MZHE (në draftin e parë - Dhjetor 2009);

**Ndihmës Koordinator -** Zana Mehmeti nga IPH / MMPH dhe

**Anëtarët -** Sabit Restelica, Ismail Hetemaj, Hazir Çadraku, Fatmir Azemi, Abdurrahman Vërbovci dhe Sylë Tahirsylaj nga MMPH; Valon Stavileci, Sabri Limari dhe Pëllumb Gjinolli (në fund të procesit) nga PATEL / MZHE; Lulzim Korenica, Fatos Aliu dhe Arsim Kuliqi nga MZHE (**ish MEM**); Burbuqe Deva nga MKRS; Isah Rudaku nga MBPZHR; Xhevat Tafa nga MAPL; Afrim Krasniqi nga MPMS; Naim Kelmendi nga MTPT; Gëzim Tërnavë nga KEK-u Sh. A. dhe Nazif Shala nga Komuna e Obiliqit,

Anëtarët tjerë pjesëmarrës, në dy fazat e para të draft-Planit fillestar (Profili dhe Vizioni) ishin Ilirjana Mejzini e Adem Ibërhysaj nga MMPH dhe Miftar Nika e Besiana Qorra nga MZHE.

### Pjesmarrës të tjerë nga:

- Komunitat tjera pjesëmarrëse në zonë,
- Universiteti,
- Agjenci dhe Institute vendore,
- OJQ-të vendore dhe të huaja:
- Sektori Publik dhe Privat:
- Profesionistë të pavarur:
- Agjenci dhe partnerë ndërkombëtarë

## FALËNDERIM

Falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit e grupit punues ndërministror (GPNM), përfaqësues të komunave e të organizatave publike qeveritare dhe joqeveritare si dhe ekspertë tjerë profesional, për kontributin e dhënë në takimet e organizuara, me qëllim të ndihmës dhe mbështetjes së MMPH-së gjegjësisht Institutit për Planifikim Hapësinor, në hartimin dhe ngritjen e cilësisë së këtij dokumenti:

**"Plani Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik - Fusha e Mihjes së Re, 2010 - 2020+".**

**LISTA E SHKURTIMEVE**

<b>Shkurtesa</b>	<b>Emërtimi</b>
BK	Buxheti i Kosovës
ZKM	Zyra Kryeministrit
KDP	Komiteti Drejtues i Projektit për transaksionin e Termocentralit "Kosova e Re"
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave, i referohet përgjegjësi, vendimeve dhe burimeve të shfrytëzuara nga ky institucion para datës 22 Mars 2011
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, i referohet përgjegjësi, vendimeve dhe burimeve të shfrytëzuara nga ky institucion pas datës 22 Mars 2011
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MTPT	Ministria e Transportit dhe Post -Telekomunikimit, i referohet përgjegjësi, vendimeve dhe burimeve të shfrytëzuara nga ky institucion para datës 22 Mars 2011
MI	Ministria e Infrastruktues, i referohet përgjegjësi, vendimeve dhe burimeve të shfrytëzuara nga ky institucion pas datës 22 Mars 2011
MEF	Ministria për Ekonomi dhe Financa, i referohet përgjegjësi, vendimeve dhe burimeve të shfrytëzuara nga ky institucion para datës 22 Mars 2011
MF	Ministria e Financave, i referohet përgjegjësi, vendimeve dhe burimeve të shfrytëzuara nga ky institucion pas datës 22 Mars 2011
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MAPL	Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MSH	Ministria e Shëndetsisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
GPNM	Grupi Punues Ndër-Ministror
AKMM	Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit
IHMK	Instituti Hidro-Meteorologjik i Kosovës
DBN	Departamenti i Banimit dhe Ndërtimit
DMM	Departamenti i Mbrojtjes Mjedisit
DPH	Departamenti për Planifikim Hapësinor
IPH	Instituti për Planifikim Hapësinor
PH	Plani Hapësinor
ZIVE	Zonë me Interes t'Veçantë Ekonomik
FM R	Fusha e Mihjes së Re
PH FMR	Plani Hapësinorë për Fushën e Mihjes së Re
PVZH	Plani Veprimi për Zhvendosje
FZHK	Fondi për Zhvillim të Komunitetit (ose CDF - Community Development Found)
PKX	Plani Kryesor Xehtarë (Minerar)
PPX	Plani Plotësues Xehetar
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSMS	Vlerësimi Strategjik Mjedisor dhe Social
PATEL	Projekti i Asistencës Teknike Energjia nga Linjiti
TKE	Traktatit të Komunitetit për Energji
IED	Direktiva për emisione industriale
LCPD	Direktiva për Impiante të mëdhaja me djegie (Large Combustion Plant Directive)
EJL	Evropa Jug Lindore
ENTSO-E	Operator i Sistemit të Transmisionit në Rrjetin Evropian - Lindje (European Network Transmission System Operator - East)
AER	Agjencionit Evropian për Rindërtim
BE	Bashkimi Evropian
BB	Banka Botërore
UNMIK	Misioni i Administrimit të Përkohshëm i OKB-së në Kosovë

KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KOSTT	Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu (Kosovo Operator System, Transmission and Trade)
INKOS	Instituti i Kosovës për projektim dhe hulumtim pranë KEK-ut
PPRT	Projekti për Pastrimin dhe Rehabilitimin e Tokës
STEAG	Konzorcium STEAG
Vattenfal	Hartues i Planit Kryesor Xehetar për fushën e Sibovcit (VEM dhe DMT)
VEM	Kompania Vattenfall Europe Mining AG
DMT	Kompania Deutsche Montan Technologie GmbH
SEK	Strategjia e Energjisë së Kosovës
SEE	Strategjia e Energjisë Elektrike
HC	Hydrocentral
TC	Termocentral
TC A	Termocentrali Kosova A
TC B	Termocentrali Kosova B
TC KR	Termocentrali Kosova e Re
PF	Djegia në Formë të Pluhurit
CFB	Djegia në Shtresën e Fluidizuar
KK	Kuvendi Komunal
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
TZHEK	Trekëndëshi i Zhvillimit Ekonomik
SWOT	Analiza me Përparësi, Dobësi, Mundësi dhe Rreziqe
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive Kosovare
Mt/v	Milion tonelatë në vit
MWh	Megavatorë
MCM	Milion Kubik Metër



## PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT

Parathënie.....	09
Përmbledhja ekzekutive .....	11
Hyrje .....	14
Zhvillimi i procesit të rikonfigurimit .....	15
Përfshirja dhe përkufizimi i zonës .....	17
Gjithpërfshirja në hartim të planit .....	20
Qëllimi i hartimit të planit .....	21
Bazueshmëria, sistemi dhe procesi i planifikimit .....	22
Struktura dhe përmbajtja e fazave të planit .....	26
<b>I PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR DHE ANALIZA E GJENDJES</b>	<b>27</b>
Profili dhe analiza e gjendjes ekzistuese .....	27
Pozita, kontesti dhe veçoritë natyrore dhe gjeografike.....	27
Pozita gjeografike.....	27
Konteksti i zonës dhe pjesëmarrja komunale .....	28
Veçoritë natyrore dhe gjeografike .....	30
Rreziqet natyrore .....	35
Analiza e gjendjes - Shfrytëzimi i tokës.....	37
Mjedisi - Ajri .....	44
Uji .....	48
Toka.....	50
Mbeturinat dhe ndikimi i tyre .....	51
Zhurma .....	54
Peisazhi, biodiversiteti dhe trashëgimia natyrore e kulturore .....	55
Resurset e linjtit .....	58
Popullsia, zhvillimi social dhe vendbanimet .....	61
Popullsia .....	61
Zhvillimi social .....	61
Vendbanimet, banimi dhe shërbimet sociale .....	65
Zhvillimi ekonomik .....	68
Industria .....	68
Tregtia .....	68
Bujqësia .....	68
Turizmi .....	69
Infrastruktura dhe shërbimet teknike .....	70
Infrastruktura e transportit .....	70
Infrastruktura hidroteknike .....	71
Infrastruktura e energjisë elektrike .....	72
Menagjimi i mbeturinave .....	74
Zona e "FMR-së" në kontekst të planifikimit .....	75
Zona në kontekst me planin hapësinor të Kosovës .....	75
Konteksti i zonës me planet zhvillimore dhe analizat komunale .....	76
Raportet dhe strategjitë sektoriale .....	77
Analiza - SWOT .....	81
Vlerësimi i kapaciteteve investive .....	84
Sfidat kryesore .....	88
<b>II VIZIONI, PARIMET DHE CAQET</b>	<b>89</b>
Vizioni i bazuar në sfida, parime dhe caqe .....	89
Sfidat kryesore të bazuara në prioritete dhe parime ndërkombetare .....	90
Parimet e përgjithshme .....	98

	Deklarata e Vizionit .....	98
	Synimet (caqet) afatgjate të zhvillimit hapësinor.....	99
	Prioritetet strategjike .....	101
<b>III</b>	<b>KORNIZA E ZHVILLIMIT TË ARDHSHËM HAPËSINOR</b>	<b>103</b>
	Konceptet dhe struktura e zhvillimeve të ardhshme .....	103
	Koncepti i zhvillimit hapësinor "Detelinë dhe Helikë" .....	103
	Struktura e zhvillimeve sipas konceptit .....	105
	Prodhimi dhe furnizimi i sigurt me energji elektrike dhe të ngrohjes .....	105
	Shfrytëzimi i linjtit për furnizim të qëndrës gjeneruese .....	107
	Korniza e politikave për zhvendosjen e popullsisë .....	108
	Rehabilitimi mjedisor .....	110
	Vlerësimi i skenarëve bazuar në konceptin për zhvillimet e ardhshme .....	113
	Skenarët alternativ për zgjedhjen e lokacionit për kapacitetet e reja gjeneruese .....	113
	Kriteret e veçanta për vlerësimin e skenarëve .....	114
	Vlerësimi i skenarëve për zhvillimin e mihjes së re .....	117
<b>IV</b>	<b>STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN E ARDHSHËM</b>	<b>120</b>
	Strategjitë konkurruese .....	120
	Strategjia sipas trendit (ose "zero") .....	120
	Startgjia sipas konceptit zhvillimor .....	121
	Zhvillimi i strategjisë sipas konceptit zhvillimor.....	123
	Shfrytëzim i parashikuar i tokës në 2020 .....	139
	Vlerësimi i strategjive .....	142
<b>V</b>	<b>DISPOZITAT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË</b>	<b>143</b>
	Dispozitat per zbatim te Koncept – Strategjise .....	143
	Kushtet dhe masat e Qeverisë, Pushtetit lokal, Investitorit privat dhe tjerë.....	143
	Kushtet dhe masat e përgjithshme .....	143
	Aplikimi i planit nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës .....	144
	Aplikimi i planit nga ana e pushtetit lokal .....	144
	Aplikimi i planit nga ana e investitorit privat .....	145
	Zbatimi i planit nga ana e institucioneve tjera përgjegjëse .....	145
	Rregullimi dhe shfrytëzimi i hapësirës .....	146
	Dispozitat për konsultime, bashkëpunim dhe pjesëmarrje .....	146
	Dispozitat mbi kronologjinë dhe etapat e zbatimit .....	147
	Udhëzime mbi hulumtime e mëtejshme .....	147
	<b>SHTOJCAT NË PLANIN HAPËSINOR</b>	<b>151</b>
	<b>PLANI STRATEGJIK I VEPRIMEVE</b>	<b>155</b>




## Parathënie

Plani Hapësinor i Zonës me Interes të Veçantë Ekonomik "Fusha e Mihjes së Re" është dokumenti kryesor i sektorit të planifikimit hapësinor që siguron kornizën bazë në mbështetje të projekteve të ndryshme edhe nga sektorët tjerë qeveritar për zonën energjetike në fjalë dhe më gjerë. Ky Plan është ndërtuar në bashkëpunim me të gjitha sektorët e rëndësishme të Qeverisë së Kosovës. Gjithashtu, në hartimin e tij, kanë marrë pjesë edhe profesionist të dalluar të fushës, institucionet e ndryshme shkencore, universiteti, përfaqësues të organizata të ndryshme joqeveritare e të shoqërisë civile, zyrtarë të nivelit lokal dhe pa dyshim, shumë e rëndësishme ishte edhe ndihma dhe përkrahja e ofruar nga organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Plani Hapësinor i ZIVE të FMR-së, është dokument që garanton respektimin e të drejtave dhe lirive të të gjithë qytetarëve që jetojnë në të. Gjithë-përfshirja, zhvillimi i baraspeshuar dhe i qëndrueshëm, promovimi i transparencës së plotë në planifikim, janë disa nga parimet që dëshmojnë se dokumenti është në përputhje me standardet kryesore që dalin nga ligjet e vendit dhe rregulloret evropiane. Me këtë dokument Kosova në mënyrë të pavarur orienton kahen e zhvillimit, rregullimit, mbrojtjes dhe shfrytëzimit racional të resurseve natyrore si dhe të territorit të vet.

Zhvillimi i ofruar ekonomik, nëpërmjet zhvillimit të sektorit energjetik, duke siguruar prodhim dhe furnizim të rregullt të energjisë elektrike, është garant edhe për zhvillim të barabartë social dhe mjedisor (zhvillimi qëndrueshëm) në të gjitha komunat pjesëmarrëse të zonës.

Duke qenë të vetëdijshëm për situatën e vështirë ekonomike dhe problemet e shumta që po ballafaqohet vendi ynë, jemi të sigurt që dokumenti i ofruar i zhvillimit të ardhshëm hapësinor të zonës së interesit që del nga Plani Hapësinor i Kosovës, është bazë e mirë e veprimeve që ndikojnë në zgjidhje e problemeve të trajtuara. Prandaj, për zbatimin e këtij Plani, do të duhet gjithsesi ndihma e të gjithëve, në mënyrë që bashkërisht të ndikojmë në ndërtimin e mjedisit më kualitativ jetësorë për të gjithë qytetarët e Kosovës.



**Dardan Gashi**  
Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



# PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

**S**igurimi i prodhimit dhe furnizimit të rregullt me energji elektrike është parakusht për zhvillimin ekonomik të vendit. Në Kosovë, prodhimi aktual i energjisë elektrike, varet kryesisht nga gjenerimi i saj që ka për bazë djegien e linjtit në blloqet e Termocentraleve 'Kosova A' dhe 'Kosova B'.

Kosova, në këtë fazë të planifikimit të zhvillimit të energjetikës, e bazon në shfrytëzimin e burimeve vendore. Linjiti është resursi më i rëndësishëm energjetik i Kosovës, i cili furnizon rreth 97% të prodhimit total të energjisë elektrike. Resurset e vlerësuara të linjtit në gjithë Kosovën arrijnë rreth 12.5 miliardë tonë, nga të cilat, sasia prej 8.6 miliardë tonë, konsiderohet që janë rezerva që nga aspekti ekonomik konsiderohen me lehtëri për tu shfrytëzuar.

Zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të energjisë në Kosovë e gjejmë kryesisht, në përfitimin e energjisë elektrike me djegie të linjtit. Ky zhvillim, duke shfrytëzuar rezervat e linjtit me kritere rigorozë ndërkombëtare mbi ngrohjen globale, kontrollit, tregëtimit dhe emetimeve të dyoksidit të karbonit, bazohet në kapacitetet dhe cilësinë e rezervave minerare të linjtit në Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik (ZIVE) - "Fusha e Mihjes Re" dhe në ndërtimin e impiantit (termocentralit) të ri - TC "Kosova Re" brenda saj.

Zona e interesit FMR, për të cilën hartohet ky Plan Hapësinor, është me sipërfaqe prej 150 km<sup>2</sup> (nga ajo e propozuara si në vendimin e shpalljes së zonës Nr. 02/57, dt. 13.03.2009 me 143 km<sup>2</sup>) dhe përfshinë faktorë të ndryshëm përcaktues hapësinor. Secili prej tyre, kërkon analiza, studime dhe hulumtime paraprake mbi ndikimet sociale dhe mjedisore që shkaktohen nga veprimet, aktivitetet dhe projektet e planifikuara ekzistuese dhe të ardhshme në kuadër të zhvillimeve të sektorit energjetik.

Termocentralet ekzistuese, aktivitetin e vet të funksionalizimit deri në shuarje, pas rehabilitimit të kërkuar që bazohet në standardet e lejuara ndërkombëtare, TC 'Kosova A' do ta zhvillojë më së largu deri në fund të vitit 2017 kurse me rehabilitim teknik dhe mjedisor, TC 'Kosova B' deri kah vitet 2030. Ndërkohë, në bazë të Strategjisë së Energjisë për periudhën 2009 - 2018, pritet ndërtimi i termocentralit të ri TC "Kosova e Re" në dy faza, ku funksionimin e blloqeve të para duke ju referuar planit, do ta kemi në periudhën prej së paku pesë viteve, gjersa vazhdon ndërtimi dhe zhvillimi edhe i blloqeve tjera, në mënyrë që edhe dy blloqet në TC Kosova B të zëvendësohen plotësisht rreth vitit 2030.

Zhvillimi dhe avancimi i mihjes sipërfaqësore, në fushën e re minerare, nën operim të KEK-ut realizohet sipas Planit Kryesor Xehetar të përpiluar nga Vattenfall<sup>1</sup>, me qëllim të furnizimit të termocentraleve me linjit. Ky proces, tërheq me vete, problematikën shumë të ndjeshme sociale, të zhvendosjes së popullatës nga vendbanimet që ndikohen drejtpërdrejtë në këtë hapësirë. Procesi i zhvendosjes, me kronologjinë e vet, të evidentimit, shpronësimit, vlerësimit, kompensimit dhe rivendosjes së popullatës në vendbanimet e reja, kryhet paraprakisht për të lejuar fillimin e mihjes sipërfaqësore në nxjerrjen dhe bartjen e linjtit deri në termocentrale.

Rehabilitimi dhe përmirësimi mjedisor, zhvillohet si proces i pa shmangshëm dhe pa shkëputje, duke filluar me largimin dhe ri kultivimin e zonave të hirit të deponuar e të palosjeve të jashtme të djerrinës dhe duke vazhduar me rehabilitime, zëvendësime dhe vendosjes së pajisjeve të reja teknologjike në blloqet ekzistuese (në pengim të ndotjes dhe degradimit në ajër, ujë dhe tokë), të zonave të degraduara dhe të minierave të shfrytëzuara. Ndërtimi i barrierave në mbrojtje nga vërshimi, erozioni, dridhjet dhe zhurma e sidomos krijimi i brezit rrethues të zonës minerare dhe gjeneruese energjetike nga gjelbërimi në kuadër të këtij procesi, janë të obligueshme dhe me fillim sa më të shpejtë të realizimit.

<sup>1</sup> Vattenfall Europe Mining AG, Deutsche Montan Technologie GmbH "The Main Mining Plan for New Sibovc Mine", June 24, 2005.

Sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të bazuar në kornizën ligjore të Kosovës, obligohet MMPH-ja - IPH-ja (Instituti për Planifikim Hapësinor) të hartoj Planin Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik "Fusha Mihja e Re". Plani Hapësinor është punuar me ndihmën e grupit punues profesional në nivel të ekspertëve ndërministror, ku kontribut të konsiderueshëm kanë dhënë edhe konsulentë dhe ekspert profesional tjerë, të huaj dhe vendor.

Qëllimi i hartimit të Planit Hapësinor për Fushën e Mihjes së Re është planifikimi i aktiviteteve të ardhshme brenda dhe jashtë zonës në dobi të sigurimit të prodhimit të energjisë elektrike dhe të ngrohjes nga djegia e linjitet, në termocentralet ekzistuese dhe të ndërtimit të TC-së Kosova e Re, të zhvendosjes së popullatës dhe të mirave materiale nga vendbanimet e prekura nga aktivitetet e vazhdueshme të mihjes si dhe të përmirësimit mjedisor e të kualitetit të jetës së banorëve të zonës duke shfrytëzuar në mënyrë racionale resurset dhe trashëgiminë natyrore dhe kulturore.

Zona me interes të veçantë ekonomik e FMR-së, në kontekst vendor me Planin Hapësinor të Kosovës, është vendosur në "Zonën e Kaltër" të ashtuquajturin "Port i Kosovës", përbri TZHEK-ut (Trekëndëshit për Zhvillim Ekonomik të Kosovës) dhe përfshinë komunat: Obiliq, Lipjan, Fushë Kosovë, Drenas, Podujevë dhe Prishtinën si qendër. Ndërsa, në kontekst lokal, zona e interesit "Fusha e Mihja Re" do të adaptohet në planet dhe strategjitë zhvillimit përfshin komunat (Obiliq, Fushë Kosovë, Vushtrri, Drenas).

Fusha e Mihjes së Re, si zonë e interesit të veçantë ekonomik, përfshinë më vete elementët dhe faktorët përcaktues hapësinor si: Fushën e Re të Mihjes (fusha 'C'), Zonat industriale të TC-ve ekzistuese me lokacionet e mundshme për TC KR, Korridoret transportues dhe infrastrukturorë, Minierat ekzistuese, Deponimet e jashtme të djerrinës, Deponimet e krijuara të hirit dhe Zona mbrojtëse (buferike) për rreth këtyre faktorëve ndikues hapësinor.

Nga analiza e shtjelluar e profilit mbi gjendjen dhe situatën ekzistuese, dolën probleme të ndryshme, të radhitura në fusha përkatëse tematike bazuar në prioritetet Qeveritare dhe principet themelore ndërkombëtare, të grupuara në 4 (katër) Sfidat Kryesore të Zhvillimit të zonës së FMR-së:

1. Sigurimi i energjisë elektrike dhe të ngrohjes,
2. Shpronësimi, zhvendosja dhe kualiteti i jetës së komunitetit,
3. Shfrytëzimi resurseve natyrore dhe
4. Gjendja mjedisore.

Mbështetur në materialet në dispozicion (analiza, hulumtime, vlerësime, raporte, studime, strategji dhe drafte tjera të ndryshme) si dhe idetë e dhëna të bazuara në përvojat e ekspertëve profesional, në diskutimet e shumta gjatë takimeve punuese, është hartuar edhe deklarata e Vizionit e formësua në këtë përmbajtje:

**"Zona e Interesit të Veçantë Ekonomik - Fusha e Mihjes së Re, zonë e menaxhuar me kujdes, në përputhje me standardet e BE-së në dobi të rritjes ekonomike, mirëqenies sociale dhe gjendjes së kënaqshme mjedisore."**

Arritja e Vizionit të theksuar, mund të sigurohet, duke u mbështetur në parimet e përgjithshme (me të cilat përputhet ky plan strategjik) për mbrojtjen dhe zhvillimin e kësaj zone të interesit dhe në kundërvështrim analog me të katër Sfidat Kryesore. Pra si reflektim koherent i gjithë kësaj janë bashkërenditur të katër Synimet e Zhvillimit të Ardhshëm Hapësinor:

**Prodhim dhe furnizim i sigurt me energji elektrike** - Objektivat e propozuar, duhet të plotësojnë synimin e theksuar dhe kanë të bëjnë me: Mundësinë e ndërtimit të njërive (kapaciteteve) të reja gjeneruese energjetike me djegie të linjitet; Bartjen, shpërndarjen e energjisë elektrike dhe mirëmbajtjen e rrjetit elektroenergjetik vendor; Iniciativa të vazhdueshme për shfrytëzimin e burimeve të ri përsëritshme për prodhimin e energjisë.

**Planifikim dhe kontroll i procesit të zhvendosjes dhe zhvillimit të Vendbanimeve** - Tentohet të arrihet, me objektivat e propozuara siç janë: Inventarizimi dhe vlerësimi i pronës dhe pasurisë së paluajtshme; Shpronësimi i pronave dhe kompensimi i pasurisë së paluajtshme; Zbatimi i procesit të pranueshëm për zhvendosje - rivendosje të komunitetit dhe arritje e marrëveshjes për çështjen e varrezave; Planifikimi dhe kontrolli i zhvillimeve në përmirësim të jetesës brenda zonës; Krijimi i Fondit për Zhvillimin e Komunitetit si dhe Kontrolli i zhvillimeve në tërë zonën e basenit të Kosovës.

**Menaxhim i qëndrueshëm i resurseve natyrore** - Synim ky i cili pretendon të arrihet, me objektiva të propozuara, si: shfrytëzimi racional i rezervave të linjtit; parandalimi i vet-djegies së linjtit në minierë (mihje) si dhe shfrytëzimi dhe menaxhimi racional i resurseve ujore.

**Përmirësim i gjendjes mjedisore dhe përkujdesje ndaj trashëgimisë** - Këtu potencohen, disa nga objektivat e shumta të propozuara, me të cilat besohet të arrihet ky synim, si: përmirësimi i performancës mjedisore të TC-ve ekzistuese; mbyllja e blloqeve të vjetra, rehabilitimi dhe rikultivimi i hapësirave të degraduara; monitorimi dhe kontrolli i rregullt mjedisor mbi ajrin, ujin dhe tokën; menaxhimi i qëndrueshëm i 'Deponisë Rajonale të Mbeturinave' në Mirash; menaxhimi dhe shfrytëzimi i hirit të freskët për nevoja në ndërtimtari si dhe përkujdesje e duhur dhe efikase për larminë biologjike dhe trashëgiminë (natyrore, kulturore, historike e industriale) në zonën e FMR-së.

Më tutje, është punuar në përcaktimin e konceptit të zhvillimit të ardhshëm hapësinor, i cili mundëson dhe lehtëson marrjen e vendimeve lidhur me zhvillimet e ardhshme në zonë. Bazë për këtë është shfrytëzuar vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin kjo zonë është shpallur 'Zonë me Interes të Veçantë Ekonomik', me synimin kryesor që përmes zhvillimit të sektorit energjetik të rritet dhe përparoj edhe zhvillimi ekonomik i vendit.

Koncepti i zhvillimit të ardhshëm hapësinor për zonën e interesit të FMR-së, i emërtuar "Detelinë dhe Helikë", shprehë në mënyrë skematike, zhvillimet e ardhshme në kuadër të katër synimeve kryesore - përbërëse të Vizionit - të karakterizuara si procese të vazhdueshme. Ky koncept, potencon zhvillimet e ardhshme të fuqisë së vazhdueshme gjeneruese të energjisë, e vendosur mu në mes të zonës si bosht qendror i helikës dhe tri elisat shtytëse që tregojnë proceset përcjellëse, të shfrytëzimit racional të resursit të linjtit, mbrojtjes së interesave të popullatës gjatë trajtimit të vendbanimeve si dhe rehabilitimit të mjedisit jetësor. Mirëpo, në zonën e FMR-së, vetëm kur të plotësohen kriteret e kërkuara të aspektit social dhe mjedisor (të shprehura simbolikisht me bimën ekologjike - detelinën), atëherë lejohet të ndodhin këto zhvillime të parapara (të shprehura simbolikisht me helikën).

Përmes këtij koncepti tentohet arritje e zhvillimit të dëshiruar të ardhshëm hapësinor, të Vizionit të deklaruar paraprakisht për zonën e FMR-së, ku veprimet dhe aktivitetet që dalin nga koncepti janë të qarta dhe të qëlluara. Aktivitetet e propozuara janë në mbështetje të plotë të planifikimit dhe zhvillimit të koordinuar hapësinor në korrelacion me sfidat kryesore të përfshira në zonë. Përpjekje e shtuar i është dhënë bashkëveprimit të lartë ndërinstucional, në mes të nivelit qendror dhe atij lokal, duke ndikuar në harmonizimin e veprimeve gjatë përzgjedhjes së aktiviteteve me prioritet dhe zbatimit të projekteve konkrete duke përfshirë edhe kontrollin e zhvillimeve brenda dhe jashtë zonës.

Njëri ndër preokupimet kryesore të grupit punues ka qenë përzgjedhja e lokacionit adekuat për zhvillimin e minierës së re dhe ndërtimin e termocentralit Kosova e Re. Ndër skenarët e mundshëm, bazuar në studime dhe hulumtime paraprake, janë analizuar dhe vlerësuar kahja e zhvillimit të minierës dhe katër lokacione potenciale për ndërtimin e TC-së 'Kosova e Re'. Në analiza është përfshirë lokacioni i kompleksit industrial TC "Kosova A"; lokacioni i kompleksit TC "Kosova B"; lokacioni në afërsi të fshatit Bivolak dhe lokacioni në afërsi të fshatit Grabovc. Nga vlerësimi i kriterëve specifike për zgjedhjen e lokacionit, pos atyre të përgjithshme, për secilin skenar, ka rezultuar se: lokacioni më i preferuar dhe më i përshtatshëm për ndërtimin e "TC KR" është opsioni B (brenda kompleksit industrial të TC 'Kosova B').

Planin i përgjithshëm dinamik, për zhvendosje-rivendosje të popullatës së vendbanimeve në zonën e rrezikuar, është përgatitur sipas radhitjes së vendbanimeve që atakohen të bazuar në skenarin e përzgjedhur për avancimin dhe zhvillimin e mihjes, në përputhje me Planin Kryesor Xehetar.

Ky plan dhe të gjitha aktivitetet tjera janë përshkruar në mënyrë të detajuar në kaptinën Strategjia e zhvillimit hapësinor të zonës - që është edhe pjesa kryesore e dokumentit. Strategjia sipas konceptit të zhvillimit të FMR shtjellon më tej skenarin e përzgjedhur i cili arrihet me zbrëthimin hierarkik të tij së pari në synime, më pas secili synim në objektiva specifike dhe në fund secila objektive ka masat, aktivitetet dhe projektet e veta konkrete për arritjen e saj.

Planin Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes së Re" përfundon me kaptinën e dispozitave për zbatim, që njëherit shprehin rregullat dhe përgjegjësitë për secilin pjesëmarrës të përfshirë në realizimin e aktiviteteve të parapara.



# HYRJE

Në përgjithësi, prodhimi aktual i energjisë elektrike në Kosovë varet nga Termocentralet e vjetruara "Kosova A" dhe "Kosova B", të cilat djegin linjitet që nxirret nga minierat ekzistuese të Bardhit dhe Mirashit, Sitnicës, me vendndodhje në perëndim të kryeqendrës së Kosovës - Prishtinës. Prodhimi linjitet nga miniera e re "Sibovc Jugperndimor", fillon në vitin 2010. Pasuritë minerale në mihjet ekzistuese (Bardh dhe Mirash), janë në përfundim dhe pritet të shterojnë në vitin 2011. Prandaj, duke e pasur këtë parasysh, Qeveria e Kosovës me sektorin e vet përkatës ka marrë iniciativën për hapjen e minierave të reja. Kjo iniciativë, natyrisht se përveç sektorit energjetik kërkon përfshirjen e të gjitha sektorëve tjerë duke përfshirë këtu edhe sektorin e planifikimit hapësinor në cilësinë e koordinatorit të procesit të planifikimit.

Sigurimi i prodhimit dhe furnizimit me energji të mjaftueshme elektrike, në përmbushje të nevojave të konsumit vendor dhe në përgjithësi të zhvillimit ekonomik të Republikës Kosovës, është elementi kryesor në këtë proces. Zhvillimin e mëtejshëm të mihjes sipërfaqësore duhet bazuar në kapacitetet dhe cilësinë e rezervave minerare në zonën e veçantë me interes ekonomik (ZIVE) - "Fusha e Mihjes së Re". Investimi në ndërtimin e një impianti (termocentrali) të ri (TC "Kosova Re"), me teknologji më të avancuar, me efikasitet më të lartë prodhues e njëkohësisht më miqësor me mjedisin, do të ishte më i arsyeshëm nga investimi i vazhdueshëm e shumë i kushtueshme në rehabilitim dhe adaptimin e blloqeve të TC 'Kosova A' përkundër jetëgjatësisë dhe teknologjisë që kanë ato.

Ngritja e blloqeve të reja, nga ndërtimi deri në funksionimin e tyre, duhet zhvilluar krahas funksionimit të blloqeve në të dy termocentralet ekzistuese. Pritet që aktivitetin e vet, të funksionalizimit deri në shuarje - dekomisionim, TC 'Kosova A' me blloqet e saj A3, A4 dhe A5 do ta zhvillojë më së largu deri në vitin 2017, kurse TC 'Kosova B' me blloqet e saj B1 dhe B2 (të rehabilituara më 2017) deri në vitin 2030.

Zhvillimet e tilla, si: ndërtimi dhe funksionimi i termocentralit të ri 'Kosova Re'; dekomisionimi i blloqeve në TC Kosova A dhe rehabilitimi i blloqeve në TC Kosova B; zhvendosjen e popullatës dhe dislokimin e vendbanimeve; zhvillimet minerare në fushës re të mihjes duke përfshirë mbushjen dhe ri-kultivimin e minierave të shfrytëzuara në Bardh dhe Mirash, kushtojnë shumë. Pa dyshim se përgjegjësia kryesore bie mbi Qeverinë e Kosovës dhe mundësitë që ka Buxheti i Kosovës. Nisur nga vështirësitë ekonomike vendore është e qartë se për zhvillimin e kapaciteteve të reja energjetike do të na duhet ndihma edhe nga burime tjera financiare. Prandaj, vendimet e Qeverisë dhe marrëveshjet e arritura me kompaninë bartëse të Projektit, duhet të definojnë qartë, kapacitetet e nevojshme gjeneruese, pozicionin e institucioneve të Kosovës si dhe detyrimet e investitorit të jashtëm në proceset e cekura, gjatë zhvillimit të Projektit, shumë të nevojshëm energjetik për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Strategjia e Energjisë së Kosovës për periudhën 2005 - 2015, e hartuar nga Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM) dhe miratuara nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2005, vërteton faktin, që në skemat afatgjate, linjiti do të mbetet karburanti kryesor për prodhimin e energjisë elektrike për Kosovën. E njëjta është vërtetuar edhe në Strategjinë e Energjisë së rishikuar të Kosovës për periudhën 2009-2018 ku, zhvillimi i mihjeve të linjitet në periudhën e ardhshme është paraparë të ndodhë në pjesën veriore të basenit të linjitet "Kosova". Kjo pjesë njihet edhe me emrin "Fusha e Sibovcit", por, me kërkesën e banorëve të asaj ane gjatë konsultimeve publike kjo fushë tani quhet "Fusha e Mihjes së Re".

Kjo strategji, mbi të cilën është hartuar drafti i parë i PH për "FMR" në Nëntor 2009, kërkon që linjiti si burim vendor të vihet në shfrytëzim për prodhim të energjisë elektrike, me një trajtim të përgjegjshëm mjedisor dhe socio-ekonomik. Pas shfrytëzimit të mihjes dhe të furnizimit me linjitet të termocentraleve ekzistuese dhe atyre të reja të ndërtuara në faza me kapacitete gjeneruese prej 2 x 1000 MW, kërkohet që, sipërfaqet e shfrytëzuara minerare, të mbushen e të rehabilitohen dhe më pastaj të ri kultivohen. Krahas proceseve me aktivitete të përmendura, kërkohet të zhvillohen edhe aktivitete të pranueshme në kuadër të procesit të shpronësimit dhe të zhvendosjes-rivendosjes së komunitetit. Rezultat të këtyre proceseve, do të jenë ndryshimet në strukturën hapësinore, të shprehura si në konfiguracion, mjedis, shfrytëzim të tokës, peizazh, shtrirje të vendbanimeve etj.

## ZHVILLIMI I PROCESIT TË RIKONFIGURIMIT

Draft-dokumenti paraparak - Plani Hapësinor për zonën me interes të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes së Re" ishte i bazuar në Strategjinë e Energjisë 2005 – 2015 dhe dokumentet tjera të hartuara dhe të miratuara deri në Korrik të vitit 2009. Me ndryshimet e bëra gjatë rishikimit të kësaj Strategjie dolën edhe vendime dhe udhëzime tjera në shprehje të interesit përgjithshëm për energjinë e Kosovës.

Strategjia e Energjisë së Kosovës për periudhën 2009 – 2018 (Rishikim i asaj 2005 – 2015), e aprovuar me plotësim me 01 Prill 2010 nga Kuvendi i Kosovës, parasheh:

- Zhvillimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të furnizimit me energji në mënyrë që të gjithë konsumatorët të kenë qasje në furnizim eficient dhe të pandërprerë me energji, të një kualiteti adekuat.
- Ristrukturimi dhe zhvillimi i sektorit të energjisë në përputhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë, duke siguruar që legjislacioni mbi energjinë në Kosovë është në përputhje me Acquis Communautaire të Unionit Evropian për Energji.
- Zhvillimi dhe rehabilitimi i kapaciteteve të gjenerimit me djegie të linjitet, përfshirja e sektorit privat për të siguruar gjenerim të mjaftueshëm me energji elektrike për konsumin vendor, kapacitet rezervë dhe eksport.
- Zhvillimin e linjave të transmisionit për të siguruar furnizimin vendor dhe lidhjet me vendet fqinje.
- Zhvillimin e infrastrukturës së distribucionit për të zvogëluar humbjet në rrjetin distributiv.
- Promovimi i investimeve të huaja në sektorin e energjisë përmes restrukturimit të sektorit dhe sigurimit të një mjedisi rregullativ brenda kontekstit të tregut konkurrues.
- Optimizimi i shfrytëzimit të të gjitha resurseve energjetike, duke përfshirë resurset vendore apo të importuara.
- Promovimi i vetëdijes për mbrojtje mjedisore në aktivitetet energjetike, në përputhje me Acquis Communautaire për Mjedisin.
- Sigurimi i shfrytëzimit eficient të energjisë dhe promovimi i përdorimit të resurseve të ripërtëritshme të energjisë.

Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 17.12.2009 nr. 07/99 (shih shtojcën 3), rikonfiguron transaksionin për Termocentralin Kosova e Re dhe fushën e lignitit Sibovc, me këto komponentë:

- Ndërtimi i centralit të ri për gjenerim të energjisë elektrike "termocentrali Kosova e Re" me kapacitet fillestar të instaluar prej 500 MW me mundësi zgjerimi deri në 1000 MW dhe stabilimentet përkatëse të interkoneksionit.
- Zhvillimi i menjëhershëm i Fushës së Linjitet në Sibovc për të ofruar linjit për centralet ekzistuese në Kosovë (Kosova A dhe Kosova B) dhe njësitë e reja ekzistuese të termocentralit "Kosova e Re" kur të hyjnë në operim.
- Partecipimi i sektorit privat në termocentralin Kosova B.

Me të njëjtin vendim u kërkua të bëhet shprehja e interesit, ku do të përshkruheshin hollësitë e transaksionit, kriteret minimale për përzgjedhje, konkurrencë dhe synimet e Qeverisë për këtë transaksion.

Me datë 18 dhjetor 2009 u publikua shprehja e interesit, ku u kërkua nga aplikuesit që të dorëzojnë kredencialet e tyre për para-kualifikim deri më 29 janar 2010. Me datë 20 dhe 21 Janar 2010 u mbajt konferenca ndërkombëtare e investitorëve për këtë transaksion, ku kishte interes të theksuar të kompanive të ndryshme ndërkombëtare. Konferenca konsistonte në prezantime dy ditore, rreth mundësive për investime në Kosovë dhe vizitës në teren në kapacitetet ekzistuese të Gjenerimit të Energjisë Elektrike dhe në Mihje. Me datë 18 Shkurt 2010 është bërë shpallja e listës së ngushtë të ofertuesve të para-kualifikuar.




Me datë 01 Prill 2010, Kuvendi i Republikës së Kosovës aprovoi me ndryshime Strategjinë e Energjisë së Kosovës 2009-2018. Ndryshimet e miratuara me vendimin Nr. 03-V-272 të Kuvendit të Kosovës (shih shtojcën 4), njëherit dhe rekomandime të Komisionit Funkcional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, janë të theksuara si në vijim:

- Resurset e Linjitet të vihen të dispozicion dhe shfrytëzim në pajtim me kapacitetet e reja gjeneruese të energjisë dhe në harmoni me interesat zhvillimore të Kosovës.
- Të krijohet ambient ligjor për konkurrencë dhe treg të lirë në fushën e sektorit të energjisë.
- Sektori privat do të përfshihet në Rivitalizimin e TC Kosva B në kuadër të transaksionit "Kosova e Re".
- Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese të bëhet në bazë të interesit afatgjatë për Kosovës, në fazën e parë kapaciteti 1000 MW me mundësi të ndërtimit të kapaciteteve të tjera, në harmoni me kërkesat dhe bilancin energjetik të vendit dhe të rajonit, dhe
- Qeveria e Kosovës obligohet të harmonizojë Planin e Veprimit me Startegjinë e Energjisë për periudhën 2009 - 2018 të miratuar.

## PËRFSHIRJA DHE PËRKUFIZIMI I ZONËS

### Përfshirja e zonës

Në Mars të vitit 2009, me propozim të MEM-it (Ministrisë së Energjisë dhe Minierave), Qeveria e Republikës së Kosovës "Fushën e Mihjes së Re" e shpallë Zonë me Interes të Veçantë Ekonomik, me sipërfaqe tokësore prej 143 km<sup>2</sup>, si në hartën 1 të ndërtuar mbi kufijtë e zonave kadastrale.




Harta 1. Kufiri i propozuar i zones me faktorët ndikues hapësinor (Sip.143 Km2) : Burimi: PATEL / MEM

Kjo zonë e interesit të veçantë e FMR-së, për të cilën hartohet ky plan hapësinor, përfshinë më vete elementet dhe faktorët përcaktues hapësinor për të cilët nevojitet studime - hulumtime dhe analizë mbi ndikimet e tyre primare në mjedis nga aktivitetet ekzistuese dhe ato të planifikuara.

Faktorët apo elementët hapësinor, që rrethohen (përmbledhen) në një zonë të përbashkët, janë të listuar në vijim dhe paraqitur në hartat e më poshtme:

- Zona e ndikimit të Fushës së Re Minerare (e ashtuquajtura "C" apo me qendër Sibovcin) ka një hapësirë përafërsisht 16 km<sup>2</sup> për shfrytëzim;
- Lokacionet e TC-ve ekzistuese "Kosova A dhe Kosova B" si dhe opsionet për ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re;
- Korridoret për shiritat transportues dhe infrastruktura;
- Minierat ekzistuese dhe aktuale;
- Deponimet e jashtme të djerrinës të krijuara nga aktivitetet minerare në të kaluarën dhe të tanishme;
- Deponimet e krijuara të hirit nga dhe në afërsi të TC-ve "Kosova A dhe B" si dhe zonat nën ndikim të ri-ngritjes së pluhurit në ajër rreth këtyre deponimeve, dhe
- Zona përkufizuese (buferike) rreth faktorëve të cekur hapësinor duke përfshirë edhe korridoret e linjave të rrjetit të transmisionit dhe kanalit të ujit "Ibër - Lepenc".




Harta 2. Kufiri i përcaktuar i zones me faktorët ndikues hapësinor (sip. 150Km<sup>2</sup>) : Burimi: IPH / MMPH

Duke ju falënderuar punës së palodhshme të grupit të përbashkët punues (Grupit Punues Ndërmintor dhe zyrtarëve të IPH-së), që me daljen e tyre në teren me hartën bazë për shpalljen e zonës, definuan dhe përcaktuan vijën më evidentuese (vijën më vizuale dhe më të prekshme) të kufirit të zonës me sipërfaqe territoriale prej rreth 150 km<sup>2</sup>, si në hartën 2 për të cilën duhet hartuar këtë Plan Hapësinor.



## Përshkrimi i përkufizimit të zonës

Zona e FMR-së, siq dihet, shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës dhe zënë një sipërfaqe prej 14,986 hektarëve ose rreth 150 km<sup>2</sup>, e paraqitur si në hartën 3. Kjo zonë përfshinë sipërfaqe nga territoret e të katër komunave pjesëmarrëse të saj: Obiliq, Fushë Kosovë, Vushtri dhe Glllogvc.



Harta 3. Kufiri i zonës së FMR-së me sipërfaqe prej 150km<sup>2</sup>. - Burimi: IPH / MMPH

Kufiri fillon, në pikën më jugore të saj, nga fshati Sllatinë, në udhëkryqin e rrugëve Pejë – Prishtinë dhe Bellaqevc/Bardh – Magurë (rruga e vjetër për Aeroport) dhe shkon në drejtim të lindjes duke ndjekur rrugën M9 deri në dalje të qytetit të Fushë Kosovës, gjegjësisht në kuotat; X = 4722505.17 m', Y = 508997.04 m' dhe Z= 551.2 m'. Pastaj kufiri drejtohet nga veriu deri në trasenë e hekurudhës ku dhe e përcjell atë në drejtim të lindjes në gjatësi prej 1,352 m'. Përsëri, linja e kufirit duke përcjellë kufirin ndërkomunal Fushë Kosovë - Prishtinë, merr drejtim nga veriu duke kaluar në pjesën perëndimore të fshatit Orloviq dhe vazhdon përgjatë rrugës M2 duke i lënë shpatiet e Gazimestanit në të djathtë të saj, pastaj kalon përmes fshatit Llazarevë, Milloshevë deri në pikëtakim me kufirin ndërkomunal Obiliq - Vushtri. Nga kjo pikë (ura afër fshatit Babimoc), vija kufitare drejtohet nga perëndimi duke ndjekur rrjedhën e lumit Llap deri në pikën në mes dy fshatrave Stanovc i Ulët dhe Priluzhë. Kufiri më tej vazhdon dhe futet brenda vendbanimit Priluzhë deri në pikën ku takohet me binarët e hekurudhës të cilën e përcjell në drejtim të Mitrovicës deri në gjatësinë prej 1,400m. Nga këtu, kufiri i zonës së FMR-së rrethon zonat kadastrale si: Gllavotin (K. Vushtrrisë), Bibolak (K. Vushtrrisë), Zhilivodë (K. Vushtrrisë), Grabovc i Epërm (K. Obiliqit), Grabovc i Poshtëm (K. Fushë Kosovës), Vasilevë (K. Glllogvcit), Bellaqevc/Bardh i Madhë (K. Fushë Kosovës), Pomazotin (K. Fushë Kosovës), Bellaqevc/Bardh i Vogël (K. Fushë Kosovës) për të përfunduar përsëri në udhëkryqin e fshatit Sllatinë (K. Fushë Kosovës) duke i bërë ato pjesë të saj.

## GJITHPËRFSHIRJA NË HARTIM TË PLANIT

Në Vendim, me numër protokoll 02/57 të datës 13.03.2009, Qeveria e obligon Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor për hartimin e Planit Hapësinor për këtë zonë. Me këtë rast, si edhe për shkak të nevojës për hartim të këtij Plani, përveç zyrtarëve profesional në stafin e Institutit për Planifikim Hapësinor është themeluar edhe Grupi Punues Ndër-Ministror (GPNM), në përbërje fillestare me ekspertë nga MEM dhe MMPH. Që në fillim të procesit të hartimit të këtij Plani, ky grup punues zgjerohet edhe me përfaqësues nga sektorët tjerë përbërës të Qeverisë së Kosovës. Vazhdimi i punës së grupit gjatë këtij procesi e gjenë atë të ndarë në nëngrupe punuese, të caktuara sipas sfidave në fazën e parë, gjegjësisht sipas synimeve në fazat e mëvonshme. Grupet punuese vazhdimisht zgjerohen edhe më tej me kyçjen e pjesëmarrësve tjerë, përfaqësues jashtë qeveritar, nga grupe tjera të interesit në rolin e ekspertëve dhe të konsulentëve profesional.

Përveç kësaj, bazuar në parimin e gjithëpërfshirjes si dhe në kërkim të vazhdueshëm për të dhënat e duhura, bëhet ftesë për angazhimin e përfaqësuesve nga opinioni më i gjerë, me qëllim të involvimit dhe pjesëmarrjes më të hershme të tyre gjatë punës së grupeve punuese. Përfundimisht, në diskutimet e hapura konsultuese dhe shqyrtimet e organizuara publike, ipet mundësia e kyçjes edhe të përfaqësuesve tjerë si në skemën e paraqitur në fig. 1 në vijim, kur edhe arrihet plotësisht objektivi i synuar i gjithëpërfshirjes së palëve të interesuara.

### Skema – Kush është i përfshirë?




Figura 1. Skema e gjithëpërfshirjes në procesin e hartimit të Planit. – Burimi IPH / MMPH.

## QËLLIMI I HARTIMIT TË PLANIT

Zhvillimi i minierave të lartpërmendura dhe prodhimi i energjisë elektrike do të shkaktojë ndryshime dhe transformime të mëdha në strukturën hapësinore dhe demografike të zonës me interes të veçantë ekonomik Fusha e Mihjes Re. Përderisa, ndërtimi i Termocentralit Kosova e Re zgjatë për 4 - 5 vjet dhe shfrytëzimit të tij rreth 40 vjet, zhvillimi i minierës ndodhë të kalojë nëpër një proces më afatgjatë prej 4 - 5 dekadave, gjatë së cilës periudhë, me ndërhyrjen e aktiviteteve të shumta, do të ndryshojë shfrytëzimi aktual i tokës si edhe vetë peizazhi natyror. Me këtë Plan, përveç aktiviteteve minerare për eksploatim të linjtit, prodhim dhe furnizim të energjisë elektrike, jepen propozime për zhvillimet e ardhshme hapësinore si në aspektin e rehabilitimit mjedisor ashtu edhe atë social.

Hartimi i këtij Plani, bazohet në Raportin Final të Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Social (raportin e VSMS-së<sup>2</sup>) i përpiluar në kuadër të Projektit të Asistencës Teknike për Energji nga Linjiti (PATEL) në mbështetje të MEM-it. Aty, ipet përshkrimi i gjendjes ekzistuese sociale dhe mjedisore, vlerësohen efektet e projektit të propozuar dhe përbërësve të tij, bëhet identifikimi i ndikimeve nga skenarët e paraparë të zhvillimit si dhe propozohet plani i monitorimit dhe masat zbutëse për ato ndikime.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij Plani, i cili po hartohet nga institucioni me mandat ligjor (MMPH - IPH) në bashkëpunim me grupin punues ndërministror, është që, të ofroj bazën e projekteve për zhvillimin ekonomik të vendit në përgjithësi e të zonës me interes së veçantë në veçanti si edhe të informoj vendim-marrësit për mundësitë, opcionet dhe ndikimet e zhvillimeve në zonën e FMR-së.

Po ashtu, ky draft duhet të synojë dhe të definojë qartë:

- Implikimet hapësinore të ndërtimit të TC Kosova e Re dhe të zhvillimit të Minierës së Re (të fushës "C" ose të fushës me qendër fshatin e Sibovcit);
- Kornizën bazë të planifikimit hapësinor për aktivitetet e zhvillimeve në FMR që do ndërmerren nga Investitori përmes një Kompanie Private të Projektit;
- Masat zbutëse të planifikuara hapësinore në trajtimin e pasojave në mënyrë që të jenë të pranueshme për nga aspekti social dhe për mjedisin, dhe
- Udhëzimet që mund të shfrytëzohen për hartimin e planeve të zonave tjera të veçanta si dhe për komunitatet e përfshira në trajtimin e kësaj zone në planet e tyre të ardhme lokale: hapësinore, zhvillimore dhe urbane.

Plani Hapësinor për zonën e FMR-së është dokument, i cili promovon interesat e përbashkëta të banorëve të Kosovës, për një zhvillim më të shpejtë ekonomik, me qëllim të përmirësimit të kualitetit të jetesës, duke mbrojtur njëkohësisht resurset natyrore, biodiversitetin dhe trashëgiminë natyrore e kulturore.

<sup>2</sup> Për më shumë hollësi mbi procesin dhe rezultatet e procesit të VSMS-së, shih faqen elektronike të Projektit për Asistencë Teknike për Energji nga Linjiti: [www.lignitepower.com/sesa](http://www.lignitepower.com/sesa)



## BAZUESHMËRIA DHE PROCESI I PLANIFIKIMIT

Korniza Ligjore e Kosovës, për trajtimin, planifikimin dhe zhvillimin e zonës së energjetikes sigurohet përmes "Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor", ku sipas nenit 12 të këtij ligji, do të hartohen - Plane Hapësinore për Zona të Veçanta - të cilat kërkojnë një regjim të veçantë të organizimit, zhvillimit, destinimit dhe mbrojtjes. Po ashtu, pjesë e kësaj kornize, është edhe legjislacioni dytësor mbi "Procedurën e Diskutimeve për Planet Hapësinore dhe Urbane" si dhe Udhëzimi Administrativ mbi "Elementet e Themelore të Përmbajtjes së Planeve Hapësinore për Zona të Veçanta".

Planet hapësinore për zona të veçanta, hartohen nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) gjegjësisht Instituti për Planifikim Hapësinor (IPH), në rolin e bartësit dhe koordinatorit të projektit. Para finalizimit të Draft-planit për aprovim, MMPH-ja të njëjtin e vë në dispozicion, së paku për 60 ditë për shqyrtim dhe komente, si për publikun e gjerë ashtu dhe për institucionet tjera qeveritare si dhe për komunat pjesëmarrëse në zonë të interesit. Plani Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik 'Fusha e Mihjes së Re', pasi të jetë finalizuar edhe me rezultatet nga konsultimet publike, dorëzohet në Qeveri për aprovim paraprak dhe i cili hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës. Pas miratimit dhe publikimit në Gazetën Zyrtare të Kosovës, planet hapësinore për zona të veçanta, merren parasysh në planifikimet hapësinor të nivelin më të ulët - nga ai lokal/komunal.

Zhvillimi i parashikuar i sektorit të energjisë, përveç instrumentit ligjor të miratimit të Planit Hapësinor për Zonë të Veçantë, i nënshtrohet edhe Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor, sipas ligjit në fuqi për VNM-në. Bazuar në këtë dhe praktikën më të mira ndërkombëtare, për ndërtimin e termocentralit të parashikuar dhe zhvillimin minerar të nxjerrjes së linjitet si dhe në ndërlidhjet reciproke me çështjet mjedisore dhe sociale, duhet orientuar edhe kërkesat që ofrohen brenda dispozitave kontraktuese me Investitorin Privat.

### **Baza ligjore**

Duhet theksuar se baza ligjore në Kosovë është e përafuar në masë të kënaqshme me kornizën legjislative *acquis communautaire* të BE-së. Ky Plan bazohet në legjislacionin në fuqi në Kosovë si dhe në praktikën dhe standardet e mira ndërkombëtare. Gjatë hartimit të Planit, është respektuar baza ligjore nga sektori i Mjedisit, Energjisë, Minierave, legjislacioni nga sektorët tjerë relevant si dhe kompleksiteti i Udhëzimeve përkatëse të cilat burojnë nga këto ligje, si në vijim:

- Ligji për Planifikimin Hapësinor nr. 2003/14;
- Ligji për ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14 nr 03/L-106;
- Ligji mbi Mbrojtjen e Mjedisit nr. 03 / L - 025;
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës nr. 02 / L - 18;
- Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga ndotja nr. 03/ L - 160;
- Ligji mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis nr. 03 / L - 024;
- Ligji mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor nr. 03 / L - 015;
- Ligji mbi Mbeturinën nr. 02 / L - 30;
- Ligji mbi Ujërat nr. 2004 / 24;
- Ligji për Mbrojtjen nga zhurma nr. 02 / L - 102;
- Ligji mbi Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes nr. 063 / L - 043;
- Ligji për Veprimtaritë Hidrometeorologjike nr. 2006/02-L79;
- Ligji mbi Ndërtimin nr. 2004/15;
- Ligji për Energjinë nr. 2004 / 8;
- Ligji për Energjinë Elektrike nr. 2004 / 10;
- Ligji për Rregullatorin e Energjisë nr. 2004 / 9;
- Ligji për ndryshimin e Ligjit 2004/9 mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-080;
- Ligji mbi Minierat dhe Minerale Nr. 03 / L - 163;
- Ligji për Rrugët nr. 2003/11
- Ligji mbi Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr. 03 / L - 139;
- Ligji për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore nr. 03 / L - 154;
- Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural nr. 03 / L - 098;



- Ligji për Trashëgiminë kulturore nr. 02 / L - 88;
- Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura nr. 03 / L - 039;
- Ligji për Tokat Bujqësore nr. 02 / L - 26;
- Ligji për Kufijtë Administrativ Komunal nr. 03 / L - 041;
- Ligji për ndërmarrje publike nr. 03 / L - 087;
- Ligji për partneritet publiko-private dhe koncesionet në infrastrukturë dhe procedurat për dhënie të tyre nr. 03 / L - 090.

### **Baza institucionale**

**Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)** - është strukturë kryesore dhe pjesë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, në kuadër të kornizës institucionale, me kompetenca të qeverisjes dhe është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe të strategjive që rrjedhin nga ligjet bazike të të dy sektorëve - të Energjisë dhe të Minierave. Të gjitha vendimet, qëndrimet dhe studimet relevante, për këta dy sektorë, propozohen dhe ndërmerren nga kjo Ministri. Para së gjithash, hartimi i këtij dokumenti, është bazuar në Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës për periudhën 2009 - 2018 (rishikim i Startegjisë së Energjisë paraprake 2005 - 2015), të përgatitur nga MEM dhe të miratuar në Prill 2010 nga Kuvendi i Kosovës.

Në bashkërenditje me kompetencat e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, janë edhe dy agjenci të themeluara dhe të pavarura në cilësinë e rregullatorëve përgjegjëse për sektorë të energjisë dhe minierave.

**Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë)** - është institucion i pavarur, i themeluar me Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë Nr. 2004/9, i cili udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve të emëruar nga Kuvendi i Kosovës. Përgjegjësi e ZRRë-së është mbikëqyrja e tregut të energjisë, mbrojtja e konsumatorëve të Energjisë, licencimi i operatorëve energjetik, etj.

**Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM)** - Fillimisht, është themeluar me Rregulloren me Nr. 2005/2 të 21 Janarit, e cila më pas ndryshohet me Rregulloren e 29 Korrikut me Nr. 2005/38 dhe me Ligjin Nr. 03/L-81 të datës 13 Qershor 2008 ku përcaktohet për Agjenci e pavarur rregullative për sektorin e Minierave. KPM-ja, si agjenci e pavarur, që është në përputhje me nenin 119 (paragrafi 5.) dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, udhëhiqet nga Bordi i drejtorëve të zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës dhe ka nën përgjegjësi të vet licencimin e "Operatorëve Minerar".

**Korporata Energjetike e Kosovës (KEK Sh.a)** - është kompani e cila gëzon statusin ndërmarrje publike energjetike dhe është e licencuar për mihje sipërfaqësore të linjitet nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe për prodhim e furnizim me energji elektrike nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. KEK-u udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve të zgjedhur nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

**Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu (OSTT - KOSTT)** - është ndërmarrje publike energjetike, e licencuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë dhe ka statusin e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut me energji elektrike në Kosovë.

Përveç kornizës dhe infrastrukturës së përmendur ligjore e institucionale, hartimi i këtij Draft Plani Hapësinor për Fushën e Mihjes Re, bazohet edhe në shumë studime, hulumtime, raporte dhe plane të hartuara që më parë, të ndërlydhura me shtrirje hapësinore të projekteve për gjenerim të energjisë elektrike dhe zhvillim të minierës me aktivitetet tjera përcjellëse paralele.

**Planet, studimet dhe raportet** e ndryshme, të cilat marrë në konsideratë, që mbështesin zhvillimin e Termocentralit të Ri dhe të Minierës Re, janë:

- Plani Kryesor Xehetar për Minierën e Re të Linjitet të Sibovcit - në kuadër të FRM-së, përgatitur nga Vattenfall Europe Mining (VEM) dhe Deutsche Montan Technologie (DMT) në vitin 2005 [ose MMP 2005];
- Plani Plotësues Minerar për Minierën Jug-Perëndimore të Linjitet në Sibovc, përgatitur nga Konsorciumi STEAG në vitin 2006, [ose PPM-JP];
- Studime që Mbështesin Zhvillimin e Kapaciteteve të Reja Gjeneruese dhe Përcjellëse në Bartje - Kosova UNMIK-u - Task4 Zgjedhja e Vendit, përgatitur nga konsorciumi Pöyry, Cesi, Terna dhe Decon në vitin 2007;

- Raporti i Shqyrtimit të Terrenit për Projektin e Pastrimit dhe Ri-Kultivimit të Tokës (CLRP), përgatitur nga DMT/VEM/INKOS, Raporti Përfundimtar, Korrik 2008;
- Vlerësimi Strategjik Mjedisor dhe Social (VSMS) - Raporti përfundimtar mbi Opsionet e Zhvillimit të TC-së Kosova e Re dhe Minerës së Linjtit, përgatitur nga konsorciumi i udhëhequr nga ERM dhe mbështetur nga ELC Electroconsult dhe CSA Group, Nëntor 2008;
- Studimi i Parafizibiliteti për Furnizim me ujë të Termocentralit Kosova e Re të propozuar, nga Hidrosistemi "Ibër - Lepenc", përgatitur nga konsorciumi Becom, Enviros, Exergia, Tractabel Enginering dhe Cowi, Shkurt 2008;
- Korniza e Politikave për Zhvendosje të Vendbanimeve dhe Draft-Ligji për Eksproprijimin me Interes Publik, përgatitur nga Hunton & Williams dhe IPA Energy + Water Consulting në vitin 2008;
- Raporti i Hulumentit Social për Zonën e Studimit të PATEL, përgatitur nga Prism Research në Prill 2008;
- Hulumtimi Socio-ekonomik i Komuniteteve të Prekura, përgatitur nga Prism Research, Maj 2008;
- Konsultimi me Komunitete: Themelimi i Raporteve të Forumeve për Zhvillim të Komunitetit, përgatitur nga Fondi për Zhvillim të Komunitetit - CDF, Maj 2008.

Ndërsa, nga planet hapësinore dhe analizat hapësinore për komuna si dhe nga planet zhvillimore komunale dhe urbane, janë marrë në konsideratë:

- Plani Hapësinor i Kosovës 2010 - 2020+ (Rishikim i PHK 2005 - 2015+), përgatitur nga Instituti për Planifikimin Hapësinor (IPH) në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe në bashkëpunim me sektorët tjerë në Qeverinë e Kosovës.
- Analizat Hapësinore Komunale, për Vushtri dhe Obiliq, përgatitur nga IPH-ja dhe mund të gjenden edhe në faqen elektronike të MMPH-së: [www.rks-gov.net/mmph](http://www.rks-gov.net/mmph);
- Planet Zhvillimore Komunale dhe Urbane (PZhK-të dhe PZhU-të), për komunat: Drenas, Vushtri dhe Obiliq;
- Plani Zhvillimor Urban për Fushë Kosovë dhe
- Dokumentet tjera strategjike (Strategjitë dhe Raportet zhvillimore sektoriale dhe territoriale) që ndërlidhen me planifikimin dhe zhvillimin hapësinor.

### Sistemi i planifikimit në Kosovë




Figura 2. Skema e sistemit të planifikimit në Kosovë - Burimi: IPH / MMPH

Sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor, ndahet në dy nivele, në atë qendror dhe komunal / lokal. Siç shihet edhe në fig. 2, në nivelin qendror të planifikimit hartohen planet hapësinore si për tërë territorin e Republikës së Kosovës ashtu dhe për zonat e veçanta (me specifika të ndryshme). Kurse, në nivelin lokal / komunal, hartohen planet zhvillimore komunale dhe urbane si dhe ato rregulluese urbane.

### Procesi i planifikimit

Hartimit të Planit Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik "Fusha e Mihjes Re", duhet të kaloj nëpër disa faza, gjatë të cilave mund të dalin edhe vendime ose veprime të ndryshme gjatë zhvillimit të këtij procesi, deri në miratim të Planit, për më qartë shih fig. 3.

Me iniciativë të Ministrisë së Energjisë dhe Minerave (MEM) dhe në bazë të propozim-vendimit të saj për zonën energjetike, Qeveria merr vendim dhe shpall, Fushën e Mihjes Re për Zonë me Interes të Veçantë Ekonomik për vendin. Me këtë rast, Qeveria ka obliguar Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) konkretisht Institutin për Planifikim Hapësinor (IPH), që të hartoj Planin Hapësinor për zonën në fjalë. Pas hartimit të Planit dhe shqyrtimit publik, MMPH-ja e dorëzon në Qeveri, e cila pas aprovimit e dërgon në Parlament për miratim.




Figura 3. Skema e procesit të planifikimit (Procedura e hartimit të Planit) në Kosovë - Burimi: IPH / MMPH

Ky Plan Hapësinor për zonën me interes të veçantë ekonomik, është dokument Strategjik për sektorin e energjisë në Kosovë, dhe si dokument shtetëror i miratuar, paraqet arritje të madhe për vendin, në zbatim dhe përmbushje të Planit Hapësinor të Kosovës, që së bashku do të kontribuonin në Strategjinë e përgjithshme për Zhvillim të Qëndrueshëm të Republikës së Kosovës.

Rol të rëndësishëm në hartimin e Planit Hapësinor për zonë me interes të veçantë ekonomik kanë pasur edhe Institucionet Qeveritare. Grupi Punues Ndërmnistror (GPNM), i themeluar për hartimin e këtij Plani, i përbërë nga përfaqësues të Institucioneve të ndryshme ka marr parasysh strategjitë e ndryshme sektoriale, siç janë: Plani Hapësinor i Kosovës, Plani i Veprimit për Mjedis 2006–2010, Strategjia e Energjisë 2009-2018, draft-Strategjia Minerare e Kosovës, Strategjia për zhvillimin e qëndrueshëm

bujqësor dhe rural në Kosovë, dokumentet relevante mbi objektet dhe tërësitë e trashëgimisë natyrore e kulturore dhe të tjera.

Këtu analizohen strategjitë e të gjitha sektorëve që kanë ndërhyrje mes veti, qofshin ato në ndërlidhje të mirë bashkëveprimi (strategjitë sinergjike) apo të atyre që janë në kundërshtim (strategjitë konfliktuoze) me njëra tjetrën. E gjithë kjo, bëhet me qëllim të arritjeve më mira të mundshme, si në minimizim të konfliktit kundërtshënës ashtu edhe në priorizim dhe avancim të interesit bashkërendës, në përparim të zonës "Fusha e Mihjes së Re" si dhe të gjithë vendit.

## STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PLANIT

Dokumenti, Plani Hapësinor i zonën me interes të veçantë ekonomik 'Fusha e Mihjes Re', përbëhet nga pjesa tekstuale dhe ajo grafike. Në pjesën grafike hyjnë të gjitha llojet e ilustrimeve qofshin ato harta, figura (skema – grafikone), tabela dhe pamje apo fotografi.

Struktura dhe përmbajtja e PH "FMR", është hartuar sipas "Udhëzimit Administrativ për Zbatimin e Ligjit të Planifikimit Hapësinor – mbi Përmbajtjen e Elementeve Kryesore të Planit Hapësinor për Zona të Veçanta", Nr. 43 me Protokoll 04/05, i nxjerrë nga MMPH. Ky Plan, si në udhëzimin e cekur, paraqet gjendjen ekzistuese sociale dhe mjedisore me pasojat e shkaktuar nga aktivitetet minerare të nxjerrjes së linjtit dhe prodhimit të energjisë elektrike deri me tani si dhe gjendjen në bazë të parashikimeve për aktivitetet e njëjta në të ardhmen e po ashtu edhe të shfrytëzimit të tokës pas rehabilitimit të minierave të shtjerrura, dekomisionimit, demontimit dhe rregullimit të hapësirave për rreth termocentraleve.

Plani Hapësinor për Fushën e Mihjes Re, është i ndarë në pesë (5) faza dhe ka mundësi që të hartohet në një volum të vetëm me pesë kaptina (si në këtë rast) apo si një përmbledhje me pesë volume të ndara dhe atë sipas kësaj strukture:

- **Faza apo Kaptina 1** paraqet profilin hapësinor të zonës me interes të veçantë ekonomik FMR dhe përshkruan gjendjen ekzistuese mjedisore dhe sociale;
- **Faza apo Kaptina 2** paraqet vizionin e dëshiruar për zonën me parimet dhe synimet e këtij Plani;
- **Faza apo Kaptina 3** paraqet kornizën e propozuar për zhvillimet e ardhshme hapësinore të planifikuara;
- **Faza apo Kaptina 4** paraqet strategjinë e sugjeruar me masa, aktivitete dhe veprime për zbatimin e konceptit për zhvillimet e ardhshme, dhe
- **Faza apo Kaptina 5** paraqet rregullat dhe përgjegjësitë për zbatimin e strategjisë së propozuar për zhvillimin hapësinor të zonës.



# PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

# I

## 1. PROFILI DHE ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE


### 1.1. POZITA, KONTEKSTI DHE VEÇORITË NATYRORE - GJEOGRAFIKE

#### 1.1.1. POZITA GJEOGRAFIKE

Republika e Kosovës, bënë pjesë në Evropën Jug – Lindore, shtrihet në Gadishullin Ballkanik dhe ka pozitë qendrore në Ballkanin Perëndimor. Rrethohet nga katër shtete fqinje, duke u kufizuar: me Shqipërinë në Jug-Perëndim, Malin e Zi në Veri-Perëndim, Serbinë në Lindje dhe Veri si dhe Maqedoninë (IRFJ) në Jug. Sikur edhe në rajon, në territorin e Kosovës dhe në zona të ndryshme, shtrihen basene të linjtit, nga të cilat, me theks të veçantë potencohet baseni i Kosovës si më i madhi dhe gjendet në rrafshin e Kosovës.

Nga hartat e paraqitura në hartat 4, vërehet se, zona me interes të veçantë ekonomik “Fusha e Mihjes së Re” është pjesë e “Basenit të Kosovës” dhe përfshinë gati gjysmën e tij - në pjesën veriore.

**Hartat 4. Konteksti hapësinor: Baseneve të linjtit në Kosovë dhe Zona e FMR-së në Basenin Kosova.** Burimi: IPH / MMPH



Zona me interes të veçantë ekonomik (ZIVE) është e kufizuar me malet e Çiçavicës në veri-perëndim si dhe me rrugët magjistrale-kombëtare M9 (Prishtinë-Pejë) në jug dhe atë M2 (Prishtinë-Mitrovicë) në veri-lindje. Pjesa jugore dhe qendrore e zonës është e shënuar nga tokat e shfrytëzuara të minierave sipërfaqësore të Mirashit dhe Bardhit, deponitë e jashtme të zgjeruara të djerrinës, zonën industriale të lokacionit Kosova A, ndërsa në veri të mihjeve ekzistuese të linjitet shtrihet toka bujqësore.

Zona me interes të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes së Re", zë pozitë pothuaj qendrore në territorin e Republikës së Kosovës dhe është shumë afër kryeqendrës saj - Prishtinës, me rreth 150 km<sup>2</sup> (ose me saktësisht 14.986 ha), shtrihet në pjesën qendrore të rrafshit të Kosovës. Kjo zonë, me qendrën e saj në gjatësinë dhe gjerësinë të përafërt gjeografike prej 21°00' gjegjësisht 42°30', në aspektin administrativ shtrihet në katër komunat pjesëmarrëse: të Obiliqit (Kastriotit), Fushë Kosovës, Vushtrrisë dhe Gllgovcitet (Drenasit).

### 1.1.2. KONTEKSTI I ZONËS DHE PJESËMARRJA E KOMUNAVE

Shtrirja e zonës së interesit, në komunat pjesëmarrëse, shihet qartë në hartat si në hartën 5 dhe tabelën 1, të paraqitura si në vijim, me të dhënat e shprehura për secilën komunë në hektarë dhe përqindje.

Harta 5. Shtrirja dhe konteksti territorial i zones FMR me komunat - Burimi: MMPH /IPH




Tabela 1. Sipërfaqet (në hektarë dhe %) të kontekstit FMR - Komuna pjesëmarrëse. - Burimi: MMPH /IPH

Konteksti i sipërfaqeve, FRM - Komunë pjesëmarrëse, në ha dhe %				
Komunat	Sip.Totale (ha)	FMR në Komunë	Sip. në FMR (ha)	Komunë në FMR
Obiliqi	10.484	72.0%	7.566	50,5 %
Fushë-Kosova	9.522	49.0%	4.673	31,2 %
Vushtrria	34.485	5.1%	1.782	11,9 %
Gllgovci	27.568	3.5%	965	6,4 %
<b>Sipërfaqja totale e FRM-së</b>			<b>14.986 ha</b>	<b>100,0 %</b>

Kjo zonë, me shtrirjen e saj në perëndim të kryeqendrës – Prishtinës, për qendër aktuale të gjenerimit të energjisë elektrike në shkallë vendi ka komunën e Obiliqit, përderisa termocentralet Kosova A dhe Kosova B janë të vendosura në afërsi të qytetit – zonës urbane të saj. Minierat aktuale, në kuadër të kësaj zone, në Bardh dhe Mirash, kanë shtrirje më të madhe në komunën e Obiliqit dhe më pak në atë të Fushë Kosovës.

Deponitë e jashtme të djerrinës në jug të zonës së FMR-së, janë të vendosura kryesisht në komunë të Fushë Kosovës dhe pjesërisht në territorin komunal të Obiliqit gjersa deponia e jashtme në jug-perëndim të zonës, që është me lokacion në Vasilevë, ka shtrirje në territorin e komunës së Drenasit.

Ndërtimi i Termocentralit Kosova Re dhe hapja e Fushës Re për mihje sipërfaqësore, e ashtuquajtur Fusha me qendër fshatin Sibovc ose Fusha "C", do të ketë shtrirjen e ndikimit më të madh, kryesisht në komunën e Obiliqit dhe do të përfshijë rreth 13 % të territorit të saj, derisa në komunat e Fushë Kosovës dhe të Vushtrrisë kjo shtrirje është e pjesërishme.

Momentalisht, largimi i dheut apo djerrinës, për nxjerrjen dhe shfrytëzimin e linjtit, ka filluar të realizohet në cepin jug-perëndimor të saj nga ana e KEK-ut dhe është në komunën e Fushë-Kosovës në afërsi të fshatit Grabovc i Ulët. Ndërsa, zgjerimi afatgjatë i Minierës Re të linjtit, në kuadër të zonës me interes të veçantë ekonomik të FMR-së, pritet të orientohet drejt veriut që do të arrijë deri në territorin e komunës së Vushtrrisë, në pjesën lindore të fshatit Zhilivodë.

Lokacioni i Deponisë Rajonale Sanitare të Prishtinës, me shtrirjen e saj prej 50 hektarëve për përdorim 15 vjeçar, është e vendosur në pjesën veri-lindore të Minierës ekzistuese të Mirashit dhe ndikon në vendbanimet për rreth meqë zen pozitë qendrore në zonën e FMR-së.

Qendra e transformimit dhe e rrjetit të transmisionit të energjisë elektrike që shërben për transformimin e energjisë së prodhuar në tensione dhe rrjet adekuat bartës ose për shpërndarje. Kjo qendër nga e cila distribuohet energjia elektrike menaxhohet nga KOSTT sh.a. dhe gjendet në afërsi të zonës industriale të termocentralit Kosova B.


Kanali i ujit të Hidrosistemit "Iber – Lepenc" furnizon termocentralet Kosova A dhe Kosova B, me uje pa perpunar, nga liqeni akumulues i Ujmanit/Gazivodes. Ky kanal, që kalon nëpër zonën e FMR-së, shfrytëzohet nga shumë konsumatorë dhe bazuar në kapacitetin e mjaftueshëm të tij mund të furnizoj edhe Termocentralin Kosova e Re.



### 1.1.3. VEÇORITË NATYRORE DHE GJEOGRAFIKE

**Morfologjia dhe topografia e terrenit.** Baseni i thëngjillit në basenin e Kosovë mbulon sipërfaqe prej rreth 300 km<sup>2</sup>, me shtrirje të diagonales vertikale me mesatare në gjatësi prej 30 km nga veriu në jug dhe me një zgjerim mesatar në drejtimin lindje-perëndim prej 10 km. Morfologjia e Pellgut të Kosovës, formon luginën e zgjeruar, ku dallimet në lartësi mbi detare nuk janë më shumë se 80 metra. Një rrafsh qendror, që shtrihet përgjatë lumit Sitnicë, përcillet me një terren më kodrinor, që i afrohet maleve Çicavicë dhe Golesh në perëndim e gadi deri tek malet e Sharrit në jug-perëndim. Toka, në rrethinat e minierës, përdoret kryesisht për bujqësi, me disa pyje të vogla në pjesën jugore të pellgut.

Zona e "Fusha e Mihjes së Re" (FMR), si në hartën 6, gjendet mes luginës së lumit Sitnicë në lindje me lartësi mbidetare prej rreth +525 metra dhe një vargmal që zgjerohet në jug me lartësi mbidetare që shkon në +750 metra, kurse në anën perëndimore vazhdon të rrethohet me luginën e Lumit Drenica me lartësi mbidetare të shtrirjes prej rreth +550 metra.



**Topografia** aktuale e terrenit, në Fushën e Re të mihjes ose fusha "C", është një sipërfaqe kodrinore me ndryshime relative të lartësive mbidetare prej +550 deri në +670 metra. Gjegjësisht me shtrirje të fshatit Hade në jug deri në +656 m', të fshatit Lajthishtë në lindje dhe Shipitullë në perëndim deri në +666 m' si dhe të fshati Siboc, mbi Përroin me të njëjtin emër, në veri prej +560 metra lartësi mbidetare.

Veprimtaritë më të rëndësishme në këtë zonë nga këndvështrimi mjedisor janë minierat e thëngjillit dhe prodhimi i energjisë. Eksploatimi i linjtit, është duke u bërë që gati 100 vjet dhe operacionet e mëdha siç shihen sot me mihje sipërfaqësore dhe prodhim të energjisë elektrike kanë funksionuar që gati 40 vjet, pa ndonjë trajtim të veçantë për ndikimet në popullsi dhe mjedis.




Harta 6. Shtrirja e FMR-së në kuadër të basenit të thëngjillit Kosova. - Burimi: IPH / MMPH

**Gjeologjia dhe Hidrogeologjia.** Kosova si në hartat 7 dhe 8, e me të edhe zona e interesit të veçantë ekonomik, në aspektin hidrogeologjik, ndërtohet nga sedimentet e Paleozoikut, Mezezoikut (Kretaku, Jurasiku dhe Triasiku) dhe të Kenozoikut ( Terciari dhe Kuaternari).

Paleozoiku (Pz) - është i përfaqësuar me Rreshpet kristaline (që janë të përfaqësuara me argjiloshiste, filite dhe rrallë herë me rreshpe amfibolike) dhe Gëlqerorët kristalinë (që në shumicën e rasteve shtrihen mbi rreshpe, kurse pjesa më e vogël e tyre gjendet në mesin e serisë rreshpore). Gëlqerorët kristalin ndodhen në pjesën e skajshmen perëndimore të zonës, në anët lindore të Malit të Çiçavicës, janë të shpërndarë në formë të thjerrëzave të shumta. Në grupe të vogla gëlqerorët janë të silifikuar deri në atë masë sa me vështirësi dallohen nga filitet dhe kuarcitet. Në rreshpet kristalin dhe gëlqerorët kristalin deri më tani nuk është gjetur fauna dhe nga kjo çështja e moshës së tyre është mbetur e hapur.

Mezozoiku (Mz) - është i përfaqësuar nga Serpentinitet, Flishi i Kretakut të Sipërm dhe Gëlqerorët. Serpentinitet dhe Peridotitet paraqiten në disa zona të radhitura në drejtimin V-VP -dhe J-JL. Masa të vogla paraqiten edhe në JP të fshatit Sibovc, përkatësisht në vijën kryesore shkarëse përgjatë të cilës është formuar pellgu i Kosovës.


Kenozoiku (Kz) - është i përfaqësuar nga sedimentet e Terciarit dhe të Kuaternarit. Terciari (Tc), përfaqësohet nga shkëmbinjtë andezito - dacit dhe tufet, si dhe sedimentet e Neogjenit (Ng). Kuaternari (Q), në pjesën më të madhe është i përfaqësuar me rëra aluviale dhe zhavorre.



Hartat 7. Përbërja gjeologjike e Kosovës. Burimi: KPMM



Konstatimi i përgjithshëm i cili i takon problematikës së hidrogeologjisë, brenda territorit të zonës me interes të veçantë ekonomik, konsiston kryesisht në mbulesën e dheut, mbi dhe në vet shtresën e thëngjillit. Nga hulumtimet e shumta hidrogeologjike është konstatuar se ujërat nëntokësore takohen shumë afër sipërfaqes në thellësi nga 3 - 5 m. Janë ujëra me nivel të lirë (freatike). Është me rëndësi të theksojmë se gjatë punimeve për largimin e ujërave nga miniera e Mirashit dhe Bardhit, shpeshherë ka ardhur deri te shpërthimi i ujërave nëntokësore nga të çarat e shtresave të thëngjillit. Me shpime dhe punime minerare është konstatuar se ujëmbledhësi kryesor i ujërave nëntokësore janë aluvionet në të dy anët e lumit Sitnicë, si dhe aluvionet e lumit Drenicë.



Hartat 8. Përbërja hidrologjike e Kosovës. Burimi: KPMM<sup>3</sup>

<sup>3</sup> KPMM bazuar në të dhënat nga Instituti "Inkos" - Studim për VLERËSIMIN HULUMTIMEVE DHE REZERVAVE GJEOLGJIKE TË QYMYRIT NË KOSOVË 2007, në Prishtinë dhe Instituti i Xehetarisë, Fakulteti i Xehetarisë dhe Gjeologjisë në Beograd.

Pjesa më e madhe e kësaj zone është e mbuluar me humus të verdhë dhe ngjyrë hiri, e cila është e papërshkueshme nga uji e cila nuk lejon infiltrimin e ujërave sipërfaqësor deri në shtresat e thëngjillit, por pjesa më e madhe e ujit nga të reshurat rrjedh mbi sipërfaqe deri tek shtretërit e lumenjve të përmendur, si dhe në disa përroska me rrjedhje të përkohshme që ndodhen në këtë zonë.

Në aspektin hidrogeologjik, vëmendje e veçantë duhet kushtuar përbërjes litologjike dhe granulometrike të formacioneve aluviale, dhe vetive të tyre hidrologjike siç janë: koeficienti i filtrimit, bollëkshmëria e burimit, regjimi i nivelit të ujërave nëntokësor, kushteve të ushqimit të burimit, sasia e rrjedhjes së ujit në burim dhe vetive kimike të tij, etj.

Në pjesën e kontaktit mes formacioneve të Mezozoikut ( Jurasik, Triasik dhe Kretak ) dhe sedimenteve të Kuaternarit, kemi paraqitjen e disa burimeve natyrore të ujit. Këto burime takohen në pjesën perëndimore përgjatë strehës së maleve të Çiçavicës. Të tilla burime ndodhen në fshatin Shipitullë, Grabovc, Sibovc, Caravadicë (Palaj) dhe Zhilivodë.

**Klima.** Zona e FMR-së ju nënshtrohet ndikimeve klimatike nga pellgu i Sitnicës dhe ai i Ibrit. Ka mikroklimë me specifikat e veta në të cilën kanë ndikuar proceset kimiko teknologjike si rrjedhje e zhvillimeve nga industria energjetike. Proceset e emisionit dhe imisionit në këtë zonë kanë shtrirë ndikimin e tyre në aerosolet dhe elementet e tjera klimatologjike. Për shkak të proceseve kimiko teknologjike, zona në të cilën planifikohet të ndërtohet TC Kosova e Re ka një shkallë të lartë të lagështisë relative që variron nga 95% - 47%, përderisa kufijtë normal zakonisht janë prej 45 - 56%.

Temperatura e ajrit është e ndryshueshme ku vlera mesatare vjetore, shih fig. 4, është 10.2 °C (Celsius), ngaqë muaji më i ftohtë është Janari me -1.5 °C përderisa muaji më i nxehtë është Gushti me temperature mesatare vjetore në 20.5 °C. Amplituda vjetore e temperaturës së ajrit është 21.9 °C ku me vlerat ekstreme dhe me elementet tjera krijojnë klimën e regjimit kalimtar në mes të klimës mesatare kontinentale të ashpër malore, kur vjeshta është më e nxehtë se pranvera për 1.5 °C.




Figura 4. Grafiku i luhatjes së temperaturave mujore - Burimi: Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, 2004

Në regjimin e reshjeve atmosferike të kësaj zone dhe rrethinës, ndikim parësorë kanë aktivitetet ciklonike me prejardhje të ndryshme të cilat manifestohen gjatë rrugëtimit të masave ajrore me shkallë të lartë të lagështisë dhe të ftohta nga Atlantiku ndërsa ato të nxehtat nga Jugu nga hapësira Mesdhetare si dhe ato që depërtojnë gjatë dimrit si masa të ftohta të ajrit që vijnë nga Veriu dhe Veri-Lindja. Sasia e reshjeve ndryshon nga 670 - 810 mm<sup>4</sup>.

<sup>4</sup> Instituti Hidro-Meteorologjik i Kosovës ka prodhuar një studim më 1999 që shfaq të reshurat mesatare mujore për një periudhë 25-vjeçare. Instituti gjithashtu ka siguruar vlerat mujore për vitet që nga 1979 deri më 1995. duke shtuar vlerat e viteve 2001 deri më 2004 kjo bazë e shënimeve është zgjeruar duke mbuluar periudhën prej 25 vitesh (1979 - 2004). Baza e shënimeve është kompletuar me një vlerësim ekzistues për periudhën 1948 deri më 1978.



Sipas vlerave të dominimit të drejtimit të erës dhe qetësisë së tyre mund të konstatohet se qetësisë lajmërohen më së shpeshti kur nuk ka ndryshime të shtypjes atmosferike dhe tempe-raturës me 32.7%. Prej erërave më së shpeshti është era frontale nga Veri-Verilindja me 20.3% nga Veriu me 19.4% dhe ajo që lajmërohet më pak është era në drejtim të Lindjes me 4 % dhe nga Jugu me 5%. Era nga drejtimi Verilindje më së shpeshti lajmërohet në pranverë e më rrallë dimrit. Qetësia më e madhe e erës vërehet në muajin Gusht e më së paku në muajin Prill. Shpejtësia mesatare më e madhe e erës është matur gjatë muajit Mars në shumë vite dhe ka vlerën 3.2 m/sekondë, ndërsa më e vogla në muajin Shtator 1.8 m/sekondë.




Figura 5. Trëndafili Erës për Prishtinë. - Burimi: IHMK, 2004.

Trëndafili i erës, i paraqitur si në fig. 5, është punuar për pikën monitoruese pranë Institutit Hidro-Meteorologjik të Kosovës, mbi të dhëna të besueshme dhe është relevant sepse gjendet brenda rrezes pesë-kilometërshe nga qendra e zonës së FMR-së. Kurse, në të ardhmen, nga të dhëna e grumbulluara në stacione monitoruese të instaluar brenda zonës së FMR-së, do të kemi edhe trëndafilin adekuat për zonën e interesit.

Foto 1. Pamje e Prishtinës me pluhurin e sjellur nën ndikim të erës. - Burimi: IPH / MMPH



### 1.1.4. RREZIQET NATYRORE

**Sizmika** - Kosova i nënshtrohet lëvizjeve tektonike vertikale dhe është në një zonë aktive sizmike të shtrirë përgjatë Rripit Orojenik - Alpine - Himalaje. Në hartën e më poshtme, si në hartën 9, paraqiten zonat me shkallë sizmike në Kosovë bazuar në magnitudat që janë vëzhguar deri me tani me epiqendrat e tërmeteve të regjistruara gjatë periudhës një shekullore. Regjistrimet historike tregojnë se kanë ndodhur 534 tërmete, prej tyre 82 të intensitetit më të madh se 6° MSK (kategori sipas shkallës së Merkalit), 12 të intensitetit >7° MSK, 10 të intensitetit >8° MSK dhe 3 të intensitetit >9° MSK.




**Harta 9. Pozita e FMR-së, në zonën sizmike me intensitet 7° MSK sipas tërmeteve të regjistruara, në Kosovë.**  
Burimi: Instituti për sizmikë në MEM dhe IPH/MMPH

Çdo ndërtim i ri, në të ardhmen, në zonën e interesit të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes së Re", duhet të jetë i përshtatur me normat dhe standardet ndërtimore për zonat sizmike me mbi 7° MSK. Zona e FMR-së shtrihet në zonën sizmike që për 95 vitet e ardhshme pritet të goditet nga tërmeti që do të shkaktonte akceleracion - nxitim të truallit në intervalin e vlerave 0.06 - 0.08 g, sipas hartës së fundit të Rrezikut Sizmik për territorin e Kosovës.



**Vërshimi dhe erozioni** - Shtrirja e vërshimeve më të theksuara në zonën me interes të veçantë "Fusha e Mihjes së Re", të paraqitura si në hartat 10, janë problem i vazhdueshëm në këtë zone territoriale. Vërshimet e sipërfaqeve tokësore shkaktohen më së shpeshti nga dalja e lumit Sitnicë nga shtrati dhe janë evidente, sidomos në periudhën kohore kur edhe probabiliteti i reshjeve të shumta ose të zgjatura është më i madh - nga Nëntori deri në Mars. Analizuar në tërësi, gjendja e tanishme e mbrojtjes nga veprimet e dëmshme të ujit nuk është e volitshme. Infrastruktura mbrojtëse (arginaturat, veprat tjera rregulluese, pritat ose biokulturat për mbrojtje nga erozioni dhe rrëketë), edhe ashtu pjesërisht e trajtuar më parë, viteve të fundit ka pësuar dëmtime të mëdha.




Hartat 10. Shtrirja e vërshimit të lumenjëve (majtas) dhe nivelet e erozionit (djathtas) në zonën FMR-së. - Burimi: IPH/MMPH sipasa Atlasit Hidroekonomik të Kosovës.



## 1.2. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE

### 1.2.1. SHFRYTËZIMI I TOKËS




**Harta 11. Sipërfaqet në shfrytëzim dhe nën pronësi të KEK-ut. - Burimi: KEK / Divizioni Qymyrit**

Në kuadër të zonës është me rëndësi të dihet pjesëmarrja e pronësisë së tokës. Në hartën 11, janë paraqitur sipërfaqet nën shfrytëzim dhe në pronësi të KEK-ut, të cilat përbëjnë pothuajse rreth 20% të sipërfaqes së përgjithshme. Kurse, pronësia e pjesës tjetër të sipërfaqes brenda zonës, është private dhe publike, që ndryshon nëpër komunat pjesëmarrëse.

Komuna e Obiliqit, është komuna më e ndikuar nga gjenerimi i energjisë elektrike, mihjes sipërfaqësore, deponimeve të hirit dhe të djerrinës si dhe zhvendosjes së vendbanimeve, ka nën shfrytëzim dhe pronësi private 54 % (ose me 5.683 ha) të sipërfaqes së tokës, kurse nën pronësi dhe menaxhim publik janë 4.809 ha (ose 46 %), nga e cila KEK-u posedon 15 %.

**Shfrytëzimi i tokës** për zonën e interesit në fjalë, ka rëndësi të madhe dhe nënkupton destinimin e sipërfaqeve apo llojin e nxënies së hapësirës, gjegjësisht të sipërfaqeve tokësore nën renditje të sektorëve nga të cilët shfrytëzohen ato. Madhësia e vlerave të renditura, të shprehura në hektarë ose përqindje, paraqesin raportin ndërsektorial (p.sh. shtrirja e zonës industriale ndaj zonës së vendbanimeve apo nxënies së sipërfaqes nga zonat e ndërtuara; kundruall sipërfaqeve me tokë bujqësore e pyjore; etj). Informata e tillë, përveç që nxjerrin shfrytëzuesit më prioritar me ndikim dhe ata të ndikuar, do të shërbej edhe për krahasimin e vlerave sipas destinimeve, të atyre ekzistuese fillestare me ato në të ardhmen nga strategjia e realizuar pas përfundimit të planit/ projektit.



Harta 12. Shfrytëzimit të tokës në zonën e FMR-së. - Burimi: IPH / MPPH

Nga harta 12 dhe tabela me grafikun 2 e paraqitur në vazhdim, vërehet se toka bujqësore ka rol dominues në aspektin e shfrytëzimit të tokës, pastaj vijnë me radhë tokat pyjore dhe zonat e ndërtuara apo banimi/vendbanimet, palosjet e djerrinës, minierat e shfrytëzuara etj.



Shfrytëzimi tokës në FMR	Sipërfaqja	(%)
Zona me potenciale bujqësore	8.080 ha	55
Zona me Pyje	2.325 ha	16
Zona e Banimit / vendbanimet	1.737 ha	11
Palosjet e jashtme të djerrinës	1.320 ha	8
Zona e Minerave në shfrytëzim	1.061 ha	7
Deponitë e hirit nga Kosova "A dhe B"	272 ha	2
Zona Industriale - TC Kosova 'A' dhe 'B'	191 ha	1
<b>Gjithsejtë:</b>	<b>14.986 ha</b>	<b>100</b>





Tabela me grafikun 2. Shfrytëzimi tokës në zonën e FMR-së. - Burimi: IPH / MMPH

**Zonat me potenciale Bujqësore** - Bujqësia, nga të dhënat sipas tabelës 2 dhe grafikut 2, është shfrytëzimi dominues i tokës në FMR. Tokat bujqësore zënë 55% ose 8 080 ha të territorit dhe kryesisht përdoret për kultivimin e grurit dhe misrit, por edhe perime në sipërfaqe më të limituar. Tipi i tokës është vertisole me përmbajtje të argjilës, kurse tokat pjellore të shprehura sipas bonitetit janë të paraqitura si më poshtë, në hartën 13.

Gjatë sezonit të verës dhe periudhave të thata është e pafavorshme për shkak të çarjeve vertikale. Shfrytëzimi aktual i plehrave kimike dhe agro-kemikaleve është i ulët për shkak të çmimit të lartë dhe shumë fusha kanë mbetur të papunuara.



**Zonat me pyje** - Pyjet, në zonën e FMR-së, zënë territor prej 2.325 ha ose marrin 16% nga sipërfaqja e tërësishme e saj. Në pjesën perëndimore të kësaj zone shtrihen pyje të ulëta që mbulohet nga brezi i pyjeve kserotermofile dhe mezotermofile të dushqeve dhe lloje të tjera si: Shpardi - *Quercus Frainetto*, Qarri - *Quercus Cerris*, Shkoza e zezë - *Carpinus Orientalis*, Ahu - *Fagus Moesiaca*. Ndërsa, pjesa jug-perëndimore e zonës mbulohet dhe karakterizohet me një sipërfaqe të pyjeve të ngritura me anë të pyllëzimeve, kryesisht me Hartina - *Pinus Silvestris* dhe pisha e zezë - *Pinus Negra*. Kryesisht janë pyje të ulëta të degraduara.

Harta 13. Shtrirja e klasave të tokës bujqësore<sup>5</sup> në zonën e FMR-së. - Burimi: IPH / MMPH sipas UN FAO

<sup>5</sup> Bazuar në nomenklaturën dhe kriteret e Organizatës e Kombeve të Bashkuara për Bujqësi dhe Ushqim - UN FAO.

**Vendbanimet / Banimi** - Hapësirat e ndërtuara, për nevoja strehimi apo veprimi të popullatës, në vendbanime në kuadër të zonës së FMR-së, zënë rreth 11% të sipërfaqes së tërësishme të kësaj zone gjeografike shtrihen në 1.702 ha. Qyteti i Obiliqit dhe ai i Fushë Kosovës janë dy qendra urbane dhe njëherit të dy qendrat komunale brenda zonës së FMR-së. Të gjitha vendbanimet tjera, të cilat gjenden në këtë zonë të interesit, janë kryesisht vendbanime të karakterit rural, pra janë fshatra të banuara me popullatë që mirren me veprimtari kryesisht bujqësore.

Vendbanimet në brendinë e zonës së Fushës Mihja e Re, në bazë të ndikimeve që kanë dhe mënyrës së veçantë të trajtimit që kërkohet, sipas grupit punues ndërministror ndahen, siç janë paraqitur edhe në hartën 14, në tri kategori:

### 1. Vendbanimet në fushën e re të mihjes - që obligohen t'i nënshtrohen procesit të zhvendosjes.

Këtu kemi të bëjmë me vendbanimet brenda fushës së re të mihjes, që ndikohen drejtpërdrejt nga zhvillimet e nxjerrjes së linjitit dhe avancimi i Mihjes dhe ato janë:

- Hade (me rreth 5.0 km<sup>2</sup> dhe 2.900 banorë) – K. Obiliq,
- Leshkoshiq (Lajthishtë me rreth 3.7 km<sup>2</sup> dhe 1.300 banorë) – K. Obiliq,
- Shipitullë (një lagjeja Krasniqi me rreth 1.0 km<sup>2</sup> dhe 100 banorë) jo e tërë – K. Obiliq dhe
- Sibovc (me rreth 7.5 km<sup>2</sup> dhe 2.020 banorë) – K. Obiliq.


**2. Vendbanimet në pika të nxehta - që preferohen t'i nënshtrohen procesit deri në zhvendosje.** Në këtë grup, kemi të bëjmë me vendbanimet që janë brenda trekëndëshit të ndikimeve degraduese (në mes të pikave të nxehta), që ndikohen direkt nga objektet për gjenerim të energjisë elektrike, deponitë e hirit dhe palosjet e jashtme si dhe nga avancimi i zhvillimeve minerare dhe deponi rajonale e mbeturinave dhe nënvizohen këto:

- Krusheci (apo Dardhishtë, me rreth 6.6 km<sup>2</sup> dhe 2.210 banorë) – K. Obiliq,
- Caravadica (apo Palaj, me rreth 7.1 km<sup>2</sup> dhe 1.150 banorë) – K. Obiliq dhe
- Lagjeja e Berishëve në Graboc të Poshtëm – K. Fushë Kosovë.

**3. Vendbanimet tjera në FMR - që ndikohen nga zhvillimet e pritura.** Këtu bëjnë pjesë të gjitha vendbanimet tjera brenda zonës me interes të veçantë të FMR-së, të cilat preken në mënyrë indirekte nga ndikimet, qofshin ato nga zhvillimet minerare, gjatë gjenerimit dhe transmisionit të energjisë elektrike, ndikimeve gjatë bartjes së linjitit apo të hirit, prej deponisë së mbeturinave dhe të palosjeve të jashtme etj, që duhet të gëzojnë trajtim dhe përkujdesje të veçantë nga institucionet e Qeverisë qendrore dhe të asaj lokale ku numërojmë këto:

- Obiliq i ri – Qendra Komunale (me 5.300 banorë) dhe Obiliq i vjetër (me 1.500 b.),
- Mazgit i Poshtëm dhe i Epërm – K. Obiliq (me 3.000 b.),
- Milloshevë - K. Obiliq (rreth 1.500 b.),
- Plemetin – K. Obiliq (me 2.200 b.),
- Hamidi – K. Obiliq (me 300 b.),
- Graboc i Epërm – K. Obiliq (me 760 b.),
- Shipitullë – K. Obiliq (pjesa e mbetur, rreth 600b.)
- Fushë Kosova – Qendra Komunale.
- Nakaradë – K. Fushë Kosovë,
- Lismir – K. Fushë Kosovë,
- Kuzmin – K. Fushë Kosovë,
- Vragoli – K. Fushë Kosovë,
- Bardh i Vogël – K. Fushë Kosovë,
- Pomazotin – K. Fushë Kosovë,
- Bardh i Madh – K. Fushë Kosovë,
- Graboc i Poshtëm – K. Fushë Kosovë,
- Bivolak – K. Vushtrri,
- Zhilivodë – K. Vushtrri,
- Gllavatin – K. Vushtrri,
- Prilluzhë – K. Vushtrri,
- Vasilevë – K. Gillogoc





Harta 14. Vendbanimet në zonën e FMR-së - Burimi: IPH / MMPH

**Zonat e palosjeve të jashtme të djerrinës** - Largimi substratit të sipërme dhe shtresave tjera të dheut, për zbulimin dhe nxjerrjen e linjtit, ka për rezultat krijimin e një sipërfaqe të madhe të palosjeve të djerrinës duke degraduar sipërfaqe të konsiderueshme të tokës kryesisht bujqësore. Rreth 8% të sipërfaqes së tërësishme të FMR-së apo 1.320 ha janë sipërfaqe të mbuluar me këto palosje të jashtme. Sipas skemës së përgatitur, nga KEK-u, si në fig. 6, së shpejti fillon edhe realizimi i Projektit për PRT.




Figura 6. Skema e shtrirjes së palosjeve të jashtme dhe minierës ekzistuese në zonës s FMR-së. - Burimi: KEK

**Zonat e minierave ekzistuese** - Mihjet ekzistuese të hapura të linjtit në Bardh dhe Mirash (foto 2), zënë sipërfaqe prej 1.061 ha ose 7 % nga territori i përgjithshëm FMR-së, zonës me interes të veçantë ekonomik dhe operojnë që nga viti 1963/64. Tash për tash këto dy miniera furnizojnë dy termocentralet me përafërsisht 7 milion tonelata linjit të nxjerrë në vit. Në kuadër të kësaj zone gjendet edhe Deponia rajonale sanitare e mbeturinave. Që nga viti 2006 në pjesën e aktiviteteve të kryera të minierës së Mirashit është ndërtuar deponia rajonale dhe ka filluar të shfrytëzohet hapësira për deponimin të mbeturinave urbane të Komunave të Prishtinës, Obiliqit, Fushë Kosovës, Podujevës dhe Lipjanit. Në kuadër të këtij aktiviteti nuk bëhet seleksionim dhe riciklimi i materialit të mbeturinave.



Foto 2. Pamje nga miniera ekzistuese e Mirashit - Burimi: Divizioni i Qymyrit / KEK

**Deponitë e hirit.** - TC-të Kosova A dhe B gjenden në një zonë të rrafshët të luginës së lumit Sitnicë. Secili TC ka nga një deponi të madhe hiri të cilat janë çështje me ndikim mjedisore. Deponia e hirit të Kosovës B është e konsoliduar ndërsa nga vitit 2006 hiri i freskët, prej prodhimit, në mënyrë hidraulike bartet në ish minierën e Mirashit. Deponia e hirit të Kosovës A, si në foto 3, është duke u zgjeruar në drejtim jugor dhe po ashtu planifikohet bartja e hirit të freskët nga ky termocentral, në mënyrë hidraulike në minierën e Mirashit. Siperfaqja e përgjithshme e pjesmarrjes së deponive të hirit, në zonën e FMR-së është 2 % apo 272 Ha.



Foto 3. Pamje nga deponitë e hirit të TCA - Burimi: IKMM / MMPH



**Zonat Industriale - Gjenerimi i energjisë elektrike** - Lokacionet e TC-ve 'Kosova A' dhe 'Kosova B' (foto 4) janë zonat e vetme me rëndësi industriale në këtë hapësirë. Poashtu në kundër të këtyre zonave në afërsi të TC Kosova A gjenden edhe Repartet e Gazifikimit, Ngrohjes Industriale, Tertoret, Separacionet dhe ato për prodhimin e Plehrave Artificiale të cilat janë lënë jashtë përdorimit më se dy dekada më parë. Sot ato paraqesin një problem të madh mjedisor për shkak të kontaminimit kryesisht me fenolë dhe substanca tjera.

Të gjitha këto lokacione industriale prezente me të gjitha stabilimentet përcjellëse, në sipërfaqen e përgjithshme të FMR-së zënë vetëm 1% të sajë apo 191 Ha.



Foto 4.. Pamje e termocentralit Kosova B - Burimi: IPH/MMPH

## 1.2.2. MJEDISI

### Ajri

Burimet e ndotjes së ajrit në tërë Kosovën janë të dhëna në dokumentin "Kadastri e ndotësve të ajrit"<sup>6</sup>, ndërsa për zonën e FRM-së, burime të ndotjes së ajrit konsiderohen aktivitetet nga mihjet sipërfaqësore të minierave në shfrytëzim, termocentralet, deponitë e hirit të krijuara nga djegia e thëngjillit, vetëndezja e thëngjillit në miniera, ndotja nga trafiku lokal dhe nga sistemi i ngrohjeve. Poashtu jo larg nga kjo zone gjendet edhe miniera dhe shkretorja e Feronikelit, e cila konsiderohet si ndotës potencial. Rreth 30 km në veri të zonës shtrihet edhe kompleksi i minierës "Trepça" si një ndër burimet e ndotjes. Këto burime të ndotjes emitojnë kryesisht këta ndotës: SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, CO, CO<sub>2</sub>, grimcat të suspenduara në ajër, metale të rënda (Pb, Zn, Cr, Ni, Cd, Mn) etj.

Erërat dominuese, në zonën e interesit vijnë nga V-VL bazuar në grafikun "Trëndafili i Erës" për Prishtinën, të cilat kanë për rrjedhojë ndikimet në fshatrat në drejtim J-JP, si më të prekurat nga emetimet e TC Kosova A dhe Kosova B, deponitë e hirit dhe aktivitetet e mihjeve.

Të dhënat e besueshme mbi cilësinë e ajrit në zonën e interesit janë të kufizuara dhe jo-sistematike. Dy stacione monitorimi janë të pranishme në zonë, një në qytetin e Obiliqit dhe tjetri në Institutin INKOS, në afërsi me TC Kosova A, por këto matin vetëm SO<sub>2</sub>, blozën dhe PM<sub>10</sub>. Nuk ka matje të vazhdueshme mbi NO<sub>x</sub>-in. KEK-u, nëpërmjet INKOS-it merr mostrat nga depozitimi i pluhurit në afërsi të ish-objektit të separacionit afër TC Kosova A dhe mihjes së Bardhit.

Instituti INKOS, bënë matjet dhe paraqet pasqyrën mbi gjendjen mjedisore në disa pika të përcaktuara, gjegjësisht përqendrimin e imisioneve (ndotësve kryesor) në ajër, përfshirë SO<sub>2</sub>, blozën, thërmijet ajrore dhe pluhurin e depozituar (sedimentet), të cilat raportohen tek KEK-u. Në vazhdim, janë paraqitur vlerat mesatare vjetore për vitet 2002 - 2005, si në tab. 3 në vijim, sikurse edhe ato mujore për vitet 2006, 2007 dhe 2008 si në tab. 4 më poshtë.

Mesatarja vjetore në pikat matëse të emisioneve gjatë 2002 - 2005											
Emetuesit dhe viti	INKOS	Kastriot	Bardh	Separacion	TC B	Dardhishtë	PML				
SO <sub>2</sub>	2002	18.36		Pa stacion matës	Pa stacion matës	Pa stacion matës	110 µg/m <sup>3</sup>				
	2003	11.48	80.86					20.15			
	2004	11.00	58.40					24.00			
	2005	13.26	33.80								
Bloza	2002	12.10					10.05	50 µg/m <sup>3</sup>			
	2003	9.87	25.25				10.56				
	2004	10.10	14.40				6.22				
	2005	18.48	22.31								
Grimcat e pluhurit në ajër	2002	85.13					119.04	150 µg/m <sup>3</sup>			
	2003	100.40	91.85				113.43				
	2004	56.80									
	2005	56.00									
Sedimenti / Pluhuri depozituar	2002	727.00					817.20	300 mg/(m <sup>2</sup> -d)			
	2003	1865.00	553.61				410.85		4093.50	583.90	
	2004	313.00	460.00				195.00		1518.16	694.00	1279.50
	2005	429.00	428.00							429.00	989.90

Tabela 3. Vlerat mesatare të imisioneve gjatë viteve 2002 - 2005. - Burimi: INKOS

<sup>6</sup> Burimi: Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit / MMPH



Bazuar në kriteret e lejuar afatgjatë për SO<sub>2</sub> – 110 µg/m<sup>3</sup> dhe blozë – 50 µg/m<sup>3</sup>, në ata afatshkurtër për SO<sub>2</sub> – 350 µg/m<sup>3</sup> dhe blozë – 140 µg/m<sup>3</sup>, e poashtu edhe ata momental për SO<sub>2</sub> – 500 µg/m<sup>3</sup> dhe blozë - 150 µg/m<sup>3</sup> si dhe në ata për 24 orë SO<sub>2</sub> – 500 µg/m<sup>3</sup> dhe blozë – 50 µg/m<sup>3</sup>, vlerat janë paksa më të favorshme për vitet 2006, 2007 dhe 2008.

Muaji	Imisioni mesatar i SO <sub>2</sub> dhe blozës (në µg/m <sup>3</sup> ) në pikat matëse për 2006, 2007 dhe 2008											
	SO <sub>2</sub>		Bloza		SO <sub>2</sub>		Bloza		SO <sub>2</sub>		Bloza	
	INKOS	Kastriot	INKOS	Kastriot	Kastriot	Bardh	Kastriot	Bardh	Kastriot	Bardh	Kastriot	Bardh
1	9.20	13.7	11.26	18.60	35.60	25.11	17.45	6.58	26.09	38.34	28.97	10.40
2	9.34	19.81	21.55	34.46	17.80	19.91	19.83	5.04	18.35	20.76	32.79	15.11
3	9.21	13.00	11.30	18.60	23.77	32.20	12.95	3.91	36.72	32.50	28.34	7.37
4	42.00	22.50	7.31	14.36	24.40	31.05	7.47	3.61	16.39	27.94	13.68	4.93
5	27.59	29.10	8.45	11.20	21.75	27.31	19.21	2.28	11.37	36.83	11.26	3.26
6		21.00		6.73	24.36	57.89	6.70	1.94	12.39	29.39	9.54	2.26
7		9.88		12.30	24.40	41.97	10.08	2.96	14.25	20.33	12.56	5.05
8		11.80		9.37	22.30	28.75	9.37	4.74	23.75	33.03	6.77	5.87
9		15.20		11.10	46.11	33.61	7.89	2.86	16.13	21.86	7.26	4.53
10		19.30		17.40	39.86	39.79	32.87	5.44	18.35	29.14	15.46	8.45
11		31.40		43.51	36.72	32.50	28.34	7.37	22.09	24.47	17.88	10.78
12		41.07		34.33	36.72	38.34	28.34	10.40	23.38	27.08	9.42	6.20
Mes.	19.46	20.7	11.97	19.33	29.48	34.03	16.7	4.76	19.93	28.47	16.16	7.01

Tabela 4. Vlerat mesatare të imisioneve gjatë viteve 2006, 2007 dhe 2008. - Burimi: INKOS


Sedimentet analizohen sipas standardit gjerman VDI drejtimi 2119 Blatt 2 (1972). Mostrat grumbullohen gjatë një muaji, kurse rezultatet shprehen në mg/(m<sup>2</sup>d). Mostrat e sedimentit krahas përcaktimit sasior të pluhurit, shfrytëzohen edhe për përcaktimin e materieve të tretshme dhe të patretshme, pH-së si dhe përmbajtja e klorureve dhe sulfateve të tretshme. Nga të dhënat prej raporteve del se: kriteret e lejuara janë tejkaluar disa herë, nga vlerat mesatare prej 300 mg/(m<sup>2</sup>d) për 3 - 4 muaj gjatë vitit si dhe pH-ja sipas OBSH-së, përderisa materiet inorganike dhe tretëse janë pjesë përbërëse e pluhurit total për periudhën 2006, '07 dhe '08.

Për përcaktimin e thërrmijave ajrore shfrytëzohet metoda gravimetrike e cila bazohet në përcaktimin e masës së thërrmijave ajrore nga pesë mostra e grumbulluar gjatë muajit nga filtrimi i sasisë së caktuar të ajrit. Nuk ka tejkalime të kriterëve të lejuara gjatë viteve 2002 - 2006, pos një herë më e theksuar në muajin dhjetor 2007 dhe 4 herë gjatë vitit 2008.

Të dhënat më të fundit në dispozicion të përdorura në VSMS që janë marrë nga Raporti Mjedisor i KEK-ut i vitit 2006, tregojnë ndotje të konsiderueshme që gjenden brenda standardeve evropiane, me përjashtim të depozitimit të pluhurit. Megjithatë, ato pak lokacione të marrjes së mostrave nuk mund të konsiderohen si pasqyrim i plotë i nivelit të vërtetë të ndotjes së ajrit të mjedisit tek receptorët e ndjeshëm, popullsia dhe vendbanimet. Gjatë konsultimeve publike me komunitetin dhe anketës së ekonomive familjare në këtë zonë gjatë hartimit të VSMS-së, nga pjesëmarrësit janë raportuar probleme të shumta në frymëmarrje dhe simptome tjera shëndetësore, të cilat i atribuohen ndotjes mjedisore.

Instituti hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) vazhdon të bëjë monitorimin e ajrit në Pikat Monitoruese, si në hartën 15, prej tyre: 9 në Mitrovicë, 1 në Prishtinë (lokacioni i IHMK-së) dhe 5 pika monitoruese në Drenas (2 në zonën rurale afër shkretës në fshatrat Qikatovë e Gllabar dhe 3 brenda zonës industriale të Feronikelit).

IHMK, nuk ka të vendosur asnjë stacion (pikë) monitorimi brenda zonës së FMR-së, përderisa i referohet të dhënave për cilësinë e ajrit nga pika monitoruese në Prishtinë. Në këtë pikë, matet NO<sub>x</sub>, SO<sub>2</sub>, bloza dhe grimcat e suspenduara, përderisa në kompleksin Feronikel maten grimcat e suspenduara dhe metalet e rënda.



Harta 15. Shtirja e pikave për monitorim të ajrit në Kosovë. - Burimi: IHMK

Në mungesë të rrjetit dhe pajisjeve të mirëfillta për monitorim të ajrit, IHMK nuk i monitoron të gjithë parametrat që merren si tregues i cilësisë së ajrit, sipas "Ligjit për mbrojtjen e ajrit", por vetëm koncentrimin e këtyre parametrave në ajër: SO<sub>2</sub>, blozën dhe aerosedimentin (Pluhuri total i depozituar, pH-ja, përçueshmëria elektrike, jonet sulfate, jonet klorure dhe metalet e rënda).




Figura 7. Grafiku i vlerave mesatare mujore të SO<sub>2</sub> në IHMK për 2005-2008. - Burimi: IHMK / MMPH



Rezultatet e vlerave mesatare vjetore dhe mujore së bashku me normat e lejuara sipas direktivës 99/30/EC për SO<sub>2</sub> (fig. 7) dhe blozë janë paraqitë me grafikone, ndërsa për aerosedimentin BE nuk ka normativë zyrtare.

Vlerat mesatare mujore të Blazës, në pikën monitoruese IHMK për periudhën 2005-2008, janë paraqitur në grafikun si në fig. 8 në vijim:




Figura 8. Grafiku i vlerave mesatare mujore të Blazës matur në IHMK 2005 -2008. - Burimi: IHMK

Kurse, vlerat mesatare vjetore të joneve sulfate, joneve klorure, pH-së dhe përçueshmërisë elektrike në pikën monitoruese IHMK, 2007/2008 dhe mund të shihen në grafikun në fig. 9.




Figura 9. Grafiku i vlerave mesatare vjetore të joneve sulfate, joneve klorure, pH-së dhe perqushmerise elektrike për 2007 dhe 2008. - Burimi: IHMK

## Uji

Vetë fusha e mihjeve mbulon gjashtë zona ujëmbledhëse të zonave më të vogla ujore; katër prej tyre që rrjedhin në drejtim të Lumit Sitnica në lindje dhe dy në drejtim të Lumit Drenica në perëndim. Përgjatë lumit Sitnica, shtrihet një fushë, që përmblytet me ujë në sezonën e reshjeve të mëdha në të cilën gjendet lokacioni i zonës industriale ku janë vendosur dy blloqet e TC-it "Kosova B".

Në zonën e interesit, veçanërisht Lumi Sitnicë është i ndotur nga shkarkimet në rrjedhën e mesme të tij nga shkarkimet urbane, e përveç tyre edhe nga efluentët nga termocentralet dhe mihjet e KEK-ut sh.a, të cilat shkarkohen direkt, pa ndonjë trajtim adekuat, si dhe rrjedhat e ujërave nga deponitë e hirit. Përveç këtyre, lumenjtë pranojnë vëllim të madh të materieve organike, pasi që nuk ka fare ose fare pak trajtim të ujërave të zeza. Të dhënat e përpiluara brenda VSMS-së mbi pikat e shkarkimit dhe marrjes së mostrave të cilësisë së ujit tregojnë që uji i Lumit Sitnicë duhet kategorizuar si Ujë i Klasit IV, sipas sistemit ish-jugosllav të klasifikimit (pra, "ujë që mund të përdoret vetëm pas një trajtimi special") dhe është larg nga standardet evropiane të cilësisë.

Shfrytëzuesit më të mëdhenj të ujit sipërfaqësor janë TC- Kosova A dhe B, duke shfrytëzuar dhe lumin Llap . Megjithatë, nuk ka analiza të mjaftueshme mbi trajtimin e ujërave shkarkues. Furnizimi me ujë të rëndomtë të TC Kosova e Re është shqyrtuar në kuadër të një studimi të veçantë për furnizim me ujë nga Hidrosistemi Ibër.

**Ujërat sipërfaqësore.** Burimet kryesore të ujërave sipërfaqësor, në zonën "FMR-së" e që i takojnë pellgut Detit Zi, janë lumi Sitnica dhe lumi Drenica, si dhe disa përroska më të vogla me rrjedhje të përhershme dhe të përkohshme.

Lumi Sitnicë, është degë e Lumit Ibër, i cili prej burimit e deri te vendi i shkarkimit në lumin Ibër, afër Mitrovicës, është i gjatë 90 km, me prurje mesatare 15 m<sup>3</sup>/sek<sup>7</sup>. Është lumë fushor me pjerrtësi të vogël, me shtrat të gjerë, të cektë dhe me gjarpërime, veçohet me prurje të vogla vjetore të ujit. Gjatë stinës së Verës nuk ka prurje më të madhe se 2.5 m<sup>3</sup>/sek, kurse gjatë stinës së dimrit dhe në pranverë, kur bëhet shkërrja e bores, kjo prurje është 15 herë më e madhe, përkatësisht 37.5 m<sup>3</sup>/sek. Gjatë prurjeve të mëdha të ujit, lumi Sitnica del jashtë shtratit dhe përmblytet sipërfaqe të tokave punuese për rreth, duke i shkaktuar dëme të mëdha bujqësisë. Sitnica konsiderohet edhe si ujëmbledhësi më i madh i rrafshit të Kosovës në të cilin shkarkohen lumenjtë: Drenicë, Llap, Prishtevkë, Graçankë, Janjevkë, Trepçë si dhe disa procka me pak ndikim. Ndotësi më potencial i këtij lumi është KEK-u, dhe ujërat nga amvisëritë, të cilat shkarkohen direkt në lumë pa u trajtuar.



Foto 5. Pamje nga vërshimi i zonës në afërsi të TC Kosova A. Burimi: IPH / MMPH, 2005

<sup>7</sup> Sipas Master Planit të Ujrave të Kosovës, 1983-2000



**Aluvionet e Lumit Sitnica.** Tarracat e aluvioneve të lumit Sitnica kanë shtrirje të rëndësishme hapësinore përgjatë rrjedhjes së tij, dhe burimet e dala në formimet e tyre. Mund të jenë të rëndësishme për furnizimin me ujë të pijes, bujqësisë dhe industrisë së kësaj zone.

Trashësia e sedimenteve është e ndryshme, ashtu që në afërsi të Vushtrrisë sillet deri në 10 m, përderisa në tërë sipërfaqen e Lypjanit arrin trashësinë deri në 15 m, ndërsa në afërsi të fshatit Batusë trashësia shkon deri 33 m. Sipas të dhënave që kemi, burimet afër Vushtrrisë që janë bërë në punime hulumtuese është konstatuar thellësia 2.7 - 7.7 m, gjatë se cilit niveli i tij është i lire dhe ka një nivel prej 2.2 m, të Lypjani është konstatuar në thellësinë 16.6 - 28.6 m, niveli ujëmbajtës arrin në 4.78 m, prej sipërfaqes së tokës. Ndonjë hulumtim me detal i këtij tereni nuk është bërë në këto aluvione.

**Trajtimi i Ujërave të ndotura**

Nuk ka as një sistem për trajtimin e ujërave të ndotura, të gjitha ujërat shkarkohen pa u trajtuar në lumin Sitnicë. Ujërat e zeza nga vendbanimet brenda zonës së FMR-së, në mungesë të rrjetit të kanalizimit shkarkohen përmes kanaleve të hapura në ujë rrjedha, gjë e cila rezulton me ndotjen e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësorë.

Kontrollin dhe monitorimin e shkallës së ndotjes të lumit Sitnica, bëhet nga IHMK dhe INKOS-i përmes një rrjeti monitorues me rreth 17 pika<sup>8</sup>.


Termocentralet ekzistuese posedojnë pajisje për trajtim të pjesërishëm të ujërave të ndotura industriale përderisa minierat nuk kanë kurrfarë pajisje për një trajtim adekuat.

Disa parametra të disa lumenjve kalojnë vlerat maksimale të lejuar sipas standardeve të Bashkimit Evropian për cilësinë e ujit të lumenjve. Shumë nga lumenjtë e rëndësishëm kanë treguar shenja ndotjesh të mëdha nga lëndë organike, ato kanë deficit në oksigjen të tretur me nevoja të larta kimike për oksigjen ( COD) dhe oksigjen biologjik ( BOD).

**Cilësia e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore**

Nga të dhënat ekzistuese për cilësinë e ujërave sipërfaqësor të marra nga IHMK-ja (Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës), mund të themi se gjendja nuk është e kënaqshme sepse ka tejkalime të vlerave maksimale të lejuara. Matjet analizohen për secilin lumë në hyrje dhe në dalje të lumit dhe në bazë të tyre përcaktohet cilësia e ujit. Sipas sistemit monitorues të IHMK-së dhe INKOS-it, ujërat e sipërfaqësorë në këtë zonë janë të ndotur si rezultat i proceseve kimiko-teknologjike dhe ujërave të pa trajtuar.

Ujërat nëntokësorë, në përgjithësi janë të një cilësisë të mirë në burim. Megjithatë, cilësia e tyre monitorohet nga INKOS përmes 5 pikave monitoruese të instaluar brenda zonës së interesit të veçantë. Matja e cilësisë së ujit nëntokësorë bëhet në baza mujore.



**Harta 16. Kategorizimi lumenjve sipas shkallës së ndotjes. Burimi: DU / MMPH**

<sup>8</sup> Raporti 2003, INKOS dhe Raporti Statistikor Vjetor 2008, IHMK

## Toka

Lloji i tokës që dominon në zonën e FMR-së janë toka vertisole, të cilat janë bazë e prodhimit të bujqësore. Brenda zonës së interesit të veçantë ekonomik, disa hapësira të tokës janë mbuluar me djerrinë të depozituar nga aktivitetet e mëhershme mihëse dhe deponitë e hirit të termocentraleve.

Aktualisht, ndikimi mjedisor nga bujqësia është i pranishëm për shkak të përdorimit të plehrave artificiale dhe pesticideve. Me zhvillimin e ekonomisë rurale, përdorimi i plehrave dhe pesticideve sigurisht se do të shënojë ngritje. Njëkohësisht, nuk ka shumë ndotje nga industria për shkak të mungesës së aktivitetit industrial. Megjithatë, lokacionet e mëparshme të industrisë së rëndë mbeten burim i ndotjes mjedisore, meqë ato janë ende të kontaminuara me ujëra të ndotura me mbetje të metaleve dhe materie të ndryshme kimike, të cilat janë duke rrjedhur në sipërfaqe dhe ujëra nëntokësore. Sa i përket ndikimit në pejsazh, janë shtatë deponi me lokacion në veriperëndim, jugperëndim, jug dhe juglindje të mihjeve të Bardhit dhe Mirashit, të cilat mbulojnë një sipërfaqe prej rreth 15 km<sup>2</sup>. Dëmtimet mjedisore të shkaktuara nga deponitë e vendosura jashtë fushave të mihjes ndodhin kryesisht për shkak të mungesës së menaxhimit të deponive, stabilitetit të dyshimtë afatgjatë gjeoteknologjik dhe mungesës së rivegjetimit. Në përgjithësi Mirashit perëndimor kanë ndodhur edhe rrëshqitje të dheut për shkak të paqëndrueshmërisë së brigjeve të deponive. Perceptimet në pejsazh tregojnë se jo më shumë se 10% të deponive të jashtme janë rikultivuar. Këto deponi paraqesin burim potencial të pluhrave për punëtorët në mihje dhe popullatën lokale nga fshatrat Bardh dhe Hade, në masë më të theksuar gjatë verës.

**Ndotja dhe degradimi i dheut.** Ekziston ndotje e dheut në zonën e ish objekteve industriale energjetike, në lokacionin në afërsi të TC Kosova A, depozitimi i mbetjeve toksike të prodhimit (mbetjeve fenolike), deponimi i hirit të TC Kosova A, si dhe punimeve të vjetra minierare nëntokësore. Këto kontaminime të mëhershme i janë nënshtruar një programi të gjerë të hulumtimit brenda Projektit të Pastrimit dhe Ri-Kultivimit të Tokës (PPRT / CLRP) i cili, mes tjerash, synon të identifikojë kontaminimet e paraqitura, të sigurojë kufizimin e rreziqeve të afërta deri në sanimin eventual të tyre.

Burimet kryesore potenciale të identifikuar të kontaminimit të dheut dhe ujërave nëntokësore janë:

- derdhjet e substancave vajore dhe materieve tjera kimike, veçanërisht në lokacionet e stabilimenteve të mëhershme të gazifikimit dhe azotikut;
- shirat acidike, aerosolet dhe grimcat e suspenduara nga termocentralet, aktivitetet e mihjeve si dhe deponitë e hirit (më parë ka pasur edhe depozitime të ndotësve nga impiantet e vjetra të gazifikimit dhe azotikut);
- deponimi i mëparshëm dhe aktual i mbeturinave në deponi të hirit, në veçanti në deponinë e hirit të Kosovës A dhe në minierën e vjetër (deponia sanitare rajonale); dhe
- shkarkimet e ujërave të pa trajtuara industriale dhe të zeza.

Bazuar në hulumtimet më të reja lidhur me testimin e ujërave nëntokësore dhe ujërave të lira sipërfaqësore në fazën e hulumtimit të lokacionit të PPRT-së ka tregtuar nivele paksa të rritura të BTEX (Benzol, Toluen, Etilbenzol dhe Xylene) dhe PAH (hidrokarbone aromatike policiklike) në disa mostra. Metalet janë brenda standardeve të ujit të pijshëm (OBSH, BE) përveç arsenit, i cili është gjetur në përqendrime (12 dhe 13 mikrogramë/L) pak mbi standardet e ujit të pijshëm (10 mikrogramë/L) në mostrat e marra në perëndim të deponisë së hirit të Kosovës A. Këto përqendrime të arsenit mund të jenë të lidhura me praninë natyrore të këtij elementi në gjeologjinë e zonës. Përfundimi është se rezultatet e testimit nuk mund të identifikojnë asnjë kontaminim të rrjedhave të ujërave nëntokësore në deponinë e hirit. Ka raportime verbale të kontaminimeve të ujërave nëntokësore në puse, që tani duket se me gjasë lidhet me hedhjen e materieve kimike në galeritë e vjetra të minierës por një gjë e tillë ka nevojë për hulumtime shtesë. Disa puse të cekëta treguan nivele të larta të përqendrimit të elektrike (nga kriperat) që sugjerojnë ndikim nga pluhuri i hirit apo derdhjet e ujit nga deponia e hirit<sup>9</sup>.

<sup>9</sup> Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Social (VSMS, faqe 18).

Hulumtimet nga PPRT<sup>10</sup> treguan praninë e pikave të nxehta me nivel të lartë të mbetjeve fenolike, ujërave fenolike dhe praninë e katranit në deponinë e hirit të Kosovës A ndonëse deponia nuk është përdorur në baza të rregullta për deponimin e këtyre materieve. Dy pellgjet në krye të pjesës së mesme të deponisë së hirit të Kosovës A dhe disa shpimeve krahas njërit nga këto pellgje janë identifikuar si zona të deponive. Shuma totale e këtyre mbetjeve është shumë e kufizuar dhe duket se ato janë të izoluara në masë të pranueshme. Hiri i depozituar në deponi të hirit përmban nivele të ngritura të metaleve të rënda, por për shkak të përbërjes kimike të hirit potenciali për kullim është i kufizuar. Nivelet e ngritura të disa metaleve të rënda, po ashtu, janë gjetur në deponitë e djerrinës por të njëjtat ishin të ngjashme me ato të gjetura në natyrë në atë zonë. Në zonën në afërsi të Prishtinës (Dragodan) përreth deponisë së djerrinës si dhe deponisë së hirit afër Kosovës A, janë gjetur shumë deponi ilegale të mbeturinave me mbeturina komunale, mbeturina ndërtimore, mbeturina tjera nga termocentralet, shirita të vjetër gome, hekurishte, etj.

Analiza gjeokimike përfshinte analizën e mostrave të tokës të marra në thellësi të ndryshme (nga 0.50 deri 80 metra) në 11 shpime të reja për përcaktimin e vlerës pH, kalciumit, magnezit, kaliumit, sodiumit dhe metaleve. Në perëndim të deponisë së hirit, afro 200 metra nga fshati Krushevc (Dardhishtë), është përdorur një pus i mëhershëm i ventilimit për deponimin e mbetjeve të katranit dhe fenolit. Kjo praktikë e njëjtë ka ndodhur edhe në miniera tjera të mëparshme nëntokësore. Veç kësaj, deponitë e hapura nuk kanë veshje adekuate apo pajisje tjera për mbrojtjen e tokës dhe nuk ka asnjë masë për zvogëlim të ndikimit për të shmangur kontaminimet e derdhjeve të ujërave nga reshjet e vrullshme dhe stuhitë.

Përderisa rezultatet e studimit tregojnë ujëra të kontaminuar nëntokësorë, nuk ishte e qartë lidhshmëria me materialet e mbeturinave nga deponia e hirit. Po ashtu, galeritë e ndotura të minierave mund të parashtrijnë rrezik serioz për ujërat lokale nëntokësore dhe pusët, por për këtë duhen hulumtime tjera.

Terreni i stabilimenteve të vjetra të azotikut dhe gazifikimit duken të jenë të kontaminuara. Sipas PPRT është planifikuar fillimi i një studimi në vitin 2008 për të identifikuar nivelin e kontaminimit.

Po ashtu, sipas PSBT, investimet për punë të përmirësimit në deponinë e hirit në Kosovën A dhe deponitë e djerrinave janë përfshirë në draftin final të projektit (prill 2008). Pas miratimit formal, masat e propozuara për riformësim, largim të pjesës së pjesshme jo stabile, mbulimi dhe mbjellja e vegetacionit duhet të sigurojnë zgjidhje adekuate kundër emetimit të partikulateve, ndotjes së mundshme të tokës/ujërave nëntokësore dhe kontaminimit të rrjedhave të ujit.

Nuk ka informata të disponueshme mbi përbërjen në deponinë e hirit të Kosovës B. Me gjasë ai përmban lloje tjera të mbeturinave të ngurta, siç janë goma të vjetra dhe mbetje tjera industriale.

Deponia e hirit shpeshherë ka vërshime. Kjo gjendje me gjasë ka shkaktuar kontaminimin e Sitnicës me shtresime (sedimente). Deponia e hirit Kosova B emiton shumë më pak partikulate sesa Kosova A por ka në dispozicion të dhëna të kufizuara mbi gjendjen e ujërave lokale nëntokësore. Një hulumtim mbi këtë është i duhur.

### **Mbeturinat dhe ndikimi i tyre**

Mbeturinat lajmërohen në forma të ndryshme dhe ato janë si rezultat i punës në mihje, në gjenerim të energjisë dhe mbetjet nga ish proceset e prodhimit në Industrinë kimike (Gazifikim, Azotik dhe Tertore). Sasitë më të mëdha të mbetjeve janë si produkt i djegies së linjtit, të cilat nuk mund të shmangen, por ka mundësi të shumta që ato të reduktohen. Nga kapacitetet ekzistuese dhe ish industria kimike veçohen këto mbetje:

- Mbeturinat e djegies së linjtit (hiri dhe zgjyra)
- Pajisjet dhe materialet e vjetruara
- Mbeturinat prej trajtimit të ujit
- Mbetje nga procesi i Gazifikimit
- Materie radioaktive, etj.

<sup>10</sup> Në korrik të vitit 2007 ka filluar "Hulumtimi i lokacionit, organizimi teknik, planifikimi dhe përcaktimi i ndikimit mjedisor" si pjesë e Projektit për spastrimin dhe rikultivimin tokës" ((CLRP/PPRT), i cili synon të identifikojë nivelin e kontaminimit dhe të përmirësojë gjendjen mjedisore në rrethinë të minierave dhe termocentraleve të KEK-ut, përmes zvogëlimit të emetimeve të partikulareve (grimcave) nga deponimet e hirit ekzistuese të Kosovës A.



Disa mbeturina janë të parrezikshme për njeriun dhe ekosistemet. Në të njëjtën kohë ato mund të jenë të dobishme si produkte riciklimi (lloje të ndryshme metali dhe hiri) përderisa të tjerat, posaçërisht mbeturinat prej trajtimit të ujit, janë të rrezikshme dhe duhet të menaxhohen me kujdes të madh.

**Hiri** - është problemi më i madh në aspektin e sasisë dhe sipërfaqes së zënë me deponitë ekzistuese, ku sasia e përgjithshme e hirit vetëm gjatë vitit 2008 për të dy TC-të (tabela 5), ka qenë 1.161.171 t. Mostrajtimi i mirë i këtyre deponimeve të hirit paraqet problem shumë serioz social dhe mjedisor për zonën me interes të veçantë të FMR-së.

Hiri nga prodhimi energjisë elektrike në Termocentralin Kosova B transportohet dhe deponohet në hapësirën e minieres së Mirashit me sistemin e ri hidraulik që nga viti 2006.

TC Kosova A dhe TC Kosova B kanë në afërsi të tyre deponitë e hirit, të cilat kanë krijuar "kodra të reja" në peizazhin ekzistues. Sasia e përgjithshme e hirit është rreth 40 milion tonelata, në të dy deponitë. Në vijim paraqiten sasi të prodhimit të hirit gjatë periudhës 2005-2008 nga TC A dhe TC B.

<b>Hiri dhe prodhimi i tij (prodhimi në vlerën totale/prodhimi specifik në vlerën mesatare)</b>					
Div. Gjenerimit	Njësia	2005	2006	2007	2008
TC Kosova A	t/v	232618.7	321577	438272.32	376179
	t/MW	0.293	0.3109	0.315	0.27
TC Kosova B	t/v	820362.7	726559.4	723183.10	784992
	t/MW	0.232	0.227	0.219	0.21
Shuma (A+B)	t/v	1052981.4	1048136.4	1161455.42	1161171
	t/MW	0.2409	0.24241	0.267	0.24

Tabela 5. Sasi të Hirit si produkt i punës në TC e Kosovës - Burimi: TIAM / KEK-u / MEM

**Pajisjet dhe materialet e përdorura** mund të vërehen në pjesë të ndryshme afër Termocentraleve ekzistuese dhe në hapësirat e të dy Mihjeve Sipërfaqësore. Kryesisht vërehen pjesët metalike. Sasi të mëdha të pjesëve metalike janë hedhur nëpër vende joadekuate. Ndikimi mjedisor i pajisjeve dhe materialeve tjera konsiderohet i theksueshëm, andaj menaxhimi tyre është me rëndësi të veçantë. Për grumbullimin e mbeturinave metalike KEK-u ka lidhur kontratë me ndërmarrjen "METALKOS". Gjatë vitit 2006, kjo ndërmarrje ka larguar sasi të mëdha të mbeturinave (tabela 6)..

Largimi hedhurinave nga TC-Kosova B sipas vitieve <sup>11</sup>	Hedhurina metalike	Hedhuri na të tjera	Gjithsej tonelata
Viti 2004	870	5702	6572
Viti 2005 (Janar-Mars)	171	4390	4561
Viti 2005 (Prill-Qershor)	282	3110	3392

<b>Mbeturinat metalike të larguara gjatë vitit 2006</b>	
T.C. Kosova A	632,662 t
T.C. Kosova B	342,536 t
Gjithsej	975,198 t

Tabela 6. Mbeturinat e larguara nga TC-Kosova B gjatë vitit 2004 dhe 2005 (majtas) dhe nga dy TC-të gjatë vitit 2006 (djathtas). - Burimi: KEK

**Mbeturinat nga trajtimi i ujit.** Mbetjet që shkaktohen nga trajtimi i ujit (përgatitjet kimike të ujit procesor) janë shumë të ngarkuara me kripëra dhe elemente të ndryshme. Mbeturinat nga ky proces deponohen në deponitë e hirit. Përbërja kimike e këtyre mbetjeve për momentin nuk është e njohur dhe shtrohet nevoja e monitorimit të cilësisë së tyre.

<sup>11</sup> TIAM-KEK

**Kemikatet dhe vajrat.** Kemikatet dhe vajrat industriale nuk janë të deponuara në mënyrë adekuate dhe me to operohet në mënyrë jo të rregullt. Problem në vete paraqesin kemikatet e vjetra (skaduar), të ruajtura për shumë vite dhe në disa situata përbërja e të cilave nuk është e njohur në tërësi.

**Bifenilet e polikloruara (PCB) -** Kapacitetet ekzistuese të Minierave të linjtit, Termocentralet Kosova A dhe B si dhe shërbimet e mirëmbajtjes përdorin sasi të mëdha të vajrave industriale. Vetëm një sasi e vogël e PCB-ve, apo substancave që përbëjnë PCB-në janë raportuar të përdorura për momentin dhe përdorimi i tyre shmanget për aq sa është e mundur. Në KEK tregohet gatishmëri që të iket blerjes së vajrave që mund të kenë ndikim në mjedis pas përdorimit të tyre. Sasitë e mëdha të vajrave me përmbajtje të PCB janë përdorur para konfliktit dhe me siguri janë hedhur në deponimet e hirit, por kjo duhet të konstatohet.

**Mbetjet nga Reparti i Gazifikimit.** Procesi i gazifikimit të linjtit ka filluar në vitin 1970 dhe ka vazhduar deri më 1988, gjatë të cilit është përfutur gazi termik dhe mbetjet tjera, si fenoli i koncentruar, katrani, vaji i mesëm, benzina e papërpunuar, uji amoniakor etj, pjesë e të cilave shifën edhe në foton 6. Si rezultat i gazifikimit të linjtit kanë mbetur të deponuara këto nus produkte<sup>12</sup>:

- Fenol i koncentruar..... 850 m<sup>3</sup>
- Benzinë e pa përpunuar..... 113 m<sup>3</sup>
- Ujë fenoli..... 113245 m<sup>3</sup>
- Katran dhe vaj i mesëm..... 753 m<sup>3</sup>
- Di-izopropiletër..... 78 t

Krahas këtyre materieve që paraqesin probleme të mëdha mjedisore, kjo zonë po ashtu karakterizohet me një mori objektësh tjera (Tertorja, ndarja e ajrit etj), që në vetvete përmbajnë materie të ndryshme, por që gjendja e tyre nuk është e njohur. KEK-u është duke bërë përpjekje për zgjidhje të kësaj problematike.



Foto 6. Pamje të disa nga rezervarët me përmbajtje të nus produkteve, të mbetura nga procesi i gazifikimit - Burimi: KEK / INKOS

**Materiet radioaktive.** Brenda repartit të gazifikimit ekziston një depo e izoluar ku janë të deponuara një sasi e materieve radioaktive. Këto materie janë izotope të kobaltit (Co-60), që kanë qenë të instaluar në gjeneratorët e repartit të gazifikimit. Bunkeri për deponimin e materieve radioaktive është i ndërtuar në vitin 1988. Në këtë bunker janë të deponuara tri tipa të burimeve radioaktive<sup>13</sup>:

- tipi I-rë: 12 burime, me aktivitet fillestar  $A_0=3.70$  GBq;
- tipi II-të: 18 burime, me aktivitet fillestar  $A_0=0.74$  GBq;
- tipi III-të: 4 burime, me aktivitet fillestar  $A_0=1.48$

<sup>12</sup> Raporti i gjendjes së mjedisit, KEK, 2006

<sup>13</sup> Instituti i Mjekësisë së Punës, 2006

Matjet e kryera nga KFOR<sup>14</sup> -i japin të dhënat e mëposhtme:

Brenda bunkerit

- prapa paravanit mbrojtës të betonit..... 4-104.23  $\mu\text{Sv/h}$ ;
- para paravanit mbrojtës..... 4- 23.12  $\mu\text{Sv/h}$ ;

Jashtë mureve të bunkerit

- para hyrjes doza është 0.11-0.18  $\mu\text{Sv/h}$ ;

Këto vlera të matura nuk janë të rrezikshme për kohë të shkurtra të ekspozimit, por megjithatë nuk rekomandohet hyrja brenda bunkerit. Rrezatimi përreth bunkerit është në vlera normale.

**Azbesti** apo materialet që përmbajnë asbest, nuk përdoren në TC Kosova B. Në kohën kur Kosova A është ndërtuar ishte e zakonshme përdorimi i asbestit por shumica e tij është zëvendësuar. Sasia që ka mbetur është e mbyllur dhe do të paraqet problem pas mbylljes së përdorimit të TC Kosova A.

## Zhurma

Zhurma paraqet problem serioz për shëndetin e punëtorëve dhe popullatës. Në disa vende të TC-ve niveli i zhurmës ndonjëherë kalon 85 dB. Izolimi i zhurmës aplikohet rreth pajisjeve të zhurmshme. Punëtorët përdorin mjete mbrojtëse në hapësirat me zhurmë të shkaktuar nga TC-të. Faktorët si drejtimi dhe shpejtësia e erës, absorbimi atmosferik dhe lagështia e ajrit, ndikojnë në përhapjen e zhurmës. Gjatë kohës së natës, zhurma në Komunën e afërt Obiliq, rreth 500 metra prej Kosovës B, është mbi nivelin për hapësirat e banuara sipas Carl Bro<sup>15</sup>. Në mungesën e hartave të zhurmës, Carl Bro ka llogaritur shkallën e zhurmës shiko në tabelën 7.

Vendi	Distanca	Zhurma lokale	Niveli i llogaritur i zhurmës
Obiliq	500m	55 - 60	63

**Tabela 7. Shkalla e zhurmës - Burimi: Carl Bro, 2002**

Vlerat tipike për kufijtë e lejuar të emetimit afër vendbanimit më të afërt që janë aplikuar në vendet e BE-së janë 55 dB gjatë ditës dhe 40-50 dB gjatë natës.

Në afërsi të palosjes së hirit lajmërohen burime të shumta të zhurmës, të cilat ndikojnë në kualitetin e jetës së njerëzve që jetojnë në fshatrat përreth. Janë vërejtur këto burime të zhurmës:

- Eskavatorët
- Mjetet Transportuese (automjetet dhe shiritat transportues të linjtit/hirit)
- Zhurma operative e Termocentraleve Kosova A dhe B
- Operimi i lokomotivave të KEK-ut.

**Emetimet e zhurmës** nga termocentralet vijnë kryesisht nga shiritat transportues, pajisjet për thërrmim, kazanët, turbinat, gjeneratorët, ventilatorët, kompresorët, pompat e shumta, kullat ftohëse dhe oxhaqet. Në zona të ndryshme përreth pajisjeve të blloqeve të termocentraleve, niveli i zhurmës mund të tejkalojë vlerën prej 85 dB (decibelëve).

Historikisht nuk ka të dhëna nga monitorimi i nivelit të zhurmës në afërsi të objekteve dhe pajisjeve, megjithëse niveli i zhurmës, si për të punësuarit ashtu edhe për banorët në brendësi të zonës energjetike, konsiderohet aspekt kyç që duhet trajtuar në kuadër të standardeve të BE-së dhe praktikave më të mira.

<sup>14</sup> Measure of Radiation in Power Plant Kosovo A, 12th of July 2006

<sup>15</sup> Carl Bro, 2002, VNM dhe Plani i Veprimit për KEK



## Peizazhi, biodiversiteti dhe trashëgimia natyrore e kulturore

**Peizazhi.** Në Zonën me Interes të Veçantë FMR- së, gjer me tani nuk ka ndonjë peizazh që është shpallur i mbrojtur në bazë të legjislacionit në fuqi. Sa i përket pamjes vizuale mund të thuhet se, në pjesën më të madhe të zonës nuk është e kënaqshme, përveç pjesës veri perëndimore të FMR-së.

Sipërfaqja e zonave natyrore në zonën e interesit do të rritet pas përfundimit të projektit, në fakt pas rikultivimit. Në planet e ardhshme, zona e mihjeve ekzistuese, depozitat e hirit dhe depozitimet e djerrinës do të pastrohen, ri-kultivohen dhe mbillen, rrjedhë që vazhdimisht do të përmirësohet pamja vizuale e zonës – peizazhi natyror.

**Biodiversiteti dhe trashëgimia natyrore.** Zona e 'FMR-së', për të cilën hartohet ky Plan Hapësinor, nuk karakterizohet me ndonjë vlerë të lartë sa i përket trashëgimisë natyrore. Në zonën e shtrirjes së mihjes së re ekzistojnë vetëm disa monumente natyrore sipas shënimeve të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe atë:

- Burim i ujit mineral në Graboc të Epërm
- Burim/krua në qendër të fshatit Caravadicë (Palaj);
- Trung druri i vetëm bliri (*Tilia spec.*), i vjetër rreth 200 vjet, në lagjen Nicak (Sibovc), dhe
- Grup trungjesh druri të bungut (3x *Quercus spec.*, 1x *Quercus cerris*), diku rreth 300 vjeçar, në lagjen e Megjuanëve (Sibovc).

Projekt-Plani Hapësinor i FMR-së nuk prekë asnjë zonë strikte të mbrojtur natyrore apo vendbanim (habitat) të mbrojtur për qëllime të ruajtjes së bimëve, kërpudhave apo kafshëve të kërcënuara ose të rrezikuara nga zhdukja.

**Trashëgimia arkeologjike dhe kulturo-historike.** Gjithashtu, trashëgimia arkeologjike, arkitektike dhe historike është shumë e rëndësishme për të kontribuar në zhvillim të qëndrueshëm, sidomos me pjesëmarrjen e saj në llojllojshmërinë (diversitetin) e zhvillimit të zonave rurale, çka në fakt kërkohet edhe për zonën e FMR-së. Tërësitë dhe objektet e njohura të kësaj trashëgimie, janë paraqitur me vendndodhjen e tyre hapësinore në hartën e zonës së interesit si në hartën 17, kurse të dhënat tjera më interesante e edhe për lokalitetet tjera arkeologjike i gjejmë në listën e më poshtme si në tabelën 8.


**"Kalaja apo Gradina" e Bellaqevcit** – Është Qytezë e mesjetës së hershme me vendimin numër: E.K. 02 – 389/77 gjënë vend në listën e monumenteve (objekteve dhe tërësive) nën mbrojtje të shtetit. Ajo gjendet në afërsi të fshatit Bellaqevc (Bardh i Madh) dhe shtrihet mbi kodrinën më të afërt në anën perëndimore të tij.

**Tyrbja e Sulltan Muratit të I-rë** – Është vënë nën mbrojtje që në vitin 1950 me vendimin numër: E.K. 245/50 dhe gjendet në kilometrin e 6-të larg Prishtinës, në fshatin Mazgit (në anën e majtë të magjistrales Prishtinë – Mitrovicë). Tyrbja e Sulltan Muratit të I-rë ose Meshed-i Hüdâvendigâr (në foto 7), është ndërtuar në shekullin XIV dhe paraqet veprën më të vjetër Otomane në Kosovë. Për vlerat e saja kulturore, historike dhe arkitektike është shpallur monument dhe mbrohet me ligjin mbi trashëgiminë kulturore. Pranë Tyrbes, në vitin 1896, ishte ndërtuar objekti për pushimin dhe bujtjen e vizitorëve të saj, të quajtur Selamllëk (Selamlık). Tyrbja është rinovuar disa herë më parë, por ky më i fundit, në vitin 2005, është rinovim më i rrënjësishëm dhe i kryer nga Kryesia e Bashkësisë Islame e Republikës së Turqisë.

**Foto 7. Pamje e Tyrbes së Sulltan Muratit të I-rë.** Burimi: IPH / MMPH









Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Ministry of Environment and Spatial Planning



Instituti për Planifikim Hapësinor  
Institut za Prostorno Planiranje  
Institute for Spatial Planning

### PLANI HAPËSINOR I "FUSHËS MIHJA E RE" TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORO-HISTORIKE

### LEGJENDA

<ul style="list-style-type: none"> <li><span style="border: 2px solid green; display: inline-block; width: 20px; height: 10px; margin-right: 5px;"></span> Kufiri i FMR</li> <li><span style="border: 1px solid gray; display: inline-block; width: 20px; height: 10px; margin-right: 5px;"></span> Kufi komunal</li> <li><span style="border: 1px solid gray; display: inline-block; width: 20px; height: 10px; margin-right: 5px;"></span> Njësi kadastrale</li> <li><span style="border: 2px solid red; display: inline-block; width: 20px; height: 10px; margin-right: 5px;"></span> Rrugët magjistrale</li> <li><span style="border: 2px solid orange; display: inline-block; width: 20px; height: 10px; margin-right: 5px;"></span> Rrugët regionale</li> <li><span style="border: 2px solid gray; display: inline-block; width: 20px; height: 10px; margin-right: 5px;"></span> Rrugët regionale të pa asfaltuara</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li><span style="display: inline-block; width: 20px; height: 10px; border-bottom: 1px solid gray; margin-right: 5px;"></span> Hekurudhat</li> <li><span style="display: inline-block; width: 20px; height: 10px; border-bottom: 1px solid blue; margin-right: 5px;"></span> Lumë</li> <li><b>Monumente natyrore</b></li> <li><span style="display: inline-block; width: 10px; height: 10px; background-color: green; border-radius: 50%; margin-right: 5px;"></span> Dru bliri</li> <li><span style="display: inline-block; width: 10px; height: 10px; background-color: blue; border-radius: 50%; margin-right: 5px;"></span> Krua</li> <li><span style="display: inline-block; width: 10px; height: 10px; background-color: green; border-radius: 50%; margin-right: 5px;"></span> <span style="display: inline-block; width: 10px; height: 10px; background-color: green; border-radius: 50%; margin-right: 5px;"></span> Trungje bungu</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li><span style="display: inline-block; width: 10px; height: 10px; background-color: red; border-radius: 50%; margin-right: 5px;"></span> Monumente Kulturore me status të mbrojtur MKRS</li> <li><b>Lokalizete arkeologjike sipas statusit</b></li> <li><span style="display: inline-block; width: 10px; height: 10px; background-color: blue; border-radius: 50%; margin-right: 5px;"></span> E evidentuar</li> <li><span style="display: inline-block; width: 10px; height: 10px; background-color: green; border-radius: 50%; margin-right: 5px;"></span> E hulumtuar</li> <li><span style="display: inline-block; width: 10px; height: 10px; background-color: yellow; border-radius: 50%; margin-right: 5px;"></span> E pahulumtuar</li> </ul>
---	--	---

Harta 17. Shtrirja e trashëgimisë natyrore dhe kulturo-historike në dhe rreth zonës "FMR"- Burimi:MMPH/IPH



**Lista e lokaliteteve brenda zonës së FMR-së**

Nr	Komuna	Vendbanimi	Lokaliteti	Statusi - i/e	Pronësia	Periudha	Nr. Inv.
1	Fushë Kosovë	Graboc i Poshtëm	Nekropola Mesjetare	Hulumtuar	Afrim Berisha	Mesjet e hershme	
2	Fushë Kosovë	Graboc i Poshtëm	Kërshi i Halitajve	Evidentuar	Afrim Berisha	Para-historike	
3	Fushë Kosovë	Bellaçevc i Madh	Kalaja e Bellaçevcit	Nën Mbrojtje		Mesjetë e hershme	E.K.-389/77
4	Fushë Kosovë	Bellaçevc i Vogël	Arat e Komanovës	Pa hulumtuar		Mesjetë e hershme	
5	Fushë Kosovë	Sllatinë e Vogël	Arat në rrugë-Tumë	Pa hulumtuar	Nezir Gërguri	Para-historike	
6	Fushë Kosovë	Sllatinë e Vogël	Arat	Pa hulumtuar	Restelica & Gashi	Romake	
7	Fushë Kosovë	Lismir	Oborr shtëpie - A.T.	Evidentuar	Abdullah Tërnavë	Romake	
8	Fushë Kosovë	Vragoli	Te mulliri	Pa hulumtuar	Hamdi Dervisholli	Romake	
9	Fushë Kosovë	Vragoli	Kumanovkë	Pa hulumtuar	private	Antikë e vonë	
10	Obiliq	Graboc i Epërm	Gradina - Maja e Zezë	Evidentuar		Para-historike	
11	Obiliq	Graboc i Epërm	Lugu i Kishës	Evidentuar		Antikë e vonë	
12	Obiliq	Hade	Lugu i Bucakut	Pa hulumtuar		Mesjetë e hershme	
13	Obiliq	Sibovc	Quvriat-te Kisha	Pa hulumtuar		Antikë e vonë	
14	Obiliq	Mazgit	Tyrbja e S. Muratit	Nën Mbrojtje		Osmane	E.K.-245/50
15	Vushtri	Bivolak	Lugu i lumit të Strovcit	Pa hulumtuar	Mexhit Klinaku	Mesjetare	
16	Vushtri	Zhilivodë	Kërshi	Evidentuar	Pajazit Krasniqi	Para-historike	

**Tabela 8. Trashëgimia kulturo-historike për zonën e FMR-së - Burimi: DTK / MKRS**



## Resurset e linjtit

Linjiti është resursi më i rëndësishëm energjetik i Kosovës, i cili furnizon rreth 97% të prodhimit total të energjisë elektrike. Rezervat e përgjithshme gjeologjike, të Resurseve të linjtit në gjithë Kosovën, të vlerësuara sipas Institutit "INKOS", arrijnë rreth 12.5 miliardë tonë, nga të cilat konsiderohet, që sasia prej 8.6 miliardë tonë janë rezerva të eksploatueshme, që nga aspekti ekonomik janë të levërdishme për tu shfrytëzuar. Resurset e linjtit, në Republikën e Kosovës, me sipërfaqe të tërësishme prej 334 km<sup>2</sup>, gjenden në tri basene kryesore: "Baseni i Kosovës", Baseni i Drenicës dhe "Baseni i Dukagjinit". Hulumtimet gjeologjike shtesë, janë të nevojshme në të tri basenet, me përjashtim të fushës qymyrbajtëse të Sibovcit e cila është hulumtuar në hollësi, mbi të cilat janë mbështetur edhe projektet e detajuara teknike për shfrytëzim, në kuadër të Strategjisë energjetike të Kosovës dhe "Projektit për gjenerimin e energjisë elektrike nga linjiti"




Figura 10. Krahasimi me minierat ndërkombëtare. - Burimi: MEM/VSMS/PricewaterhouseCoopers LLP

Cilësia e resurseve të linjtit në basenet e Kosovës është me përmbajtje të ulët të sulfurit si dhe koncentrim të gëlqeres (kalcium oksidit) e dobishme për absorbimin e një pjese të sulfurit gjatë djegies. Cilësia e linjtit sikur edhe raporti në mes të shtresës së djerrinës dhe asaj të linjtit që është shumë i favorshëm i bëjnë minierat shumë tërheqëse për shfrytëzim (shih fig. 10).

Zona e veçante me interes ekonomik gjendet në zonën aktive të mihjes të Basenit të linjtit të Kosovës. Minierat sipërfaqësore të Mirashit dhe Bardhit (me prodhim vjetor të linjtit përafërsisht 7 milionë tonelata) pothuajse janë shterur pas 3 - 5 dekadave të operimit dhe prodhimit. Prandaj, kanë filluar përgatitjet për eksploatimin e linjtit në të ashtuquajturën "Fushë jugperëndimore të Sibovcit" dhe minierën e Sitnicës. Këto miniera, janë vazhdim i minierës së Bardhit e para, kurse e dyta zgjerim i minierës së Mirashit, të parapara për të siguruar furnizimin afatshkurtër të linjtit për termocentralet ekzistuese, Kosova A dhe Kosova B.




Figura 11. Fushat e mihjes së linjtit në Basenin Kosova. Burimi: MEM/VSMS/PricewaterhouseCoopers LLP.

Në basenin e Kosovës janë identifikuar tri zona potenciale për zhvillimin e kapaciteteve të reja të mihjes së linjtit. Për shfrytëzim të këtyre kapaciteteve minerare, në një afat prej 40 vitesh, do të mund të ndërtohen dhe të instalohen kapacitetet e reja të gjenerimit të energjisë elektrike, bazuar në rezervat e linjtit të këtyre fushave të reja minerare, të paraqitura me shtrirje si në fig. 11 si dhe në tabelën 9.

Rezervat e linjtit	Fusha "C"/Sibovcit	Fusha "D"/Dardhishtes	Fusha "E"/Jugore
Gjeologjike (në million ton)	990	395	537
Të shfrytëzueshme (në m.t.)	830	280	370
Sipërfaqet e rezervave	19.7 km <sup>2</sup>	7.8 km <sup>2</sup>	8.0 km <sup>2</sup>
Kapaciteti i mundshëm për gjenerim 40 vjeçar	2000 MW	600 MW	1000 MW

Tabela 9. Rezervat linjtit brenda FMR-së në Basenin e Kosovës - Burimi: MEM / KEK




Resurset e linjtit në Fushën e Re të Mihjes vlerësohen të jenë rreth një miliardë tonë dhe përbëjnë një aset të konsiderueshëm të Kosovës që do të sigurojë prodhim të energjisë gjatë shumë dekadave të ardhshme. Rezervat e llogaritura të linjtit si resurs natyror, brenda kësaj fushe me qendër Sibovcin në një sipërfaqe prej 19.7 km<sup>2</sup>, ka rezultuar me rezerva gjeologjike prej 990 milion ton nga të cilat 830 milion ton janë të shfrytëzueshme.

Nga hulumtimet paraprake dhe studimet e bëra nën financim të Agjencia Europiane për Rekonstruim, janë në dispozicion dy plane Xehetare, për lokacionin e të cilave shih hartën 18.

**Plani Kryesor Xehetar (PKX)** për Mihjen e Re në fushën e Sibovcit i vitit 2005 është bërë me qëllim të sigurimit teknik dhe ekonomik të prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë dhe garanton blloqet ekzistuese dhe të reja të impianteve gjeneruese për furnizimin e tyre me linjit për djegie gjatë tërë jetëgjatësisë së tyre.

**Plani Plotësues Xehetar (PPX)** për Fushën e Sibovcit Jug-Perëndim i vitit 2006, përkundër PKX për Fushën e Re të Mihjes (Sibovcit), fokusohet në furnizim e sigurtë të blloqeve të termocentraleve ekzistuese me linjit për djegie, duke garantuar sasinë e kërkuar prej 9 milion ton/vit, për periudhën kohore të jetëgjatësisë tyre deri në vitin 2024.



Harta 18. Raporti mes fushave minierare (në shfrytëzim, sipas PKX dhe asaj të licencuar sipas PPX. Burimi: MEM / VSMS / PricewaterhouseCoopers LLP

### 1.2.3. POPULLSIA, ZHVILLIMI SOCIAL DHE VENDBANIMET

#### Popullsia

Zhvillimi i popullsisë është një fushë mjaft me rëndësi për planifikime dhe zhvillime të ardhshme. Të gjitha zhvillimet në hapësirë bëhen në interes të vetë popullatës. Prandaj, analiza e zhvillimeve demografike është e domosdoshme për planifikim adekuat të zonës duke aluduar në kërkesat e popullsisë dhe interesin e zonës për zhvillime të ardhshme.

Tani më është e njohur se në Kosovë, që nga viti 1981 e këndej, nuk ka pasur regjistrim të popullsisë dhe të dhënat ndryshojnë varësisht nga organizatat të cilat janë marrë më vlerësimin e numrit të popullsisë qoftë për zona të caktuara por edhe për vetë nivelin e Kosovës. Të dhënat e shfrytëzuara, që me këtë rast janë të vlerësuara si më reale, janë marrë nga vlerësimi i UNHCR-it të vitit 1998.

**Numri i popullsisë** - në zonën e FMR-së jetojnë rreth 55.000 banorë. Ndërsa në zonën strikte ku duhet të bëhet zhvendosja e popullatës jetojnë rreth 7000 banorë. Dihet se të dhënat për popullsinë mungojnë jo vetëm për këtë zonë, por edhe në nivel të Kosovës. Të dhënat e shfrytëzuara janë nga burime dhe vite të ndryshme. Në këtë zonë duhet cekur se ndodhen dy qytete me numër të madh të banorëve, Obiliqi dhe Fushë Kosova.

	Zonat kadastrale në zonën e FMR-së	km <sup>2</sup>	Popullsia	Dendësia
1	Malisht (Vasileva)	9.48	779	82
2	Bardh i Madh (Bellaqefci i M)	11.29	3500	310
3	Fushë Kosovë	10.68	16225	1520
4	Gurarbër (Grabofci i Poshtëm)	8.06	1788	222
5	Albana e Vogël (Slatina e V)	1.32	600	454
6	Livragonë (Vragolia)	1.73	1653	954
7	Bardhi i Vogël (Bellaqeci i V)	1.57	850	540
8	Kuzmin	4.30	565	132
9	Mesbardh (Pomozitini)	2.74	697	255
10	Lismir (Dobërdupi)	4.89	1250	256
11	Palaj (Ceravadica)	7.11	1147	161
12	Mjekaj (Grabofci i Epërm)	8.59	762	89
13	Hade	4.91	2892	589
14	Hamidi	1.73	280	161
15	Lajthishtë (Leshkoshiqi)	3.68	1284	349
16	Mazgit	5.80	3104	535
17	Analum (Plemetin)	5.72	2026	354
18	Shipitullë	2.96	662	224
19	Shpat (Sibofci)	7.50	2018	269
20	Dardhishtë (Krushefci)	6.63	2210	333
21	Muzakaj (Millosheva)	7.13	3200	449
22	Obiliq	11.16	5300	475
23	Burim (Bivolaku)	2.97	1302	438
24	Rranzë (Zhilivoda)	4.68	1092	233
25	Gurkuq (Gllavotini)	2.55	447	175
26	Preluzhë (Prelluzha)	6.57	2222	338
	<b>Totali / Dendësia mesatare e popullsisë (b/km<sup>2</sup>).</b>	<b>145.75</b>	<b>57855</b>	<b>397</b>

Tabela 10. Dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve. Burimi: IPH / MMPH





**Dendësia e popullsisë** - në zonën e FMR-së jetojnë rreth 360 b/km<sup>2</sup>. Kjo është dendësi e lartë e popullsisë krahasuar me mesataren e Kosovës. Nga tabela 10 dhe harta 19 e mëposhtme vërehet se: brenda zonës kemi dallime të theksuara sa i përket dendësisë së popullsisë, vendbanimet me numër më të vogël të popullsisë kanë dendësi më të vogël, përderisa në dy qytetet dendësia është më e lartë.

**Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë** - ka rëndësi të madhe për zhvillimin demografik, ekonomik dhe social. Nga kjo strukturë rrjedhin kontingjentet kyçe të popullsisë, që kanë ndikim në zhvillimin demografik dhe socio-ekonomik të një popullate.

Kjo zonë ka popullsi kryesisht të re, edhe pse, në periudhat e fundit kohore, vërehen disa tendenca me ndryshime të vogla në zvogëlimin e vlerave të grup-moshave të reja. Mbi 30% e popullsisë, në zonë janë me moshë të re, prej 0 deri 18 vjeç, gjersa grup-moshat 19 – 35 vjeç kapin vlerën prej afër 30%, atëherë grup moshë 36 – 65 vjeç përfshijnë rreth 35% kurse grup-moshat mbi 66 vjeç arrijnë në rreth 5% të popullsisë së përgjithshme. Këto të dhëna, si në fig. 12, tregojnë se kjo zonë sikur edhe tërë Kosova ka një popullsi të re me rreth 60% nën moshën 35 vjeçare.

**Harta 19. Dendësia e popullsisë (b/km<sup>2</sup>) nëpër zonat kadastrale të FMR-së. - Burimi: IPH / MMPH 2009.**





Sa i përket raportit gjinor, ekziston një deballanc i vogël gjinor, në popullsinë e kësaj zone, ku popullsia mashkullore dominon me 51.1 %, në krahasim, me popullsinë femërore që ka 48.9 % të popullsisë së përgjithshme.

**Figura 12. Grafiku i strukturës së popullsisë sipas moshës në FMR për vitin 2008<sup>16</sup>.** - Burimi: IPH / MMPH 2009

**Struktura etnike e popullsisë** - sipas të dhënave të vitit 1998, mbi 70% e popullsisë ishin shqiptarë, kurse të tjerët ishin serb, rom, ashkali etj. Të dhënat e prezantuara janë burim i vlerësimeve të bëra nga organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.

**Migrimet e popullsisë** - sot paraqesin një problem shumë dimensional hapësinor, demografik, ekonomik, social dhe politik, ndërsa i nxisin një varg faktorësh të ndërlikuar dhe shpeshherë reciprokisht të lidhur e të kushtëzuar<sup>17</sup>. Mungesa e të dhënave demografike në përgjithësi dhe për migrimet në veçanti, vështirëson punën dhe arritjen deri te rezultatet e sakta mbi migrimet për këtë zonë. Sipas vlerësimeve të ndryshme mund të thuhet se ka migrime të theksuara kryesisht nga viset me të thella rurale drejt atyre urbane. Mirëpo, nuk duhet harruar se kemi të bëjmë edhe me migrime jashtë vendit të cilët përbëjnë një numër të madh të popullatës. Shkaqet që i kanë kushtëzuar këto migrime janë të natyrave të ndryshme, duke përfshirë ato ekonomike dhe të punësimit (përmirësimi i kualitetit të jetës), sociale, demografike, politike etj. Shkaqet ekonomike dhe punësimi janë ndër faktorët kryesor që i kanë kushtëzuar këto migrime, për faktin se në hapësirë një numër i konsiderueshëm nuk kanë mundur të gjejnë punë dhe si zgjidhje e vetme për të siguruar kushte më të mira të jetesës ishte emigrimi dhe punësimi në botën e jashtme.

## Zhvillimi social

**Arsimi** - Arsimimi i popullsisë është themeli i një shoqërie të shëndoshë, i cili garanton perspektivë për të ardhmen shoqërore, ekonomike, kulturore dhe politike të një vendi. Në sistemin arsimor të Kosovës, pas vitit 2000, u bënë zhvillime të theksuara në realizimin e programeve mësimore bashkëkohore. Në vitin 2002, u krijua një model i ri për sistemin arsimor në vend. Struktura e reformuar ofron 5 vite të arsimit fillor, pasuar nga 4 vite të shkollimit të ulët të mesëm dhe 3 apo 4 vite të shkollimit të lartë të mesëm. Modeli 5+4+3 po zëvendëson strukturën e mëparshme 4+4+4. Me strukturën e re, arsimi i obligueshëm është zgjatur për një vit, tani në 9 vite nga ai i mëparshmi me 8 vite.

Struktura organizative e sistemit arsimor në zonën e FMR-së është e organizuar në katër nivele: Arsimin parashkollor (5 - 6 vjeçar), arsimin fillor (I - V), arsimin e mesëm të ulët (VI - IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (X - XII). Numri i objekteve shkollore gjithsej është 28, duke përfshirë edhe shkollat e mesme. Në procesin arsimor janë të përfshirë rreth 7500 nxënës.

Çerdhe dhe kopshte për fëmijët e moshës nën 5 vjet brenda territorit të zonës janë tri sosh gjithsej dhe i gjejmë në hapësirat e qendrave urbane (F. Kosovë dhe Obiliq).

Arsimi parafillor e hasim tek një numër i konsiderueshëm i shkollave fillore që ofrojnë edukim njëvjeçar parashkollor për fëmijët e moshës 5 dhe 6 vjeç.

<sup>16</sup> Rezultatet e hulumtimit të realizuara nga PATEL - MEM përmes Prism Resarch 2008, të analizuara nga IPH - MMPH.

<sup>17</sup> Hivzi Islami, Studime Demografike, 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës, Prishtinë 2008. fq. 255.

Raporti nxënës-mësimdhënës në hapësirat shkollore mesatarja sillet rreth 20 nxënës për 1 mësimdhënës me dallime të theksuara nga njëra shkollë në tjetrën. Sa i përket kushteve fizike të objekteve shkollore ato ndryshojnë nga njëri vendbanim në tjetrin. Në aspektin e përgjithshëm të mësim-nxënies kushte jo të kënaqshme na paraqiten në vendbanimet e thella rurale. Për të pasur analiza edhe më të hollësishme kërkohen të dhëna esenciale për secilën shkollë veç e veç.

**Shëndetësia** - Shëndetësia kosovare, edhe për kundër investimeve të mëdha të bëra pas vitit '99, është në gjendje jo të mirë. Sistemi shëndetësor kosovar ka mjaft probleme, si fondet e ulëta, mungesa e mundësive për trajtimin e disa sëmundjeve të komplikuar si leukemia, insuficienca e veshkave, kardiokirurgjia, trajtimi onkologjik-radioterapia etj. Por, vështirësi ka edhe të natyrës organizative gjegjësisht implementimit të ligjit të shëndetësisë, paralelizmit të strukturave serbe, mosekzistimi i sigurimit shëndetësor, mungesa e kuadrit të mjaftueshëm, mungesa e mjeteve për investime të reja në pajisje, hulumtime shkencore, mos përfshirja e sektorit privat në SISH, etj. Aktualisht në Kosovë sistemi shëndetësor është i organizuar në tri nivele: a) niveli parësor b) dytësor dhe c) nivelin tretësor. Përveç në sektorin publik, është e organizuar edhe në sektorin privat në një shkallë mjaft të gjerë.

Në territorin e FMR-së, në sektorin publik, shëndetësia është e organizuar në nivelin parësor. Shërbimet shëndetësore ofrohen në rreth 12 objekte shëndetësore, ku dy prej tyre janë Qendra Kryesore të Mjekësisë Familjare të cilat ndodhën në hapësirat urbane ndërsa të tjerat janë Ambulanta dhe Qendra të Mjekësisë Familjare.

Sa i përket gjendjes fizike të objekteve shëndetësore kjo ndryshon nga njëri objekt në tjetrin, por në përgjithësi kanë një gjendje të konsiderueshme. Gjithashtu duhet cekur se në këtë territor ofrohen shërbime mjekësore edhe nga sektori privat. Ky sektor ofron shërbime të kirurgjisë, gjinekologjisë, pediatriisë, stomatologjisë, diagnostikës, neuropsikiatriisë, internistikës, etj.

Riorganizimi i sistemit shëndetësor dhe investimet në infrastrukturën sociale në përgjithësi, e kryesisht në atë shëndetësore, ndikojnë në përmirësimin e gjendjes shëndetësore të popullatës. Gjendja e mirë shëndetësore është shumë e varur edhe nga indikatorët mjedisor, në radhë të parë nga ajri, uji për pije, si në aspektin sasior, ashtu edhe në atë cilësor, etj.

**Papunësia dhe varfëria** - Një ndër sfidat kryesore për popullatën e Kosovës është shkalla e lartë e papunësisë, e cila reflektohet me probleme të shumta në shoqërinë kosovare. Shkalla e papunësisë në vend është rreth 44.4%<sup>18</sup>. Kjo shkallë e papunësisë është më e larta në rajon. Vlerësohet se 1/3 e popullsisë së Kosovës është nën moshën 16 vjeç, ndërkaq rreth 60% e popullsisë janë në moshë pune. Kjo shkallë e lartë e papunësisë, rritet edhe më shumë te femrat (58.06%), pavarësisht nga shkalla shumë e lartë e mos aktivitetit për to.

Sipas hulumtimit të dhënave për territorin e FMR-së për secilin vendbanim, kemi vënë re se papunësia e lartë është një prej sfidave më shqetësuese për popullatën e kësaj ane. Numri i punëkërkuësve të regjistruar në zyrën e punësimit, të cilët presin për të gjetur një vend pune, është i madh (rreth 12% të numrit të përgjithshëm të popullsisë), i cili nuk do të thotë se është real, mund të jetë edhe shumë fish më i madh, sikur të regjistroheshin të gjithë të papunët.

Kjo shkallë e lartë e papunësisë ka ndikuar në rritjen e shkallës së varfërisë. Varfëria ka prekur pothuajse të gjitha porët e jetës shoqërore në Kosovë. Hulumtimet e kohëve të fundit flasin për shkallë të lartë të varfërisë. Sipas këtyre hulumtimeve bi gjysma e popullsisë (50.3%) jetojnë në varfëri të përgjithshme, ndërsa rreth 13% e banorëve jetojnë në varfëri ekstreme<sup>19</sup>. Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, shkalla e ulët e arsimimit, shkatërrimet e shtëpive, bizneseve dhe ndërmarrjeve nga lufta e fundit në Kosovë ('99), ndikuan në rritjen e varfërisë.

Varfëria është një fenomen kompleks social i cili është vështirë të matet. Për matjen e varfërisë kërkohen të dhëna si: të ardhurat për kokë banori, niveli i arsimimit, kushtet e banimit, shëndetësia, etj. Parcializimi i tokave, kreditë jo të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë, tatimet e larta, farëra, plehra artificiale, etj, janë në disfavor të bujqësisë (bujkut), për këtë dhe arsye të tjera, nuk ka interesim të

<sup>18</sup> UNDP, Raporti i Zhvillimit Njerëzor, Kosovë 2004.

<sup>19</sup> UNDP, Raporti i Zhvillimit Njerëzor, Kosovë 2004.

popullatës të merret në mënyrë aktive dhe ekskluzivisht me bujqësi, sektor ky i cili do të mund të ulte shkallën e papunësisë dhe varfërisë. Viset rurale me largësi të theksuar nga zona urbane, zona kodrinore malore, me shkallë të ulët të arsimimit, me shëndetësi të pa zhvilluar, me kushte jo të mira banimi etj, janë të përfshira në shkallë më të lartë të papunësisë dhe varfërisë.

## Vendbanimet, banimi dhe shërbimet sociale

Në hapësirën e FMR-së janë 26 vendbanime të shtrira gjithandej hapësirës për të cilën po planifikohet, ku dy prej tyre janë hapësira urbane ndërsa të tjerat janë hapësira rurale. Vendbanimet që i takojnë komunës së Obiliqit janë gjithsej 12, ndërsa 9 vendbanime i takojnë Fushë Kosovës, 4 vendbanime komunës së Vushtrrisë dhe 1 vendbanim komunës së Glllogocit.

Sipas madhësisë për nga numri i popullsisë, vendbanimi më i vogël është Hamidi/ja me 280 banorë dhe më i madhi është vendbanimi Fushë-Kosovë (zona urbane) me 16.225 banorë, ndërsa të gjitha vendbanimet në zonë mund ti ndajmë në pesë grupe:

- vendbanimet deri në 500 banorë,
- vendbanimet me 501-1500 banorë,
- vendbanimet me 1501-3000 banorë,
- vendbanimet me 3001-5000 banorë dhe
- vendbanimet me mbi 5000 banorë.

Sa i përket tipizimit të vendbanimeve, ekzistojnë dy lloje; vendbanimet të tipit të koncentruar dhe të shpërndarë. Në grupin e parë të vendbanimeve hyjnë vendbanimet e mëdha përkatësisht qyteti i Fushë Kosovës dhe i Obiliqit dhe vendbanime tjera me numër të madh të popullsisë. Ndërsa, në grupin e dytë, hyjnë vendbanimet me numër më të vogël të popullsisë si: Hamidi-ja, Nakarada, etj. Këto vendbanime (të shpërndara) paraqesin tërësinë e objekteve banuese dhe ekonomike të prodhuesve bujqësorë dhe njëkohësisht i takojnë kategorive më të vogla të fshatrave. Shumica e këtyre vendbanimeve janë të vendosura më larg qendrave urbane dhe janë vise rurale, të cilat janë fshatra tipike bujqësore. Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është shkalla e lartë e autonomisë, transformimi i vogël, lidhja jo e mirë me qendrat urbane dhe me shpopullim më të theksuar.

Në shumicën e vendbanimeve kemi banim individual, përjashtim bëjnë zonat urbane e Fushë Kosovës dhe Obiliqit, ku kemi banim të përzier kolektiv dhe individual. Vendbanimet që ndodhen afër qendrave urbane dhe, atyre afër rrugëve, vërehen tendencat e zhvillimit linear, duke i përcjellë vijat komunikative, për këtë arsye objektet e banimit si dhe ato të bizneseve shtrihen në formë vargore. Kjo arsyetohet edhe me faktin se popullsia vazhdimisht po heq dorë nga bujqësia.

Numri më i madh i objekteve të banimit është ndërtuar në hapësirat e rrafshëta urbane, që njëkohësisht është edhe hapësira më e banuar. Për nga cilësia e materialit ndërtimor, sipërfaqes së ndërtuar dhe pajisjeve në hapësirat e banimit, kjo zonë, gjithashtu disponon me një fond banesor mjaftë cilësor.

Rrethanat e luftës gjatë vitit 1998/99 kanë bërë që shume objekte të vjetra banuese dhe të tjera të shkatërrohen. Pas vitit 2000 filloj ndërtimi i shtëpive bashkëkohore gjë që bëri të ndryshohet stili tradicional i shtëpive. Objektet e banimit dhe oborret kanë dallime të theksuara varësisht nga vendi i ndërtimit, si: qyteti, vendbanimet pranë qytetit, vendbanimet kodrinore-malore. Shumica e objekteve të banimit janë të rrethuara me mure, në oborre dallohen edhe objektet tjera ekonomike bujqësore.

Të gjitha vendbanimet të cilat ndodhen në zonën e FMR-së janë të ndikuara nga ndotjet dhe zhurma që krijohet në afërsi të termocentraleve dhe të aktiviteteve minerare të nxjerrjes së linjtit (mihjeve sipërfaqësore). Mirëpo vendbanimet të cilat preken drejtpërdrejt dhe kërkojnë tretman të veçantë (për zhvendosje) janë: Sibovc, Hade, Shipitullë dhe Leshkoshiq (Lajthishtë). Në këto vendbanime jetojnë rreth 7000 banorë. Gjatë vitit 2004/05 nga vendbanimi Hade janë zhvendosur 158 familje (664 banorë) si pasojë e rrëshqitjeve të shkaktuara nga aktivitetet minerare.






Foto 8. Pamje e fshatit Hade. Burimi: IPH / MMPH.

Objektet, qendrat dhe zyrat e institucioneve qeverisëse dhe të infrastrukturës e të shërbimeve komunale si ato sociale, të sigurisë, rekreative, kulturore, prodhuese dhe tregtare që janë në zonën me interes të veçantë ekonomik të FMR-së, shtrirja e të cilave mund të shihet në hartën 20, numërohen:

Harta 20. Objektet e infrastrukturës sociale dhe të shërbimeve në zonën e FMR-së. Burimi: IPH / MMPH.



#### Objektet e administratës publike:

- Qendrat komunale në Obiliq dhe Fushë Kosovë
- Zyret komunale për punsim në Obiliq dhe Fushë Kosovë
- Qendrat për punë sociale në Obiliq dhe Fushë Kosovë
- Zyret komunale për pensione në Obiliq dhe Fushë Kosovë
- Zyre e ofiqarisë në Bardhë

**Objektet edukative arsimore:**

- Qerdhe të fëmijve janë 2 në FushëKosovë dhe një në Obiliq;
- Shkolla fillore dhe të mesme janë në Fushë Kosovë – qendër urbane 4, 2 në Bardh të Madh dhe nga një në Lismir, Kuzmin, Pomozotin, Vragoli, Sllatinë, Bardh të Vogël, Graboc të Ulët, kurse në Komunën e Obiliqit – qendër urbane 2 dhe nga një në Milloshevë, Plemetin, Siboc, Leshkoshiq (Lajthishtë), Shipitullë, Caravadicë (Palaj), Graboc i Epërm, Hade, Krushec (Dardhishtë) dhe Mazgit, përderisa në Prilluzhë, Gllavotin, Bivolak dhe Zhilivodë janë nga një në komunën e Vushtrisë si dhe në atë të Drenasit në Vasilevë;

**Objektet shëndetësore:**

- Qendra kryesore të mjekësisë familjare (QKMF) janë nga një në Fushë Kosovë dhe Obiliq;
- Qendra të mjekësisë familjare (QMF) ose Ambulanca janë nga një në Vragoli, Sllatinë, Bardh i Vogël, Bardh i Madh dhe Graboc i Poshtëm në komunën e Fushë Kosovës, kurse në komunën e Obiliqit kemi në Plemetin, Caravadicë (Palaj) Shipitullë, Siboc dhe Milloshevë.

**Objektet e sigurisë publike:**

- Stacioni policor në Obiliq dhe Fushë Kosovë
- Stacioni policor rajonal i trafikut në Fushë Kosovë
- Stacioni i policisë në Prilluzhë;
- Njësia operative për intervenime kundër zjarrit pranë KEK-ut dhe në Fushë Kosovës
- Njësia ushtarake në Pomozotin (Komuna e F. Kosovës);

**Objektet dhe institucionet rekreative:**

- Stadionet futbollistike në Obiliq dhe Fushë Kosovë
- Fusha e hendbollit në Obiliq
- Halla e sporteve në Obiliq (në ndertim)
- Objekte tjera sportive në Fushë Kosovë janë 2 dhe nga një në Lismir, Sllatinë, Bardh i Madh, Milloshevë dhe Prilluzhë,
- Parku në qendër të qytetit në Obiliq
- Qendra rinore në Plemetin
- Hotelerike në Fushë Kosovë janë 3 sosh, Sllatinë 4, Vragoli 2 dhe Obiliq

**Objektet kulturore-historike, fetare dhe të përkujtimeve:**

- Shtëpi kulture në: Obiliq, Milloshevë, Prilluzhë dhe Fushë Kosovë;
- Shtëpi muze në Hamidi;
- Mulli uji në Graboc të epërm dhe
- Xhamitë janë në: Obiliq të vjetër, Obiliq të ri, Mazgit të Ulët, Hade, Hamidi, Siboc, Graboc të epërm, Milloshevë, Krushec (Dardhishtë), Fushë Kosovë (4), Bardh të Madh dhe Sllatinë nga 2 sosh, kurse nga një në Lismir dhe Vragoli, Zhilivodë, Bivolak dhe Gllavotin;
- Kishat janë në: Obiliq, Plemetin, Prilluzhë dhe Fushë Kosovë;
- Monumente përkujtimeve: të martirëve të lirisë në Obiliq, i Ferid Currit në Mazgit të ulët si dhe të martirëve të luftës së UÇK-së në Hade dhe Shipitullë

**Objektet për shërbim me karburante:**

- Pikat e karburantit në Fushë Kosovë janë 4, Vragoli 4, Sllatinë 4, Bardh i Madh 2, Obiliq 3, Milloshevë 3 dhe Llazarevë 1.

**Objekte prodhuese:**

Në komunën e Fushë Kosovës janë fabrikat si ajo e Miellit, Thertorja, Qumështorja, Ushqimit për kafshë, e Llaqeve, e Barnave etj, kurse në atë të Obiliqit, përveç objekteve termoenergetike mund të përmendim edhe 4 objekte për përpunimin dhe paketimin e gjërave ushqimore si dhe 4 Depo për materiale ndërtimore, 2 fabrika për përpunimin e plastikes dhe të gomës.

#### 1.2.4. ZHVILLIMI EKONOMIK

Zhvillimi ekonomik i zonës me interes të veçantë ekonomik varet kryesisht nga prodhimi i energjisë elektrike dhe zhvillimi i aktiviteteve minerare e që paraqiten si industritë kyçe në këtë zonë, duke përfshirë edhe aktivitetet në fushën e bujqësisë. Një prej potencialeve më të mëdha që i ndihmon zhvillimit ekonomik të kësaj zone poashtu janë edhe rrugët magjistrale M2 në relacionin Prishtinë – Mitrovicë dhe M9 në relacionin Prishtinë - Pejë.

Pasuria e thëngjillit në këtë zone e cila është në eksploatim të kontrolluar, në të ardhmen e afërt e cila planifikohet të zgjerohet njëherit do të përcillet edhe me zhvendosjen graduale të vendbanimeve të cilat ndodhen mbi rezervat e linjtit.

Nga zhvillimi ekonomik i kësaj zone varet edhe zhvillimi i qëndrueshëm i tërë vendit që kryesisht ndërlidhen me potencialet e trashëguara të gjenerimit të energjisë. Kjo do të thotë që përveç përparësisë që ofron kjo trashëgimi kryesisht industriale, ka edhe problemet e veta në lidhje me nevojat për investime të reja në sektorin e energjisë dhe të minierave, dhe si rrejedhojë zhvendosjen e fshatrave brenda zonës minerare.

##### Industria

Minierat dhe prodhimi i energjisë elektrike janë industritë kyçe në këtë zonë dhe lirisht mund thuhet se kjo zonë është qendër ekskluzivisht industriale, në të cilën gjenden kapacitetet gjeneruese të Termocentraleve Kosova A dhe Kosova B.

Reparti i gazifikimit, ngrohtorja industriale dhe ai i prodhimit të plehrave artificiale që janë në lokacionin e zonës industriale "Kosova A" janë mbyllur më shumë se dy dekada më parë. Ekzistojnë gjithashtu dy "tertore", për prodhim dhe shitjen e thëngjillit tek palët e treta, mirëpo shfrytëzimi i këtyre kapaciteteve përdoret vetëm 3 - 5%.

Aktivitetet e KEK-ut, që përfshijnë rreth 5,100 punëtorë, sigurojnë punësim dhe të hyra primare për shumicën e banorëve të disa fshatrave të zonës.

##### Tregtia

Tregtia në këtë zone është bërë sektori më aktiv sidomos në dekadën e fundit. Tregtia ka marrë hov në zhvillimin e saj në formë të bizneseve të vogla dhe të mesme. Nëse shikohet me kujdes, përgjatë dy akseve rrugore që përshkojnë këtë zonë, magjistrale Prishtinë – Mitrovicë dhe asaj Prishtinë – Fushë Kosovë - Pejë, shihet një numër i përqendruar i aktiviteteve biznese dhe ndërmarrjeve tregtare.

Ndërsa, shumica e ndërmarrjeve apo bizneseve të regjistruara në lokalitetet e fshatrave të kësaj zone janë biznese të vogla tregtare që kanë të punësuar 2-3 persona.

Duke u bazuar në analizat hapësinore të komunave që gjenden brenda kësaj zone të interesit të veçantë të hartuara nga IPH/MMPH, nga të dhënat e regjistrimit të bizneseve rezulton se sektori i tregtisë pas sektorit industrial është dominues ndaj sektorëve të tjerë.

##### Bujqësia

Në zonën e FMR-së, bujqësia është zhvilluar tradicionalisht nga familjet e mëdha dhe ka qenë aktiviteti kryesor ekonomik jashtë sektorit të energjisë dhe minierave. Përafërsisht 60 % e popullatës që jetojnë në këtë rajon janë bujq që kultivojnë drithëra, kryesisht grurin dhe misrin. Korrja dhe bluarja e drithërave kryesisht është e rregulluar në formë kooperative dhe në formë individuale. Nuk ka ndonjë fermë të madhe blegtorale, mirëpo kryesisht ka ferma të vogla dhe të mesme të deleve dhe derrave në fshatin Caravadicë (Palaj).



Si biznese, aktivitetet bujqësore në sektorin e bujqësisë nuk figurojnë të regjistruara mirëpo është evidente se ato janë ndër aktivitetet primare familjare. Prandaj, zona e FMR-së karakterizohet me aktivitete tipike rurale (bujqësi dhe pylltari) për rreth fshatrave.

Pronësia e tokës ndryshon sipas vendbanimeve, por shumica e banorëve kanë tokën në pronësi ku ata jetojnë dhe një oborri rreth shtëpisë që shfrytëzohet për prodhime bujqësore të nevojave vetanake. Sidoqoftë, rëndësia ekonomike e bujqësisë në zonë është në rënie. Sot shumë fusha me tokë kualitative bujqësore janë të lëna djerrë dhe shumica prodhojnë vetëm për konsum familjar.

Nivelet e të ardhurave në fshatrat e anketuar janë të ulëta dhe shumica e banorëve varen nga bujqësia ekstensive për mbijetesë, për pjesën më të madhe të ushqimit, në mos tërë ushqimin.

Të hyra tjera ndihmëse, sipas familjeve të anketuara, krijohen përmes aktiviteteve të tjera si në fig. 13, përmes prerjes së druve dhe fermave të vogla.

Rreth gjysma e popullsisë i shtojnë të ardhurat për 10% nga prodhimet bujqësore ( shitja e qymështit dhe bylmetit), kurse 40% e popullsisë plotësojnë të hyrat buxhetore nga shitja e prodhimeve të tjera bujqësore duke ngritur të ardhurat e përgjithshme familjare për 20%. Ndërsa 15% e popullsisë përmes prodhimeve të mishit ngrisin të ardhurat e tyre për 40%. Prerja e drunjëve i shton të ardhurat për 10% të buxhetit familjar të 25% e popullsisë së anketuar.




Figura 13. Grafiku i të hyrave ndihmëse në ekonomitë familjare. Burimi: VSMS 2008, nga PATEL/MEM

## Turizmi

Turizmi në zonën e interesit të vacant ekonomik nuk ka nodnjë zhvillim të dukshëm. Pasi që zona konsiderohet të jetë një nga zonat me mundësi më të mëdha të zhvillimit të industrisë se të sektorëve të tjerë të ekonomisë, turizmi si sektor ka zhvillim të limituar. Përgjashtim bën turizmi kulturor, por ky lloj i turizmit ka një sezon shumë të shkurtër. Një nga monumentet kulturo - historike të rëndësisë së madhe është "Tyrbja e Sulltan Muratit II", në fshatin Mazgit afër Obiliqit, me kapacitetin më të madh gjatë muajit maj prej rreth 20 mijë vizitorëve.

Mali i Qyqavicës i cili gjendet në pjesën veri-perëndimore të zonës së FMR-së, ka mundësi të zhvillimit të turizmit të gjuetisë. Gjithashtu, edhe në pjesën veriore të zonës, posaçërisht vendasit e fshatit Zhilivodë, në mënyrë ilegale, akoma merren me aktivitete të gjuetisë. Dikur, këto rezervate, janë vizituar në mënyrë të organizuar nga njerëz të pasionuar me gjeteti nga viset e ndryshme të Evropës, aktivitet ky që ka gjeneruar edhe të mira materiale.

## 1.2.5. INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET TEKNIKE

### Infrastruktura e transportit

**Rrugët** - Transporti rrugor për në dhe prej zonës së veçantë të FMR-së, është i zhvilluar përmes qasjes së lehtë me rrugët kryesore kombëtare të zgjeruara M2 (Prishtinë - Mitrovicë) dhe M9 (Prishtinë - Pejë), të cilat janë edhe kufinj të Veri-Lindor dhe Jug-Lindor (gati gjysma e vijës kufizuese) të zonës.

Këtu vlen të theksohet edhe lidhja direkte me autoudhën Merdare - Morinë, qës sipas projektit më të ri të Ministrinë e Transportit dhe të Postë - Telekomunikimeve, si në hartën 21 të punuar në IPH, nuk do të kalojë nëpër zonën me interes të veçantë ekonomik të FMR-së, gjegjësisht do e tangjenton atë në cepin e saj Jug - Lindor ku takohet me hekurudhën (zona industriale Prishtinë).

Lidhjet tjera apo rrugët kryesore që kalojnë mospërmasë zonës janë rrugët rajonale R220, që kalon (paralel me M2) nëpër Prilluzhë, Plemetin, Obiliq dhe Krushevc (Dardhishtë) e që lidhet në M2 si dhe asaj që ndanë në dysh zonën minerare R120, që vjen nga M2 dhe kalon përmes Obiliqit, Caravadicës (Palaj), Hades, Grabovcit të Poshtëm, Bardhit të Madh e deri në Sllatinë të Vogël ku kyçet në M9. Meqë rruga rajonale R120 është ndërprerë, për shkak të aktiviteteve minerare në skajin verior të minierës ekzistuese të Bardhit, është ndërtuar rruga tjetër e cila ka rolin zëvendësues.

Rrugët tjera, janë ato lokale, që lidhin vendbanimet përbrenda e zonës së FMR-së me rrugët rajonale dhe qendrat e tyre urbane si dhe me vendbanimet më të afërta të komunës tjetër (ndërkomunale). Këtu, për rrugë të këtij niveli, mund të përmenden:

- Ruga Veri-Perëndimore, përreth zonës së re minerare, duke filluar nga Prilluzha, Gllavotini dhe Bivolaku, që ndahet për Hamidi - Plemetin dhe për Zhilivodë, Shipitullë, Grabovc i Epëm, Grabovc i Poshtëm e deri tek Bardh i Madh;
- Ruga Qendrore, që kalojnë përmes zonës së re minerare, që prej qendrës së Obiliqit lidhet në Palaj dhe merr drejtimin e Leshkoshiqit (Lajthishtë) për në Hamidi ose në Sibovc e deri në Shipitullë apo tjetra që ndahet për Hade, dhe
- Ruga Jug - Lindore, në raport me zonën e re minerare, që lidhin Obiliqin me Mazgitin dhe me Millosheven nëpërmjet Krushecit me Nakaraden dhe Lismirin në Fushë Kosovë për të vazhduar nëpër Kuzmin e deri në Bardh të Madh.


**Hekurudhat** - Dy linja hekurudhore kalojnë përmes zonës së veçantë të interesit ekonomik. Njëra është linja Shkup-Fushë Kosovë - Mitrovicë me stacione në Krushevc (Dardhishtë), Obiliq dhe Plemetin dhe tjetra është linja Fushë-Kosovë - Pejë, me stacion hekurudhor në Kuzmin, Bardh të Madh dhe Graboc të Epërm. Duhet të theksohet këtu se edhe lokacionet e Termocentraleve ekzistuese "Kosova A" dhe "Kosova B" janë të lidhura me linjat hekurudhore.

**Transporti** - Transporti publik, në të dy qendrat komunale, të Obiliqit dhe Fushë Kosovës, që gjenden brenda zonës së FMR-së, është i bazuar në autobus dhe minibus lokalë si dhe të ndihmuar me transportin urban dhe shërbimin e taksive të Prishtinës. Lidhjet e transportit nuk i kanë të organizuara të gjitha fshatrat. Nga vendbanimet me qasje në transport publik mund të veçojmë: Obiliqin (e Ri e të Vjetër), Caravadicën (Palaj), Haden, Leshkoshiqin (Lajthishtë), Sibovcin, Hamidinë, Fushë Kosovën, Kuzminin, Vragolinë, Bardhin e Vogël, Bardhin e Madh dhe Grabovcin e Poshtëm.

**Telekomunikacioni dhe posta** - Hapësira e FMR mbulohet në tërësi nga valët e telefonisë mobile. Shërbimet i ofrojnë dy operatorët e vetëm të telefonisë mobile në Kosovë, Vala dhe Ipko. Fatkeqësisht, e njëjta nuk mund të thuhet për telefoninë fikse, sepse në rrjetin e saj nuk përfshihen të gjitha vendbanimet e zonës së FMR. Rrjeti i telefonisë fikse shtrihet në vendbanimet: Obiliq, Fushë Kosovë, Palaj, Grabovc i Epëm, Grabovc i Poshtëm, Mazgit, Hamidi (rrjet sekondar nga Plemetini), Plemetin, Kuzmin (nuk shfrytëzohet nga PTK), Vragoli, Bardh i Madh, Bardh i Vogël dhe Pomazotin, ndërkaq në Prilluzhë, edhepse ekziston infrastruktura e telekomit, nuk kemi qasje për shkaqe të natyrës politike.

Sa i përket shërbimit postar në këtë zonë, ai ofrohet në dy zyrat në Fushë Kosovë me kodet postare 12000 dhe 12010, pastaj në qendrën tranzite në rrugën Prishtinë – Fushë Kosovë(kodi postar 12010), në zyren në Obiliq me kodin postar 15000 dhe në zyren në Bardh të Madh me kodin postar 12060.

**Harta 21. Shtrirja e infrastrukturës teknike në zonën e FMR-së. - Burimi: IPH /MMPH / MTPT**



### Infrastruktura hidroteknike

**Furnizimi dhe cilësia e ujit pijshëm** - Furnizimi me ujë të pijshëm i vendbanimeve në ZIVE (Zonën e Interesit të Vecantë Ekonomik) “Fusha e Mihjes Re” bëhet nga njësitë operative në kuadër të ujësjellësit rajonal - KRUK “Prishtina”.

Njësia Operative “Ujësjellësi Obiliq”, është ndërmarrje e cila furnizon nëntë (9) vendbanimeve brenda komunës dhe furnizon me ujë të pijshëm rreth 15.000 banorë, jo vetëm të qytetit të Obiliqit<sup>20</sup>por edhe fshatrat: Obiliq i vjetër, Hade, Caravadicë (Palaj), Sibovc, Hamidi, Plemetin, Krushec (Dardhishtë), Mazgit, Milloshevë dhe Llazarevë. Bazuar në të dhënat e kësaj ndërmarrjeje, furnizimi i rregullt i banorëve me ujë për pijes bëhet nga akumulimi i ujërave nëntokësorë në tri puset me kapacitet të gjithmbarshëm prodhues prej 42 l/s (me kapacitet të tanishëm prej 3 X 14 l/s). Luhatje në kapacitetet e puseve gjatë stinëve të vitit nuk ka.

<sup>20</sup> Sipas të dhënave nga NjO “Obiliq” - 2009



Furnizimi me ujë nga burimet nëntokësore, bunarët ose pusët individuale bëhet në 4 vendbanime të komunës: Shipitullë, Grabovc, Sibovc, Hamidi.

Brenda zonës së FMR-së, në sistemin e ujësjellësit publik rajonal KRUK "Prishtina" përfshihen edhe vendbanimet e komunës së Fushë Kosovës me qendërën komunale Fushë Kosovë dhe fshatrat Lismir, Kuzmin, Vragoli, Bardh i Madh, Bardh i Vogël, Pomazotin si dhe fshati Prilluzhë në komunën e Vushtrrisë.

Sa i përket cilësisë së ujit të pijshëm, nga të dhënat e disa operatorëve dhe që janë konfirmuar nga Instituti Kombëtar për Shëndetësi Publike (IKSHP), situata e tanishme në këtë zonë është si në vijim:

- Kualiteti i ujit që del nga grykëderdhjet e fabrikave për përpunimin e ujit është në pajtim me kualitetin sipas standardeve Evropiane<sup>21</sup>.
- Nuk përdorën sasi të mjaftueshme të klorit për dezinfektimin e ujit dhe asnjë nga burimet e ujit të pijshëm nuk është i mbrojtur;
- Ekziston rreziku shëndetësor sa i përket kontaminimit me ujë të pijshëm, duket përfshirë sëmundjet nga bakteret që zhvillohen në ujë, sidomos diarea.
- Një burim tjetër i kontaminimit është depërtimi i ujërave që përmbajnë parazitë nëpër gypat lidhës kur këta gypa nuk janë nën presion të duhur
- Pajisjet personale apo gjysmë-kolektive rrallë herë janë të dizajnuara dhe të mirëmbajtura siç duhet dhe pusët e cekëta shpeshherë nuk kanë fare zona mbrojtëse përreth

Objektet për furnizim me ujë, duket se janë në gjendje të mirë dhe në përgjithësi të mirëmbajtura, megjithatë, kontaminimi i burimeve të ujit është vërejtur.

Humbjet e sasisë së ujit të prodhuar, janë:

Në sistemin prodhues:	5 %
Në gypat kryesor:	10-15 %
Në rrjetin shpërndarës:	20-25 %
Humbjet e përgjithshme:	35-45 %


**Rrjeti i kanalizimit** - Sipas VSMS, në sistemin e kanalizimit të ujërave të zeza përfshihen vendbanimet: Obiliq, Obiliq i vjetër, Mazgit, Krushevc (Dardhishtë), Caravadicë (Palaj), Milloshevë dhe Llazarevë dhe Plemetin (të gjitha në komunën e Obiliqit), pastaj Fushë Kosovë, Lismir, Kuzmin, Vragoli, Bardh i Madh, Bardh i Vogël, Pomazotin (nga komuna e Fushë Kosovës) dhe Prilluzhë në komunën e Vushtrrisë. Nuk ka të dhëna të sakta për numrin apo përqindjen e banorëve të zonës, që kanë qasje në sistemin e kanalizimit, mirëpo vlerësohet që në territorin e komunave të Obiliqit dhe Fushë Kosovës diku rreth 60 % e banorëve kanë qasje.

<sup>21</sup> Daniel Ludier, Raporti për menaxhimin e resurseve ujore

## Infrastruktura e energjisë elektrike

**Rrjeti i bartjes së energjisë elektrike.** – Bartja e energjisë së prodhuar elektrike në këtë zonë sigurohet nga Operatori Kosovar i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) Sh.a.

Vendbanimet në zonën e FMR-së janë të lidhura me rrjet nga linjat lokale për furnizim. Mbi basenin e linjitit, apo më saktë mbi fushën e re të mihjes me qendër Sibovcin, në kuadër të FMR-së së planifikuar, siq shihet edhe në hartën 22, nuk kalon ndonjë linjë transmisioni me rëndësi rajonale.




**Harta 22. Rrjeti i bartjes së energjisë elektrike në dhe rreth zonës FMR - Burimi: PHK - IPH / MMPH**

Gjatësia e tërësishme e linjave të bartjes (400 kV, 220 kV dhe 110 kV) është rreth 1.100 km. Rrjeti i bartjes në Kosovë, posaçërisht linja prej 400 kV-ve, është dëmtuar pjesërisht gjatë kohës së luftës. Përderisa, sistemi i linjave të bartjes është kthyer në funksion, pas riparimeve të kryera të pasluftës, janë ndërtuar edhe nënstacionet të reja 400 / 110 kV (p.sh. në Pejë).

Rrjeti i bartjes prej 400 dhe 220 kV-ve në kuadër të sistemit elektroenergetik të Kosovës është pjesë integrale e sistemit të ndërlidhur rajonal të transmisionit. Përveç me Republikën e Shqipërisë, ku lidhja është vetëm në nivelin e tensionit 220 kV-ësh, përmes nënstacionit në Prizren deri në HC Fierzë – Shqipëri.

Sistemi elektroenergetik Kosovar i bartjes së energjisë elektrike është i ndërlidhur me të gjitha sistemet e shteteve tjera fqinje në nivelin e tensionit 400 kV-ësh. Mirëpo, pritet që në vitin 2012, do të jetësohet edhe linja e re 400 kV, si në hartën 23, nga nënstacioni 400 / 220 kV afër Kosovës B me nënstacionin Kashar të Shqipërisë.



Harta 23. Shtrirja e rrjetit të transmisionit energjisë elektrike në Kosovë dhe lidhjet me rajon - Burimi: KOSTT marr nga PATEL/MEM

## Menaxhimi i mbeturinave

Ndërmarrja Rajonale e Mbeturinave në Prishtinë "Pastrimi" është duke organizuar marrjen, transportimin dhe deponimin e mbeturinave të krijuara, nga banorët që jetojnë e veprojnë brenda territoreve të komunave të Prishtinës, Glogocit (Drenasit), Fushë Kosovës, Obiliqit dhe atë të Lipjanit.

Deponia Sanitare Rajonale (e pajisur me bazën e kullimit, mirëpo pa trajtim të mëtutjeshëm), është me kapacitet mujor prej 6.000 tonëve ose kapaciteti i saj i gjithmbarshëm është prej 3.500.000 m<sup>3</sup>, për deponimin e mbeturinave të grumbulluara nga 725.251 banorë.

Lokacioni i Deponisë Rajonale Sanitare të Prishtinës, me shtrirjen e saj prej 50 hektarëve, është e vendosur në pjesën veri-lindore të Minierës ekzistuese të Mirashit dhe planifikohet të ketë jetëgjatësi prej 15 viteve.



### 1.3. ZONA e "FMR-së" NË KONTEKST TË PLANIFIKIMIT

#### Zona në kontekst me Planin Hapësinor të Kosovës

Në raport me draft Planin Hapësinor të Kosovës, zona e interesit të veçantë ekonomik për FMR-në është pjesë përbërëse e Hapësitës së Kaltër (Porti i Kosovës) i cila përfshinë Prishtinën si qytet referues në qendër dhe disa komuna përreth duke përfshirë Obiliqin, Fushë Kosovën dhe Drenasin. Hapësira e Kaltër karakterizohet me një sërë funksionesh hapësinore dhe synime të zhvillimit të fokusuar në administratë, arsimim, kujdes shëndetësor, shërbime dhe tregti, industri e lehtë, turizëm por edhe bujqësi jashtë qendrave ekonomike.

Zona me interes të veçantë ekonomik "Fusha e Mijes së Re", si në fig. 14, është e vendosur në Veri të Trekëndëshit të Zhvillimit Ekonomik të Kosovës (TZHEK) si pjesë përbërëse e Hapësitës së Kaltër që për nga funksioni paraqet qendrën kryesore të zhvillimit në Kosovë. TZHEK-u parashihet të jetë boshti kurrizor i zhvillimit ekonomik i interesit nacional, një burim i të hyrave për ekonominë Kosovare, dhe një lokacion potencial për investuesit e jashtëm të mundshëm. Prandaj, në kontekst të zhvillimit të gjerë hapësinor, zona e "FMR"-së paraqet mbështetësin kryesor të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në përgjithësi dhe në veçanti është në përkrahje direkte të Trekëndëshit të Zhvillimit Ekonomik.




Figura 14. Skema e raportit në mes zonës së FMR-së, TZHEK-ut dhe Autoudhës nga PHK 2010-2020+. - Burimi: IPH / MMPH

Planin Hapësinor i "FMR"-së dhe zhvillimet e parapara janë në harmoni të plotë me qëllimet e parapara në Planin Hapësinor të Kosovës. Nga konfliktet më të theksuar në mes sektorëve të ndryshëm janë identifikuar: toka bujqësore dhe shfrytëzimi i sajë - me mihjen e planifikuar sipërfaqësore dhe mjedisi me prodhimin e energjisë.

Zona e interesit të FMR është e vendosur në një zonë me potencial të lartë të zhvillimit bujqësor, prandaj si e tillë është trajtuar në detaje dhe ka qenë

temë e diskutimeve në shumë takime ndër-sektorale. Mendim i të gjithë pjesëmarrësve është se - në rrethanat ekzistuese ekonomike, përparësi duhet të ketë konsolidimi i prodhimit të energjisë për nevoja të industrisë përpara shfrytëzimit të kësaj zone për nevoja të bujqësisë. Në bazë të planit, shtresa e tokës kualitative bujqësore do të hiqet, për tu rikultivuar dhe përdorur si tokë bujqësore, pas shfrytëzimit të linjtit që ndodhet nën të. Kjo është procedura e cila do të aplikohet në të gjithë sipërfaqen e paraparë për mihje sipërfaqësore, e cila përfundimisht do të kthehet në tokë bujqësore sipas fazave të parapara me planin e mihjes.

Konflikti më i shprehur momental është prodhimi i energjisë dhe ndikimi i tij në mjedis. Duke ju referuar të dhënave nga burime të ndryshme, ndotja momentale që shkaktohet nga impiantet ekzistuese, për disa parametra i tejkalon standardet e lejuara ndërkombëtare. Prandaj, duke ju referuar rekomandimeve të ekspertëve të fushës energjetike, është planifikuar që kapacitetet e reja energjetike të respektojnë në mënyrë rigoroz standardet e kërkuara. Ndërtimi i kapaciteteve të reja do të krijoj kushte që impiantet e vjetra të mbyllen, në mënyrë që ndikimet në mjedis të jenë minimale.

## Zona në kontekst me planet zhvillimore dhe analizat komunale

### *Konteksti i zhvillimit hapësinor*

Zhvillimi i paraparë i sektorit të energjisë dhe minierave kryesisht do të ndikojë në Komunën e Obiliqit. Do të forcojë rolin e komunës së Obiliqit që do të jetë si qendër e gjenerimit të energjisë elektrike për Kosovë me efekte përkatëse në ekonomi dhe punësim. Megjithatë, në të njëjtën kohë do të ketë implikime hapësinore për një kohë të gjatë. Kjo do të ketë një ndikim shumë kufizues në shfrytëzimin e tokës dhe opsionet tjera zhvillimore në hapësirën komunale. Zhvillime të rëndësishme në të ardhmen të komunës së Obiliqit do të varet në masë të madhe nga situata dhe zhvillimet në zonën e FMR-së. Edhe Komuna e Fushë Kosovës do të përjetoj ndryshime hapësinore, kryesisht me ndikime pozitive, në periudhën afat-mesme. Këtu, sipërfaqe të konsiderueshme të tokave bujqësore aktualisht janë të degraduara, kryesisht nga miniera ekzistuese e Bardhit, të cilat do të ri-kultivohet në të ardhmen. Sipërfaqet e mbuluara me deponimin e djerrinës të vendosura në jug të zonës **aktuale** kanë potencial të bëhen toka bujqësore apo pyjore. Ndërsa, në dy komunat tjera pjesëmarrëse në zonë implikimet janë më pak të shprehura. Përderisa, në komunën e Vushtrrisë, pjesa më e ndikuar nga ndotja, zhurma dhe në peizazh do të jetë zona rreth fshatrave - Zhilivodë dhe Bivolak, në komunën e Drenasit, implikimet në hapësirë të ndikuara nga zhvillimet janë më të vogla dhe atë në zonën kadastrale të Vasilevës.

### *Planet dhe Analiza Hapësinore komunale*

**Komuna e Obiliqit** në Asamblenë e saj komunale i ka miratuar Planet Zhvillimore, Komunal dhe Urban, të hartuara në bashkëpunim me kompaninë fituese të tenderit për këtë qëllim. Zbatimi i këtyre dy planeve si një tërësi, apo atij komunal të ndarë veç, duhet të jetë në harmonizim të plotë me këtë Plan Hapësinor të zonës me interes të veçantë ekonomik – për "Fushën e Mihjes së Re".

Analiza Hapësinore për Komunën e Obiliqit, e përgatitur që para tri viteve nga Instituti për Planifikim Hapësinor (IPH), paraqet dokumentin bazë dhe lehtësim për përgatitjen e planeve zhvillimore komunale. E veçanta e shprehur aty, është në të mbuluarit e zhvillimeve minerare dhe gjeneruese në zonën e FMR-së me qëllim të reduktimit të ndikimeve në vendbanimet e prekura si dhe të sigurojë udhëzime për zhvillimet hapësinore në të ardhmen. Aty, po ashtu, ofrohen edhe orientimet të përcaktuara në shfrytëzimin e tokës në veçanti si dhe kushtet e volitshme për zhvillimin e asaj zone.

**Komuna e Fushë Kosovës** ka filluar me hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor, edhe pse disponon me Planin Zhvillimor Urban, të hartuar më parë mirëpo jo sipas këtij Ligji. Komuna e Fushë Kosovës poashtu gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal duhet të bazohet në këtë plan hapësinor për zonën me interes të veçantë ekonomik – PH për 'FMR-në'.

**Komuna e Vushtrrisë** e ka të përfunduar Planin Zhvillimor Komunal, i cili, sipas nevojës për zbatim, duhet të përshtatet dhe të jetë në pajtueshmëri me rekomandimet që dalin nga ky PH për zonën me interes të veçantë të FMR-së.

Analiza hapësinore e Komunës së Vushtrrisë është hartuar nga IPH/MMPH dhe padyshim ka shërbyer si dokumenti bazë për hartimin e të dy planeve zhvillimore të parapara me LPH.

**Komuna e Drenasit**, edhe kjo komunë disponon me dy planet ( PZHK-në dhe PZHU-në) për të cilat ka marrë edhe pëlqimin nga MMPH-ja dhe se për zbatimin e PZHK-së duhet përshtatur me këtë PH për zonën e FMR-së.

## 1.4. RAPORTET DHE STRATEGJITË SEKTORALE

### Zhvillimi i mihjes së re

Zona e interesit të veçante ekonomik gjendet në zonën aktive të mihjes të Basenit të linjtit të Kosovës. Minierat ekzistuese sipërfaqësore, të Mirashit dhe Bardhit (me prodhim të linjtit rreth 8 milionë tonelata në vit), pothuajse janë shterur pas 3 gjegjësisht 5 dekadave të operimit dhe prodhimit. Prandaj, kanë filluar përgatitjet për eksploatimin e linjtit në të ashtuquajturën "Fushë jugperëndimore të Sibovcit" dhe minierën e Sitnicës e cila është zgjerim i minierës së Mirashit, për të siguruar furnizimin afatshkurtër të linjtit për termocentralet Kosova A dhe B. Resurset e linjtit në FRM vlerësohen të jenë rreth një miliardë tonë dhe përbëjnë një aset të konsiderueshëm të Kosovës që do të sigurojë prodhim të energjisë gjatë 5 dekadave të ardhshme.

Kurse, shikuar në aspektin cilësor, nga 8115 mostrat e nxjerra në fushën e mihjes re, rreth 92% e lignitit ka vlerë kalorike prej 8.000-9.500 kJ/kg (ose me një vlerë mesatare prej 8.548 kJ/kg), me përmbajtje shumë të ulët prej 1.01 % të sulfurit (në lagështi prej 45%) dhe përqindje të vogël prej 14.7% të mbetjes së hirit. Ndërsa, pjesa tjetër, me vetëm rreth 8 % ka vlerë kalorike prej 6 500 - 8 000 kJ/kg.

### Gjenerimi i energjisë elektrike

Kapacitetet gjeneruese të instaluar teknike dhe në dispozicion, shih tabelën 11, të dy termocentraleve Kosova A dhe Kosova B, të menaxhuara nga KEK-u (shoqëri aksionare), do të ishin të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesave bazike aktuale të konsumit vendor për energji elektrike. Mirëpo, për shkak të vjetërsisë (prej 24 deri 46 vjet), degradimit dhe mos investimit në termocentrale në Kosovë gjatë periudhës 1990-1999 dhe të operimit e të mirëmbajtjes joadekuate me vite të tëra para dhe pas lufte, siguria dhe gatishmëria e pajisjeve janë dëmtuar seriozisht. Momentalisht, gjendja është paksa më e mirë, me gjithë ngritjen e vazhdueshme të operimeve në blloqe, deri në rreth 70 % të kapaciteteve të instaluar.

Blloqet nëpër i termocentrale	Kapacitetet e blloqeve në MW			Lloji i karburant	Fillimi punës (mosha)
	Instaluar	Pragu	Në Dispozicion		
<b>TC Kosova A</b>					
Blloku A1	65	58	0	Linjit/Naftë	1962 (46)
Blloku A2	125	113	0	Linjit/Naftë	1964 (44)
Blloku A3	200	182	110-120	Linjit/Naftë	1970 (38)
Blloku A4	200	182	110-120	Linjit/Naftë	1971 (37)
Blloku A5	210	187	125-130	Linjit/Naftë	1975 (33)
<b>TC Kosova B</b>					
Blloku B1	339	309	240-260	Linjit/Mazut	1983 (25)
Blloku B2	339	309	260 - 280	Linjit/Mazut	1984 (24)

Tabela 11. Kapacitetet gjeneruese në blloqet e termoelektranave ekzistuese në Kosovë - Burimi: KEK, 2009

Pjesa më e madhe e blloqeve prodhuese të termocentralit Kosova A janë në kushte të dobëta operuese dhe me mundësi shumë të vogla për prodhim (nën nivelin e parametrave të instaluar), si pasojë e defekteve e prishjeve të papritura dhe të vjetërsisë së blloqeve. Blloqet A1 dhe A2 janë jashtë funksionit, kurse riparime dhe remonte emergjente dhe kapitale janë bërë në blloqet A3 (në vitin 2006), në A4 (në vitin 2007) dhe A5 në vitin 2008. Statusi i blloqeve në Termocentralin Kosova A do të bazohet në studimin e Dekomisionimit (2010), Strategjinë e Energjisë së Kosovës 2009 - 2018, ndërtimin e blloqeve të reja të Termocentralit Kosova e Re dhe në vendimet e Qeverisë lidhur me sigurimin e furnizimit të konsumit elektroenergjetik.



Në të dy blloqet e TC Kosova B ka rënë fuqia aktive për shkak të dëmtimeve në të gjithë rotorët e CTU të turbinës, për këtë arsye, në bllokun B1 fuqia maksimale neto është 240 MW, ndërsa në atë B2 280 MW. Kapacitetet prodhuese të këtyre dy blloqeve do të rriten dukshëm, deri në nivelin 290 – 300 MW, pasi të jenë zëvendësuar, rrotorët CTU në dy turbina si dhe rrotori i gjeneratorit në bllokun B1 gjatë vitit 2010.

Hidro-Centrali i Ujmanit (ose i Gazivodës me  $2 \times 17.5 \text{ MW} = 35 \text{ MW}$ ), është i vetëm dhe më i rëndësishëm për momentin në sistemin elektroenergetik të Kosovës që shfrytëzon resursin ujor, i cili menaxhohet nga Kompania Publike "Hidro-Sistemi Ibër - Lepenc" (shkurt HS ILE). Kurse, sa i përket hidrocentraleve tjera të vogla, si në Lumbardh, Dikancë, në Istog dhe Radavc, janë zhvilluar aktivitete në riaktivizimin ose dhënien me qira të tyre gjatë viteve 2004 - 2009.

Kapaciteti i përgjithshëm i prodhimit neto në Kosovë, prej rreth 970 MW në fund të vitit 2009, ishin nga TC Kosova A 402 MW, TC Kosova B 525 MW, HC Ujmani prej 35 MW dhe nga Hidrocentralet tjera në rrjetin e shpërndarjes 8.5 MW. Duhet theksuar se gjatë 10 vjetëve të fundit është vërejtur ndryshim i theksuar në strukturën e konsumimit të energjisë elektrike ndërmjet kategorive të ndryshme të konsumatorëve.

### Bartja e energjisë elektrike

Sistemi i bartjes menaxhohet nga KOSTT Sh.A. (Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut), operator i Kosovës për energji elektrike. Kosova është palë kontraktuese e Komunitetit rajonal të Energjisë dhe është e lidhur në sistemin rajonal përmes interkoneksioneve me Serbinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Shqipërinë.

Kosova gjithashtu gjendet në qendër të trajektores veri-jug të rrjetit të transmisionit në rajonin e Evropës Juglindore (EJL), dhe është me rëndësi për rrjedhat e fuqisë së energjisë për dhe nga Serbia, Maqedonia dhe Greqia. Rënia e cilitdo segment të këtyre linjave të transmisionit ka ndikim negativ në rrjedhat e energjisë në rajonin e EJL. Sh.a. KOSTT ka mungesë të investimeve për shkak të mungesës së fondeve në periudhat e kaluara, dhe tani ka kapacitete të mjaftueshme të bartjes, për mbulimin e kërkesës së pikut në Kosovë, gjatë periudhave dimërore.

Gjatësia e tërësishme e linjave të bartjes (400 kV, 220 kV dhe 110 kV) është 1.098,6 km me kapacitete transformuese 2550 MVA. Sistemi i linjave të bartjes është kthyer në funksionim, pas riparimeve të kryera të pasluftës, përderisa janë ndërtuar edhe nënstacionet të reja (për shembull si ai 400 / 110 kV në Pejë). Rrjeti i bartjes prej 400 dhe 220 kV-ve në kuadër të sistemit elektroenergetik të Kosovës është pjesë integrale e sistemit të ndërlidhur rajonal të transmisionit.

### Furnizimi, faturimi dhe inkasimi i energjisë elektrike

Rrjeti elektro-energetik i Kosoves mbulon 100% kërkesat e konsumatorëve në Kosovë për furnizimin me energji elektrike. Prodhimi energjisë elektrike në kapacitete ekzistuese është nën nivel të kërkesave aktuale, kështu që një pjesë e saj mbulohet nga importi. Në rrjetin elektrik në vitin 2009 ishin të kyçur 406,610 konsumatorë me bruto shpenzim vjetor 5,271 GWh.

Sfida kryesore dhe parakushte për stabilizimin e furnizimit me energji elektrike, tërheqjes së investimeve në sektorë të ndryshëm dhe zhvillim ekonomik të Kosovës në përgjithësi, janë humbjet komerciale, fatutimiefikas, dhe mospagesa e rregullt e energjisë elektrike. Humbjet komerciale (keqpërdorime dhe mospagesa nga ana e minoritetit serb) janë ende të nivelit tejet të lartë në rreth 25 %. Kjo gjendje duhet patjetër të zvogëlohet dhe me masat ligjore të eliminohet. Realizimi i pagesave të faturuara të energjisë së konsumuar elektrike është në nivel prej 81%. Mospagesa dhe keqpërdorimet janë të nivelit 35%, ose rreth 65% është realizuar inkasimi, krahasuar me energjinë në dispozicion për shitje.

Për mungesë të zhvillimit të mjaftueshëm, të rrjetit elektrik i shpërndarjes së energjisë elektrike nuk është në gjendje të mirë operimi, në mënyrë që të përballoj furnizimin e konsumit të tepruar me ngarkesa maksimale, si në linja dhe nënstacione, në periudhat dimërore. Në vitin 2006 humbjet teknike kanë qenë 18.2 %, ndërsa në vitin 2008 ato bijnë në 17.1%. Humbjet komerciale janë ende të larta me një

trend të ngadalshëm zvogëlimi sipas viteve, ku gjatë vitit 2006 kanë qenë 29.18%, dhe në vitin 2008 figurojnë të jenë 25.8%.

### Mbrojtja e mjedisit

Raporti Final i Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Social (VSMS)<sup>22</sup> është përfunduar në nëntor të vitit 2008, pas konsultimeve me ekspertët dhe publikun. Në këtë raport identifikohen në nivel strategjik çështjet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale të ndërlidhura me gjendjen ekzistuese dhe me zhvillimin e sektorit të energjisë dhe linjitet në rajonin e gjerë të Minierës së Re të planifikuar. Raporti i VSMS-së hulumton dhe shqyrton rezultatet e zgjidhjeve strategjike, që Qeveria e Kosovës (lidhur me objektivat e Strategjisë së Energjisë) dhe investitori, në të ardhmen duhet të ndërmarrin hapat adekuat në kontekst të përmirësimit të gjendjes së furnizimit dhe të zhvillimit të projekteve të reja kapitale në sektorin e energjisë. Opsionet më të rëndësishme të zhvillimit nga perspektiva mjedisore dhe sociale janë analizuar dhe ato kanë të bëjnë me lokacionin e ndërtimit të termocentralit të ri, skemën dhe dinamikën e zhvillimit të minierës, madhësinë e blloqeve të termocentralit, përzgjedhjen e teknologjisë si dhe avancimin e zhvillimit të projektit në raport me kërkesën e nivelit të prodhimit të energjisë dhe jetës së mbetur në operim të termocentraleve ekzistuese e sidomos të TC Kosova A.

Duke iu referuar Studimit Themelor Mjedisor dhe Social, studimeve dhe gjendjes aktuale mjedisore, ky raport arrin tek përfundimi se gjendja mjedisore në zonën energjetike është tejet komplekse për disa arsye:

- Gjendja mjedisore është prekur thellë nga aktivitetet minerare nga e kaluara, të cilat kanë shkaktuar edhe modifikime hapësinore të theksuara në terren;
- Cilësia e ajrit është e dobët për shkak të emetimeve nga termocentralet ekzistuese, të ndërtuara me teknologji dhe standarde të vjetra, të cilat nuk janë në pajtueshmëri me standardet aktuale të BE-së;
- Cilësi e pësuar e tokës dhe ujërave nëtokësore nga depozitimi i hirit dhe mbeturinave tjera si dhe nga veprimtaria e stabilimenteve të Tertorës, Gazifikimit dhe Azotikut në të kaluarën;
- Cilësia e ujërave sipërfaqësore është e ndikuar nga shkarkimet e ujërave të patrajuara urbane dhe industriale (nga termocentralet, aktivitetet minerare etj);
- Emetimet e zhurmës nga aktivitetet minerare janë bezdisëse për njerëzit që jetojnë në afërsi të mihjeve sipërfaqësore;
- Mungesa dhe kontrolli jo efikas mjedisor (apo mos-efikasitet i kontrollit) sa i përket ujit dhe ajrit;
- Nuk ka procedura formale për menaxhimin (mosmenaxhim) të ujërave në lokacionet industriale;
- Menaxhimi i dobët i deponisë rajonale të mbeturinave dhe jashtë standardeve mjedisore; etj

**Trajtimi i emisionit të dioksidit të karbonit (CO<sub>2</sub>).** - Republika e Kosovës, angazhohet të bëhet pjesëmarrëse UNFCCC dhe të ratifikojë Protokollin e Kyotos, përderisa ajo tani merr pjesë në procesin e diskutimit të post-Kyotos. Mbështetjen e GEF/UNDP për MMPH-në, që të bëjë përgatitjen e komunikimit të parë nacional, e përkrahë edhe MEM-i (tani MZHE).

Kosova, vazhdimisht po angazhohet të zbatojë në kohën e duhur detyrimin për t'u përmbajtur kuotave të emetimeve të lejuara nga stabilimentet e saj energjetike. Ajo, do t'u kërkojë operatorëve privat të stabilimenteve të reja gjeneruese, të respektojnë, në përputhje edhe me kushtet e tregut, të gjitha angazhimet që Kosova do të marrë përsipër në kuadër të pjesëmarrjes në marrëveshjet e përmendura më sipër.

<sup>22</sup> VSMS është hartuar si pjesë e projekti PATEL të financuar nga WB dhe EC. Rezultatet përfundimtare të VSMS-së do të informojnë njëherit edhe për hartimin e Planit Zhvillimor të Zonës së Minierës së Re e cila do të prezantoj kornizën e investimeve sektoriale dhe poashtu masat zbutëse për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve të mundshme negative të opsioneve të ndryshme zhvillimore.

## Toka bujqësore

Duke pasur parasysh zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë së vendit Qeveria e Kosovës e bazuar në Strategjinë e Energjisë së aprovuar ka prioritet zhvillimin e sektorit të energjetikës përmes hapjes së minierës së re dhe ndërtimit të Termocentralit Kosova e Re.

Është evidente se Republika e Kosovës mund ta ndërtoj një të ardhme të sigurt duke zhvilluar sektorin e energjetikës bazuar në shfrytëzimin e linjtit duke respektuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të ruajtjes së tokës bujqësore. Në Kosovë, zhvillimit të sektorit të energjetikës, duhet të konsistoj krahas përfitimit të energjisë elektrike nga djegëja e linjtit të shfrytëzohet edhe resurset e ripërtrishme të energjisë, si burimet e ujit, erës, biomasës, solare, etj..

Fusha e Mihjes së Re, karakterizohet me shfrytëzimin e sipërfaqeve të mëdha të tokës bujqësore për ushtrimin e veprimtarisë minerare, gjë e cila njëkohësisht, shkakton degradim të plotë ose të përkohshëm të tokës për përdorim të nënsektoreve bujqësore.

Veprimet dhe aktivitetet, që do të zhvillohen në FMR, e që për rezultat do të sjellin ndryshime në destinimin e tokës bujqësore janë:

- Hapja e minierës së re (në Fushën "C" ose me qendër Sibovcin);
- Vendosja e paisjeve për transportimin e linjtit dhe gypat për transport hidraulik të hirit;
- Rivendosja e vendbanimeve të zhvendosura në sipërfaqet e reja të tokës bujqësore;
- Ndotja e tokave bujqësore për rreth termocentralit nga pluhuri që del nga tymtarët, nga shirat acidik si dhe nga deponite e hirit (që llogariten të kenë një radius veprimi në tokat bujqësore për rreth).

Foto 9. Pamje e tokës bujqësore në zonën e interesit. – Burimi: IPH / MMPH





## 1.5. ANALIZA SWOT

Bazuar në të dhënat e deritanishme, mbi gjendjen ekzistuese të zhvillimeve hapësinor, sipas sektorëve të ndryshëm, në kuadër të kësaj zone, është hartuar dhe paraqitur në vazhdim, instrumenti apo vegla e njohur si analiza SWOT (shkurtesë kjo në gjuhën anglishte që tregon për Strengthenes – Përparësitë, Weaknesses – Dobësitë, Opportunities – Mundësitë dhe Threatness – Rreziqet apo kërcnimet) për zonën e FMR-së. Nëse duam ta kemi shkurtesën e kësaj analize edhe në gjuhën shqipe, kur për Dobësitë – që janë njëjtë me të Metat, për Përparësitë – janë Avantazhet, Kërcënimet - Rreziqet si dhe për Mundësitë – janë Shanset, atëherë analiza me këtë shkurtesë do të quhej - "Analiza MARrSh".

Analiza SWOT (MARrSh në shqipe), e ndërtuar me informatat që dalin nga Profili zhvillimor si fazë (apo kaptinë) e parë, jep pasqyrë më të qartë të për rezultatet mbi gjendjen ekzistuese të zonës dhe ndihmon shumë për në fazat e ardhshme, të planifikimit të zhvillimeve, gjatë procesit të hartimit të këtij Plani Strategjik Hapësinor.

Të dhënat e rreshtuara dhe mbi të Metat/Dobësitë si dhe për Avantazhet/Përparësitë e zonës, janë informata që dalin nga këndvështrimi dhe ndikimi i brendshëm, të cilat njoftojnë opinionin mbi gjendjen faktike dhe udhëzojnë vendim-marrësit dhe ekspertët e planifikimit për të orientuar zhvillimin e ardhshëm të zonës së interesit.

Ndërsa, të dhënat që dalin nga këndvështrimi dhe ndikimi i jashtëm ose ai ndërkombëtar, janë të dhëna të cilat njoftojnë opinionin dhe orientojnë vendim-marrësit dhe ekspertët e planifikimit, për kujdesin rreth interesave që mund të paraqiten në formë të rreziqeve dhe të shanseve, në rast të moszbatimit apo zbatimit të zhvillimeve të ardhshme të planifikuara për hapësirën e zonës së interesit.

Informatat që marshojnë të listuara në vazhdim, për zonën me interes të veçantë ekonomik - 'Fusha e Mihjes Re', janë të trajtuara veçmas sipas grupimeve të theksuara si më lartë:

### 1.5.1. TË METAT (OSE DOBËSITË)

1. Ndryshimi i strukturës hapësinore dhe mjedisit - Degradimi i mjedisit;
2. Mungesë e krijimit të zonës mbrojtëse (tampon) rreth minierave;
3. Mungesë e impiantit për pastrimin e ujrave industriale
4. Mungesa e impiantit për pastrimin e ujrave urbane;
5. Prezenca e deponive të hapura të hirit;
6. Mungesë e sistemit monitruar për ajër, ujë dhe tokë;
7. Humbja e tokës bujqësore;
8. Mungesa e PZHK-ve për Komunitet Obiliq dhe Fushë Kosovë;
9. Zhvendosja e vendbanimeve nga Fusha e Re e Mihjes;
10. Infrastruktura e vjetruar në rrjete të furnizimit (ujësjellës, kanalizim, energjetik etj);
11. Mangësi në kornizën legjislative për dislokimin dhe zhvendosjen e vendbanimeve;
12. Vjetërsia e kapaciteteve gjeneruese (TC Kosova A);
13. Reduktimet e energjisë elektrike;

### 1.5.2. AVANTAZHET (OSE PËRPARËSITË)

1. Rezerva të konsiderueshme nëntokësore të linjtit me kosto më të ulët prodhimi në basenin e Kosovës;
2. Infrastruktura fizike bazë për zhvillimin e sektorit të energjisë;
3. Kuadro me përvojë në fushën e energjetikës;
4. Institucione adekuate të planifikimit hapësinor (IPH, DPH/MMPH);
5. Institucione për monitorim mjedisor (AKMM, IHMK, DMM; INKOS);
6. Kornizë ligjore bazë në sektorët për planifikim, të mjedisit, energjisë dhe atë të minierave;
7. Zonë në qendër të Kosovës për gjenerim të energjisë elektrike e Kosovës;
8. Infrastruktura sistemit të transmisionit dhe lidhje e mirë me shtetet fqinje përmes linjave të interkoneksionit;
9. Infrastruktura ekzistuese dhe potenciale për zhvillimin e sektorit të minierave;
10. Interesimi i sektorit privat për investime;
11. Pjesëmarrja e komunitetit në procesin e planifikimit dhe vendim marrjes;
12. Popullsia me moshë të re dhe aktive për punë;

### 1.5.3. RREZIQET (OSE KËRCËNIMET)

1. Vonesa në marrjen e vendimeve bazë për projektin Kosova e Re;
2. Mos ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese - krijon varësi importi të energjisë elektrike, vazhdim të reduktimeve dhe nuk zëvendësohet Kosova A;
3. Ofrimi i kushteve më të favorshme nga vendet fqinje për Investitor në sektorin e energjisë;
4. Mos zbatimi i standardeve mjedisore sipas termineve të përcaktuara të BE-së në kapacitete ekzistuese të gjenerimit në TC Kosova A;
5. Mos rehabilitimi teknik dhe mjedisor të blloqeve në TC Kosova B sipas termineve të planifikuara;
6. Zvogëlimi i vendeve të punës me aplikimin e teknologjive të avancuara;
7. Mos realizimi i projektit të linjës 400 kV Shqipëri-Kosovë;
8. Vonesa në Zhvendosje të vendbanimeve sipas planit Xehetar të avancimit të mihjes.

#### 1.5.4. SHANSET (OSE MUNDËSITË)

1. Furnizimi i pandërprerë i konsumit vendor me energji elektrike nga burimet vendore në zhvillim ekonomik të vendit;
2. Republika e Kosovës të bëhet faktor konkurrues në tregun rajonal të energjisë;
3. Shfrytëzim i përvojave të vendeve të zhvilluara për zhvillimin e këtij sektori;
4. Hapja e vendeve të reja të punës dhe të shërbimeve gjatë ndërtimit të TC- së Kosova e Re dhe Mihjes së re;
5. Procesimi, kapja dhe prodhimi i CO<sub>2</sub>;
6. Shfrytëzimi i hirit dhe gjipsit për prodhimtari ndërtimore;
7. Rikuperimi dhe rikultivimi i dëmeve të trashëguara;
8. Përdorimi i teknologjive më të avancuara konform normave dhe standardeve të BE-së;
9. Rritja e interesimit për edukim në lëmin e energjisë;
10. Shfrytëzimi i ujit procesor për ngrohje qendrore;

## 1.6. VLERËSIMI I KAPACITETEVE INVESTIVE

### Investimet në sektorin e energjisë në periudhën 1999-2008

Vlerësimi i kapaciteteve investuese është hulumtim i potencialit dhe burimeve të mundshme për financimin e planeve dhe politikave zhvillimore për një territor të përcaktuar për zhvillim. Rezultatet nga këto analiza duhet të përdoren si bazë e të dhënave, që do të mundësojnë identifikimin e mundësive për investim në territorin përkatës. Duke u bazuar në këto mundësi, krijohet një pasqyrë më reale e përzgjedhës së projekteve dhe programeve që do të jenë specifike për zonën. Këto kapacitete të investimeve përbëhen nga: kapacitetet e sektorit publik, të atij privat, të partneritetit publik-privat (PPP), kreditë dhe grantet, fondet ndërkombëtare, donacionet, etj.

Në rastin e zonës me interes të veçantë ekonomik – "Fusha e Mihjes së Re", sa i përket investimeve dhe interesit të gjithmbarshëm për zhvillim të zonës, situata definitive nuk është e përcaktuar me saktësi. Përveç disa projekt-planeve me vlera investive të qarta që vijnë nga sektori për miniera dhe energji nuk ka projekt-plane nga sektorët tjerë me kapacitete apo me vlerësime të përcaktuara të investimeve. Qartësia mbi kapacitetin e investimeve në sektorin për energji dhe miniera, bazohet në studimet - hulumtimet dhe obligimet e mëhershme të realizuara nën mbikëqyrje të Qeverisë së Kosovës si dhe në informatat e drejtpërdrejta nga Ministria e Energjisë dhe Minerave.

Natyrisht, për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike, që po ballafaqohet Republika e Kosovës kundruall nivelit të ulët të buxhetit të saj publik, zhvillimet janë paraparë të realizohen në partneritet me sektorin privat, i cili do të mbulojë pjesën më të madhe të investimeve.

Gjendja e objekteve dhe sistemeve në sektorin energjetik, e trashëguar pas luftës, ka kërkuar mjete të konsiderueshme financiare prej rreth 320 milion €. Kjo shumë ka shërbyer vetëm për aktivizimin, sanimin e gjendjes së krijuar, në periudhën 1990-1999, për vazhdim të punës së objekteve me kapacitete të reduktuara në sektorin e linjtit, prodhimit të energjisë elektrike dhe të ngrohjes.

Prej fundit të vitit 1999 deri në vitin 2008, përveç mjeteve vetanake të KEK-ut dhe ndërmarrjeve të ngrohjes, sektori i energjisë ka pranuar rreth 1,052 milion € në formë subvencionesh, prej te cilave 459 milion € nga Buxheti i Kosovës (BK) dhe 593 milion € nga donatorët (nga të cilat 415 milion € prej Agjencionit Evropian për Rindërtim - AER, Komisionit Evropian, KFW etj.). Këto mjete janë shpenzuar për: import të energjisë elektrike, operime, mirëmbajtje (sektori i linjtit, termocentralet, transmisioni, distribucioni dhe blerje të lëndës djegëse për sistemet e ngrohjes qendrore) si dhe eliminim të pasojave nga zjarrit në Termocentralin Kosova B dhe nga rrëshqitja e masave të djerrinës në minierën e linjtit Bardh në vitin 2002. Alokimet prej BK-së me rreth 70 milion €/në vit, gjatë tri viteve të fundit kanë përbërë 11 % të të gjitha shpenzimeve buxhetore. Kjo mbështetje e gjerë financiare ka bërë që prodhimi të ketë një rritje të vazhdueshme për çdo vit, falë prodhimit të qymyrit (nga hapja e minierës 'Sitnica') dhe të energjisë elektrike (nga remontet në tri blloqet e Termocentralit Kosova A).

Megjithatë, si rezultat i rritjes së konsumit si dhe i performancës së dobët në kontrollin e konsumit dhe të arkëtimit të energjisë së distribuar, KEK-u sh.a. ka pasur ndikime negative në financat publike dhe në mjedisin biznesor. Kështu që, Korporata Energjetike e Kosovës, nga pamundësia për të importuar energji elektrike dhe cilësia e ulët e shërbimeve që ofron, ekonomisë kosovare i shkakton shpenzime të mëdha dhe mbetet barrë e shtrenjtë mbi supet e Buxhetit të Kosovës. Andaj, përveç që shpenzohet një pjesë e konsiderueshme e donacioneve për Kosovën, mosfurnizimi i rregullt me energji elektrike shpesh konsiderohet barriera më e madhe e investimeve nga jashtë në Kosovë.

Situata aktuale në sektorin e Sistemeve të Ngrohjes Qendrore është e njëjta, pothuaj se në tërësi, si me sektorin e energjisë elektrike.

Në tabelën 12, si në vijim, janë dhënë shpenzimet e bëra në sektorin e energjisë, të përgjithshme dhe të ndara sipas investitorit, gjatë nëntë viteve 2000- 2008.



Përshkrimi:	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	Total
<b>Totali i donatorëve</b>	<b>259.5</b>	<b>18.8</b>	<b>66.4</b>	<b>138.5</b>	<b>48.2</b>	<b>10.4</b>	<b>28.2</b>	<b>15.5</b>	<b>0</b>	<b>585.5</b>
Subvencionet	-	-	4.1	-	-	-	-	-	-	4.1
Asistenca Teknike	-	-	9.8	90.3	10.9	10.4	21.4	3	-	145.8
Investimet kapitale	259.5	18.8	52.5	48.2	37.3	-	6.8	12.5	-	435.6
<b>Totali i BKK-së</b>	<b>11.6</b>	<b>45.9</b>	<b>108.1</b>	<b>56.3</b>	<b>41.4</b>	<b>67.2</b>	<b>47.1</b>	<b>65.6</b>	<b>163.5</b>	<b>606.7</b>
Mjetet e BKK-së	11.6	45.9	108.1	56.3	41.4	57.2	47.1	65.6	84.1	517.3
Kredia e dhene KEK-ut	-	-	-	-	-	10	-	-	79.4	89.4
<b>Totali i donatorëve dhe BKK-së</b>	<b>271.1</b>	<b>64.7</b>	<b>174.5</b>	<b>194.8</b>	<b>89.6</b>	<b>77.6</b>	<b>75.3</b>	<b>81.1</b>	<b>163.5</b>	<b>1192.2</b>

Tabela 12. Totali i shpenzimeve për sektorin e energjisë (në milion €) - Burimi: MEF

Kjo mbështetje ka vazhduar edhe për vitin 2009, kur shpenzimet për sektorin e energjisë arritën në 9.4% të totalit të buxhetit për atë vit.

Karakteristika kryesore e sektorit të energjisë në periudhën 1999-2009 është operimi me objekte të ndërtuara në periudhën 1962-1984, me standarde aktuale të kohës dhe në periudha të ndryshme, të cilat nuk janë mirëmbajtur dhe nuk janë revitalizuar gjatë periudhave të caktuara. Disa prej tyre janë kah fundi i jetës (Termocentrali Kosova A, minierat e linjtit Mirash dhe Bardh) dhe disa tjera janë jashtë operimit dhe me status të pa definuar (ngrohtorja industriale, gasifikimi, azotiku) dhe nuk përmbushin standardet e sotme mjedisore.

### Vlerësimi i investimeve të planifikuara në sektorin e energjisë për 2010 - 2020

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë së Energjisë për periudhën 2009-2018 dhe Programit të Zbatimit të saj për periudhën 2009-2011, siguria e furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike në Kosovë përbën një prioritet të lartë që mbështet zhvillimin ekonomik të vendit.

Siguria e furnizimit të konsumit elektroenergjetik në periudha të ndryshme, avancimi në zhvillimin e Mihjes së Re për furnizimin e blloqeve ekzistuese, ndërtimi i kapacitete të reja gjeneruese për zëvendësimin e kapaciteteve të cilat dalin nga prodhimi, politikat sociale dhe rregullimi i mjedisit janë prioritetet kryesore për Qeverinë e Kosovës.

Strategjia e Kosovës për Energji identifikon: gjendjen e objekteve ekzistuese, planet dhe veprimet lidhur me statusin e tyre në periudha të ndryshme, projektet relevante zhvillimore dhe periudhën e realizimit. Përveç mirëmbajtjes së objekteve ekzistuese, zhvillimet kryesore të energjetikës në Kosovë janë edhe realizimi i investimeve kapitale siç është hapja e Minieres së Re të qymyrit, rehabilitimi i TC Kosova B dhe ndërtimi i Termocentralit Kosova e Re dhe objektet përcjellëse në periudhën 2010-2020 që planifikohen të ndërtohen në zonën e veçantë "Fusha e Mihjes së Re".

Projekti "Mihja e Re e lignitit dhe Termocentrali Kosova e Re" planifikohen të ndërtohet në faza, në të cilin faza e parë me 600 (2 x 300) MW dhe me hyrjen në punë komerciale në vitin 2015/16 e cila zëvendëson prodhimin e Termocentralit Kosova A. Faza e dytë me kapacitete tjera prej 600 (2 x 300) MW deri në vitin 2020, eliminon importin e energjisë elektrike, përmbush kërkesën në rritje, stabilizon furnizimin e konsumit në periudhën afatgjatë dhe dukshëm përmirëson gjendjen mjedisore. Faza e tretë me kapacitete deri në 1 000 MW, që varet nga kërkesat vendore dhe të rajonit, mund të jenë në operim pas vitit 2025 mundëson zëvendësimin e Termocentralit Kosova B, pas përfundimit të jetës së tij, për periudhën afatgjatë. Realizimi i projektit "Mihja e Re e lignitit dhe Termocentrali Kosova e Re" nënkupton investime për objekte kapitale dhe investime shtesë të paraqitura në tabelën 13.

NR	Sektorët	Burimi Investimit	Periudha 2009-2011	Periudha 2012-2016	Periudha 2017-2020
1.	<b>Minierat e qymyrit</b>	<b>616.2</b>	<b>151.2</b>	<b>275.0</b>	<b>190.0</b>
1.1	Rehabilitimi i pajisjeve ekzistuese dhe blerja e të rejave për Minierën e Re	BKK	75.0		
1.2	Rehabilitimi i ekskavatorëve në sistemin e djerrinës	BGJZH, BK	41.2		
1.3	Projekti Minierës së re - Projekti Sibovcit Jug Perëndimor – faza I-rë - Projekti Përfundimtar Minierës së Re – faza II-të	IPP IPP	35.0	200.0 75.0	190.0
2.	<b>Gjenerimi</b>	<b>1,911.0 mil. € (10.5 mil. \$)</b>	<b>375.0/ (10.5)</b>	<b>1,031.0</b>	<b>505.0</b>
2.1	Termocentrali Kosova A - Mirëmbajtja - Hartimi i 'Studimit për Dekomisionim' - Projekti për transportimin hidraulik të hirit - Rregullimi i elektrofiltrave - Dekomisionimi	BK,KEK, ZNKE BB, KEK BK, IPP BK, BE	56.4 3.0 5.0 7.5	15 60.0	
2.2	Termocentrali Kosova B - Mirëmbajtja - Studimit Fizibilitetit për Revitalizimit teknik dhe mjedisor (USAID) - Revitalizimi i dy blloqeve - Zhvendosja e depos se hirit/rregullimi - Projekti kogjenerimit <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ kfw (donacion)</li> <li>▪ komuna e Prishtines</li> <li>▪ kredi</li> </ul>	BK,KEK,  Donacion PPP PPP  Kfw, BK	37.0  3.0 10.0	250 30.0	
2.3	Plani hapësinor, ndertimi deri 2000MW - Përgatitja e Projektit 'Termocentrali Kosova e Re' - Ndërtimi filestar (Faza I) 2x300 + 600 MW - Ndërtimi fazes II 2x300+600 MW - Kyçja e Termocentralit Ri në SEK - Hartimi i 'Studimit të Fizibilitetit për Rezervar Uji' - Ndërtimi i basenit të ujit rezervë	BK, KE, BB IPP IPP IPP IPP IPP	2.0 € & 10.5 \$ 250 1.0	450.0 200.0 6.0 20.0	500.0 5.0
3.	<b>Mjedisi</b>	<b>5.6 mil. € (11.1 mil. \$)</b>	<b>5.6 (11.1)</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>
3.1	- Projekti rregullimit të hirit dhe djerrinës	QH, BB	3.0 € & 10.5 \$		
3.2	- Sistemi monitorimit të ajrit (Faza I) - Stacioni i monitorimit të ujit në TC Kosova A dhe B, riparimi i sistemit të kanalizimit mostrat e tokës	BB  BK, BE	0.5 € & 0.6\$  2.1		
4.	<b>Sociale</b>	<b>211 mil. €</b>	<b>111.0</b>	<b>100.0</b>	<b>0.0</b>
4.1	- Zhvendosja e Lagjes Shala - Përfundimi i zhvendosjes së Hades - Zhvendosja e vendbanimeve në FMR - Vlerësimi Ndikimit Mjedisor (VNM) të projektit - Vlerësimi Ndikimit Social (VNS) të projektit	BK BK,KEK IPP IPP IPP	5.0 80.0 20.0 4.0 2.0	100.0	
5.	<b>Objektet jashtë operimit</b>	<b>106 mil. €</b>	<b>6.0</b>	<b>100.0</b>	<b>0.0</b>
5.1	- Hartimi i studimit për dekomisionimin e: Azotikut, Gazifikimit, Ngrohtores ind, Separacioneve dhe Tertoreve - Dekomisionimi dhe rregullimi i tokës	(BK, BE, BB)  (BK, BE, BB)	6.0	100.0	
6.	<b>Total milion € (Euro)</b> <b>Total milion \$ (Dollar)</b>	<b>2915.3</b> <b>21.6</b>	<b>641.3</b> <b>21.6</b>	<b>1,491.0</b> <b>0.0</b>	<b>695.0</b> <b>0.0</b>

**Tabela 13. Investimet e planifikuara për sektorin e energjisë në zonën e projektit të "Minierës së Re të linjtit dhe Termocentralit Kosova Re". - Burimi: PATEL / MEM, 2009.**

Në investimet e vlerësuara për periudhën 2009-2020, për realizimin e projektit "Miniera e Re e lignitit dhe Termocentrali Kosova e Re", Qeveria e Kosovës planifikon kycjen e ekspertizës dhe kapitalit privat nga jashtë dhe për rehabilitimin teknik dhe mjedisor të Termocentralit Kosova B me modelin e Partneritetit Publiko Privat.

### **Përshkrimi i shkurtër për kapacitetet investive sipas sektorëve prezent në zonë**

Spektori i bujqësisë edhe përkundër sipërfaqes së bollshme të tokës së punueshme, nuk ka ndonjë planifikim të qartë të zhvillimit. Arsye për këtë është sektori energjetik dhe zhvillimet që po ndodhin në këtë drejtim. Këto zhvillime e bëjnë të paqartë dhe me mëdyshje angazhimin në zhvillimin e bujqësisë. E vetmja informatë e cila lidhet me këtë sektor, do të jetë angazhimi për Projektin e Pastrimit dhe Rehabilitimit të Tokës (PPRT) me fokus janë palosjet e djerrinave dhe deponisë së hirit TC Kosova A, që në mënyrë direkte do të ndikojnë në rritjen e fondit të tokës bujqësore.

Të gjitha investimet e nevojshme nga aspekti i infrastrukturës teknike do të jenë pjesë e llogarive dhe planeve që duhet të parashihen në projektin e TCKR-së. Investime shtesë sa i përket infrastrukturës do të realizohet me ndërtimin e rrugëve të nevojshme për lidhjen e vendbanimeve të reja që do të popullohen nga banorët e fshatrave të dislokuara.

Të dhënat mbi investimet në infrastrukturën sociale (shërbimet, objektet e arsimit, shëndetësisë, kultit fetar dhe shërbimet tjera), në bazë të informatave janë të pamjaftueshme. Ndërtimi i kapaciteteve të reja do të realizohet në vendbanimet e reja, të cilat do të krijohen me zhvendosjen e popullatës nga zona e mihjes.

Deri më tash nuk është bërë ndonjë kalkulim i arsyeshëm që do të na ndihmonte në nxjerrjen e kostos së përafërt të investimeve në realizim të projekteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore si çështje tjetër e cila kërkon vëmendje të shtuar. Janë identifikuar disa probleme nga të cilat më i ndjeshmi është dislokimi i monumenteve me vlerë. Deri më tash, duke ju referuar gjendjes mjedisore në zonë, por edhe nga informatat që disponojmë, nuk është bërë ndonjë investim përmbajtësor në këtë sektor si një ndër më të ndijshmit.

Përlllogaritja e kapaciteteve investive komunale - në zonën e FMR-së është e vështirë për faktin se të gjitha orientimet zhvillimore komunale, janë të drejtuara jashtë zonës dhe sa më larg saj.

## 1.7. SFIDAT KRYESORE TË BAZUARA NË PROBLEMET DHE ÇËSHTJET E GJETURA

Bazuar në analizën e deritanishme mbi gjendjen ekzistuese, vërehet se problemet dhe çështjet me të cilat duhet ballafaquar, në zonën me interes të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes së Re", janë të shumtë. Ato janë grupuar dhe ndarë sipas fushëveprimtarisë së tyre, në të ashtuquajturat Sfidat Kryesore, mbi të cilat ka vazhduar puna e nëngrupeve punuese në hartimin e këtij Plani. Ky Plan, në kaptinat e ardhshme, do të ofrojë zgjidhjet e mundshme për problemet e grupuara në këto katër sfida, të renditura si në vazhdim:

1. **Sigurimi i energjisë elektrike për periudhë afatgjate** - Çështjet e grupuara në këtë sfidë kanë të bëjnë me problemet si të përzgjedhet investimi dhe lokacioni për TC Kosova e Re, teknologjia më e avancuar, kapaciteti prodhues i instaluar në përmbushje të kërkesave, etj.
2. **Zhvendosja dhe kualiteti i jetës së komunitetit** - Çështjet e grupuara në këtë sfidë kanë të bëjnë me problemet rreth mënyrës dhe metodologjisë për zhvillimin e procesit në realizim të programeve për zhvendosje të komunitetit.
3. **Shfrytëzimi i resurseve natyrore** - Çështjet e grupuara në këtë sfidë kanë të bëjnë me problemet rreth shfrytëzimit të resurseve të linjitit dhe potencialit ujqor.
4. **Gjendja mjedisore** - Çështjet e grupuara në këtë sfidë kanë të bëjnë me problemet rreth përmirësimit dhe rehabilitimit të elementëve mjedisor (ajrit, ujit dhe tokës) dhe zonave të degraduara dhe shfrytëzimit të potencialeve tjera të erës, të gazit, solare, biomasës, etj.



# VIZIONI PËR ZHVILLIMIN E ARDHSHËM HAPËSINOR

## II

### 2. VIZIONI I BAZUAR NË SFIDA, PARIME DHE CAQE

**F**usha e Mihjes së Re do të pësojë një shkallë të lartë transformimesh të hapësirës e cila do të shfrytëzohet për gjenerim të energjisë nga linjiti. Kohëzgjatja e këtyre zhvillimeve prej së paku 50 vitesh hynë në terminet afatgjate të zhvillimit në rajon. Eksploatimi i linjimit në Fushën e Re të Mihjes, si proces afatgjatë, do të ketë transformime graduale të shkallës së lartë që zhvillohen krahas ritmit dhe avansimit të mihjes si dhe ndërtimit të Termocentralit Kosova e Re. Paralelisht këtyre zhvillimeve, nga aktivitetet e njohura gjatë proceseve të mihjes dhe gjenerimit të energjisë, duhet të trajtohen dhe të ipen zgjidhje të pranueshme edhe për problemet sociale e mjedisore, që del të jenë pasojë e zhvillimeve të tilla.

Gjatë zhvillimit të kësaj pjese, të Vizionit, që është një ëndërr e realizueshme, ku arritja e saj, mbështetet mbi sfidat kryesore zhvillimore dhe parimet e përcaktuara ndërkombëtare, si dhe ndërtuaret nga caqet e synuara, të cilat duhet të përmbushen me objektiva të definuara dhe të përkrahura me prioritetet qeveritare. Këto objektiva duhet të jenë të pranueshme, në aspektin mjedisor e social dhe në linjë me masat për zhvillim ekonomik, e me të edhe zhvillimin e sistemit energjetik, të Kosovës.

Problemet dhe çështjet e hasura e të grupuara brenda sfidave, për rezultat do të kenë veprimet (qofshin masa, aktivitete apo projekte) që qojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit energjetik (në mihje dhe gjenerim), zhvendosje-rivendosje të pranueshme për komunitetin si dhe pastrimin e rehabilitimin (foto 10) e hapësirave nga ndotjet dhe degradimet e së kaluarës në harmonizim të plotë me normat e lejuara sipas Direktivave të BE-së.

**Foto 10. Pamje nga rehabilitimi i pjesëshëm i deponisë së djerrinës.** Burimi: IPH / MMPH.



## 2.1. SFIDAT KRYESORE TË BAZUARA NË PRIORITETET DHE PARIMET NDËRKOMBËTARE

Zhvillimi i ardhshëm i Kosovës, në termin afatgjatë, mbështetet në integrimin rajonal, bazuar në kohezionin socio-ekonomik dhe territorial si dhe në bashkëpunimin ndërkufitar. Zhvillimin e ardhshëm ekonomik, Kosova e bazon në zhvillimin e sektorit të energjisë përmes prodhimit të energjisë elektrike duke shfrytëzuar resurset e saj natyrore.

Problemet e grumbulluara, janë grupuar dhe ndarë sipas fushëveprimtarisë së tyre, në të ashtuquajturat Sfidat Kryesore të Zhvillimit, mbi të cilën bazë ka vazhduar puna e nëngrupeve punuese në hartimin e këtij Plani. Ky Plan, në kaptinat e ardhshme, do të ofrojë zgjidhjet e mundshme për problemet e grupuara në këto sfida të renditura si në vazhdim:

- 1 **Sigurimi i energjisë elektrike për periudhë afatgjatë** – Çështjet e grupuara në këtë sfidë kanë të bëjnë me problemet rreth përzgjedhjes së investitorit, të lokacionit për T CKR, të teknologjisë më të avancuar, kapacitetit prodhues të instaluar për TC-në Kosova Re, rehabilitimin e TC Kosova B si dhe zhvillimin e rrjetit për bartje të energjisë elektrike në Kosovë.
- 2 **Zhvendosja dhe kualiteti i jetës së komunitetit** – Çështjet e grupuara në këtë sfidë kanë të bëjnë me problemet rreth gjetjes së mënyrave dhe metodologjive më të kënaqshme për zhvillimin e proceseve në realizim të programeve për shpronësim, zhvendosje si dhe projekteve që sigurojnë një më kualitative të komunitetit.
- 3 **Shfrytëzimi i resurseve natyrore** – Çështjet e grupuara në këtë sfidë kanë të bëjnë me problemet rreth sigurimit dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve të linjtit, potencialet ujore, të erës, të gazit, solaëre, biomasës, gjeotermale etj.
- 4 **Gjendja mjedisore** – Çështjet e grupuara në këtë sfidë kanë të bëjnë me problemet rreth përmirësimit dhe rehabilitimit të elementëve mjedisor (ajrit, ujit dhe tokës) dhe zonave të degraduara.

### 2.1.1. SFIDA 1 : SIGURIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

#### Pse dhe çka është sfiduese?

Historikisht, energjia dhe minierat kanë qenë shtylla të ekonomisë kosovare, duke ofruar punësim direkt dhe indirekt, burime të të ardhurave, fitime nga eksporti, si dhe kontribut për industrinë e sektorit. Megjithatë, prej të qenit kontribues në rritjen ekonomike ajo është bazuar në nivelin e ulët të shfrytëzimit të potencialeve të resursit të linjtit, në një burim të pa ripërtrishëm e që deri më tani vetëm 3% e kapaciteteve janë të shfrytëzuara.

Përveç kësaj, në periudhën 1999 – 2009 furnizimi i paqëndrueshëm me energji elektrike ka dalë si një prej pengesave kryesore ndaj zhvillimit të ekonomisë kosovare dhe tërheqjes së investimeve. Kosova vazhdon të vuajë nga reduktimet jo të rregullta elektrike, importit tejet të shtrenjtë dhe se hulumtimet e kompanive të ndryshme kanë raportuar, që mungesa e furnizimit të qëndrueshëm elektrik është një prej pengesave kryesore ndaj funksionimit të tyre.

Problemet dhe sfidat kryesore të cilat janë identifikuar përmes analizës së zhvillimit historik dhe te trendeve të kërkesës për energji dhe mbulimit të saj në të ardhmen në Kosovë janë:

- Zhvillimi ekonomik i vendit, kërkesat në rritje të vazhdueshme, teknologjia e vjetruar për prodhimin e energjisë elektrike, termocentrali Kosova A shumë afër mbylljes, rritja e kërkesës për energji elektrike, zëvendësimi i termocentraleve të vjetra në periudhat e caktuara kërkojnë një qasje serioze në planifikimin dhe prurje të vendimit për ndërtimin urgjent të njësive të reja për prodhim të energjisë.

- Sigurimi i furnizimit vetanak të konsumit, i pavarur dhe duke eliminuar importin e energjisë elektrike në periudhën afatgjatë, mund të arrihet me shfrytëzimin e resurseve vendore të energjisë ku prodhimi kryesor pritet të jetë bazuar në shfrytëzimin e linjtit.
- Përveç ndërtimit të termocentraleve, me djegie të linjtit me teknologji më të avancuara, paralelisht mund të zhvillohen aktivitetet në ndërtimin e Hidrocentralit Zhur me koncesion si dhe nga burimet tjera të ripërtërijtshme.
- Presioni ndaj sektorit të energjisë mund të zvogëlohet me kursimin e energjisë elektrike, shfrytëzimin efikas të saj, ndërtimin e sistemeve të ngrohjes qendrore në qendrat urbane, pagesën e rregullt të energjisë elektrike e të ngrohjes dhe duke siguruar edhe llojet e tjera të energjisë në konsumin energjetik të Kosovës.

#### **Cilat janë mundësitë e identifikuara?**

Sipas studimeve të realizuara në një periudhë shumë të gjatë bazuar në gjendjen aktuale të sektorit të energjisë dhe gjendjes mjedisore, rekomandimet janë që prodhimi i energjisë elektrike në të ardhmen në Kosovë do të bazohet së pari në shfrytëzimin e burimeve vendore të energjisë duke siguruar sovranitetin, pavarësinë energjetike dhe sigurinë e furnizimit.

Burimet vendore të energjisë me linjit, hidropotencial dhe burime tjera të rinovueshme mund të plotësojnë kërkesat e Kosovës për energji elektrike në periudhën afatgjatë. Me ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re, ndërtimi i mihjes së re të linjtit për furnizim të kapaciteteve ekzistuese dhe të reja, mund të siguronte shkyçjen e Termocentraleve të vjetra në periudha të caktuara dhe plotësimi i kërkesave në rritje, në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit.

Rezultatet e Raportit të VSMS-së së vitit 2008 për ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re deri në 2.000 MW rekomandojnë së pari lokacionin industrial në afërsi të TC Kosova A ose lokacioni në vazhdim të TC Kosova B e që njëherit nuk preferon shfrytëzimin e lokacioneve të gjelbëruara.

Nga aspekti i teknologjisë preferohet shfrytëzimi i teknologjisë CFB (djegia në shtresën e fluidizuar) ose PF (djegia me imtësim në formë të pluhurit) me parametrat sub ose super kritike me efikasitet të lartë dhe teknologji komercialisht të vërtetuara.

Gjendja aktuale e mjedisit kërkon adresim të qartë dhe zbatimin e programeve dhe projekteve për zvogëlimin e ndikimit në mjedis në mënyrë që ai të mos bëhet pengesë në zhvillimin e ardhshëm të sektorit të energjisë. Mbrojtja e mjedisit gjatë implementimit të projektit ekskluzivisht do të bazohet në LPCD (Large Combustion Plant Directive apo Direktiva për Termocentralet e mëdha me djegie), e cila direktive aktualisht shfrytëzohet për planifikimin dhe ndërtimin e blloqeve për termocentrale të reja në Evropë.

#### **Çfarë thonë marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me energjinë?**

Pasi që Kosova është nënshkruese e Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë (TKE) të Evropës Juglindore, në këtë kontekst, Qeveria e Kosovës është e angazhuar substancialisht për të zhvilluar sektorin e energjisë në përputhje me kërkesat e TKE-së.

Traktati për Komunitetin e Energjisë kërkon nga palët kontraktuese që të zbatojnë pjesë të rëndësishme të *acquis communautaire*, ofron mundësi për krijimin e një tregu të vetëm të energjisë dhe mekanizmin për operim e tregjeve të energjive që përcillen nëpërmjet rregjave.

#### **Çështjet e identifikuara:**

- Furnizimi i paqëndrueshëm me energji elektrike dhe sigurimi i furnizimit
- Kërkesat për energji në rritje të vazhdueshme
- Zgjedhja dhe definimi i teknologjise me efikasitet të lartë, ndikimi minimal mjedisor dhe teknologji komercialisht të vërtetura.
- Lokacionet ekzistuese si më të përshtatshme për ndërtimin e TC-së Kosova e Re
- Qmime të ulëta për prodhimin e linjtit dhe të pranueshme të energjisë elektrike
- Shfrytëzimi i burimeve të ripërtërijtshme
- Shkyçja e Termocentraleve të vjetra në periudha të caktuara
- Obligimet mjedisore në kuadër të TKE-së.

## 2.1.2. SFIDA 2 : ZHVENDOSJA DHE KUALITETI I JETËS SË KOMUNITETIT

### Pse dhe çka është sfiduese?

Shpronësimi i pasurisë së paluajtshme në zonën e identifikuar si zona "Fusha e Mihjes së Re" paraqet një sfidë e cila do duhej trajtuar me shumë seriozitet. Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Ligjin mbi Shpronësimin e pronës së paluajtshme ku në mënyrë të detajizuar janë paraparë modalitetet procedurale kur kemi të bëjmë me shpronësimet dhe po ashtu synohet të respektohen standardet ndërkombëtare të zhvendosjes bazuar në politikat operacionale të Bankës Botërore 412 (zhvendosja jo-vullnetare) dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi, përmes hartimit të kornizës së politikave për zhvendosje.

Zhvendosja është sfidë në vete dhe deri më tani paraqitet edhe si sfidë kryesore gjatë trajtimit të këtij plani Hapësinor për zonën me interes të veçantë ekonomik. Zhvendosja si proces në të kaluarën është paraqitur si një vrimë e zezë në zhvillimin e projekteve me interes për Kosovën. Kosova nuk ka legjislacionin adekuat mbi trajtimin e zhvendosjes së popullsisë, mirëpo synohet që e njëjta të rregullohet me dokumentin e politikave të zhvendosjes. Në kuadër të MMPH-së është hartuar Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH) e cila reflekton praktikën dhe standardet më të mira ndërkombëtare<sup>23</sup> për mbrojtjen, kompensimin dhe kushtet e zhvendosjes së popullsisë dhe do të implementohet nga Kompania Private e Projektit.

Për secilën fazë të zhvendosjes së popullsisë hartohet Plani i Veprimit për Zhvendosje i cili duhet të jetë në përputhje me Politikën Operacionale të Bankës Botërore 412 dhe me Principet e Ekuadorit – standardi i Performances PS 5. Kompania e Projektit duhet të jetë përgjegjëse për bartjen e kostos financiare rreth zbatimit të planit të veprimit për zhvendosje.

Sfidë në vete është edhe përcaktimi i lokacioneve të reja, përkatësisht ri-vendosja në hapësira tjera (përafërsisht rreth 850 - 950 njësi banimi me rreth 4000 banor të fshatrave Hade, Leshkoshiq (Leshkoshiq (Lajthishtë)), Shipitullë dhe Sibovc duhet të zhvendosen duke i ruajtur të gjitha specifikat e komunitetit në kuptimin fizik – ndërtimi i shtëpisë së banimit me elementet përcjellëse, ekonomik dhe social –zhvillim të veprimtarive ekonomike dhe sociale, ruajtja e kompaktësisë familjare etj). Kuvendet Komunale të hapësirave të prekura nga projekti nuk kanë prona publike të mjaftueshme për destinim të ndërtimit pasi që tokat në pronësi të ish kooperativave dhe kombineve bujqësore janë tashmë të privatizuara dhe janë në pronësi të individëve me afat kohor prej 99 vjetësh, dhe po ashtu pronat publike komunale janë në sasi më të vogël sesa vetë kërkesa që duhet të ju ofrohet banoreve.

Nëse mendohet që të bëhet bartja e të zhvendosurve nga komuna e Obiliqit në komunat tjera, është i njëjti problem me pronat dhe njëherit do të krijohet një debalancë në kuptimin demografik - zvogëlim të numrit të banoreve në komunën e Obiliqit dhe rritje e numrit të banorëve në komunën tjetër që do të ndikojë në të gjitha sferat e zhvillimeve në komunë apo komunat tjera përkatëse.

### Cilat janë mundësitë e identifikuar?

- Të hartohen aktet nënligjore mbi përcaktimin e metodologjisë për llogaritjen e kompensimit të pronës së shpronësuar dhe dëmet që kanë në bëjnë me shpronësimin, në përputhje me ligjin mbi shpronësimin e pronës së paluajtshme. Këto akte nënligjore duhet ti hartojë Ministria e Ekonomisë dhe Financave si nevojë e domosdoshme për zbatim adekuat të këtij ligji.
- Të hartohet ligj i veçantë i cili do të trajtonte çështjen e zhvendosjes si tërësi.
- Të përfshihet Qeveria në cilësinë e mbikëqyrësit gjatë procesit të zhvendosjes.

### Çështjet e identifikuar:

Është me rëndësi të theksohet se shpronësimi i tokës dhe zhvendosja janë pjesë të pandara kur është fjala për operimet minerare. Ka kosto të lartë dhe është njëra nga çështjet më sfiduese dhe më komplekse e cila duhet të adresohet. Prioriteti i menjëhershëm, i cili duhet të përmbillet para se fusha e

<sup>23</sup> Politika e Operimit të Bankës Botërore 4.12 (OP 4.12) mbi Zhvendosjen e Banorëve në mënyrë jo vullnetare, dhe Korporata Financiare Ndërkombëtare (KFN) korresponduese, Standardi i Performancës 5 (PS-5)



minierës së Sibovcit të mund të hapej, është që të bëhet zhvendosja e fshatit Hade. Kjo tanimë është prioritet i Qeverisë, pasi që një pjesë e fshatit ishte duke u shembur në minierën e Mirashit si rezultat i keq-menaxhimit të mëhershëm të operimeve minerare.

Shpronësimi dhe zhvendosja do të duhej të aplikohet përgjatë të gjitha aspekteve të minierave të lignitit dhe projektit të energjisë. Kjo do të përfshinte shpronësimin e tokës për operimet minerare dhe pajisjeve tjera përcjellëse, duke përfshi edhe tokën e cila do të mund të kërkohej për zyre, depo të lëndës së parë, djerrinë dhe për rrugë kaluese.

Disa nga çështjet e identifikuar të cilat do të preken nga shpronësimi dhe zhvendosja janë:

- Humbja e tokës: kur një pjesë e tërë apo e rëndësishme e tokës humbet, popullsia do të humbë të ardhurat dhe në raste të shumta edhe furnizimin e tyre me ushqim (pemët, perimet, qumështin). Gjatë procesit të shpërnguljes tek një vend tjetër do të humbin të paktën frutat;
- Humbja e shtëpive: Siç humbet shtëpia si strukturë fizike, njerëzit do të humbin edhe shërbimet tjera përcjellëse, siç janë: furnizimi me ujë, qasje në rrugë dhe energjinë elektrike;
- Humbja e Bizneseve: Bizneset e vogla mund të preken nga humbja e lokacionit të biznesit dhe humbja e klientëve, veçanërisht atyre të rregullt;
- Humbja e punësimit: Nëse një biznes është prekur me mbyllje atëherë kemi humbje të vendeve të punës dhe po ashtu si pasojë e zhvendosjes në ndonjë hapësirë tjetër personat mund të humbin punën për shkak të largësisë që krijohet;
- Humbja e shërbimeve dhe trashëgimisë kulturore: Këtu përfshihet humbja e qasjes të lehtësirat tjera siç janë: shkollat, ambulanca, xhamitë, varrezat, memorialët e luftës, dhe të tjera.

### 2.1.3. SFIDA 3 : SHFRYTËZIMI I RESURSEVE NATYRORE

#### Pse dhe çka është sfiduese?

Kosova posedon resurse të konsiderueshme të mineraleve energjetike. Në planin afatgjatë linjiti si resurs mineral do të mbetet burimi kryesorë për prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë.

Rezervat e linjtit në Kosovë gjenden në dy basenet më të mëdha, të emërtuara "Kosova" dhe "Dukagjini" dhe në disa basene të vogla. Rezervat gjeologjike të linjtit janë vlerësuar të jenë rreth 14 miliardë tonelata (këtu përfshihen të gjitha kategoritë e rezervave).

Linjiti i Kosovës është i ri dhe ka përmbajtje të ulët të sulfurit, koncentrim relativisht të mirë të gëlqeres (kalcium oksidit) për absorbimin e një pjese të sulfurit gjatë procesit të djegies. Raporti në mes të djerrinës dhe linjtit është shumë i favorshëm, fakt ky që i bën minierat sipërfaqësore ekonomikisht tërheqëse për shfrytëzim me kosto të ulët.

Në studimet paraprake në basenin "Kosova" janë identifikuar disa fusha të eksplorimit si dhe janë rradhitur për zhvillim bazuar në sasinë dhe kushtet e eksplorimit (për pjesa djerrinë:linjiti).

Bazuar në sasinë dhe kushtet e eksplorimit, për basenin "Kosova" është përcaktuar Zona C ("Sibovci" apo "Fusha e Re e Mihjes") që ofron kushtet më të volitshme për eksplorim sipërfaqësorë.

Në bazë të analizave të deritanishme, hapja e minierës së re të linjtit në Zonën C "Fusha Mihja e Re" nga pikëpamja ekonomike, sociale dhe mjedisore është më e pranueshme. Për këtë, fillimi i hapjes dhe futjes në prodhim të kësaj mihje ka përparësi të konsiderueshme.

Problemet dhe sfidat kryesore të cilat janë identifikuar përmes analizës së zhvillimit të resurseve natyrore dhe trendëve të kërkuara posaçërisht në mihjet e linjtit janë:

- Kërkesat në rritje për linjitin si resurs të vetëm për momentin për gjenerimin e energjisë elektrike,
- Shfrytëzimi racional i resurseve të linjtit,

- Paqëndrueshmëria e çmimeve të linjitet dhe rritja e kostos së prodhimit,
- Konkurrenca e tregut të energjisë elektrike në rritje,
- Konfliktet e pronësisë mbi tokën,
- Përmirësimi dhe plotësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe fiskal,
- Përgatitja e burimeve njerëzore të afta për menaxhim të mihjeve në miniera,
- Mbrojtja e mjedisit,
- Rritja e sigurisë së punëtorëve në sektorin e mihjeve,
- Rikuperimi i sipërfaqeve të eksploatuara (shih foto 11) në hapësira të favorshme për shfrytëzim adekuat të mëtejshëm
- Rritja e vazhdueshme e çmimeve të derivateve të naftes dhe gazit natyror në tregun botëror dhe me implikime politike

#### **Cilat janë mundësitë e identifikuarat?**

Zhvillimi i qëndrueshëm nënkupton zhvillim të tillë i cili kënaq nevojat e sotme por nuk rrezikon generatat e ardhshme dhe nevojat e tyre. Resurset e linjitet në zonën e Fushës së Re (fusha "C") të mihjes vlerësohen të jenë rreth një miliardë tonë dhe përbëjnë një aset (pasuri) të konsiderueshëm të Kosovës që do të mundësonte sigurimin e prodhimit të energjisë elektrike në objektet ekzistuese dhe zhvillimit të kapaciteteve të reja me fuqi të instaluar deri 2000 MW dhe operimit të tyre gjatë 4 dekadave të ardhshme, dhe se kjo përfaqësonë vetëm 1/10 e resurseve të përgjithshme të linjiteve në Kosovë.

#### **Çështjet e identifikuarat:**

- Shfrytëzimi jo racional i resurseve natyrore- linjitet,
- Emisioni i grimcave të pluhurit dhe gazrave gjatë aktiviteteve minerare,
- Mos aftësimi i kuadrove të mjaftueshme për menaxhimin e resurseve natyrore-linjitet,
- Humbja e sipërfaqeve të tokave bujqësore,
- Mos rikuperimi i tokave të dëmtuara nga aktivitetet minerare, mos ri-kultivimi i minierave aktuale sipërfaqësore,
- Mos implementimi i legjislacionit në sektorin e minierave,
- Pasiguria në punë e punëtorëve në sektorin e mihjeve.

**Foto 11. Pamje nga mihjet ekzistuese. Burimi: IPH / MMPH**



## 2.1.4. SFIDA 4 : GJENDJA MJEDISORE

### Pse dhe çka është sfiduese?

Koncentrimi i kapaciteteve për nxjerrjen, transportin dhe deponimin e linjtit si dhe Termocentralet ekzistuese me teknologji të stërvjetruar për prodhim të energjisë elektrike që me emisionet aktuale krijojnë një zonë tepër të ndotur të mjedisit. Sipërfaqja e shtrirjes së objekteve ekzistuese dhe deponitë e hirit dhe djerrinës janë të mëdha dhe të gjitha së bashku kanë ndryshuar tërësisht peizazhin e kësaj zone.

Në afërsi me TC A-në ekziston një zonë e vjetër dhe e braktisur industriale, ku kanë operuar stabilimentet e tertorjeve, ngrohtores industriale, gazifikimit dhe azotikut deri para më se dy dekadave. Ndikimi i aktiviteteve të mëhershme (përfshirë tertorjet, gazifikimin dhe azotikun) sot manifestohet si dhe i kontaminuar dhe infiltrim i metaleve dhe kripërave në dhëra, duke rezultuar në kontaminim të lumenjve dhe Ujërave sipërfaqësore. Kësisoj, kontaminimi aktual i lumenjve dhe ujërave sipërfaqësore nuk paraqitet vetëm si rezultat i aktiviteteve aktuale.

Kapitulli i raportit të VSMS-së mbi Studimin Themelor Mjedisor dhe Social arrin tek përfundimi se gjendja mjedisore në zonën e interesit është tejet komplekse për disa arsye:

- Gjendja mjedisore është prekur thellë nga aktivitetet minerare nga e kaluara, të cilat kanë shkaktuar edhe modifikime të theksuara në terren;
- Cilësia e ajrit është e dobët për shkak të emetimeve nga termocentralet ekzistuese, të cilat nuk janë në pajtueshmëri me standardet e BE-së, për shkak të vetëdjegies së linjtit dhe emetimit të partikulateve nga deponitë e hirit, të cilat përbëjnë burimin kryesor të ndotjes së ajrit;
- Burimet ujore janë të atakuar nga ndikimet dhe kërkesat konkurruese për ujë të shfrytëzuesve të ndryshëm, gjë që reflektohet me ndërprerje të kohëpaskohshme në furnizim me ujë të pijshëm gjatë muajve të verës.
- Cilësia e tokës dhe ujërave tokësore ka pësuar në masë të gjerë nga depozitimi i hirit dhe mbeturinave tjera dhe nga veprimtaria e stabilimenteve të azotikut dhe gazifikimit në të kaluarën.
- Cilësia e ujërave sipërfaqësore ka pësuar ndikim serioz nga derdhjet e ujërave të zeza të patrajtuara nga termocentralet, aktivitetet minerare dhe ujërat e zeza urbane;
- Emetimet e zhurmës nga aktivitetet minerare janë bezdisëse për njerëzit që jetojnë krahas kufijve të minierës;
- Mungesa dhe kontrolla jo efektive mjedisore apo mosefikasiteti i tyre (sa i përket ujit e ajrit);
- Nuk ka procedura formale për menaxhimin e ujërave në lokacionet industriale.

### Çështjet ekzistuese mjedisore duhet të trajtohen me prioritetin më të lartë.

Bazuar në gjendjen ekzistuese në teren dhe Sipas konkluzioneve të Raportit Final të VSMS-së aprovuar të vitit 2008, një ndër sfidat e vazhdueshme do jetë poashtu kthimi i sipërfaqeve të zëna bujqësore dhe hapësirat e banuara më parë që të kthehen për shfrytëzim të serishëm. Rikultivimi i tokave ku tashmë janë deponuar djerrina apo hiri zënë vend të rëndësishëm në planet e veprimit dhe projekte të ndryshme afatmesme dhe afatgjata. Është tepër sfiduese rikthimi i gjendjes së më parme të kësaj sipërfaqeje pas përfundimit të aktiviteteve për nxjerrjen e linjtit nga minierat që akoma janë në funksion.

Në kapitullin bazik të raportit të VSMS-së gjithashtu shtjellohet çështja e furnizimit me ujë si faktor potencialisht limitues për zhvillimin e projektit e poashtu edhe për zonen me interes të veçantë. Edhe pse furnizimi me ujë është konfirmuar si i gatshëm për përkrahje të projektit të propozuar, sistemi i Ibër-Lepencit për momentin përballë me probleme, të humbjeve komerciale të satirave të mëdha të ujit (deri në 40%) në kanal kryesor. Nëse nuk zgjidhet ky problem do të mbesë i tillë për shkak të kërkesave konkurruese për furnizim me ujë që ka të ngjarë të paraqiten në të ardhmen afatgjatë. Kjo gjendje imponon përpilimin e një kornize gjithëpërfshirëse politike, institucionale dhe të planifikimit për menaxhimin e resurseve ujore në Hidrosistemin Ibër-Lepenc.

Mungesa e të dhënave të sakta për nivelin e emisioneve direkte në ajër nga tymtarët e termocentraleve Kosova A, të cilat janë në funksion prej 26 - 48 viteve është mjaft sfiduese. Puna joefikase e elektrofilterëve të këtyre termocentraleve është konstatuar pothuaj në çdo raport, studim apo vlerësim të shkaqeve të ndotjes së ajrit përreth tyre. Pak më mirë qëndron gjendja e elektrofilterëve të instaluar ne termocentralet Kosova B. Për të dy këto komplekse energjetike është sfiduese mungesa e sistemit kontinual të monitorimit të emisioneve në burim. Për të dy termocentralet personeli përgjigjës për mjedis bën kalkulimin e e nivelit të emisioneve specifike, në mënyrë që të ofrohen informata për emisionet e SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, PM<sub>10</sub>, CO<sub>2</sub>, sasi të e hirit dhe shpenzimet e ujit procesor.

Cilësia e ajrit monitorohet në mënyrë tejet modeste nga Instituti INKOS (2 pika matëse) dhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (me një pikë matëse). Në të tri këto pika monitoruese përcaktohen: SO<sub>2</sub>, pluhuri si PM<sub>10</sub> dhe bloza

Mbeturinat në Zonën e Interesit ekonomik lajmërohen në forma të ndryshme dhe ato janë si rezultat i punës në mihje, në gjenerim të energjisë dhe mbetje nga proceset në Industrinë kimike (Gazifikim, Azotik dhe Tertore). Sasi të më të vogla të mbetjeve janë si produkt i djegies së linjtit, të cilat nuk mund të shmangen, por ka mundësi (metoda) të shumta që ato të reduktohet.

Problem të veçantë dhe ekstrem paraqet Deponia Regionale e mbeturinave në Mihjen e Mirashit (deponi pa selektim të mbeturinave nga amvisëritë dhe ato urbane dhe menaxhim jo të mirë).

Historikisht nuk ka të dhëna nga monitorimi i nivelit të zhurmës, megjithëse niveli i zhurmës si për të punësuarit ashtu edhe banorët në afërsi të kapaciteteve energjetike konsiderohet aspekt kyç që duhet trajtuar gjatë zhvillimit të minierës dhe termocentraleve të reja.

Përkundër faktit se në zonën e interesit të veçantë ekonomik nuk ka ndonjë zonë të mbrojtur apo biodiversitet të studiuar, megjithatë kur merret parasysh degradimi i një sipërfaqeje aq të madhe, konsiderohen shqetësuese ndryshimet e përgjithshme, të cilat pashmangshëm prishin ekuilibrin ekologjik në tërë zonën.

#### **Mundësitë e identifikuar**

- Përmirësimi i situatës dhe monitorimit mjedisor dhe zhvillimi i sistemeve për menaxhim mjedisor. Çfarëdo rritje e emetimit në ajër duhet të shmanget para se TC-të ekzistuese të riparohen në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kualiteti i ajrit të jetë përmirësuar;
- Një sistem i zvogëlimi të emetimit në ajër duhet të studiohet dhe të implementohet në termocentralin Kosova A dhe Kosova B së bashku me zhvillimet e parapara për termocentralin Kosova e Re;
- Sistemi i deponimit të hirit ka nevojë të bëhet hidraulik edhe nga TC Kosova A (në mënyrë që ti shmangemi ndikimit në kualitetin e ajrit që është i ndërlidhur me deponimin aktiv të hirit të terur);
- Brigjet anësore të stoqeve të hirit duhet të rrafshohen dhe në sipërfaqet e reja të formuara të përtërihet vegjetacioni në mënyrë që të shmanget emetimi i mëtutjeshëm i pluhurit.
- Instalimi i sistemit të monitorimit të ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës për tërë zonën e interesit të veçantë të projektuar për zhvillimin e kapaciteteve energjetike.
- Inicimi i një studimi mbi zhurmën për të tërhequr krahasimin me standardet e zbatueshme dhe për të konstatuar papajtueshmërinë e mundshme dhe masat e nevojshme për mbrojtjen e punonjësve dhe banorëve nga ky fenomen i ndieshëm.
- Rishikimi i rregullt i politikave dhe praktikave mjedisore.
- Përgatitja dhe zbatimi i planit për menaxhimin e mbeturinave. Hulumtimi i mundësisë së shfrytëzimit të hirit fluturues dhe zgjurës (p.sh. në çimentore, për ndërtimin e rrugëve, etj.).
- Rishikimi i projektit të Deponisë Rajonale në Mihjen e Mirashit

Mënyra më e mirë për menaxhimin e mbeturinave të djegies është përdorimi i hirit si zëvendësim për rërën, zhavorrin dhe materialet tjera natyrale për industrinë e prodhimit të çimentos, ndërtimit të rrugëve, mbushjen e minierave të shfrytëzuara dhe për përdorimin e sajë si tampon për rrugë. Zgjidhja e dytë dhe njëkohësisht shumë efikase e eliminimit të hirit dhe djerrinës është kthimi i tyre ne vendet boshe të mihjeve ekzistuese sipërfaqësore.

Ndër projektet konkrete në të cilat po punohet, është trajtimi i mbetjeve nga procesi i gazifikimit të linjtit e që bashkërisht me rikthimi i hirit nga deponija e termocentraleve Kosova A dhe B në hapësirat



e minierës së Mirashit si dhe projekt i ngjashëm për rikutivimin e deponive të djerrinës së deponuar nga minierat Bardh e Mirash, po udhëhiqen nga Banka Botërore, Qeveria Holandeze dhe KEK-u.

**Çështjet e identifikuar:**

- Ndotja e ajrit – monitorimi dhe zvogëlimi i emisioneve në ajër
- Ndotja e ujit dhe tokës – monitorimi
- Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe Biodiversitetit
- Menaxhimi i mbeturinave (kontrolli mbi llojet, sasi të etj)
- Deponia Regjionale e mbeturinave urbane në Mihjen Mirash – menaxhimi, selektimi, riciklimi dhe masat urgjente në zvogëlimin e ndikimit në mjedis
- Rehabilitimi i deponimeve të hirit dhe Rikutivimi i tokës
- Parandalim dhe masat mbrojtëse për vetë ndezjen e linjitet
- Trajtim i zhurmës (planifikim i masave të nevojshme mbi izolimin e zhurmës, pajimet mbrojtëse, amortizim i zhurmës, pajisjet e reja etj.

## 2.2. PARIMET E PËRGJITHSHME

Me këtë rast, Plani Hapësinor për Fushën e Mihjes së Re, përveç që mbështetet në kornizën vendore ligjore dhe institucionale për hartimin e tij, është në përputhje edhe me parimet (principet) tjera të dala nga normat ndërkombëtare e posaçërisht ato të Bashkimit Evropian.

Parimet e përgjithshme, me të cilat është në përputhjet dhe gjenë mbështetje ky Plan strategjik, për mbrojtjen dhe zhvillimin e zonës së interesit të veçantë ekonomik të FMR-së, mund të theksohen si në vijim:

- **Korniza ligjore mbi planifikimin hapësinor në Kosovë.** - Plani Hapësinor për zonën me interes të veçantë ekonomik 'Fusha e Mihjes së Re' është plan strategjik dhe duhet të kaloj nëpër procesin e planifikimit strategjik.
- **Zhvillim të qëndrueshëm dhe të barabartë në gjithë territorin e Kosovës;**
- **Promovim i të drejtave të barabarta ekonomike për të gjithë kosovarët si dhe mbrojtje të trashëgimisë e të resurseve natyrore.** - Në përputhje me Strategjinë e Energjisë së Kosovës, do të jetë synim që të shfrytëzohet linjiti, duke qenë se është resurs vendor për prodhimin dhe furnizimin me energji elektrike në Kosovë.
- **Balancim në mes të zonave urbane dhe rurale.** - Rritje e Kualitet te jetës duke siguruar model dinamik te zhvillimit te qëndrueshëm rural duke i zhvilluar dhe jap vlere sektorëve kyç brenda zonës.
- **Promovim i transparencës dhe qasjes në ofrimin e të dhënave;**
- **Parimi i gjithëpërfshirjes;**
- **Promovim i procesit demokratik të pjesëmarrjes -palëve të interesit;**
- **Udhëzimet mbi parimet për zhvillim të qëndrueshëm hapësinor - PEZHH** (Harmonizimi politikave sektoriale për një zhvillim të dëshiruar hapësinor, Zvogëlim i konflikteve potenciale në mes të sektorëve);
- **Udhëzime mbi parimet për zhvillim të qëndrueshëm - Agjenda 21** (Respektimi i standardeve dhe normave të BE-se për mbrojtjen e mjedisit dhe popullatës në zonën e interesit);
- **Udhëzime mbi parimet e qeverisjes së mirë - Agjenda e UN HABITAT-it; etj.**

## 2.3. DEKLARATA E VIZIONIT

Duke u bazuar në tërë materialin e disponueshëm, analiza, hulumtime, vlerësime, raporte, strategji dhe parime është hartuar edhe deklarata e Vizionit, e cila pas shumë e shumë diskutimev të modaliteteve të trajtuara gjatë takimeve në grupe punuese, e formësuar kështu në fund nga Grupi Punues Ndërministror, ka këtë përmbajtje:

**Zonë e Interesit të Veçantë Ekonomik - Fusha e Mihjes së Re, zonë e menaxhuar me kujdes, në përputhje me standardet e BE-së në dobi të rritjes ekonomike, mirëqenies sociale dhe gjendjes së kënaqshme mjedisore.**

## 2.4. SYNIMET (CAQET) AFATGJATE TË ZHVILLIMIT HAPËSINOR




Figura 15. Skema piramidale për arritjen e Vizionit. Burimi: IPH/MMPH

Me qëllim të arritjes së deklaruar të VIZIONIT, në mënyrën më të lehtë të mundshme, duhet që Deklarata e Vizionit të ndahet (apo derivohet) në katër (4) synime të fushave të ndryshme të përcaktuara tematike, duke i renditur dhe grupuar, brenda tyre, objektivat gjegjëse.

Në pjesën e Strategjisë (fazë e katërtë) të këtij Plani, shtjellohen dhe renditen veprimet, masat dhe prorijektet e duhura për të arritur secilën nga këto objektiva, si në fig.15.

Sfidave të zhvillimit hapësinor, të mësipërme, do ju kundërvihen synimet e propozuara me nga disa objektiva, si në vazhdim:

### Synimi 1.

#### PRODHIMI DHE FURNIZIMI I SIGURTE ME ENERGI ELEKTRIKE

- ❖ S1.O1. - Ndërtimi i njësive të reja gjeneruese në Termocentralin Kosova e Re, me teknologji më të avancuar, me djegie të linjtit, që nga viti 2011;
- ❖ S1.O2. - Furnizim, bartje dhe shpërndarje e sigurtë e energjisë elektrike në rrjetin elektro-energjetik të sistemit vendor dhe të interkoneksionit deri në vitin 2012;
- ❖ S1.O3. - Iniciativa të vazhdueshme për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme për prodhimin e energjisë&
- ❖ S1.O4. - Shfrytëzimi i ujit/avullit të procesuar nga TC për ngrohje qendrore për Prishtinë, Obiliq, Fushë Kosovë

Fotot 12. Pamje e ftohësit hiperbolik dhe shtyllave të transmisionit. Burimi: Të ndryshme IPH/MMPH



**Synimi 2.****PLANIFIKIM DHE KONTROLLË E PROCESIT TË ZHVENDOSJES DHE ZHVILLIMIT TË VENDBANIMEVE, BRENDA DHE PËR RRETH ZONËS SË FMR-SË**

- ❖ S2.O1. - Hartimi, miratimi dhe zbatimi i doracakut "Korniza e Politikave për Zhvendosje";
- ❖ S2.O2. - Vlerësimi i pronës dhe pasurisë së paluajtshme;
- ❖ S2.O3. - Shpronësimi i pronave;
- ❖ S2.O4. - Kompensimi i pronës dhe pasurisë së paluajtshme;
- ❖ S2.O5. - Zbatim i procesit të pranueshëm për zhvendosje - rivendosje të komunitetit;
- ❖ S2.O6. - Arritje e marrëveshjes me komunitetin për çështjen e varrezave;
- ❖ S2.O7. - Krijimi i fondit për zhvillim të komunitetit nga investitori, &
- ❖ S2.O8. - Planifikim dhe kontroll i zhvillimeve në përmirësim të jetesës brenda dhe rreth zonës.

**Synimi 3.****MENAXHIM I QËNDRUESHËM I RESURSEVE NATYRORE**

- ❖ S3.O1. - Shfrytëzim racional dhe efikas me teknologji të avancuar i resurseve të linjtit;
- ❖ S3.O2. - Parandalimi i vazhdueshëm i vet-djegëjes së linjtit në minierë (mihje);
- ❖ S3.O3. - Shfrytëzimi dhe menaxhimi racional i resurseve ujore;

**Synimi 4.****PËRMIRËSIMI I GJENDJES MJEDISORE DHE PËRKUJDESJA NDAJ TRASHËGIMISË**

- ❖ S4.O1. - Përmirësimi i performancës mjedisore të TC-ve ekzistuese në pajtim me Direktivat
- ❖ S4.O2. - Rehabilitimi dhe rikultivimi i hapësirave të degraduara
- ❖ S4.O3. - Monitorimi dhe kontrolli i rregullt ndaj elementëve mjedisor (ajër, ujë dhe tokë)
- ❖ S4.O4. - Menaxhim i qëndrueshëm i 'Deponisë Rajonale' në Mirash
- ❖ S4.O5. - Menaxhimi dhe shfrytëzimi i hirit të freskët për nevoja në ndërtimtari
- ❖ S4.O6. - Përkujdesje më efikase për peizazhin, biodiversitetin dhe për trashëgiminë (natyrore, kulturore, historike dhe industriale) në zonën e FMR-së.



## 2.5. PRIORITETET STRATEGJIKE

- P.1. Rehabilitim i menjëhershëm dhe i vazhdueshëm i zonave të ndotura dhe të degraduara - Realizimi i Projektit për Pastrimin dhe Rehabilitimin e Tokës (PPRT) me komponentat e saj;
- P.2. Realizimi i projektit të mihjes së re - Sibovcit Jug-Perëndim prej vitit 2010;
- P.3. Punët përgatitore në largim të hirit dhe pastrim të terrenit për ndërtimin e TC Kosova Re në vitin 2011;
- P.4. Fillimi i ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese në fazën e I-rë prej 600 (2x300) MW në vitin 2011, me hyrje në punë më 2015/2016 dhe vazhdimi i ndërtimit të blloqeve në fazat tjera sipas kërkesës së konsumit deri në 2020;
- P.5. Sigurimi i marrëveshjes dhe zbatimi i obligimeve të Traktatit të Komunitetit për Energji (TKE) si dhe respektimi i direktivave të BE-së me prioritet parësor për sektorin e energjisë;
- P.6. Optimizimi i punëve paralele në të dy sistemet komplementare dhe ndërtimi i linjës largpërçuese 400 kV të interkoneksionit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë deri në vitin 2012;
- P.7. Rehabilitim i vazhdueshëm i linjave të vjetëruara dhe ngritja e atyre të reja, 110 dhe 220 KV-she, në kuadër të sistemit të transmisionit (më 2010/12);
- P.8. Hartimi, miratimi dhe zbatimi i doracakut "Korniza e Politikave për Zhvendosje" (Kornizë për vlerësim, shpronësim, kompensim të pronave dhe plane të pranueshme për zhvendosje-rivendosje të komunitetit), që nga viti 2010;
- P.9. Hartimi i Planit Detal të Veprimit për Zhvendosje-Rivendosje të komunitetit me dinamikën e zbatimit për fshatrat në fazën e parë, F-I: Hade, Shipitullë dhe opcionale Krushec (Dardhishtë) në 2011;
- P.10. Krijimi i zyrës Këshilldhënëse dhe për Menagjim të Fondit (ZKMF - FMR) në vitin 2011;
- P.11. Dekomisionimi i kapaciteteve ekzistuese në termocentralin Kosova "A" prej vitit 2016;
- P.12. Rehabilitimi plotë teknik dhe mjedisor i kapaciteteve ekzistuese në termocentralin Kosova "B" më 2016 - 2017 për operim, në përputhje me direktivat për Impiante të Mëdha me Djegje, deri në fund të vitit 2030;
- P.13. Mbrojtja e resurseve të linjimit nga zhvillimet e pakontrolluara
- P.14. Hartimi i studimit të fizibilitetit dhe ndërtimit të bazenit akumulues me qëllim të rritjes së sigurisë së furnizimit me ujë rezervë të TC-ve (Kosova Re dhe Kosova B);
- P.15. Ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave (industrial, të zeza, të kanalizimit, etj) në dalje nga objektet industriale;
- P.16. Përgatitje e planit hapësinor për zonën me interes të veçantë ekonomik "HC - Zhur" në shfrytëzim të resursit ujor për fitimin e energjisë elektrike, dhe
- P.17. Ndërtimi i sistemit adekuat monitorues mbi kualitetin e ajrit, ujit dhe tokës në zonën e ndikimit të objekteve energjetike dhe jashtë saj;
- P.18. Pyllëzimi i brezave mbrojtës gjelbërues në pengim të përhapjes së ndotjes dhe zhurmës rreth objekteve gjeneruese, fushës së minierave dhe rreth zonës së FMR-së

Foto 13. Pamje nga takimet punuese të GPNM-së. Burimi: IPH /MMPH



# KORNIZA E ZHVILLIMIT TË ARDHSHËM HAPËSINOR

## III

### 3. KONCEPTET DHE STRUKTURA E ZHVILLIMEVE TË ARDHSHME

**K**oncepti - Mënyrë e të menduarit për të arritur deri te një gjendje e dëshiruar. Ndhmon në kërkimin e zgjidhjes së problemit. Koncepti i përvetësuar, në këtë rast mund të jetë temë ose frazë e çfarëdo lloji, që mbahet mend lehtë e cila të përkujton apo simbolizon diçka dhe mund të siguroj hulumtime më të fokusuar. Koncepti i tillë mundëson dhe lehtëson marrjen e vendimeve, lidhur me aktivitetet e planifikuara, në kuadër të zhvillimeve të ardhshme, për zonën ku parashihet të ndodhin ato.

#### 3.1. KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR "DETELINË DHE HELIKË"




Figura 16. Skema e konceptit "Detelinë dhe Helikë" për zhvillimin e ardhshëm të zonës së FMR-së. - Burimi: IPH / MMPH

Fakti që zona "Fusha e Mihjes së Re" është e shpallur nga Qeveria e Republikës së Kosovës për Z.I.V.E. orienton kah zhvillimi ekonomik përmes sektorit energjetik duke shfrytëzuar resurset minerare të linjtit nga rezervat në dispozicion të vendit. Ndonëse, ky zhvillim ekonomik është i domosdoshëm, duhet trajtuar në kuadër të zhvillimit qëndrueshëm, duke mos anashkaluar zhvillimet tjera përcjellëse si në aspektin social ashtu edhe atë mjedisor.

Koncepti i zhvillimit hapësinor, me emrin dhe shenjën e vet identifikuese "Detelinë dhe Helikë", i paraqitur si në fig. 16, nënkupton dhe shprehë zhvillimet e ardhshme hapësinore të planifikuara në zonën me interes të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes së Re". Nga skema e këtij koncepti nënkuptohet që zhvillimet e cekura janë procese të vazhdueshme dhe simbolizon të katër synimet e vizionit të këtij Plani Hapësinor.

Përderisa, në njëri anë, synohet përparim i rrjedhës (apo delta) së proceseve të vazhdueshme në funksion të sigurimit dhe furnizimit të blloqeve me linjit si dhe të gjenerimit, transmisionit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, dhe është shprehur me "Helikë" (ku boshti i saj mbanë në lëvizje rrotulluese të tri elisat).

Gjithashtu, me "Detelinë" (Tërfil apo Jonxhë) shprehet cilësia më e mirë e jetesës, gjatë dhe pas funksionimit të zhvillimeve të pritura, duke përfshirë proceset e planifikimit të vendbanimeve me zhvendosjen – rivendosjen e popullsisë nga zona e re e mihjes dhe të rehabilitimit mjedisor dhe më të pastër ekologjik (me rikultivim të sipërfaqeve të degraduara) në anën tjetër.

Qendra Gjeneruese me kapacitetet e saj (të vjetra dhe ato të reja që do të ndërtohen) për prodhim dhe shpërndarje të energjisë elektrike, është e vendosur në mes të zonës me interes të veçantë ekonomik, duke aluduar në të njëjtën kohë, që qendra e FMR-së është edhe qendër e "Detelinës" (simbolit ekologjik - bimës natyrore centripetale dhe "Helikës" (simbolit shtytës zhvillimor - fuqisë motorike centrifugale).

Natyrisht, edhe në të përkthyerit nga gjuhët tjera të huaja, do të emërtohej si "Alfalfa & Delta", duke asocuar në të njëjtin kuptim të zhvillimit të proceseve konkurruese - të rritjes së cilësisë së jetesës botës bimore krahas rritjes së potencialit gjenerues dhe rrjedhës së prodhimit e të furnizimit me energji elektrike, do të theksonin kornizën e zhvillimeve të ardhshme themelore, brenda mundësive hapësinore të zonës "Fusha e Mihjes së Re".

Përmes këtij koncepti tentohet:

- Planifikim dhe zhvillim i ndërlidhur dhe i koordinuar hapësinorë në mes të Fushave Tematike të bazuara në Sfidat kryesore (çështje të përmbledhura) që përfshihen në zonën me interes të veçantë ekonomik,
- Harmonizim dhe bashkëveprim në mes nivelit qendrorë me atij lokal gjatë procesit të zbatimit të projekteve konkrete dhe kontrollit të zhvillimeve brenda dhe jashtë kufirit të zonës,
- Përzgjedhje e aktiviteteve sipas prioriteteve dhe implikimeve hapësinore, kohore dhe të kapaciteteve buxhetore dhe institucionale si dhe
- Arritje e dëshiruar e zhvillimit të ardhshëm të planifikuar hapësinor, në përmbushje të Vizionit të parapërcaktuar për zonën e FMR-së (kur veprimet dhe aktivitetet që dalin nga koncepti "Detelinë dhe Helikë" janë të qëlluara).



### 3.2. STRUKTURA E ZHVILLIMEVE SIPAS KONCEPTIT

Koncepti "Detelinë dhe Helikë", në rastin e parë, është bima e detelinës (tërfillit apo jonxhës) me tri petalet e saj që shprehë tendencën për një mjedis sa më të pastër dhe ekologjik të mundshëm në zonë, kurse, në rastin e dytë ajo është helika në rrotullim të vazhdueshëm që shprehë shtytjen përpara të rrjedhave të zhvillimeve tjera të fuqishme. Këtu, dallohen lehtë aktivitetet që do të zhvillohen gjatë proceseve sikur ato të shpronësimin, të kompensimit, të zhvendosje - rivendosjes së popullsisë nga vendbanimet në zonë të mihjes së re, të planifikimit dhe kontrollit mbi zhvillimet në basenin e Kosovës, të nxjerrjes dhe furnizimit të termocentraleve me linjit, të sigurimit prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike si dhe të rehabilitimit të hapësirave të degraduara dhe rikultivimin e sipërfaqeve tokësore për shfrytëzim të ri bujqësorë e pyjor të saj.

Natyrisht, koncepti i zhvillimit të ardhshëm hapësinor për zonën me interes të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes së Re", mund të qartësohet, kuptohet dhe realizohet më lehtë atëherë kur strukturën e përgjithshme të saj e ndajmë (derivojmë) në disa nënstruktura, të bazuara në sfida dhe synime, si më poshtë.

#### 3.2.1. PRODHIMI DHE FURNIZIMI I SIGURTË ME ENERGJI ELEKTRIKE DHE TË NGROHJES.

Zhvillimi i sektorit të energjisë është nevojë dhe domosdoshmëri për një zhvillim të gjithmbarshëm ekonomik e të qëndrueshëm të vendit. Me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të energjisë, Qeveria e Kosovës, në mungesë të kapaciteteve investuese vetanake, planifikon kycjen e ekspertizës dhe kapitalit privat nga jashtë. Banka Botërore, përmes Projektit të Asistencës Teknike Energjia nga Linjiti (PATEL)<sup>24</sup>, është duke mbështetur Kosovën në përpjekjet për të joshur investimet për zhvillimin e projektit "Kosova e Re". Orientimi i zhvillimit të këtij projekti bazohet në kërkesën për prodhim dhe furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike, në strategjitë e sektorëve energjetik, si dhe në studime e hulumtime të gjeranishme të kësaj lëmie.




Figura 17. Skica e prerjes së bllokut në termocentralin me linjit. Burimi: Ligjerata trajnimi për VSMS nga PATEL

<sup>24</sup> Objektivat kryesore të PATEL janë: (a) mbështetja e Qeverisë në fuqizimin e politikave, kornizës ligjore dhe rregullative të cilat mundësojnë investimet të reja në sektorin e energjisë; dhe (b) mbështetja e Qeverisë për të joshur investitorë privat të kualifikuar për ndërtimin e termocentralit të ri me linjit, bazuar në principet e larta të qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale.

Natyrisht, për zbatim sa më të lehtë dhe funksional, projekti "Kosova e Re" është ndarë në nënsektore apo fusha tematike, nga të cilat dallojmë:

1. Zhvillimin e fushës së re të mihjes për furnizim të dy termocentraleve ekzistuese dhe termocentralit të ri Kosova e Re,
2. Ndërtimi i termocentralit të ri TC KR (Kosova e Re)
3. Participimi i sektorit privat në termocentralin Kosova B.
4. Ndërtimi i centraleve elektrike duke shfrytëzuar burime të ripërtëritshme

Në vitin 2009 ngarkesa maksimale e konsumit vendor ishte 1072 MW me bruto konsumin prej 5.271 GWh. Shkalla e rritjes mesatare vjetore e konsumit për periudhën 2000 - 2009 ishte mbi 7% dhe me humbje të përlllogaritura (qofshin ato komerciale apo teknike) prej 42 % nga sasia e energjisë në dispozicion për shitje. Ndërsa, sipas parashikimeve, me ulje të humbjeve deri në 18%, nevojat kulminante vendore në vitin 2020, varësisht nga skenarët si në vazhdim, do të ngriten në:

- a) 1410 MW, në rast të rritjes së mesme ekonomike të vendit (ose me rritje vjetor prej 2.1%) dhe
- b) 1890 MW, në rast të rritjes së lartë ekonomike të vendit (ose me rritje vjetore prej 4.2%).

Funkcionimi efikas i rrjetit të shpërndarjes dhe bartjes së energjisë elektrike ka rëndësi të madhe për shkëmbimet në sistemin e interkoneksionit dhe operimit të tregut në rajon. Ndërtimi i linjes së re 400 kV ndërmjet R. së Kosovës dhe R. së Shqipërisë mundëson edhe optimizmin afatgjatë të dy sistemeve komplementare.

Projekti "Kosova e Re", parashikon ndërtimin e termocentralit të ri, duke u bazuar në shfrytëzimin e rezervave të linjitet në fushën e re të mihjes, që mundësojnë furnizim të blloqeve në termocentralet ekzistuese deri në fund të jetës së tyre si dhe në termocentralet e reja, me kapacitet maksimal deri në 2.000 MW për periudhë më shumë se 40 vite. Mbështetur në këto vlerësime, ngritja e kapaciteteve më të volitshme bëhet duke shqyrtuar edhe skenarët e mundshëm, sipas secilit opcion, për nga:

- A. Koha e ndërtimit;
- B. Madhësia dhe lokacioni përshtatshëm për ndërtim të TC "Kosova e Re";
- C. Madhësia e blloqeve për TC Kosova e Re dhe
- D. Teknologjia e blloqeve në TC Kosova e Re.

Nga skenarët për kohëzgjatjen dhe mënyrën e zhvillimeve në ndërtim të blloqeve, gjegjësisht të njësive të parapara gjeneruese, janë potencuar si:

- I. Zhvillim i shpejtë, me ndërtim të njëpasnjëshëm dhe në faza, të njësive (blloqeve) gjeneruese, së pari 2 x 300 MW të instaluar me kohëzgjatje ndërtimi dhe hyrje në punë pas 4/5 viteve, duke vazhduar me ndërtimin dhe aktivizimin e dy blloqeve tjera 2 x 300 MW të rradhës deri në vitin 2020 si dhe më pas tjerat deri në 2000 MW gjithsej pas vitit 2025;
- II. Zhvillim i periodizuar me ndërtim të njësive (blloqeve) gjeneruese, në çdo gjashtë (6) muaj nga 300 MW të instaluar, në varësi nga kërkesat e konsumit vendor dhe interesit rajonal.

Bazuar në studimet paraprake dhe kriteret e plotësuara për selektim të lokaliteteve hapësinore për ndërtimin e blloqeve të reja gjeneruese janë identifikuar këto lokacione të mundshme:

- Në zonën industriale afër TC Kosova B
- Në zonën e lirë bujqësore në afërsi të fshatit Bivolak
- Në zonën e lirë natyrore në afërsi të fshatit Graboc dhe
- Në zonën industriale afër TC Kosova A

Natyrisht, me përzgjedhjen e lokacionit më të përshtatshëm për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re, nevojitet të definohen edhe kapacitetet e duhura prodhuese, gjegjësisht madhësia e njësive të reja në kuadër të qendrës gjeneruese elektro-energjetike. Propozimet e identifikuar të gjertanishme, për madhësi të njësive (kapacitete të blloqeve gjeneruese) që duhet të përdoren, bazohen dhe varen edhe

nga: sistemi elektroenergetik, teknologjitë e moderne komercialist të vërtetuara dhe nga aspekti mjedisor të pranueshme.

Madhësitë e blloqeve janë të ndryshme, por për Kosovën, më të preferuara janë:

- Blloqet prej 300 MW dhe
- Blloqet prej 500 MW;

Në të dyja rastet duke shfrytëzuar dy teknologji po ashtu të preferuara (CFB - me djegie në shtresën e fluidizuar dhe PC - djegie në pluhur të imtësuar)

Në parim, njësitë më të mëdha janë më efikase, mirëpo për momentin nga pikëpamja e operimit me sistemin elektroenergetik me kosto më të ulët njësitë më të përshtatshme janë të rendit 300 MW, kurse në fazat e ardhshme mund të jenë edhe njësitë me madhësi prej 500 - 600MW.

Teknologjia e blloqeve, siç u referua mund të jetë CFB dhe PC për blloqet e rendit 300 MW, që planifikohen të ndërtohen në këtë fazë, në termocentralin e ri, të bazuara në studimet e POYRY-t. Këto teknologjitë të preferuara janë me këto karakteristika:

- Teknologjia me djegie në pluhur (Pulverized firew - PF) të linjtit, për fuqi të instaluar të blloqeve prej 300, 500, 700 MW dhe efikasitetit neto të bllokut deri në 42 % , dhe
- Teknologjia me shtresë të fluidizuar qarkulluese (Circulating fluidized bed - CFB) me fuqi të instaluar të blloqeve prej 100, 200, 300 MW dhe efikasitet neto të bllokut deri në 39 %

### 3.2.2. SHFRYTËZIMI I LINJITIT PËR FURNIZIM TË TERMOCENTRALEVE.

Nga vlerësimet dhe përzgjedhjet e favorizuara, sipas skenarëve të lartpërmendur, për kohëzgjatje dhe lokacion të ndërtimit, për kapacitetet e njësive dhe teknologjisë së blloqeve gjeneruese të termocentralit të ri, varet edhe kahja e zhvillimit dhe shpejtësi e avancimit të mihjes në minierën e re të linjtit.

Për të mundur sigurimin e prodhimit të mjaftueshëm të energjisë elektrike në të ardhmen, duhet të hapet një minierë e re nga e cila do të siguroheshin sasitë e nevojshme të linjtit për furnizim të vazhdueshëm të termocentraleve ekzistuese dhe asaj të re. Fusha "C" ose e ashtuquajtura "Mihja e Sibovcit"<sup>25</sup>, që si minierë e re siguron lëndën e parë, ka sipërfaqe totale prej 19.7 km<sup>2</sup>, kurse brenda saj, ajo për shfrytëzim të linjtit është 16 km<sup>2</sup>. Ky vendburim i linjtit, që si aktivitetet do të zhvillohet për 4 - 5 dekadat e ardhshme, gjendet në hapësirën qendrore të zonës së FMR-së dhe shtrihet në perëndim të qytetit të Obiliqit dhe është në vazhdim të pjesës veriore të mihjeve ekzistuese të Bardhit dhe Mirashit.

Ndërkohë, për të zbutur efektet afat - shkurte për zhvillim normal të mihjes së re, KEK-u ka zgjeruar aktivitetin e vet edhe në pjesën lindore të Mirashit, i ashtuquajtur Sektori i Sitnicës, ku rezervat e shfrytëzueshme janë afër 10 milion ton.

Bazuar në projektin xehetar për zhvillimin e mihjes së re, me synim të furnizimit me kontinuitet të TC Kosova A dhe TC Kosova B, KEK-u sh.a., gjatë vitit 2009 ka realizuar një pjesë të projektit në hapjen e mihjes së re në Sibovc Jug-Perëndim, ku prodhimi i linjtit do të fillojë që në vitin 2010.

Në kuadër të procesit të zhvillimeve minerare, në vazhdimi kërkohet, që në radhë të parë të bëhet mihja e shtresës së sipërme të dheut dhe palosja e kësaj djerrine në hapësirat e thelluara në minierat ekzistuese (të Bardhit dhe Mirashit), ku mëpas, vazhdon mihja dhe nxerrja e linjtit si dhe transportimi direkt në termocentrale. Prej masës së bartur të linjtit nga miniera, një sasi e vogël rezervohet për terje dhe shërben si rezervë, në afërsi të kapaciteteve prodhuese.

<sup>25</sup> Fshati Siboc, vendosur në qendër të FMR-së, në planet e mëhershme të mihjes ishte emri i huazuar për fushën e re të mihjes

Mirëpo, për funksionalizim pa pengesa të procesit të zhvillimit minerar, duhet të mirren masa dhe aktivitete paraprake, në lirim të terrenit, për mbarëvajtjen e punëve sipas planit të përgatitur xehetar. Akoma më herët duhet të planifikohen masat dhe aktivitetet tjera të nevojshme si për inventarizim, shpronësim, kompensim dhe zhvendosje - rivendosje të pranueshme të popullsisë me të mirat e tyre materiale dhe shpirtërore si dhe zhvendosja e objekteve të infrastruktures.

### 3.2.3. KORNIZA E POLITIKAVE PËR ZHVENDOSJEN E POPULLSISË

Në hapësirën e zonës së interesit të FMR-së ndodhen 26 vendbanime, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejt ose indirekte janë të ndikuar nga zhvillimet e pritura në ndërtimin dhe funksionimin e njërive gjeneruese, në bartjen dhe deponimin e hirit, në avancimin e mihjes dhe bartjen e linjitet si dhe në bartjen dhe shpërndarjen e energjisë elektrike etj.

Vendbanimet që ndodhen mbi rezervat e linjitet, e të ndikuara drejtpërdrejt nga procesi i zhvillimeve minerare (në zhvendosje të masës së djerrinës, nxjerrje dhe bartje të linjitet) janë: Hade, Sibovc, Shipitullë dhe Leshkoshiq (Lajthishtë). Përveç tyre është edhe fshati Krushec (Dardhishtë) që ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejt nga ndikimet e përmendura dhe deponia rajonale në Mirash. Nëse veprimet përcaktuara me PH për zonën e FMR-së nuk japin rezultate përmirësimi të gjendjes mjedisore në këtë fshat atëherë nuk i shmanget variantit të zhvendosjes sikur edhe katër vendbanimet e para. Këto pesë (5) vendbanime, për të cilat kërkohet tretman i veçantë ngase do të nënshtrohen procesit të domosdoshëm të zhvendosjes, i takojnë komunës së Obiliqit. Prandaj, duke pasur parasysh problemet me të cilat është ballafaquar Qeveria (lokale dhe qendrore) me rastin zhvendosjes së një pjese të fshatit Hade, rekomandohet që të ndërmerren disa hapa paraprak para se të vazhdohet me procesin e zhvendosjes së popullsisë dhe rivendosjes së tyre në vendbanime të reja.

Mësimet nga e kaluara tregojnë që institucionet përkatëse (Qeveria, Komuna, KEK-u, etj) duhet të jenë shumë më të përgatitura me plane konkrete të veprimit, me qëllim të mbarëvajtjes së procesit.

Në ndërkohë, është duke u finalizuar drafti "Korniza e Politikave për Zhvendosje", që pritet të miratohet nga Qeveria, veçmas ose së bashku me këtë Plan, për të shmangur brengat e banorëve të vendbanimeve që zhvendosen. Prandaj, e njëjta parashihet që, për realizimin e procesit të zhvendosje - rivendosjes së popullsisë, duhet ndjekur disa hapa konkret, si:

- **Përfshirja e pjesëmarrësve kyç në proces** – Aktorët kryesor në këtë proces që duhet të përfshihen janë: banorët e vendbanimeve të prekura, përfaqësues të qeverisë qendrore dhe asaj lokale, të KEK-ut, të kompanisë investuese të jashtme, organizatat mbështetëse etj.
- **Takime me publikun** – Diskutimet e tilla me komunitetin dhe aktorët e përfshirë në proces janë të domosdoshme që nga fillimi i procesit e deri në përfundim të tij. Këto diskutime me publikun mundësojnë njoftimin në çdo kohë dhe informimin e drejtpërdrejt të komunitetit me situatën dhe veprimet në vazhdim të procesit.
- **Kompletimi i legjislacionit adekuat** – Kërkohet që në fillim të procesit të kompletohet legjislacioni për shpronësim, për tokën bujqësore, ndërtimore, të drejtat e qytetarëve për kompensim etj, në mënyrë që të mos lejohen zbrazëtira dhe paqartësi në aspektin ligjor gjatë zhvillimit të procesit.
- **Krijimi i bazës së të dhënave** – Databaza e tillë do të shërbejë për futjen, ruajtjen, procedimin dhe zhvillimin e të dhënave për treguesit e ndryshëm për territorin e prekur, nga çështje të ndara nën procesin e zhvendosjes e edhe më gjerë. Preferohet, të caktohet institucioni përgjegjës që do të merret më krijimin, mirëmbajtjen, klasifikimin, ruajtjen dhe zhvillimin e të gjitha të dhënave në një vend.
- **Identifikimi i pronësisë dhe pasurisë së paluajtshme** – Është e domosdoshme të bëhet identifikim, prandaj duhet të themelohet një komision për identifikimin e pronarëve të vërtetë, vlerësimin dhe kompensimin e pasurisë së paluajtshme dhe të pronave.



- **Themelimi i "Komisionit të pavarur për shqyrtim të Ankesave" - përgjegjës për për të mbuluar të gjitha aspektet e projektit.** Ky komision duhet të përbëhet prej përfaqësuesve nga sektorët relevant të Qeverisë, Komunës, komunitetit, MMPS dhe investitorit, në mënyrë që asnjë palë e interesit të mos krijoj favore apo pakënaqësi të tepruara. Me qëllim të zvogëlimit (lehtësimit) të brengave të banorëve, i njëjti komision duhet të themelohet për të mbuluar të gjitha aspektet e projektit.
- **Vlerësimi i pronave** - Kompania e Projektit do të bëjë vlerësimin e pasurisë si dhe caktimin e shumës së kompensimit, krijon një pasqyrë sa më korrekte të vlerësimit dhe kompensim të pronave, duke organizuar hulumtime të cilat do të identifikojnë pronën dhe vlerën e saj reale, mbi kriteret që do të hartoj dhe nxjerrë rezultatet për vlerësimin e secilës pronësi apo pasuri të paluajtshme (qofshin ato objekte banimi, depo të ndryshme, pjesë përcjellëse apo edhe sipërfaqe të pyjeve, tokë bujqësore, etj).
- **Mënyra e kompensimit** - Përcaktimi i mënyrave të kompensimit bëhet nga Kompania e Projektit, duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e komunitetit, Kornizën e Politikave për Zhvendosje dhe në ligjin për shpronësim, ku janë definuar dhe dallohen këto mundësi: a) Pagesë me para (kesh) në dorë, b) Kompensim të tokës me tokë, dhe c) Ndërrimin e ndërtimit për ndërtim. Vlerësimi dhe mënyra e kompensimit do të reflektohet në planin e veprimit për zhvendosje i cili do të aprovohet dhe monitorohet nga Organi Shpronësues.
- **Përcaktimi i lokacionit dhe hartimi planeve për rivendosje** - Përzgjedhjes së lokacionit për rivendosjen e popullatës së zhvendosur para së gjithash duhet ti paraprijnë hulumtimet dhe analizat të cilat nxjerrin në pah interesin e banorëve për rilokimin e tyre të ardhshëm. Është e domosdoshme që pas përcaktimit për lokacionet e parapëlqyera të kërkohet hartimi i planeve rregulluese për ato zona. Këtu mund të preferohen, zonat e ndërtuar (në vendbanimet ekzistuese të komunës së Obiliqit) me një shpeshim (densifikim) të objekteve apo edhe të ndërtimeve në vertikale (në etazhe) brenda vendbanimeve (p.sh. Obiliq, Mazgit, Milloshevë dhe Graboc i Epërm), me qëllim të ruajtjes së tokës bujqësore. Në bashkëpunim me komunitetin dhe organet gjegjëse do të vendoset për formën dhe pozitën e objekteve të kultit, të përmendoreve dhe të varrezave si çështje më e ndjeshme shpirtërore, të cilat janë po ashtu pjesë e Planeve Rregulluese Urbane që do të hartohen për vendet e dedikuara për rivendosjen e popullatës nga vendbanimet e zhvendosura.
- **Themelimi i zyrës këshillë-dhënëse** - kjo zyrë duhet të themelohet në komunën e Obiliqit që në fillim të procesit të zhvendosjes, në mënyrë që t'ju ofroj këshilla të llojllojshme komunitetit rreth procedurave dhe kohës së zhvendosjes, për çështjet e lokacioneve, llojin e kompensimeve, për kushtet dhe përparësitë e punësimit, qasjes në infrastrukturë dhe shërbime, mbi transparencën e investimeve (grumbullimit dhe harxhimit) të fondit për të zhvendosurit etj.
- **Krijimi i fondit për komunitetin e zhvendosur** - Duke pasur parasysh vështirësitë me të cilat përballen banorët nga vendbanimet e zhvendosura (humbjen e pasurisë dhe të mirave tjera materiale e shpirtërore), është e nevojshme që me një vendim nga organet kompetente të krijohet "Fondi për komunitetin e zhvendosur", me qëllim të ngritjes së standardit të jetesës. Ky fond, me përparësitë e veta, duhet të funksionoj më së paku për periudhën e ardhshme 10 vjeçare.
- **Dinamika e zhvendosjes** - Varësisht nga dinamika e avancimit të mihjes, duhet të hartohet edhe plani i hollësishëm dinamik i veprimit për zhvendosjen dhe rivendosjen e popullsisë nga vendbanimet nën procesin e zhvendosjes.

Investitori përpilon projektin e ri xehetar i cili duhet të aprovohet nga KPMM.

Zhvendosja e përgjithshme e popullsisë bazohet në zhvillimin dhe avancimin e mihjes së re mbi projektin e aprovuar dhe sipas Planit Dinamik për Zhvendosje, me afatin kohorë dhe përgjegjësitë e caktuara, të hartuar nga Investitori në bashkëpunim me Qeverinë.

Deri në vitin 2020, nevojitet të zhvendosen tërësia e mbetur e fshatit Hade dhe pjesa e fshatit Shipitullë që shtrihet në fushën e re të mihjes, bazuar në licencën e lëshuar për mihje dhe në mbulueshmërinë e këtij Plani Hapësinor. Kurse, pas vitit 2020, në varësi nga zhvillimi i projekteve, mund të vazhdoj zhvendosja e vendbanimeve tjera, në fushën e re të mihjes, të fshatit Sibovc dhe të fshatit Lajthishtë (Leshkoshiq)..

### 3.2.4. REHABILITIMI MJEDISOR

Është e domosdoshme që në zonën e interesit të FMR-së, të fillohet menjëherë me veprimet adekuate në të mirë të përmirësimit të mjedisit jetësor. Gjatë tërë kohës së zhvillimit të proceseve minerare, të gjenerimit dhe të zhvendosje – rivendosje të popullatës në vendbanime të reja, si dhe pas përfundimit të tyre, do të zhvillohet edhe procesi i vazhdueshëm i rehabilitimit mjedisor në zona e shfrytëzuara.

#### Ajri

**Emetimet në atmosferë** - Termocentrali i ri duhet të jetë plotësisht në pajtim me direktivat e BE-së, sidomos Direktivat LCP për centralët me djegie të mëdha, që do të nënkuptojnë shkallët vijuese të limituara të emetimit që nga fillimi i operimit, për:

1. Dyoksid të squfurit SO<sub>2</sub> - 200 mg/nm<sup>3</sup>
2. Okside të azotit NO<sub>x</sub> - 200 mg/nm<sup>3</sup> dhe
3. Grimca të pluhurit - 30 mg/nm<sup>3</sup>

Lidhur me produktet e djegies dhe shkallët e kërkuara të emetimit në atmosferë duket se djegia CFB (shtrati qarkullues i fluidizuar) mund të plotësojë limitet e emetimit SO<sub>2</sub> dhe NO<sub>x</sub> në dalje të kazanit duke përdorë injektimin e gëlqeres, brenerët për NO<sub>x</sub> të ulët dhe elektrofiltra statik për kapjen e hirit fluturues. Në këtë rast të posaçëm, pasi linjiti përmban sasi domethënëse të gëlqeres CaSO<sub>4</sub> dhe përqindja e sulfurit në lëndë djegëse është e ulët, mund të pritët se emetimet e dyoksidit të sulfurit do të jenë në kufirin e lejuar duke përdorur shkallën më të ulët të desulfurizimit. Në rast të aplikimit të teknologjisë PC, për uljen e emetimeve të SO<sub>2</sub> do të aplikohet larja e gazrave me gëlqere me ç'rast fitohet gjipsi. Hiri dhe zgura e prodhuar në termocentralin me teknologji CFB dhe PC do të bartet në minierën ekzistuese me transportim hidraulik.

**Dekomisionimi i Termocentralit Kosova A.** Terminet e hyrjes në punë të blloqeve të reja të TC Kosova e Re, kërkesat e konsumit, siguria e furnizimit, zvogëlimi i importit të energjisë elektrike, terminet e rehabilitimit të blloqeve në TC Kosova B, objektivet të Strategjisë së Kosovës për Energji 2009 – 2018 si dhe obligimit që ka Kosova ndaj Traktatit të Komunitetit të Energjisë (prej nga kërkohet respektimi i Direktivës 2001/80/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 23 Tetor 2001 mbi limitimin e disa ndotësve në ajër nga Impiantet e Mëdha me Djegie) rekomandojnë për punën e TC Kosova A deri në fund të vitit 2017 me propozim për remonte dhe mirëmbajtje të mirë në zvogëlim të emisioneve.

Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë ka mbështetur Studimin " Dekomisionimi i Termocentralit Kosova A" i cili është kryer në Pranverën e vitit 2010 dhe parasheh që aktivitetet për dekomisionim të fillojnë menjëherë e të zhvillohen në faza. Studimi rekomandon vendimet strategjike për Qeverinë e Kosovës dhe terminet e nxjerrjes nga puna edhe për tri blloqet e mbetura në punë (A3, A4 dhe A5) përfundimisht deri në fund të vitit 2015.

Zbatimin e procesit të dekomisionimit të TC Kosova A duhet bazuar në aktivitetet e tri grupeve punuese të themeluara në këtë qëllim:

1. Grupi punues për plotësimin e studimeve të nevojshme për dekomisionim ( kryesues MEM-i dhe në përbërje MEF, MMPH, MPMS, MIE, KEK- sh.a.).
2. Grupi punues për çështje sociale (kryesues MPMS-ja dhe në përbërje MEF, MEM, MIE, KEK-sh.a., Sindikata).
3. Grupi punues për sigurimin e financimeve dhe kryerjen e dekomisionimit (kryesues MEF-i dhe në përbërje MMPH, MIE, MEM, KEK sh.a.).

## Uji

Uji i papërpunuar që do të nevojitet për sisteme të ciklit të avullit, të ftohjes, desulfurizimit, transportit të hirit dhe zgurës, fikjes së zjarrit etj, është në varësi nga kapaciteti i instaluar dhe teknologjia e aplikuar në Termocentralin Kosova e Re. Kërkesat për ujë të papërpunuar, nga kanali i ujit të Hidrosistemit "Ibër-Lepenc", për një bllok me fuqi të instaluar prej 300 MW dhe të plotë vjetore prej 7,500, janë rreth 0.21 – 0.22 m<sup>3</sup>/sec ose 5.5 – 6.0 milion m<sup>3</sup>/vit. Kërkesat vjetore për ujë të papërpunuar do të definohen më saktësisht kur dihet, përveç kapacitetit të instaluar, teknologjisë së aplikuar, edhe dinamika e ndërtimit të blloqeve.

Meqë, rezervat e shfrytëzueshme të linjtit në fushën e re të mihjes, përveq furnizimit të Termocentraleve ekzistuese (Kosova A dhe Kosova B) deri në fund të jetës së tyre, mundësojnë edhe ndërtimin e termocentraleve të reja me kapacitetet përfundimtar deri në 2.000 MW.

Në studimin e Parafizibilitetit "Furnizimi me ujë nga Hidrosistemi Ibër – Lepenc për Termocentralin e Propozuar "Kosova C", për madhësinë e ndërtuar të termocentralit me fuqi të instaluar prej 2.000 MW, nevojitet 1.52 m<sup>3</sup>/sec dhe 47.93 milion m<sup>3</sup>/vit. Momentalisht, Termocentrali Kosova B, furnizohet nga kanali kryesor i ujit i këtij hidrosistemi me 0.5 m<sup>3</sup>/sec dhe 15.77 milion m<sup>3</sup>/vit. Ky sistem, menaxhohet nga ndërmarrja publike HS Ibër-Lepenci, e themeluar për këtë qëllim dhe nuk kërkon ndërtimin e ndonjë kanali tjetër shtesë, meqë kanali ekzistues kalon nëpër Bivolak dhe përfundon tek lokacioni i TC-së Kosova B. Në rast të ndërtimit të TC-së "Kosova e Re" në lokacion tjetër, atëherë duhet ndërtuar edhe kanalin shtesë në kuadër të këtij sistemi ose mund të përdoren burime tjera, nëse janë të mjaftueshme, për furnizimin e tij me ujë.

**Bazeni i ujit rezervë.** Për shkaqe të sigurisë së operimit të termocentralit Kosova B dhe Kosova e Re në fund të kanalit kryesor të Hidrosistemit Ibër – Lepenc do të ndërtohet një bazen për ujë rezerve për operim rreth dy javor të termocentraleve pa ndërprerje.

## Toka

**Shfrytëzimi i tokës** në hapësirat e zonës së interesit duhet të kufizohet, në kategori dhe sipas llojit/tipit të shfrytëzimit, të cilat nuk janë të ndjeshme ndaj ndotjes së tokës, kjo mund të jetë pjesë e planifikimit të orientuar hapësinor për tërë sipërfaqen mjedisore të pasur me resursin e linjtit.

**Hiri fluturues** i ekstraktuar në elektrofiltrat statik do të mblidhet në mënyrë pneumatike nga hinkat (bunkerat) e termocentralit. Prej rezervarit balancues do të bartet në një tjetër rezervar ku bëhet përzierja e hirit me ujë në raport 1:1, prej nga, suspensioni, pompohet për në deponinë e hirit në Mirash, me ç'rast përzierja e tillë e fundërruar, gradualisht do të ngurtësohet në sipërfaqen e ujit i cili kullohet dhe kthehet në termocentral. Ky sistem, i transferimit të suspensionit është i përbashkët si për hirin fluturues ashtu edhe për blozën, e cila nga kaldaja vjen në rezervar të posaqëm, ku pas ftohjes edhe grimcimit vazhdon për në rezervuarin për përzierje.

Duke pas parasysh se një numër i madh i mbeturinave, të dëmshme dhe jo të dëmshme, prodhohen në termocentrale, paraqitet nevoja e ndërtimit të deponive për mbeturina të tilla me pajisjet e nevojshme. Mbeturinat do të deponohen dhe përpunohen në mënyrë të rregullt në pajtim me legjislacionin në Kosovë dhe Udhëzimet e BE mbi mbeturinat dhe groposjen e tyre.

**Projektit për Pastrimin dhe Rikuperimin e Tokës (PPRT).** Projekt në realizim, nga donacionet e BB dhe Mbretërisë Hollandeze, i hartuar dhe në zbatim nga KEK-u, sipas komponentëve me sa vijon:

- **Rehabilitimi, formësimi dhe rikultivimi i deponisë së hirit të TC Kosova A.** Është bërë rehabilitimi i disa hapësirave për rreth në deponinë e hirit (rrafshime dhe mbulime të luginave,



gropave dhe hendeqeve) dhe përmirësimi ngritja e infrastrukturës për qasje më të mirë dhe nevoja tjera të projektit.

- **Krijimi i sistemit për transportimin hidraulik të hirit.** Është shpallur tenderi për kryerjen e punëve për instalimet e sistemit hidraulik për transportimin e hirit. Tani është faza e përzgjedhjes së kompanisë më të mirë për kryerjen e punëve.

- **Largimi i materieve dhe mbeturinave të rrezikshme në seperimet kimike nga zona industriale e TC Kosova A.** Është përgatitur Raporti për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM), për të cilin është organizuar debat publik në Komunën e Obiliqit. Nga BB janë bërë përgatitjet për shpalljen e tenderit për projektin "Trajtimi dhe largimi i mbeturinave të rrezikshme nga zona e impiantit të gazifikimit në Obiliq" pas marrjes së pëlqimit mjedisorë. MMPH-ja ka pranuar kërkesën nga KEK-u dhe pas analizave të gjithanshme, jep pëlqimin mjedisor sipas kushteve dhe legjislacionit ne fuqi për trajtimin dhe largimin e 20.241 Ton mbeturina të rrezikshme të cilat janë të vendosura në rezervuare, të pa siguruara me mure mbrojtëse dhe ekziston rreziku nga rrjedhja e tyre.

- **Riformësimi, rikultivimi dhe rregullimi i pjerrtësisë në palosjet e jashtme të djerrinave.** Planifikohet që në periudhën e verës të fillohet me rehabilitimin e deponisë së djerrinës së Vasilevës e cila konsiderohet njëra nga deponitë me stabilitet më të ulët të terrenit. Puna në këtë deponi do të përfundoj sipas planit më 2011.

**Foto 13. Pamje nga rikultivimi vetanak. – Burimi: IPH / MMPH.**





### 3.3. VLERËSIMI SKENARËVE BAZUAR NË KONCEPTIN ZHVILLIMOR

#### 3.3.1. SKENARËT ALTERNATIV PËR ZGJEDHJEN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE TË REJA GJENERUESE

Ndër skenarët e mundshëm, si opcionet më të preferuara, të bazuara në studime dhe hulumtime paraprake, që do të analizohen dhe vlerësohen, si lokacione potenciale për ndërtimin e TC-së së Re, theksojmë katër sosh:

Skenari A: Ndërtimi TC KR-së në lokacionin industrial të TC Kosova A;  
 Skenari B: Ndërtimi TC KR-së në lokacionin industrial të TC Kosova B;  
 Skenari C: Ndërtimi TC KR-së në zonën e gjelbërtë në fshatin Bivolak dhe  
 Skenari D: Ndërtimi TC KR-së në zonën e gjelbërtë në fshatin Grabovc.

Gjatë trajtimit të katër skenarëve është bërë shqyrtimi i ndikimeve nga treguesit e shumtë hapësinor, mjedisor, social, ekonomik, infrastrukturor dhe të shërbimeve të ndryshme që ndërlidhen me zonën. Me qëllim të thjeshtësimit të punës, së pari janë nxjerrë karakteristikat e përbashkëta, kurse më pas, janë hartuar kriteret e veçanta (që në vehte mund të përmbajnë disa tregues) për vlerësim të secilit lokacion veç e veç dhe në fund nga vlerat e grumbulluara është bërë krahasimi në mes tyre për të dalluar më të përshtatshmin.

##### Karakteristikat e përbashkëta për të katër skenarët

Skenarët e propozuar A, B, C dhe D, të paraqitur si në fig. 3.2, janë trajtuar dhe analizuar mirë, kurse nga vlerësimet e bëra janë shkoqitur dhe theksuar këto fakte si karakteristika të përbashkëta:

- Zona e FMR-së, vazhdon të jetë qendër e gjenerimit të energjisë elektrike në Kosovë, ku burimet vendore të linjtit do të shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe duke ditur se:
  - Bllloqet e TC-ve ekzistuese janë larg standardeve mjedisore ndërkombëtare, se jeta e tyre operacionale është e kufizuar, bazuar në kërkesat që dalin nga Direktivat e reja të BE-së;
  - TC-li Kosova A, duhet të mbyllet përfundimisht, deri në fund të vitit 2017 ose edhe më heret, për shkak të vjetërsisë së bllloqeve dhe çështjeve të sigurisë së operimit;
  - Rehabilitimi i zonës së kontaminuar në lokacionin e TC-it Kosova A të realizohet me projekt dhe staf vendor nën investim dhe mbikëqyrje të BE-së;
  - Te dy bllloqet e TC-it Kosova B, duhet ti nënshtrohen rehabilitimeve, gjatë periudhës së planifikuar 2016-2017;
  - Largimi i hirit të deponuar ose rregullimi saj në lokacionin e TC-it Kosova B do të zbatohet me projekt dhe staf vendor nën investim dhe mbikëqyrje të BE-së;
  - Bllloku i pare i TC Kosova e Re, do të duhet të filloj me operim, para mbylljes së TC-it Kosova A, bllloku i parë në fund të vitit 2015, kurse bllloku i dytë në mes të vitit 2016.
- Rezervat e linjtit në dispozicion që gjenden në kuadër të FMR-së janë të mjaftueshme të furnizojnë të dy TC-të ekzistuese deri në përfundim të operimit të tyre dhe për 4-5 dekadat e ardhshme dhe mundëson ndërtimin e TC-ve të reja me kapacitete maksimale deri në 2.000 MW;
- Plani i avancimit të mihjes zhvillohet konform zhvillimit të kapaciteteve të instaluar gjeneruese;
- Zhvendosja e vendbanimeve brenda zonës së re të mihjes, është e njëjta për të gjithë skenarët, përderisa skenarët C dhe D ofrojnë zhvendosje shtesë të vendbanimeve;
- Mundësia e punësimit do të jetë e njëjtë për të gjithë skenarët;
- Transformimi sipërfaqësor i tokës dhe rikuperimi i fushës së mihjes pas shfrytëzimit të rezervave të linjtit në kuadër të FMR-së, është proces i gjatë dhe në vazhdimsi, i cili zhvillohet paralelisht me ritmin e punës dhe progresin e mihjes;
- Rikultivimi i palosjeve të jashtme ekzistuese të djerrinës është në realizim e sipër nga KEK-u gjegjësisht DPRT / DPQ;
- Mbushja dhe rikultivimi i hapësirave të minierave ekzistuese të Bardhit, Mirashit dhe Sitnicës mbeten të mvarura nga zhvillimet minerare dhe të deponimit të hirit nga TC-të;
- Rehabilitimi i deponive ekzistuese të hirit në të gjithë skenarët është i njëjtë sipas praktikave dhe standardeve me të mira ndërkombëtare;
- Evakuimi i fuqisë nga gjithë bllloqet në Termocentralit e Ri në të katër skenarët do të realizohet në rrjetin e bartjes së tensionit 400 kV.

## Kriteret e veçanta për vlerësimin e skenarëve

Në përpjekje të përzgjedhjes së lokacionit më të përshtatshëm për ndërtimin e bloqeve të termocentralit të ri ( TC Kosova e Re), janë hartuar kriteret specifike (të veçanta), për vlerësim, të dala nga aspekti social, ekonomik, mjedisor dhe të infrastrukturës teknike. Për krahasimin e ndikimeve për rreth varësisht nga lokacioni i propozuar ose shprehur më mirë për secilin skenarë veç e veç, janë dhënë vlerat e përshtatshmërisë, për kriteret e renditura në aspektet e përmendura, shih fig. 18 dhe tabelën 14 më poshtë.




Figura 18. Skemat e skenarëve "A, B, C dhe D" për përzgjedhje të lokacionit të termocentralit "Kosova e Re". Burimi: IPH/MMPH.

Këto vlera tregojnë aftësinë ose shprehin përshtatshmërinë e secilit lokacion veçmas duke përdorë metodologjinë e vlerësimit të kriterëve mbi baza të prioritetit, të shprehura me:

- 1 - Përshtatshmërinë e lartë;
- 2 - Përshtatshmërinë mesatare;
- 3 - Përshtatshmërinë e dobët dhe
- 4 - Pa-përshtatshmëni;

NR	Kriteret për vlerësim të lokacionit për ndërtim të TCKR-së	A	B	C	D
<b>Ndikime në aspekte sociale, ekonomike dhe mjedisore</b>					
1	Numri i popullsisë që ndikohet direkt nga zhurma, dridhjet, pluhuri dhe gazrat prej zhvillimeve të pritura	4	3	2	2
2	Vendbanimet, përveç atyre në Fushën "C", që i nënshtrohen procesit të zhvendosjes (shpronësim dhe rivendosje)	2	2	3	4
3	Pronësia e lokacionit për ndërtim të termocentralit të ri	1	1	4	4
4	Trashëgimia kulturo - historike, industriale dhe arkeologjike	3	2	2	3
5	Rilokim të pranueshëm të vendbanimeve (brenda territoreve komunale dhe jashtë zonës së ndotur)	3	3	1	1
6	Ruajtje e tokës bujqësore	1	1	3	3
7	Distanca me qendrat komunale dhe aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës (ndotje ajrit, ujit dhe tokës)	4	3	2	1
8	Morfologjia dhe gjeologjia e terrenit (sizmikë, vërshime, erozion, etj)	1	2	3	4
9	Larmia biologjike dhe trashëgimia natyrore	2	2	3	4
10	Topografia dhe peizazhi	2	2	4	4
<b>Infrastrukturë teknike dhe shërbime</b>					
11	Infrastruktura ekzistuese (rrugët, hekurudha, shiritat transportues dhe reparacionit me tharëse të linjtit, etj.)	1	1	3	3
12	Furnizimi me ujë	2	1	3	2
13	Shkarkimi i ujërave	2	2	3	3
14	Qendra e sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes	2	1	3	4
15	Transportimi i hirit	1	2	4	3
<b>Vlerat totale (të përgjithshme) për krahasim</b>		<b>30</b>	<b>28</b>	<b>43</b>	<b>45</b>

Tabela 14. Kriteret për zgjedhjen e lokacionit për TCKR. Burimi: IPH /MMPH.

Vlerësimi i skenarëve alternativ për zgjedhje të lokacionit dhe ofrimit të opcionit më të preferuar për ndërtim të TCKR-së (Termocentralit "Kosova Re"), brenda zonës me interes të veçantë ekonomik, është bërë duke pasur parasysh tregues të ndryshëm të përmbledhur në kriterë mjedisore, sociale dhe infrastrukturore krahasuar me aspektet e parashikuara të zhvillimit ekonomik.

## Skenari i përzgjedhur - "B"

Ky skenar, bazuar në infrastrukturën ekzistuese në fazën fillestare mundëson ndërtimin e 2 x 300 mW. Vazhdimi i ndërtimit të kapaciteteve shtesë në këtë lokacion kërkon kryerjen e disa punëve paraprake, para fillimit të ndërtimit të TC-së 'Kosova e Re', çka nënkupton largimin e një pjese apo tërë deponisë së hirit në kompleksin industrial të TC-së 'Kosova B' si dhe mbrojtjen dhe sigurimin e stabilimenteve të gjenerimit nga rreziku i përmblytjeve që paraqitet në zonë, për shkak të vërshimit të lumit Sitnica.

Ky skenar për shkak të afërsisë me qendrën e FMR-së dhe të transmisionit, mundëson transportin në distancë më të shkurtër nga dhe drejt kapaciteteve të reja gjeneruese, duke shfrytëzuar të gjithë infrastrukturën ekzistuese për bartje të linjitet si dhe atë të energjisë së gjeneruar. Këtu nuk kërkohen ndërtime të reja të infrastrukturës së nevojshme furnizuese, komunikuese dhe qarkulluese (rrugë, ura, hekurudhë, kanal i ri për furnizim me ujë dhe largim të hirit të freskët, etj) dhe njëherit kontribuon në ruajtjen e tokës bujqësore dhe të pronave të shumta private. Ndësa, në aspektin social dhe mjedisor, ndikimi është më i vogël sepse lirimet në ajër të emesioneve ndotëse, edhe pse të nivelit më të ulët, do ndikojnë zonën e mihjes së re, nga e cila është zhvendosur popullata e vendbanimeve të gjetura aty, pa zhvendosje shtesë të ndonjë vendbanimi si në rastet ose skenarët tjera.

Skenari i përzgjedhur ka përparësitë dhe mangësitë e veta si në vazhdim:

### Përparësitë

1. Ndikim i zvogëluar i ndotjes së ajrit, nga termocentralet Kosova B i rehabilituar dhe Kosova e Re e ndërtuar sipas standardeve e praktikave më të mira botërore, në vendbanimet për rreth (në zonën nën procesin e zhvendosjes) nga emetimi i gazrave dhe partikulateve nën drejtimin e erërave;
2. Shfrytëzimi i hapësirës së lirë brenda zonës ekzistuese industriale (fushë e kaftë);
3. Mbrojtje nga shfrytëzimi i sipërfaqeve të reja të tokës bujqësore;
4. Ekzistimi i infrastrukturës së nevojshme teknike, komunikuese dhe transportuese (rrugët, sheshet, hekurudha, lumi, depot, trafo, rrjeti i transmisionit, shpërndarjes etj.);
5. Shfrytëzimi i objekteve ekzistuese administrative dhe të infrastrukturës së punëtorive dhe serviseve të cilat plotësojnë kërkesat dhe nevojat edhe për ndërtimet e reja të këtij lloji;
6. Lokacioni për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese ka vetëm një pronar dhe atë KEK-un si institucion publik;
7. Distancë më e afërt me qendrën e FMR-së, lehtësi dhe mundësi e shfrytëzimit të objekteve ekzistuese për transportimin e linjitet deri te TC Kosova e Re,
8. Largimi dhe rregullimi i deponisë së hirit në afërsi të TC Kosova B, minimizimi i ndotjes dhe sanimi i gjendjes;
9. Egziston pika e kyqjes dhe në afërsi prej 1km' me kanalën për furnizim të termocentraleve me ujë nga sistemi ekzistues i Ibër-Lepencit;
10. Distancë e pranueshme për ndikim të mundshëm me kryeqendrën dhe Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës;
11. Kyqja e termocentralit të ri në stabilimentet ekzistuese dhe në rrjetin e transmisionit të Kosovës e të interkoneksionit (400 kV dhe 220 kV) që ndodhet në 1 km' largësi prej lokacionit;
12. Ndikim më i vogël në trashëgimi dhe biodiversitet në krahasim me skenarët tjerë;
13. Pyllzimi i brezit mbrojtës gjelbërues më i konsoliduar

### Mangësitë

- Koncentrimi i gjenerimit të energjisë në të ardhmen me prodhim vetëm në një lokacion (TC Kosova B + TC e Re) për periudhë pesëmbëdhjetëvjeqare.
- Lokacioni gjendet në zonën e rrezikuar nga vërshimi i Lumit Sitnica;



### 3.3.2. VLERËSIMI SKENARËVE PËR ZHVILLIMIN E MIHJES SË RE

Në Planin Kryesor Xehetar, i hartuar nga Vatenfall Europe dhe DMT, janë dhënë opsionet e mundshme (apo skenarët) për mënyrën dhe drejtimin e zhvillimit dhe avancimit të mihjes në fushën e re minerare, të njohur si fusha 'C' ose fusha me qendër fshatin e Sibovcit, si në fig.19.




Figura 19. Skemat e skenarëve të propozuar për zhvillimin të minierës së re. Burimi: KEK "Plani Kryesor Xehetar" 2005.

#### Skenari i përzgjedhur për zhvillimin e minierës - "A"


Nga skenaret shumë të analizuar, është bërë përzgjedhja e skenarit "A", si nga aspekti ekonomik ashtu edhe mjedisor, më i preferuari për hapje të minierës së re. Ky skenar, është me zhvillim të orientuar të mihjes, duke filluar me mihje nga pjesa, për të cilën KEK-u posedon licencën për mihje të lëshuar nga KPMM-ja, të ashtuquajtur Sibovci jug-perëndimor. Kjo nënionë gjendet në pjesën veri-perëndimore të minierës ekzis-tuese të Bardhit dhe në afërsi të lagjes së Berishëve në Grabovcin e Ulët dhe i përket komunës së Fushë-Kosovës. Avancimi i mihjes do të vazhdojë në drejtim të Veriut, duke kaluar gjithmonë nëpër territorin e komunës së Obiliqit, përfshirë lagjet e vendbanimeve që duhet të zhvendosen (Hade, Shipitullë, Leshkoshiq / Lajthishtë dhe Sibovc), e deri në afërsi të fshatit Bivolak në komunën e Vushtrisë.

Duke përvehtësuar këtë skenar fitohen këto përparësi:

- shfrytëzimi i infrastrukturës së pozicionuar ekzistuese
- shfrytëzimi i hapësirave të hapura për deponim të djerrinës, hirit dhe gjipsit
- gjatësia e sistemeve transportuese të djerrinës do të jetë më e vogël
- sistemet transportuese të qymyrit do të shfrytëzojnë trasat ekzistuese të shiritave magjstral dhe në disa raste edhe pajisjen ekzistuese.
- Kushtet e volitshme për fillimin e rregullimit të hapësirave në minierat ekzistuese

Palosja e masave të djerrinës realizohet duke shfrytëzuar hapësirat e minierave ekzistuese të cilat gradualisht do të mbushen, po ashtu bazuar në po të njëjtit dokument. Pra, në fazën përfundimtare të mbulesës, kur edhe do të arrihen kuotat +607 m<sup>3</sup> të lartësisë mbidetare në pjesën perëndimore, atëherë vazhdohet mbushja në drejtim të lindjes duke përcjell terrenin.

Në hartën 24. vërehen lokacionet e mihjeve ekzistuese (Bardh dhe Mirash) dhe avancimi i zhvillimit të planifikuar në fushën e Re minerare në raport me lokacionin e propozuara për TC-në Kosova Re si dhe të deponisë së hirit e të palosjes së djerrinave.



Harta 24. Avancimi i paramenduar kohor i mihjes së re sipas skenarit "A" - Burimi: IPH/MMPH nga VSMS 2008, zyra PATEL/MEM.



Në kuadër të draft-projektit për zhvillimet e reja minerare, është me rëndësi të veçantë, të qartësohet procesi i marrjes së licencës për mihje si dhe rikultivimin e pjesës së minierave në shfrytëzim të deritanishëm dhe të parashikuar. Ky parashikim, është i paraqitur edhe më hollësisht si në fig. 20, në vijim, për zhvillimin e mihjes së re në periudha të ndryshme.




Figura 20. Parashikimet kohore afatgjate për zhvillimin e mihjes së re. Burimi: VSMS 2008, zyra PATEL/MEM.

# STRATEGJIA DHE VEPRIMET PËR ZBATIM

## IV

### 4. STRATEGJITË KONKURRUESE

#### 4.1. STRATEGJIA SIPAS TRENDIT (OSE ZERO)

**M**e Strategjinë Zero apo të ashtuquajtura Strategji e Trendit, nënkuptohet strategjia e cila, mundëson vazhdimin e trendit momental të zhvillimeve, me mënyrën e ndërhyrjeve të pakontrolluara në hapësirë dhe të investimit vetanë individual të paplanifikuar e të pa kriter. Kjo strategji nuk sjell zhvillim të harmonizuar dhe me perspektivë meqë nuk ka orientim të organizuar nga ana e një grupi, organizate apo institucioni. Përveç kësaj, zhvillimet e ardhshme nuk janë të mbështetura në ndonjë planifikim të aktiviteteve të bazuara në ndonjë studim, hulumtim apo plan të hartuar paraprakisht me afatet kohore, implikime buxhetore si dhe kornizë të nevojshme institucionale për zbatim.

Në rastin e zonë së FMR-së, mospërmbushja e kërkesave të konsumit vendor për energji elektrike të nevojshme, prodhim nën kërkesën aktuale dhe mosndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese do të vazhdon varshmërinë për furnizim me energji elektrike për periudhë afatgjate nga importi prej vendeve të rajonit. Kjo, njëherit, është dhe pasojë e vonesës në marrjen e vendimeve për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese dhe mos ofrim të kushteve të favorshme për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit dhe për ngritje të kualitetit të jetesës.

Strategjia Zero në zonën e FMR-së do të ketë për pasojë:

- Vazhdimin e reduktimeve të energjisë elektrike;
- Ngecjen në zhvillim ekonomik të vendit;
- Përkeqësimin e kualitetit të jetesës;
- Rritjen e papunësisë;
- Mbylljen e obliguar të TC-ve ekzistuese "Kosova A dhe Kosova B" sipas afateve të paracaktuara kohore;
- Largimin e investimeve të jashtme në sektorin e energjisë dhe të minierave;
- Rritjen e importit të energjisë elektrike nga vendet fqinje;
- Koston e lartë e energjisë elektrike nga importi për konsumin vendor;
- Mos shfrytëzimin e rezervave të linjtit;
- Mos monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes mjedisore;
- Vazhdimin e zhvillimeve të pakontrolluara hapësinore;
- Humbjen dhe degradimin e tokës bujqësore si dhe të mjedisit për rreth.



## 4.2. STRATEGJIA SIPAS KONCEPTIT ZHVILLIMOR

Autoritetet e institucioneve qendrore në bashkëpunim me donatorët e jashtëm të interesuar do të ndërmarrin masat e duhura në drejtim shfrytëzimit të burimeve vendore të energjisë, të rezervave të linjitet për nevoja gjeneruese dhe përmbushjes së kërkesave të BE-së për burime ripërtëritëse të energjisë elektrike. Në mënyrë direkte zhvillimi i kapaciteteve të reja energjetike do të mundësojë furnizim të sigurtë të energjisë elektrike në periudhë afatgjate dhe zhvillim më të qëndrueshëm (mjedisor, ekonomik e social). Natyrisht, kjo është bazë e sigurtë dhe çështje pararendëse për investime, të jashtme e të brendshme, në të gjitha fushat e ekonomisë së dobësuar kosovare.

Qeveria e Kosovës e ka të qartë, që në një periudhë shumë të afërt kohore, duke marr parasysh dinamikën e zhvillimeve të shpejta në rajon dhe më gjërë, e sidomos përkujdesjes ndaj ndryshimeve klimatike si shkas i ngrohjes globale, krizës financiare në botë, do të jetë shumë e më vështirë shfrytëzimi i mëtejshëm i (nxjerrjes dhe djegies) resursit të linjitet për prodhim të energjisë elektrike.

Ndërtimi i termocentralit të ri në lokacionin e përzgjedhur, shfrytëzimi racional dhe efikas (me teknologji më të avancuar të blloqeve) të rezervave të linjitet, duke furnizuar rregullisht blloqet e termocentraleve për prodhim të sigurtë, që së bashku me punën në bartje të energjisë në sistemin e interkoneksionit dhe ndërtimin e linjës së re 400 kV ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, ngrisin sigurinë, operimin dhe optimizmin e sistemit energjetik të Republikës së Kosovës.

Sipërfaqja e vogël e nevojshme e tokës ndërtimore, në zonën e kompleksit industrial "Kosova B", vetëm aq sa nevojitet për ndërtimin e blloqeve të reja 2 x 300 MW të TCKR-së.

Nga Kompania e Mihjes do të kërkohet të bëjë rehabilitim, pasi që të mbushen gropat, e minierave ekzistuese të Bardhit dhe Mirashit si dhe asaj të Sibovcit. Kompania e mihjes do të plotësojë planin për rikultivim të hapësirave të shfrytëzuara. Ky plan aprovohet nga KPMM dhe do të jetë në përputhje me planin kryesor xehetar minerar, ndërsa pronar - menaxhues do të jetë KEK-u.

Fondi i dedikuar për zhvillimin e komunitetin do të jetë 10 milion euro. Ky fond do të mbështet programet për zhvillim të komunitetit të ndikuar nga zhvillimi i mihjes dhe gjenerimit. Qëllimi i fondit është që ti ndihmohet komunitetit për të përmirësuar jetën e tyre, përmirësimin e mjedisit social dhe fizik, në aftësimin e tyre dhe pjesëmarrjen në procesin e vendimmarrjes.

Kompania e gjenerimit do të ndërtojë dhe operojë basenin e ujit, me qëllim që të ofrohet siguri e furnizimit me ujë në rast të ndonjë avarie në kanal in e ujit. Qeveria e Kosovës do të shpronësojë hapësirën e cila nevojitet për ndërtim të basenit, dhe të njëjtën hapësirë do të jep me qira kompanisë së gjenerimit për ndërtim dhe operim të basenit. Me përfundim të kohës së qiradhënies baseni i ujit do të kalojë në pronësi të Qeverisë. Baseni i ujit do të siguronte ujin e nevojshëm në rast të ndërprerjes së tërësishme të rrjedhjes së ujit në kanal, për shkak të riparimeve të kanalit ose për ndonjë arsye tjetër (njerëzore ose natyrore). Në mënyrë që të sigurohet furnizim dy javor për TC Kosova B dhe TCKR, vlerësohet se nevojitet të ndërtohet baseni me kapacitet prej 2 milion m<sup>3</sup>.


Zhvillimi i procesit të zhvendosjes - rivendosjes së popullatës nga vendbanimet në fushën e re të mihjes, gjithashtu, ka rëndësi të veçantë, bile shumë të ndjeshme. Rivendosja e tyre në vendbanimet e reja, kërkon planifikim dhe kontrollë në densifikim dhe zgjerim të vendbanimeve ekzistuese në një mjedis jatësor më të pastër. Kjo arrihet me hartimin e planeve rregulluese urbane, dhe janë më të pranueshme kur zhvillohen brenda zonës së interesit apo edhe brenda vetë komunës së Obiliqit.

Përcaktohet dhe zbatimi i brezit rrethues, tamponit gjelbërt dhe barrierave tjera me qëllim të mbrojtjes së popullatës dhe të mjedisit jetësor nëpër vendbanimet për rreth zonës së ndikuar e të rrezikuar nga degradimi, ndotja, zhurma dhe dridhjet.

Vazhdimi i procesit të rehabilitimit mjedisor (largimit të mbeturinave dhe rikuperimit të zonave të kontaminuara brenda zonës industriale të TC Kosova A, pastrimit dhe largimit të hirit tek TC Kosova B, rehabilitimit dhe rikultivimit të hirit afër TC Kosova A si dhe të palosjeve të jashtme të djerrinave), pritet të arrihet me projekte të ndryshme të përgatitura nga vendorët deri në zbatim të tyre. Ndërsa, për të realizuar këto projekte, duhet interesuar, kërkuar dhe fituar donacione ndërkombëtare (sikur rasti i Projektit për Pastrimin dhe Rehabilitimin e Tokës - PPR), nga politikatat dhe programet mjedisore

të BE-së, qofshin ato investime apo grante të jashtme ose tek e fundit edhe me fonde të pë bashkëta me pjesëmarrje të Qeverisë së Kosovës.

Strategjinë e zhvillimeve sipas konceptit, e shprehë harta e mëposhtme 25, e cila nënkupton përzgjedhjen më të mirë të mundshme të zhvillimeve nga skenarët e propozuar. Këtu janë vlerësuar dhe shtjelluar opsionet më të preferuara, për proceset e zhvilluara dhe shumë të ndërlidhura për zonën me interes të veçantë ekonomik Fusha e Mihjes së Re.



Harta 25. Strategjia e zhvillimit hapësinor të FMR-së - Burimi: IPH / MMPH.

#### 4.2.1. ZHVILLIMI I STRATEGJISË SIPAS KONCEPTIT

Zhvillimi i strategjisë, bazuar në skenarët e përzgjedhur sipas konceptit të zhvillimit të ardhshëm, qartësohet dhe nënkuptohet më lehtë, duke rikujtuar skemën piramidale si në fig 15, me kalimin nëpër procesin derivues (të zërthimeve) sipas hierarkisë, nga Vizioni më i sipërm deri në fund tek Veprimet.

Konkretisht, duke zërthyer strategjinë e zhvillimit në katër synime (ose qëllime të përgjithshme), të cilat, secila prej tyre, vazhdojnë të derivohen më tej në disa objektiva specifike. Po ashtu, edhe këto objektiva, ku secila prej tyre vazhdon të ndahet në veprime (masa, aktivitete dhe projekte përkatëse).




Figura e përsëritur 15. Skema piramidale e arritjes së Vizionit. – Burimi IPH / MMPH

Realizimi i këtyre veprimeve, në mënyrë të anasjelltë (reversible), nga poshtë – lartë, do të mundësojë arritjen e objektivave të cilat plotësojnë synimet deri tek përmbushja e Vizionit.

Katër synimet (ose qëllimet kryesore) të kësaj strategjie, për arritjen e vizionit, janë si në vijim:

##### SYNIMI 1.

##### **PRODHIM DHE FURNIZIM I SIGURT I ENERGISË ELEKTRIKE DHE TË NGROHJES**

**Synimi 1. Prodhim dhe furnizim i sigurt i energjisë elektrike dhe të ngrohjes**

- Synimi 2. Planifikim dhe kontrollë e procesit të zhvendosjes dhe zhvillimit të vendbanimeve brenda dhe jashtë zonës së FMR-së
- Synimi 3. Menaxhim i qëndrueshëm i resurseve natyrore, dhe
- Synimi 4. Përmirësimi i gjendjes mjedisore dhe nërkuidesia ndaj trashëimisë.

Me këtë synim tentohet arritja e prodhimit dhe furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike, për të gjithë sektorët në tërë territorin e Republikës së Kosovës, duke shfrytëzuar dhe menaxhuar në mënyrë racionale resurset natyrore të linjtit. Natyrisht, që gjenerimi i ardhshëm i energjisë elektrike do të jetë arritje, e mundësive për investime të reja, gjithnjë duke respektuar obligimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare mbi sigurimin e furnizimit me energji, në favor të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimeve në aspektin socio-ekonomik.



Ky synim do të arrihet përmes objektivave si:

- S1/ **Objektivi 1.** Ndërtimi i njësive të reja gjeneruese në Termocentralin Kosova e Re, me teknologji më të avancuar, me djegie të linjitit, që nga viti 2011;
- S1/ **Objektivi 2.** Furnizim, bartje dhe shpërndarje e sigurtë e energjisë elektrike në rrjetin elektro-energjetik vendor dhe në sistemin e interkoneksionit;
- S1/ **Objektivi 3.** Iniciativa të vazhdueshme për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme për prodhimin e energjisë.
- S1/ **Objektivi 4.** Shfrytëzimi i ujit/avullit të procesuar nga TC për ngrohje qendrore për Prishtinë, Obiliq, Fushë Kosovë.

### Synimi 1 / Objektivi 1

#### S1.O1. NDËRTIMI I NJËSIVE TË REJA GJENERUESE NË TERMOCENTRALIN KOSOVA E RE, ME TEKNOLOGJI MË TË AVANCUAR, ME DJEGIE TË LINJITIT, QË NGA VITI 2011

Duke marrë parasysh parashikimet më gjithëpërfshirëse, kërkesat dhe nevojat momentale për energji elektrike në Kosovë sillen rreth 5500 GWh dhe ngarkesat maksimale prej rreth 1150 MW, në periudhën 2000 - 2009 me rritje mesatare vjetore prej rreth 7%, kurse varësisht nga parashikimi i rritjes së zhvillimit ekonomik të vendit, në vitin 2020 mund të arrijnë deri në 1900 MW. Bazuar në kërkesat e konsumit vendor për energji elektrike, me këtë objektiv tentohet të sigurohet ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese energjetike deri në 1000 MW dhe me mundësi vazhdimi edhe 1000 MW tjera, që shkon drejt përmbushjes së kërkesës kulmore vendore me prodhim stabil dhe pa penguar çmimet konkurruese si dhe eksportin e tepricës së energjisë drejt tregjeve rajonale dhe më gjerë.

Me këtë objektivë, përveç arritjes së furnizimit të sigurtë të konsumit vendorë dhe atij rajonal si dhe përkrahjes së zhvillimit ekonomik të vendit, nuk mungon as angazhimi substancial i zhvillimit të vet sektorit energjetik në mënyrë të qëndrueshme dhe në përputhje me kërkesat e TKE-së (Traktati i Komunitetit për Energji) dhe direktivat e BE-së.

Ky objektiv arrihet përmes masave/projekteve/aktiviteteve si:

1. Vendimi për ndërtimin e kapaciteteve të reja të TC KR me teknologji të avancuar në vitin 2010;
2. Realizimi i objektivave të Startegjisë së Energjisë, shprehja e interesit, tenderimi, përzgjedhja e Investitorit dhe nënshkrimi marrëveshjes në vitin 2010 për ndërtimin e TC "Kosova e Re" dhe rehabilitim të TC Kosova B;
3. Realizimi i projektit të mihjes së re - Sibovci Jugperëndimor prej vitit 2010;
4. Dekomisionimi i Termocentralit Kosova A pas vitit 2017;
5. Hartimi dhe zbatimi i projektit për largimin e hirit dhe pastrimin e terrenit në lokacionin e zonës industriale të Kosovës B për ndërtimin e TC "Kosova Re" më 2010 /11;
6. Hartimi dhe miratimi i Planit Rregullues Urban për kompleksin e TC "Kosova e Re";
7. Fillimi i ndërtimit të TC-së Kosova e Re me faza:
  - a. Faza e I-rë, ndërtimi i dy blloqeve (2 x 300 = 600 MW) të TC Kosova e Re, me hyrje në punë në vitin 2015 dhe 2016, që do të lejonte rehabilitimin e blloqeve në TC Kosova B në vitet 2016 dhe 2017 duke mundësuar përmirësim të gjendjes mjedisore;
  - b. Faza e II-të, ndërtimi i dy blloqeve tjera (2 X 300 MW) të TC Kosova e Re me teknologji të avancuar deri në vitin 2020 në varësi nga kërkesat e konsumit vendor dhe rajonal;
  - c. Faza e III, ndërtimi i blloqeve tjera deri 1,000 MW me teknologji më të avansuar dhe në varësi nga kërkesat vendore dhe mundësi të eksportit komercial të energjisë elektrike
8. Nënshkrimi dhe zbatimi i vazhdueshëm i obligimeve të Traktatit të Komunitetit për Energji (TKE) si dhe respektimi i direktivave të BE-së me prioritet parësor për sektorin e energjisë;



9. Krijimi i kornizës ligjore dhe zbatimi i vazhdueshëm i "Acquis Communitaire" sipas kalendarit të reformave të kërkuara nga TKE-së si dhe i asaj ekonomike për energjinë;
10. Sigurimi i marrëveshjes së qëndrueshme për bashkëpunim të sistemit elektro-energetik të Kosovës në sistemin e interkoneksionit të rajonit (Shqipëri, Mali Zi, Serbi dhe Maqedoni) gjatë viteve 2010 - 2011;

### **Synimi 1 / Objektiv 2**

#### **S1.O2. FURNIZIM, BARTJE DHE SHPËRNDARJE E SIGURTË E ENERGISË ELEKTRIKE NË RRJETIN ELEKTRO-ENERGETIK TË SISTEMIN VENDOR DHE TË INTERKONEKSIONIT**

Energjia elektrike, e prodhuar në blloqet e termocentraleve ekzistuese, bartet deri në stacionin e transformimit prej nga më pas bëhet edhe shpërndarja e saj, prej nga furnizohen rrjeti elektro-energetik vendor dhe njëherit kalon në rrjetin e sistemit rajonal.

Masat dhe aktivitetet që do të mundësojnë përmbushjen e këtij objektiv janë këto:

1. Optimizimi i punëve paralele në të dy sistemet komplementare dhe realizimi i projektit të linjes 400 kV të interkoneksionit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë në periudhën afatshkurte (2010 - 2012);
2. Operimi stabil dhe i vazhdueshëm i Sistemit Kosovar të bartjes së energjisë elektrike dhe integrimi i saj në sistemin e interkoneksionit rajonal dhe të ENTSO-E deri më 2012;
3. Rehabilitim i vazhdueshëm i linjave të vjetëruara dhe ngritja e atyre të reja në kuadër të sistemit të transmisionit (110 dhe 220 KV-she)
4. Kontroll e vazhdueshme dhe rigoroz e rrjetit elektro-energetik në drejtim të minimizimit deri në eliminim të humbjeve të energjisë elektrike;

### **Synimi 1 / Objektiv 3**

#### **S1.O3. INICIATIVA TË VAZHUESHME PËR SHFRYTËZIMIN E BURIMEVE TË RI-PËRTRITSHME PËR PRODHIMIN E ENERGISË**

Brenda zonës së FMR-së, përveç resursit substancial të linjtit, nuk ka në dispozicion ndonjë burim tjetër alternativ të theksuar për prodhim të energjisë elektrike, nëse nuk merret parasysh mundësia e riciklimit në deponinë rajonale ku do veçohej potenciali i biomasës. Me këtë objektiv tentohet zhvillimi i sektorit energjetik duke shfrytëzuar potencialet e ri-përtritshme për gjenerim të energjisë elektrike në nivel vendi. Këtu mund të përmenden hulumtime dhe projekte për përfitim të energjisë nga resursi ujqor (hidrologjik), nga era, rrezet e diellit (solare) dhe bio-masa si dhe mundësia e kycjes në rrjetin e gazit natyrorë edhe pse në disa vende nuk konsiderohet resurs i ri-përtërishëm.

Ky objektiv arrihet përmes këtyre masave /projekteve /aktiviteteve:

1. Krijimi i kornizës së qëndrueshme ligjore dhe ekonomike prej vitit 2010 deri më 2012 për energjinë alternative;
2. Mbështetje shtetërore për përkrahje të iniciativave të Partneritetit Publik - Privat me Institucionet Financiare Ndërkombëtare prej 2010-tës.
3. Përparimi i tarifave mbështetëse për shfrytëzimin e burimeve të ri-përtritshme (Feed-in-Tariffs);
4. Themelimi Agjencisë profesionale për burime të ri-përtritshme deri në vitin 2011;
5. Realizimi i vendimit të Qeverisë Nr.02/42 të datës 31 Tetor 2008 për ndërtimin e HC Zhur dhe për hartimin e PH për zonën me interes të veçantë në realizimin e HC (hidrocentralit) të Zhurit, në vitin 2010;

6. Realizimi i projekteve për ndërtimin e Hidrocentraleve tjera të vogla gjatë viteve 2010 - 2020;
7. Hartimi i studimit të parafizibilitetit për shëndrimin e hidrocentralit të Ujmanit në hidrocentral reversibil bazuar në studimet paraprake 2010 – 2011;
8. Hartimi i projekteve konkrete gjatë viteve 2010 – 2014 për kyçje në rrjetin e gazit natyrorë;
9. Hartimi dhe realizimi i projekteve të bazuara në rekomandimet e BE-së për shfrytëzimin e burimeve të ri-përtëritshme (të erës dhe asaj diellore) për prodhim, kursim dhe efikasitet të energjisë elektrike;
10. Studime rreth potencialit dhe hartimi projekteve për shfrytëzimin e biomasës për prodhim të energjisë elektrike që nga viti 2010.

#### **Synimi 1 / Objektiv 4**

##### **S1.04. SHFRYTËZIMI I UJIT OSE AVULLIT TË PROCESUAR NGA TC PËR NGROHJE QENDRORE PËR PRISHTINËN, OBILIQIN DHE FUSHË KOSOVËN**

Me këtë objektivë tentohet të arrihet zgjidhja e ngrohjes qendrore për komunat përreth TC-ve, zvogëlimi i shfrytëzimit të energjisë elektrike për ngrohje, me efekt pozitiv në përmirësimin e gjendjes mjedisore, zvogëlimin e përdorimit të lendëve djegëse për ngrohje të cilat emitojnë gazra ndotës. Me këtë do të kemi shfrytëzim më racional dhe eficient të energjisë elektrike, ngrohje më efikase afatgjate si dhe zvogëlim të ndotjes në mjedis, pra shkurt zhvillim më qëndrueshëm.

Ky objektiv, ngrohja qendrore parësore nga TC për komunat Prishtinë, Obiliq dhe Fushë Kosovë, arrihet përmes masave/ projekteve / aktiviteteve:

1. Zbatimi i Projektit të Ngrhjes së Prishtinës, që planifikohet të realizohet, me donacione nga jashtë - BE-ja dhe Qeveria Federale e Gjermanisë, në dy faza:
  - a. Verifikimi i gjendjes, regullimi dhe zgjerimi i rrjetit të shpërndarjes deri në vitin 2015,
  - b. Realizimi i Projektit të Ngrhjes së Prishtinës nga kogjenerimi i Termocentralit Kosova B deri te këmbyesit afër Termokosit në Prishtinë në periudhën 2015 – 2017.
2. Hartimi dhe zbatimi i Projektit të Ngrhjes së Obiliqit, që planifikohet të realizohet, me donacione nga jashtë, në dy faza:
  - a. Ndërtimi i Stacionit Qendror të Këmbyesve deri në vitin 2015,
  - b. Shtrirja e Sistemit Gypor, nga kogjenerimi i Termocentralit Kosova B deri në Stacionin Qendror si dhe të rrjetit të shpërndarjes, deri në vitin 2015 .
3. Hartimi dhe zbatimi i Projektit të Ngrhjes së Fushë Kosovës, që planifikohet të realizohet, me donacione nga jashtë, në dy faza:
  - a. Ndërtimi i Stacionit Lokal të Këmbyesve deri në vitin 2015,
  - b. Shtrirja e Sistemit Gypor, nga Stacionin Qendror në Obiliq deri në Stacionin Lokal si dhe të rrjetit të shpërndarjes, deri në vitin 2015 .

**SYNIMI 2.****PLANIFIKIMI DHE KONTROLLIMI I PROCESIT TË ZHVENDOSJES DHE ZHVILLIMIT TË VENDBANIMEVE BRENDA DHE JASHTË ZONËS SË FMR-SË**

Synimi 1.	Prodhim dhe furnizim i sigurt i energjisë elektrike dhe të ngrohjes
<b>Synimi 2.</b>	<b>Planifikim dhe kontrollë e procesit të zhvendosjes dhe zhvillimit të vendbanimeve brenda dhe jashtë zonës së FMR-së</b>
Synimi 3.	Menaxhim i qëndrueshëm i resurseve natyrore, dhe
Synimi 4.	Përmirësimi i gjendjes mjedisore dhe përkujdesja ndaj trashëgimisë.

Me këtë synim, tentohet që të arrihet një trajtim i qëndrueshëm i komunitetit në zonë, i popullsisë së vendbanimeve që i nënshtrohet procesit të zhvendosjes, për shkak të zhvillimeve të planifikuara në eksploatim të resursit të linjitet e po ashtu edhe asaj të ndikueme në mënyrë direkte apo indirekte nga zhvillimet që priten në zonë. Ky synim orienton zhvillimet në zgjidhje të pranueshme për zhvendosjen e të gjitha komuniteteve të vendbanimeve të cilat gjenden në zonën e fushës së re minerare dhe të atyre që ndodhen në pikat e nxehta /hotspote/.

Objektivat e këtij synimi tentojnë që vendbanimet, brenda kufirit të zonës së re minerare dhe ato që gjenden në zona të rrezikuara, të mbështeten dhe të përkrahen deri në arritje të zgjidhjes, të pëlqyer nga komuniteti dhe të bazuara në dokumentin e miratuar nga Qeveria "Kornizën Politike për Zhvendosje". Trajtimi i çështjeve sociale, ekonomike, mjedisore dhe të infrastrukturës gjatë zhvillimeve të ndryshme në vendbanimeve mundësohet duke planifikuar dhe kontrolluar ato zhvillime. Po ashtu, përmirësimi i infrastrukturës bazë, ofrimi i shërbimeve, trajnimet dhe aftësimet profesionale etj, arrihen përmes krijimit të fondit prej 10 milion Euro nga investitori, të cilat dedikohen për një jetë më kualitative dhe për zhvillim të komunitetit.

Ky synim, arrihet përmes objektivave të veçanta me qëllim të zbatimit të kornizës së politikave për zhvendosje dhe përmirësimin të jetesës, sikur që janë:

- S2/ Objektivi 1. Hartimi, miratimi dhe zbatimi "Kornizës së Politikave për Zhvendosje";**
- S2/ Objektivi 2. Inventarizimi dhe vlerësimi i pronës dhe pasurisë së paluajtshme;**
- S2/ Objektivi 3. Shpronësimi i pronave;**
- S2/ Objektivi 4. Kompensimi i pronës dhe pasurisë së paluajtshme;**
- S2/ Objektivi 5. Zbatim i procesit të pranueshëm për zhvendosje - rivendosje të komunitetit;**
- S2/ Objektivi 6. Arritje e marrëveshjes me komunitetin për çështjen e varrezave;**
- S2/ Objektivi 7. Krijimi i fondit për zhvillim të komunitetit nga investitori**
- S2/ Objektivi 8. Planifikim dhe kontroll i zhvillimeve në përmirësim të jetesës brenda dhe rreth zonës.**

**Synimi 2 / Objektivi 1****S2.O1. HARTIMI, MIRATIMI DHE ZBATIMI I "KORNIZËS SË POLITIKAVE PËR ZHVENDOSJE"**

Zhvendosja si proces, do të mbulojë jo vetëm procedurat e vlerësimit të pasurisë së paluajtshme, shpronësimit, kompensimit dhe zhvendosjes së planifikuar por edhe krijimin e kushteve për zhvillimin e komunitetit të vendbanimeve të cilat preken nga zhvillimet e planifikuara në zonë të FMR-së.

Ky synim arrihet me:

1. Hartimin nga Qeveria dhe miratimin nga Kuvendi të "Kornizës së Politikave për Zhvendosje" më 2010/11;
2. Zbatimin i "Kornizës së Politikave për Zhvendosje" në faza sipas Planit Xehetar të Mihjes dhe të bazuar në avancimin minerar.

**Synimi 2 / Objektivi 2****S2.O2. INVENTARIZIMI DHE VLERËSIMI I PRONËS DHE PASURISË SË PALUAJTSHME (gjatë viteve 2010/11 për F-I dhe 2018/19 për F-II)**

Ky objektivi mbështetet në standardet, rregullat dhe normat e vlerësimit të pronës së paluajtshme për zonën në fjalë. Vlerësimi i pronës së paluajtshme bëhet nga kompania e projektit dhe aprovohet nga Organi shpronësues për çdo kërkesë të cilën e parasheh plani i veprimit për zhvendosje, ku për bazë merret vlera e tregut të pronës.

Kusht për vlerësimin e pronës së paluajtshme është hartimi paraprak i dokumentacionit dhe bazës së të dhënave me këto masa, projekte dhe aktivitete të përfshira:

1. Hartim i procedurës, metodologjisë dhe ndarja e përgjegjësive me kritere të njëjta për të gjithë, në vlerësimin e patundshmërisë (të tokës bujqësore, pronës dhe pasuri tjetër të paluajtshme);
2. Inventarizimi i pasurisë dhe paluajtshmërive për vendbanimet që do të nënshtrohen shpronësimit në fazën e parë (F-I: Hade - pjesa e mbetur e fshatit, Shipitullë - pjesa e fshatit në fushën e mihjes dhe Caravadicë/Palaj) në vitin 2010/11;
3. Inventarizimi i pasurisë dhe paluajtshmërive për vendbanimet që do të nënshtrohen shpronësimit në fazën e dytë (F-II: Leshkoshiq/Lajthishtë dhe Sibovc) para vitit 2020;
4. Përcaktimi i pranueshëm për vlerën, afatin dhe mënyrën e kompensimit të pasurive individuale: të tokës, të objekteve të banimit dhe objekteve tjera përcjellëse
5. Vlerësime të përafërta të nevojave për infrastrukturë dhe shërbime teknike e sociale, rehabilitim ekonomik, organizime të trajnimeve etj;

**Synimi 2 / Objektivi 3****S2.O3. SHPRONËSIMI I PRONAVE (më 2011/12 për F-I dhe më 2019/20 për F-II)**

Ky objektivi tenton rregullimin e mënyrës së shpronësimit në rastin kur nuk është arritur qëllimi i përvetësimit të pasurisë gjatë procesit të zhvendosjes, duke përfshirë procedurat e domosdoshme për realizimin e tij. Në rast se pala e prekur është e pakënaqur me procesin e vlerësimit të pronës gjatë procesit të zhvendosjes, organi shqyrtues merr vendim që përvetësimi i asaj paluajtshmërie të bëhet sipas ligjit për Shpronësim. Shpronësimi do të bëhet nga Qeveria si autoritet përgjegjës duke respektuar të gjitha afatet ligjore të kërkuara si dhe duke mos anashkaluar konsultimet publike me komunitetin e prekur.

Ky objektivi arrihet përmes projekteve/masave/aktiviteteve:

1. Organizimi i konsultimeve paraprake me komunitetin që zhvendoset;
2. Arritja e pajtueshmërisë dhe realizimi i marrëveshjes së deklaruar të mirëkuptimit, në mes të qeverisë dhe pronarëve gjatë vitit 2011 mbi mënyrën dhe afatin e kompensimit, bazuar në ligjislacionin në fuqi;
3. Lëshuarja dhe paisja e pronarëve me vendimet për shpronësim, me vlerën e arsyetuar, sipas specifikave të veçanta për llojet e ndryshme të pronave bazuar në marrëveshjen e arritur, në vitin 2011 për F-I dhe në 2019 për F-II;



## **Synimi 2 / Objektiv 4**

### **S2.O4. KOMPENSIM I PRONËS DHE PASURISË SË PALUAJTSHME (në 2012/15 për F-I dhe 2020/23 për F-II)**

Ky objektiv synon që kompensimi i pronës së shpronësuar, me vlerën e caktuar sipas kriterëve të përcaktuar, bëhet nga investitori në mënyrë që kërkesat e komunitetit të prekur janë të pranueshme. Kompensimi përfshinë edhe pjesët aksesore dhe frutat.

Paraprakisht, duhet përmendur se, Kompensimi mund të bëhet në dy mënyra:

- A. me pronë të paluajtshme e cila ka vlerë të barabartë me kompensimin, ose
- B. me kombinimin e pjesërishëm, të parave të gatshme dhe pronës tjetër të paluajtshme, të cilat së bashku kanë vlerë të barabartë me kompensimin;

Ky objektiv realizohet përmes masave/projekteve/aktiviteteve:

1. Zbatimi i kompensimit individual, për njësi banimi dhe objekte përcjellëse, të tokës bujqësore, të hyrave nga të korrat brenda vitit dhe të biznesit apo tjetër nëse ekzistojnë, më 2012/13 për F-I dhe 2020/2021 për F-II;
2. Zbatimi i kompensimit të përbashkët, i infrastrukturës e shërbimeve sociale dhe teknike deri më 2013/15 për F-I dhe 2021/23 për F-II;

## **Synimi 2 / Objektiv 5**

### **S2.O5. ZBATIMI I PROCESIT TË PRANUESHËM PËR ZHVENDOSJE-RIVENDOSJE TË KOMUNITETIT (viteve 2010/2016 për F-I dhe 2019/2026 për F-II)**

Sipas planit të avancimi të zhvillimit minerar, në fushën e re ose "C" të mihjes, hartohet edhe plani i hollësishëm dinamik për zhvendosjen e organizuar të komunitetit. Realizim i tij bëhet mbi bazë të konsultimeve publike me komunitetin dhe nën pajtueshmërinë paraprake të tyre.

Ky objektiv realizohet përmes masave/projekteve/aktiviteteve:

1. Sigurimi dhe përgatitja e lokacionit të përshtatshëm për hartimin e planeve rregulluese urbane për rivendosjen e komunitetit që zhvendoset (brenda zonës së interesit FMR ose territorit komunal të Obiliqit) në vitet 2010/11 për F-I dhe 2019/20 për F-II;
2. Arritja e marrëveshjes, në mes të Qeverisë dhe komunitetit të zhvendosur, për rivendosje e tyre në vendbanimet e reja, bazuar në pajtueshmërinë e deklaruar, F-I në 2011 dhe F-II në 2020;
3. Hartimi i Planeve të Hollësishme Dinamike të Veprimit për Zhvendosje-Rivendosje të F-I /2012 (të lagjeve të mbetura të fshatit Hade më 2011 dhe të lagjeve jug-lindore të fshatit Shipitullë si dhe të fshatit Caravadicë /Palaj/ më 2012,
4. Hartimi i Planeve të Hollësishme Dinamike të Veprimit për Zhvendosje-Rivendosje në F-II (të fshatit Leshkoshiq /Lajthishtë/ më 2021 dhe të fshatit Sibovc më 2022,
5. Aprovimi dhe zbatimit i Planit të Veprimit për Zhvendosje-Rivendosje që nga viti 2012/15 për F-I dhe nga viti 2022/25 për F-II;

**Synimi 2 / Objektiv 6****S2.O6. ARRITJE DHE ZBATIM TË MARRËVESHJES ME KOMUNITETIN PËR ÇËSHTJEN E VARREZAVE (në vitet 2012/2014 për F-I dhe në 2020/2022 për F-II)**

Zhvendosja e varrezave kërkon trajtim të veçantë duke pasur parasysh që një çështje e tillë nuk është e rregulluar me ligj. Synohet bashkëpunim paraprak i Qeverisë dhe/ose investitorit me komunitetin mbi zhvendosjen e varrezave aktuale prej zonës së mihjes së re, në një lokacion tjetër.

Ky objektivi realizohet përmes masave/projekteve/aktiviteteve:

1. Konsultim me komunitetin dhe bashkësitë fetare adekuate si dhe identifikimi i hapësirës së përshtatshme për zhvendosjen e varrezave (varësisht nga religjioni/komunitet) deri më 2012 përkatësisht 2020;
2. Konsultimet me komunitetin dhe arritja e marrëveshjes së pranueshme për zhvendosjen e varrezave para vitit 2013 respektivisht 2021;
3. Hartimi i Projektit për Zhvendosjen e Varrezave në 2013 si dhe 2021;
4. Realizimi i projektit të Zhvendosjes së Varrezave më 2013/14 gjegjësisht më 2021/22.

**Synimi 2 / Objektiv 7****S2.O7. KRIJIMI I ZYRËS DHE FONDIT PËR ZHVILLIM TË KOMUNITETIT PREJ 10 MILION EURO NGA INVESTITORI**

Përmes krijimit të fondit për zhvillim të komunitetit, tentohet të arrihet trajtimi adekuat i çështjeve sociale, mjedisore dhe ekonomike duke siguruar mjete të caktuara të cilat dedikohen për përmirësimin e kualitetit të jetës duke ngritur infrastrukturën e nevojshme bazë, efikasitet në shërbime, trajnimeve dhe aftësimeve profesionale si dhe përparësi në punësim etj.

Ky objektivi arrihet me masat, projektet dhe aktivitetet adekuate si në vazhdim:

1. Krijimi i zyrës Këshilldhënëse dhe Menagjim t Fondit në vitin 2011;
2. Identifikimi i nevojave të komunitetit për përfitimet nga fondi për zhvillim prej 2010;
3. Hartimi i Planit për Zhvillim të Komunitetit më 2011;
4. Zyrtarizim i marrëveshjes së mirëkuptimit për prioritetet dhe kriteret lehtësuese për banorët e zonës së FMR-së në:
  - a. Pagesë të energjisë,
  - b. Aftësime, trajnime profesionale dhe punësim në nënsektorët e sistemit energjetik të Kosovës,
  - c. Vizitat mjekësore,
  - d. Realizim të projekteve të ose për nevoja të komunitetit, etj;

## **Synimi 2 / Objektiv 8**

### **S2.O8. PLANIFIKIM DHE KONTROLL I ZHVILLIMEVE NË PËRMIRËSIM TË JETESËS BRENDA DHE RRETH ZONËS;**

Me këtë synim tentohet që vendbanimet brenda kufirit të zonës të mbështeten dhe përkrahen në mënyra të ndryshme duke mundësuar planifikim dhe kontrollë të zhvillimeve në vendbanimeve jashtë fushës së re minerare. Këtu, trajtimi i çështjeve mjedisore, sociale dhe ekonomike arrihet përmes krijimit të një baze për zhvillim të komunitetit, sigurimit të planeve të caktuar të cilat dedikohen për mbrojtjen dhe përmirësimin e kualitetit të jetesës (përmes ofrimit organizimit të vendbanimeve, të infrastrukturës bazë teknike dhe sociale, shërbimeve efikase etj.).

Ky objektiv arrihet me masat, projektet dhe aktivitetet adekuate si në vazhdim:

1. Hartimi i planit hapësinor/menagjuës i energjetikes se Kosoves, që me vendime të veçanta nga Qeveria dhe komunat të mbrohen rezervat e linjitit, deri në vitin 2012;
2. Harmonizimi i planeve lokale të komunave pjesëmarrëse (Obiliq, Fushë Kosovë, Vushtrri dhe Drenas) me PH për zonën me interes të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes Re";
3. Hartimi i planeve rregulluese urbane (me densifikim dhe zgjerim të lejuar të ndërtimeve në vendbanimet të cilat nuk i nënshtrohen zhvendosjes) dhe monitorimi i zhvillimeve në zonë të interesit - FMR;
4. Miratimi dhe zbatimi i planeve rregulluese me projektet konkretet për objekte të infrastrukturës dhe të shërbimeve teknike, sociale, të banimit dhe të atyre përcjellëse si dhe të hapësirave të përbashkëta më 2012/14 për F-I dhe 2020/22 për F-II;
5. Zbatimi i plan-projekteve në ndërtimin dhe vendosjen e popullsisës në vendbanime të reja gjatë viteve 2013/15 dhe 2021/23;
6. Zgjerimi dhe përmirësimi i rrjetit ekzistues të rrugëve dhe i qarkores për lidhje të vendbanimeve për rreth zonës minerare në FMR në periudhë afat-shkurte;
7. Përmirësimi i menjëhershëm i gjendjes në infrastrukturë dhe funksionalizimi i rrjetit hekurudhor në përgjithsi e sidomos në zonën e FMR-së;
8. Kycja e menjëhershme e të gjitha vendbanimeve në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit brenda zonës së FMR-së;
9. Kycja e menjëhershme e të gjitha vendbanimeve në rrjetin e telekomunikimeve brenda zonës së FMR-së.
10. Hartimi Planit Hapësinor për zonën e TZHEK-ut (trekëndëshit të zhvillimit ekonomik) deri më 2012;
11. Harmonizimi i planeve lokale, të komunave pjesëmarrëse në Basenin e linjitit Kosova, me PH për zonën e interesit TZHEK, gjatë viteve 2012/2014;
12. Hartimi i planeve rregulluese urbane dhe kontrolla e zhvillimeve të lejuara për vendbanimet brenda basenit Kosova të linjitit prej vitit 2010 deri 2015;
13. Themelimi i Njësisë Inspektuese, përgjegjëse për monitorim të zhvillimeve, në zonat me rezerva të linjitit (sidomos në Basenin Kosova), deri më 2011;

**SYNIMI 3.****MENAXHIM I QËNDRUESHËM I RESURSEVE NATYRORE**

Synimi 1.	Prodhim dhe furnizim i sigurt i energjisë elektrike dhe të ngrohjes
Synimi 2.	Planifikim dhe kontrollë e procesit të zhvendosjes dhe zhvillimit të vendbanimeve brenda dhe jashtë zonës së FMR-së
<b>Synimi 3.</b>	<b>Menaxhim i qëndrueshëm i resurseve natyrore</b>
Synimi 4.	Përmirësimi i gjendjes mjedisore dhe përkujdesja ndaj trashëgimisë.

Me këtë synim tentohet të arrihet një qëndrueshmëri në aspektin e shfrytëzimit dhe menaxhimit sa më racional të resurseve natyrore të linjtit si burim kryesor i prodhimit të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës dhe resurseve të ujit si faktorë kyç për zhvillimin e sektorin e energjisë. Arritja e këtij synimi po ashtu ka për qëllim të potencoi shfrytëzimin e linjtit, si bazë për një zhvillim ekonomik të vendit duke marrë parasysh po ashtu edhe dinamikën e zhvillimeve globale dhe mundësitë e shfrytëzimit të resurseve tjera

alternative si dhe marrë në konsideratë interesimin aktual të investitorëve aktual, kapitalit për investime në sektorin e energjisë;

**S3/ Objektivi 1. Shfrytëzimi racional dhe efikas i resurseve të linjtit;**

**S3/ Objektivi 2. Parandalim i vazhdueshëm i vet-djegëjes së linjtit në miniera (mihje sipërfaqësore);**

**S3/ Objektivi 3. Shfrytëzimi dhe menaxhimi racional i resurseve ujore;**

**Synimi 3/Objektivi 1****S3.O1. SHFRYTËZIMI RACIONAL DHE EFIKAS I RESURSEVE TË LINJITIT 2010 - 2020+**

Pasiqë, në planin afatgjatë të sektorit të energjisë, linjiti do të mbetet karburanti kryesorë për prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë, me këtë objektiv tentohet shfrytëzimi i i kontrolluar i resurseve të linjtit jo vetëm në mihjet aktuale sipërfaqësore të Mirashit dhe Bardhit që pothuajse janë shterur por edhe atyre në minierën e Sitnicës dhe FMR.

Ky objektiv arrihet përmes këtyre masave/projekteve/aktiviteteve:

1. Mbrojtja e resurseve të linjtit nga ndërtimi i pakontrolluar;
2. Shfrytëzim efikas i linjtit me teknologji më të avancuara;
3. Implementimi i Planit Kryesor Xehetar të mihjes së Re bazuar në dinamikën e zhvillimit kapaciteteve të reja gjeneruese;
4. Koordinimi i aktiviteteve të shfrytëzimit sipas dinamikës së planifikuar paralelisht me aktivitete e rikultivimit;

**Synimi 3/Objektivi 2****S3.O2. PARANDALIMI I VAZHUESHËM I VET-DJEGIES SË LINJITIT NË MINIERA 2010 - 2020+**

Ky objektiv tenton që të arrihet evitimi, shmangja apo edhe eliminimi e dukurive të rrezikshme si që është vet-djegia e linjtit në mihje.



Objektivi mund të arrihet përmes masave/projekteve/aktiviteteve si:

1. Hartimi i planit operativ për evitimin dhe parandalimin e zjarreve;
2. Krijimi i ekipit emergjent dhe trajnimin e personelit për evitimin, parandalimin dhe shuarjen e zjarreve;
3. Sigurimin e pajisjeve të nevojshme për evitimin dhe parandalimin e zjarreve për secilën minierë;

### **Synimi 3 / Objektivi 3**

#### **S3.O3. SHFRYTËZIMI DHE MENAXHIMI RACIONAL I RESURSEVE UJORE 2010 - 2020+**

Zona e FMR-së ndodhet në pjesën më aride (e thatë) të vendi, me ujëra të pakta sipërfaqësore dhe nëntokësore. Viteve të fundit shumica e lumenjve në këtë zonë janë të atakuar nga shkarkimet e pa trajtuara (nga amvisëritë, industritë etj). Pjesa më e madhe e popullsi shtrihet në këtë zonë e cila rritë kërkesën për ujë të pijshëm. Atëherë, ky objektivi tenton të arrijë menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve ujore në zonën e interesit të veçantë ekonomik i cili do të jetë i bazuar në të gjitha standardet dhe direktivat e BE - së.

Ky objektivi arrihet për mes masave/projekteve/aktiviteteve si:

1. Hartimi i strategjisë shtetërore për ujëra në pajtueshmëri me udhëzimet dhe politikat e specifikuar në Direktivën Kornizë të Ujit të BE-së;
2. Hartimi i planit për menaxhimin e pellgut të lumit Ibër:
  - a. Hartimi i projektit për rregullimin e shtratit të lumit Sitnicë;
  - b. Hartimi i projektit për rregullimin e shtratit të lumit Drenicë;
  - c. Hartimi i projektit për rregullimin e shtratit të lumit Llapit;
  - d. Hartimi i projektit për inventarizimin e të gjitha burimeve natyrore brenda zonës, me mundësi të shfrytëzimit të tyre për ujë të pijshëm për banoret e zonës.
  - e. Hulumtimi i ujërave nëntokësore në aluvionet e lumit Sitnicë, Drenicë dhe Llap.
  - f. Hartimi i projektit për riparimin dhe rehabilitimin e kanalit të hidro-sistemit Ibër-Lepenc në pjesët: Pridvoricë-Obilic; Bivolak-Drenas (zvogëlimi i humbjes/shpenzimit ilegal të ujit);
  - g. Zbatimi i masave për ndalimin e shfrytëzimit të inerteve në lumenjtë Sitnicë, Drenicë dhe Llap;
3. Zbatimi i masave kundër kycjeve ilegale në sistemin e kanalit Iber-Lepenc;
4. Aktualizimi, rishikimi dhe përgatitja e planeve për pjesën tjetër të projektit Ibër-Lepenc (pjesa e Lepencit) nga ana e HS "Ibër-Lepenc" deri në fund të vitit 2011;
5. Hartimi i studimit të fizibilitetit dhe ndërtimit të bazenit akumulues me qëllim të rritjes së sigurisë së furnizimit me ujë rezervë të TC-ve Kosova e Re dhe Kosova B më 2010/11, dhe
6. Zvogëlimi i konsumit të ujit përmes riciklimit të ujërave të shkarkuara industriale.

**SYNIMI 4.****PËRMIRËSIMI I GJENDJES MJEDISORE DHE PËRKUJDESJA NDAJ TRASHËGIMISË NË ZONËN E INTERESIT "FMR"**

Synimi 1.	Prodhim dhe furnizim i sigurt i energjisë elektrike dhe të ngrohjes
Synimi 2.	Planifikim dhe kontrollë e procesit të zhvendosjes dhe zhvillimit të vendbanimeve brenda dhe jashtë zonës së FMR-së
Synimi 3.	Menaxhim i qëndrueshëm i resurseve natyrore

**Synimi 4. Përmirësimi i gjendjes mjedisore dhe përkujdesja ndaj trashëgimisë.**

Me këtë synim tentohet të arrihet përmirësimi i performancës mjedisore ekzistuese, duke i kushtuar kujdesin maksimal hapësirave të cilat do t'i nënshtrohen rehabilitimit dhe rikultivimit. Këtu, synohet përmirësimi i peizazhit vizual duke pasur në qendër mbrojtjen e shëndetit të popullatës brenda dhe jashtë zonës së interesit, bazuar në kontrollin dhe monitorimin e vazhdueshëm sipas praktikave më të mira.

Po ashtu, ky synim orienton, në shfrytëzimin e hirit të freskët të prodhuar nga TC-të si bazë për nevoja në ndërtimtari, në përmirësimin e mjedisit jetësorë dhe të sipërfaqeve të tokës

bujqësore si dhe mundësinë e krijimit të zonës më atraktive për vizitorë të cilët do të mund të njihen me vlerat e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe industriale dhe të vendeve të reja të punës për banorët e zonës.

Synimi është ndarë dhe pritet të arrihet me këto objektiva:

- S4/ **Objektivi 1. Përmirësimi i performancës mjedisore në zonën e minierave dhe të TC-ve ekzistuese në pajtim me Direktivat e BE-së para vitit 2017.**
- S4/ **Objektivi 2. Rehabilitimi dhe rikultivimi i hapësirave të degraduara**
- S4/ **Objektivi 3. Monitorimi dhe kontrolli i rregullt ndaj elementëve mjedisor (ajër, ujë dhe tokë)**
- S4/ **Objektivi 4. Menaxhim i qëndrueshëm i 'Deponisë Rajonale' në Mirash**
- S4/ **Objektivi 5. Menaxhimi dhe shfrytëzimi i hirit të freskët për nevoja në ndërtimtari, në industrinë e çimentos etj.**
- S4/ **Objektivi 6. Përkujdesje më efektive për peizazhin, biodiversitetin dhe për trashëgiminë natyrore, kulturore, historike e industriale në zonën e FMR-së.**

**Synimi 4 / Objektivi 1****S4.O1. PËRMIRËSIMI I PERFORMANCËS MJEDISORE NË ZONËN E FMR-SË DHE TË TC-VE EKZISTUESE 2010 - 2018**

Kontrolli i ndotjes dhe përmirësimi i gjendjes mjedisore në zonën e FMR-së do të jenë në përputhje me ligjet në fuqi dhe standardet mjedisore që dalin nga Direktiva e BE-së për impiante me djegie të mëdha (LCPD 2001/80/EC), respektivisht nga Direktiva për Emisione Industriale (IED) e cila është duke u përgatitur dhe pritet të aprovohet. Kjo direktivë do të zëvendësojë direktivat e mëhershme, në mes tjerash edhe direktivat mbi LCPD-në dhe IPPC-në, ku edhe do të hyjnë në fuqi limite të reja të emisioneve, si për impiantet ekzistuese ashtu edhe për ato të reja. Arritja e këtij objektivi është parakusht për sigurimin e operimit të termocentraleve duke obliguar zvogëlimin e emetimeve, largimin, parandalimin e rrezikut dhe duke synuar pastrimin e ndotjeve të trashëguara, si dhe menaxhimin e ndotjeve aktuale e të ardhshme.

Bazuar në këtë, si dhe parashikimet për jetëgjatësinë e TC-ve ekzistuese, ky objektiv synon të arrij përmirësimin e performancës mjedisore bazuar në legjislacionin në fuqi dhe standardet mjedisore evropiane përmes masave/projekteve/aktiviteteve si në vijim:

1. Krijimi i barrierave përkatëse të zërit për të zvogëluar pengesat e shkaktuara nga zhurmat;
2. Pyllëzimi i brezave gjelbërue në zonën e FMR-së:
  - a. Brezi gjelbërues rreth minierave ekzistuese dhe të reja të mihjes;
  - b. Brezi gjelbërues rreth deponisë së re të hirit;
  - c. Brezi gjelbërues rreth Termocentraleve;
  - d. Brezi gjelbërues përgjatë tërë zonës FMR-së që lidhet me malet e Çiçavicës.
3. Hartimi i Planit për realizimin e projekteve në termocentralet ekzistuese, në:
  - a. Zvogëlimin e emetimeve të pluhurit, dhe
  - b. Shkarkimit të ujrave industriale.
4. Përmirësimi i performancës mjedisore të TC Kosova A me investime shtesë në mirëmbajtje dhe mundësia e operimit të saj deri në fund të vitit 2017 (fillimi i procesit të mbylljes);
5. Largimi i mbeturinave, dekomisionimi dhe demontimi i impianteve në kompleksin energjetiko – kimik në lokacionin "Kosva A" (gazifikimit, tertores, ngrohtores, reparacioneve, deponive të linjtit dhe azotikut);
6. Riparimet kryesore në modernizim të pajisjeve të TC "Kosova B" përfshirë instalimin e FGD-ve (Desulfurimin e gazit –denitrifikimin) në pajtim me Direktivat e BE-së;
7. Realizimi i objektivave të Studimit të Fizibilitetit për Dekomisionimin e TC Kosova A pas vitit 2017 dhe hartimi i planeve për demontim dhe rregullim të hapësirave të degraduara;
8. Hartimi i planeve, të konzervimit të integruar, për shfrytëzim të disa objekteve nga komplekset ekzistuese të TC-ve, pas mbylljes dhe rehabilitimit tyre, për zhvillim të turizmit industrial apo destinim tjetër në të ardhmen; dhe
9. Ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave (industriale, të zeza, të kanalizimit, etj) në dalje të objekteve industriale;

#### **Synimi 4 / Objektiv 2**

#### **S4.O2. REHABILITIMI DHE RIKULTIVIMI I VAZHDUESHËM I ZONAVE TË DEGRADUARA**

Rikthimi i tokave, ri-kultivimi i djerrinave dhe rehabilitimi i zonave të degraduara brenda kufijve të zonës së FMR-së është një ndër objektivat kryesore e cila orienton në përmirësimin e gjendjes mjedisore dhe në favor të shfrytëzimit agro-rural. Kjo objektivë është njëherit edhe caku i Projektit për Pastrim dhe Rikuperim të Tokave (PPRT), i cili implementohet nga KEK-u dhe përkrahet në aspekt financiar nga Donator si Banka Botërore (me një total prej 10,5 milion Euro) dhe Qeveria e Mbretërisë së Holandes (me 3,0 milion Euro). Projekti, përveq punëve rehabilituese të palosjeve të jashtme në Kodrën e Hirit, Djerrinën Jugore, Djerrinën e Lugut të Thellë dhe Kalasë, si dhe në Djerrinën e Vasilevës, ka edhe komponentet tjera si: Rehabilitimi dhe ri-kultivimi i deponisë Hirit afër TC Kosova A; Krijimi i sistemit për bartje hidraulike të hirit dhe Trajtimi dhe largimi i mbeturinave të rrezikshme nga zona e gazifikimit në Obiliq. Këtu hyjnë edhe masat ndaj degradimeve të shkaktuara nga përmbytjet dhe erozioni.

Ky objektiv arrihet përmes masave/projekteve/aktiviteteve si:

1. Realizimi i Projektit për Pastrimin dhe Rikuperimin e Tokës (PPRT), sipas komponentëve:

- a. Vazhdimi i realizimit të projektit "Rehabilitimi, formësimi dhe rikultivimi i deponisë së hirit të TC Kosova A".
  - b. Zbatimi i projektit "Krijimi i sistemit për transportimin hidraulik të hirit".
  - c. Zbatimi i projektit "Trajtimi dhe largimi i mbeturinave të rrezikshme nga zona e impiantit të gazifikimit në Obiliq".
  - d. Zbatimi i projektit "Stabilizimi, riformësimi dhe rikultivimi i palosjeve të jashtme të djerrinave.
  - e. Stabilizimi i Deponisë së jashtme të Vasilevës, sipas aktiviteve të parapara, më 2010,
  - f. Stabilizimi i Deponisë së jashtme Jugore sipas dinamikës së paraparë më 2010 / 12,
  - g. Stabilizimi i Deponive të jashtme Kalaja dhe Lugu i Thelle më 2010 / 12, dhe
  - h. Stabilizimi i Deponisë së hirit dhe të djerrinës Dragodan me aktivitetet e planifikuara më 2009 / 11;
2. Riparimi dhe rikultivimi i zonave të vjetra ndaj emetimeve të partikulateve nga termocentralet, minierat dhe deponimet e hirit;
  3. Identifikimi dhe inventarizimi i zonave aktuale erozive, brenda FMR-së;
  4. Hartimi dhe zbatimi i projektit për masat kundër erozionit
    - a. Masat biologjike - pyllëzimi,
    - b. Masat përmes gabioneve, kaskadave dhe pritave;
  5. Identifikimi dhe inventarizimi i zonave aktuale që përmythen (nën vërshime) brenda FMR-së;
  6. Hartimi dhe zbatimi i projektit për masat mbrojtëse ndaj përmytjeve
    - a. Masat parandaluese - mbrojtëse;
    - b. Masat përmes zgjerimit të shtratit dhe ndërtimit të argjinaturave të lumenjve Sitnicë, Drenicë dhe Llap;

#### **Synimi 4 / Objektivi 3**

#### **S4.03. MONITORIMI DHE KONTROLLI I RREGULLT NDAJ ELEMENTËVE MJEDISOR QË NGA 2010-TA**

Ky objektivi ndihmon kontrollin dhe menaxhimin e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës të shkaktuar nga prodhimi i energjisë duke respektuar standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare mbi mbrojtjen e mjedisit.

Ky objektivi arrihet përmes masave/projekteve/aktiviteteve si :

1. Vendosja e sistemeve matëse dhe të monitorimit të emetimeve në blloqet e termocentraleve;
2. Ndërtimi i një sistemi adekuat monitorues mbi kualitetin e ajrit, ujit dhe tokës në zonën e ndikimit të objekteve energjetike dhe jashtë saj;
3. Ngritja e kapaciteteve institucionale për monitorim dhe menaxhim të sistemit ;
4. Zgjedhja e lokacionit të përshtatshëm për vendosjen e stacioneve monitorues varësish nga shpërndarja e gazrave dhe grimcave të pluhurit;
5. Ndërtimi i bazës së të dhënave mbi monitorimin e kualitetit të ajrit, ujit dhe tokës brenda zonës së FMR-së;
6. Mbledhja dhe procedimi i të dhënave nga stacionet monitoruese dhe integrimi i tyre në Qendrën Monitoruese brenda AKMM-së dhe publikimi tyre;
7. Analizimi i të dhënave mbi kualitetin (cilësinë) e ajrit, tokës dhe llojllojshmërisë biologjike (biodiversitetit);



8. Analizimi i të dhënave mbi nivelin e zhurmës dhe të radioaktivitetit;
9. Hartimi dhe publikimi i raportit vjetor, nga AKMM, me vlerat minimale e maksimale të gjendjes dhe nivelin e lejueshmërisë të elementëve mjedisorë;
10. Hartimi i projekteve detale për ndërtimin e impianteve për trajtimi i ujërave të zeza para shkarkimit në lumenj nga TC-të, mihjet, industria dhe amvisëritë;

#### **Synimi 4 / Objektiv 4**

##### **S4.O4. MENAXHIM I QËNDRUESHËM I 'DEPONISË RAJONALE' NË MIRASH (2010 - 2020)**

Me këtë objektivë tentohet të arrihet një menaxhim më efikas në trajtimin e mbeturinave si dhe në mundësitë për shfrytëzimin e tyre pas procesit të riciklimit. Kjo do të arrihet përmes këtyre masave, projekteve apo aktiviteteve:

1. Hartim i Planit për Menaxhim të mbeturinave
2. Ndërmarrja e masave urgjente për zvogëlimin e ndikimit në rrethinë;
3. Menaxhim dhe mirëmbajtje e deponisë rajonale sipas projektit;
4. Riciklimi i mbeturinave organike nga ato inorganike;
5. Shfrytëzim i biomasës për fitim të energjisë nga djegia e saj;
6. Mbyllja e saj ne vitin 2020 dhe rregullimi terenit;
7. Rishikimi i projektit të "Deponisë Rajonale", për mundësinë e selektimit, riciklimit, përpunimit të mbeturinave dhe të trajtimit të ujërave të zeza sipas Direktivave të BE-së, deri në fund të vitit 2011.

#### **Synimi 4 / Objektiv 5**

##### **S4.O5. MENAXHIMI DHE SHFRYTËZIMI I HIRIT TË FRESKËT PËR NEVOJA NË NDËRTIMTARI (2010 - 2020+)**

Legjislacioni mjedisor dhe standardet teknike Evropiane e konsiderojnë përdorimin hirit të freskët si lëndë e parë profitabile për sigurimin e disa produkteve me theks të veçantë në ndërtimtari (prodhimin e çimentos dhe betonit). Roli dhe benefitet e hirit të freskët janë shumë gjerësisht të njohura në literaturë dhe mjaft të studiuara. Prandaj, ky objektiv bazohet në shfrytëzimin e këtyre mbetjeve industriale me qëllim që të ndihmoj në mënyrë direkte në përmirësimin e gjendjes mjedisore të zonës dhe mundësinë e krijimit të vendeve të reja të punës për banorët e zonës dhe zhvillimin ekonomik të sajë.

Duke marrë parasysh se në Evropë destinimi i përdorimit të hirit të freskët është si në vijim: Industria ndërtimore (46%); Rregullimi i mjedisit (43%); Ruajtja si rezervë e përkohshme (6%) dhe Mbushjen e gropave dhe hapësirave në rrugë (5%); objektivi tenton të arrihet përmes masave/projekteve/aktiviteteve si në vijim:

1. Rishqyrtimi i studimeve dhe aktualizimi i tyre mbi kualitetin e hirit dhe shfrytëzimin e tij për prodhime të produkteve ndërtimore më 2010/11;
2. Organizimi i një konference ndërkombëtare për shfrytëzimin e hirit 2010;
3. Hulumtimi i përvojave të mira, për shfrytëzim të hirit të freskët, për produkte ndërtimore, për përfitimin e çimentos dhe betonit në ndërtimin e rrugëve, prodhimin e tjegullave dhe pllakave të qeramikës - 'klinker', etj në vitin 2010;
4. Ndërtimi i fabrikës viteve 2011/13, për prodhim të materialit ndërtimor nga përpunimi i hirit të freskët, si:

- a. Material përforcues dhe izolues në përzierje të Çimentos;
- b. Material përforcues dhe izolues në përzierje të Betonit;
- c. Pllaka argjile dhe 'shamote';
- d. Klinker pllaka, etj.

#### **Synimi 4 / Objektivi 6**

#### **S4.O6. PËRKUJDESJE EFIKASE PËR BIODIVERSITETIN DHE TRASHËGIMINË NATYRORE, KULTURORE, HISTORIKE E INDUSTRIALE NË ZONËN E FMR-SË (2010 - 2020+).**


Ky objektivi ka për qëllim të trajtoj në mënyrë sa më të përgjegjshme mbetjet arkeologjike në rast të paraqitjes së tyre gjatë procesit të eksploatimit të mihjes, e gjithashtu trajtimin e objekteve të trashëgimisë kulturo-historike si dhe mundësinë e transformimit të objekteve të vjetra industriale në lokacione atraktive për vizitorët.

Ky objektivi arrihet përmes masave/projekteve/aktiviteteve si :

1. Hartimi i studimit gjithëpërfshirës të ndikimit të TC-së, gjatë operimit, në habitatet e llojeve të rralla biologjike në zonën e FMR-së dhe rreth saj më 2011/12;
2. Hartimi i projektit me masat mbrojtëse, që ka për qëllim ruajtjen e zogjëve të egër, nga veprimi i rrezikshëm i energjisë elektrike më 2011/12;
3. Hartimi i projektit për shfrytëzimin e ndonjë objekti nga kompleksi industrial i TC Kosova A, në kuadër të konservimit të integruar, për muze industrial, galeri artesh, etj deri më 2015;
4. Hartimi i planit për përkujdesje ndaj objekteve dhe lokaliteteve të evidentuara dhe me statusin e mbrojtjes (tyrbja e Sulltan Muratit në Mazgit dhe kalaja e Bellaqevcit në Bardh të Madh) për zhvillimin e turizmit deri më 2012
5. Inventarizimi, procedimi, kategorizimi, mbrojtja me ligj dhe përkujdesja efikase ndaj objekteve dhe tërësive arkitektonike e arkeologjike të evidentuara deri më 2012;
6. Hulumtimi, inventarizimi dhe sistemimi i objekteve apo tërësive kulturore dhe historike të panjohura deri tani gjatë periudhës 2010/20;
7. Hartimi i kriterëve dhe masave për zbatim, në rast të gjetjeve të eksponateve, në lokalitetet arkeologjike brenda dhe jashtë zonës së interesit FMR në vitin 2010;
8. Hartimi i rregullores së veçantë mbi trajtimin e peizazheve dhe të lokaliteteve me trashëgimi natyrore, kulturore dhe historike më 2011;
9. Hartimi i broshurës dhe udhëzimeve (guidës) për vlerat e trashëgimisë (natyrore, kulturore historike dhe industriale) për zonën e interesit FMR më 2011;

### 4.3. MJEDISI DHE SHFRYTËZIM I TOKËS I PARASHIKUAR NË VITIN 2020

Ndryshimet në hapësirë, që hasen në shfrytëzimin e parashikuar të tokës për vitin 2020, si më poshtë në hartën 26, nga shfrytëzimi i tokës si në vitin 2009, vijnë për shkak të zhvillimit dhe avancimit të proceseve gjeneruese, minerare, rehabilituese dhe të zhvendosjes së vendbanimeve.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja  
Ministry of Environment and Spatial Planning



Instituti për Planifikim Hapësinor  
Institut za Prostorno Planiranje  
Institute for Spatial Planning

#### PLANI HAPËSINOR I "FUSHËS MIHJA E RE"

#### SHFRYTËZIMI I TOKËS NË VITIN 2020

**Legjenda**



Harta 26. Shfrytëzimi i parashikuar i tokës për në vitin 2020. - Burimi: IPH / MMPH



Nga këtu, vërehet se, ka një zvogëlim të zonave industriale, nga dy sosh sa ishin në një të vetme dhe me ndikim shumë më të zvogëluar nga emetimet në ajër dhe nën drejtim të erës, nga shkak i përdorimit të teknologjive më të përparuara dhe i zhvendosjes së popullsisë nga vendbanimet në zonën qendrore (ose të ndikimeve direkte).

Për më tepër, janë zvogëluar hapësirat e deponive dhe sasi të hirit, që tashmë pas bartjes së tij dhe pastrimit zonës tek Kosova B dhe rehabilitimit të zonës afër Kosovës A, tashmë ka trajtim tjetër. Hiri i freskët ka mundësi të përdorimit për punimin e shtresave bazike tek rrugët ose për prodhim të elementeve të fortë dhe izolator në ndërtimtari. Natyrisht, edhe zvogëlimi i hapësirës së hapur të mihjes vjen vetvetiu, sepse do ngelin të hapura vetëm minierat e reja, kurse gropat në minierat ekzistuese do të eliminohen duke u mbushur me palosjet të reja të djerrinës.

Hartat në vazhdim, si kjo 27, paraqet shtrirjen e mundshme të ndotjes së ajrit në zonën e interesit nga emetimet e dyoksidit të sulfurit (SO<sub>2</sub>) dhe oksideve të azotit (NO<sub>x</sub>) prej TC Kosova e Re, bazuar në hulumtimet e deritanishme.




**Harta 27. Shpërndarja e gazrave SO<sub>2</sub> dhe NO<sub>x</sub> nga TC KR dhe Kosova B në ndikimin e erës në zonën e FMR-së.** - Burimi: IPH / MMPH nga VSMS 2008, zyra PATEL/MEM

Gjithsesi, pas ndërhyrjeve të njeriut, ndaj rreziqeve natyrore si më poshtë në hartën 28, në rregullim dhe mbrojtje të sigurtë e të qëndrueshme të mjedisit jetësor, duhet përmendur edhe përfitim të zonave të reja të shfrytëzueshme bujqësore. Zonat e tilla të rehabilituara, në madhësi të konsiderueshme mund të përdoren për veprimtari të ndryshme që zhvillohen në tokat bujqësore apo edhe ato pyjore, e kur kësaj i shtohen edhe hapësirat e brezit gjelbërues mbrojtës (me drunjë gethe-mbajtës halor pyjor dhe shkurre për bri) atëherë kemi edhe përmirësim të gjendjes së mjedisit jetësor.







Harta 28. Masat mbrojtëse ndaj erozionit dhe vërshimeve më të theksuara në zonën e FMR-së. - Burimi: IPH/MMPH nga Atlasi Hidroekonomik i Kosovës 1976.

Përfundimisht, përfitimi është i shprehur edhe në zhvillimin e vendbanimeve në formë të koncentruar dhe më të dendësuar se sa që ishte më parë, në favor të ruajtjes së tokës bujqësore por edhe të shtrirjes së infrastrukturës si dhe lehtësimit në ofrim të shërbimeve teknike dhe sociale.

#### 4.4. VLERËSIMI I STRATEGJIVE

Natyrisht, që të nënkuptohet dhe të sigurohet se strategjia sipas konceptit zhvillimor të Planit Hapësinor për zonën me interes të veçantë ekonomik të FMR-së është e mirë dhe pozitive, duhet të përballet me çfarëdo strategjie tjetër të hartuar, duke i krahasuar ato nëpër kriteret e njohura për vlerësim të strategjive.

Me këtë rast, meqë nuk kemi strategji tjera të përgatitura më parë, bëhet krahasimi ndërmjet dy strategjive të elaboruara në këtë kaptinë si fazë e katërtë e këtij dokumenti. Vlerësimi dhe krahasimi ndërmjet "Strategjisë sipas konceptit të zhvillimit hapësinor" dhe "Strategjisë Zero (ose të zhvillimeve sipas Trendit)", që nënkupton vazhdimësinë e zhvillimeve të pa planifikuara dhe të pa kontrolluara, është bërë dhe prezantuar në tabelën 15, si në vijim.

##### Vlerësimi i strategjive për zonën me interes të veçantë "Fusha e Mihjes së Re"

Kriteret për vlerësim <i>Strategjia, duhet të jetë, ...</i>		Strategjia sipas trendit (ose strategjia "0")		Strategjia sipas konceptit (të zhvillimit të planifikuar)	
1	<i>Reale dhe e zbatueshme</i>	2	Vazhdon zbatimi realitetit të paplanifikuar	2	Zbatohet mbi baza reale dhe të planifikuara
2	<i>Ekonomikisht e arsyeshme</i>	1	Deri diku por pa përfitime të qarta	2	E mjaftueshme dhe me përfitues të definuar
3	<i>Me role dhe përgjegjësi të qarta</i>	1	Përveç KEK-ut të tjerat të paqarta	2	Me role të ndara dhe përgjegjësi të qarta
4	<i>Me ndikim në qëllimet prioritare</i>	0	Nuk mund të bazohet zhvillimi i prioriteteve	2	Është pararojë e prioriteteve zhvillimore
5	<i>E fokusuar dhe strategjike</i>	1	E domosdoshme por pa mundësi planifikimi strategjik	2	E fokusuar dhe me prioritet strategjik në zhvillimin e vendit
6	<i>E kuptueshme dhe e përkrahur nga aktorët (pjesëmarrësit) kyç</i>	0	E pakuptueshme dhe pa papërkrahjen kyçe të pjesëmarrësve	2	Kuptimplote, përkrahje institucionale dhe ekspertizë profesionale
7	<i>Me kornizë hapësinore, kohore dhe investive</i>	1	Mirëpo pa ndonjë kornizë kohore dhe investive	2	Ofron kornizë të qartë për të gjithë treguesit përbërës (hap., koh. dhe inv.)
8	<i>Me bazë të qartë për caktimin e rregullave të nevojshme të kontrollit</i>	0	Pa bazë të qartë e të nevojshme për rregullat e kontrollit	1	Rregulla të qarta të kontrollit por jo të gjitha
9	<i>Minimizues i konflikteve në mes sektorëve dhe mundësive zhvillimore</i>	0	Konfliktet vetëm sa vijnë e shtohen vazhdimisht	1	Shprehë përpjekjet për minimizim të konflikteve
10	<i>Shtytës në maksimum i sinergjive potenciale</i>	0	Nuk ka të bëjë asgjë me funksionim të sinergjive	2	Paraqet funksionimin maksimal të sinergjive
11	<i>Të jetë fleksibile</i>	1	Mund të ketë ndonjë lloj fleksibiliteti por pa planifikim	2	Fleksibilitet në zhvillime, lokacione, kapacitete dhe investime
<b>Gjithsejt</b>		<b>7 prej 22</b>		<b>20 prej 22</b>	
Forma e vlerësimit: 2 - Plotësisht, 1- Pjesërisht (ose jotërisht) dhe 0 - Aspak					

Tabela 15. Vlerësimi i strategjive për zonën e FMR-së sipas kriterëve standarde. - Burimi: IPH / MMPH.

**KONKLUDIM:** Çdo veprim zhvillimor, në kuadër të strategjisë zhvillimore sipas konceptit të përparuar (avancimit sinergjik dhe zbutjes së konfliktit sektorial), kur është i planifikuar, i kontrolluar, dhe i udhëhequr nga institucionet qeveritare të mbështetur në kornizën ligjore, del të jetë më i suksesshëm dhe më i organizuar për zbatimin e tij sipas përgjegjësive të ndara përballë veprimeve të pasuksesshme individuale në kuadër të strategjisë së trendit, me zhvillime të paorganizuara në zbatim (investim, kohëzgjatje dhe kontrollë) të duhur.

# DISPOZITAT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË

## V

### 5. DISPOZITAT PËR ZBATIMIN E KONCEPT STRATEGJISË

**M**e anë të dispozitave për zbatim bëhet definimi më i qartë i kushteve dhe masave për shfrytëzimin, rregullimin e hapësirës duke përfshirë mbrojtjen mjedisore dhe sociale të zonës së FMR-së. Përcaktohen përgjegjësit dhe detyrat e tyre në respektimin e rregullave të parashikuara, të cilat do të ndikojnë në realizimin e drejtë të zhvillimeve të parapara në zonë dhe përreth saj.

#### 5.1. KUSHTET DHE MASAT E QEVERISË, PUSHTETIT LOKAL, INVESTITORIT PRIVAT DHE INSTITUCIONEVE TJERA PËRGJEGJËSE

##### 5.1.1. KUSHTETET DHE MASAT E PËRGJITHSHME

Me planin Hapësinor për zonën me interes të veçantë ekonomik - Fusha e Mihjes Re (në tekstin e mëtejshëm: Plani) definohen caqet e rregullimit, organizimit dhe destinimit të hapësirës si edhe kushtet dhe masat për shfrytëzim, rregullim dhe mbrojtje të zonës së veçantë.

- Plani përfshihet në projekt-elaboratin "Plani Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik - Fusha e Mihjes së Re" i punuar në bashkëpunim të ngushtë nga Instituti për Planifikim Hapësinor – MMPH me Grupin Punues Ndërmintor (i themeluar për këtë qëllim) në vitin 2009 si dhe përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike (ku përfshihen hartat, pjesa grafike, tabelat dhe fotot e ndryshme).
- Plani, mbulon periudhë kohore, prej dhjetë e më shumë viteve, gjegjësisht vitet 2010 – 2020+.
- Rishikimi i Planit bëhet në qdo pesë vite por mund të bëhet edhe sipas kërkeses në bazë të ndryshimeve në terren.
- Përgjegjës për revidim të Planit është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).
- Plani është punuar në përputhje me Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe në pajtim me direktivat, konventat dhe parimet ndërkombëtare për planifikim, zhvillim dhe mbrojtje të mjedisit.
- Të gjitha planet tjera të nivelit më të ulët dhe me ndikim në territorin e zonës FMR i nënshtrohen këtij Plani.

### 5.1.2. APLIKIMI I PLANIT NGA ANA E QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

- Bazuar në udhëzimet e KDP-së, përcakton institucionin përgjegjës për përgaditjen e lokacionit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese.
- Bazuar në udhëzimet e KDP-së, definon teknologjinë e pranueshme për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, komercialisht të vërtetuar dhe në pajtueshmëri të plote me standardet e BE-se;
- Bazuar në udhëzimet e KDP-së, përcakton fazat e zhvillimit të mihjes dhe kapacitetin e ndërtimit të termocentralit të ri;
- Bashkë me institucionet përgjegjëse, krijon dhe implementon kornizën e kërkesave që dalin nga Aquis Communitarie.
- Bën inventarizimin, vlerësimin e paluajtshmërive dhe merr vendimin për shpronësim.
- Në bashkëpunim me Komunitetin përcakton lokacionin e përshtatshëm për zhvendosjen dhe rivendosjen e popullsisë;
- Në bashkëpunim me Komunitetin dhe në konsultim me Komunitetin cakton lokacionin për zhvendosje - rivendosje të varrezave;
- Bashkë me institucionet përkatëse për trashëgimi kulturore dhe historike përkujdesen ndaj trashëgimisë kulturore në përgjithësi.
- Trajton problemet e trashëguara mjedisore dhe ato ekzistuese nga veprimtaritë e KEK sh.a. (Deponitë e hirit, e palosjeve të jashtme të djerrinës, etj).
- Aprovon dhe mbikëqyr zbatimin e të gjitha Planeve të hartuara nga Investitori Privat të cilat kërkohen dhe në bazë të kontratës;
- Organi Shpronësues në kuadër të MMPH-së bën aprovimin dhe monitorimin e Planit të Veprimit për Zhvendosje;
- MMPH është përgjegjëse për ofrimin e kushteve urbanistike për Planin Rregullues Urban të Kompleksit TC "Kosova e Re";
- MMPH jep pëlqimin mjedisor dhe urbanistik për zonën me interes të veçantë ekonomik "FMR".

### 5.1.3. APLIKIMI I PLANIT NGA ANA E PUSHTETIT LOKAL

- Institucionet e nivelit lokal, Komunitet: Obiliq, Fushe Kosove, Vushtrri dhe Drenas do të bëjnë koordinimin e menaxhimit të pjesëve të caktuar brenda Zonës me interes të veçantë FMR;
- Planet zhvillimore komunale (PZHK) të komunave pjesëmarrëse Obiliq, Fushe Kosove, Drenas dhe Vushtrri duhet të harmonizohen me këtë Plan;
- Zgjerimi i vendbanimeve në përputhje me PZHK, PZHU, PRrU dhe PH të TZHEK-ut për komunitet pjesëmarrëse në FMR (Obiliq, Fushë Kosovë, Vushtrri dhe Drenas);
- Qeveria lokale harton dhe miraton Planet Rregulluese Urbane;
- Qevria lokale, pas marrjes së pëlqimeve nga MMPH, miraton Planin Rregullues Urban për Kompleksin e TC "Kosova e Re";
- Drejtoria Komunale për Urbanizëm, gjatë hartimit të planeve rregullative / urbane, duhet orientuar zhvillimet në densifikim apo zgjerim të vendbanimit (për ato që nuk zhvendosen) në



zonen e FMR-se, varësisht nga ndikimi i ndotjes në drejtimin e erërave dhe me largësitë minimale prej 1 km' nga TC-të si dhe 200 m' nga zona e mihjes dhe shiritat transportues;

- Siguria në komunikacion (sinjalizimi, mbrojtëset rrugore);
- Ndalimi i qarkullimit të mjeteve transportuese në rrugët lokale të vendbanimeve;
- Sigurimi i minierës me rrethoja për të parandaluar rrezikun;

#### 5.1.4. APLIKIMI I PLANIT NGA ANA E INVESTITORIT PRIVAT

- Operon dhe menaxhon me kapacitete gjeneruese të reja dhe mihjen e re të linjtit pas procesit të tenderimit dhe në përputhje me kushtet e kontratës;
- Harton Planin e Veprimit për Zhvendosje bazuar në "Kornizën e Politikave për Zhvendosje"
- Harton Planin e Veprimit për Zhvendosje të varrezave në bashkëpunim me Kuvendin Komunal përgjegjës dhe në konsultim të ngushtë me komunitetin;
- Harton Planin Rregullues Urban për Kompleksin TC "Kosova e Re" në bazë të kushteve urbanistike të ofruara nga MMPH;
- Përgadit planin social i cili në mes tjerash do të përfshijë trajnimin dhe transferin e një pjese të fuqisë punëtore aktuale të KEK-ut, me qëllim të ofrimit të mundësive për punësim.
- Themelon Fondin për Zhvillim të Komunitetit të kësaj zone që do të definohet në Kërkësen për Propozim.
- Shfrytëzon në mënyrë racionale rezervat e linjtit bazuar në Planin Kryesor Minerar.
- Përkujdeset për ruajtje, mbrojtjen e mjedisit dhe hartimin e projekteve për rehabilitimin e mjedisit në të cilin do të operoj dhe të instaloj sistemin e monitorimit mjedisit për resurse natyrore dhe cilësi të ajrit.
- Shfrytëzon në mënyrë racionale resurset ujore të nevojshme për procesin e prodhimit të energjisë elektrike.
- Harton VNM, VNS dhe PVZH bazuar në këtë Plan dhe dokumente tjera të hartuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës
- Harton planin për mbylljen e termocentralit pas përfundimit të jetës operacionale.
- Harton planin për mbylljen e mihjes pas shfrytëzimit të rezervave të linjtit.
- Çdo plan të hartuar, që i kërkohet edhe me kontratë, e dorëzon për aprovim në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

#### 5.1.5. ZBATIMI I PLANIT NGA ANA E INSTITUCIONEVE TJERA PËRGJEGJËSE

- KOSTT obligohet të rehabilitoj linjat e vjetëruar dhe të bëjë ngritjen e të rejave në kuadër të sistemit të transmisionit (110 dhe 220 KV-she)
- KOSTT obligohet të merret me rimëkëmbjen e rrjetit dhe të siguroj kontrollë rigoroz në favor të minimizimit të humjeve të energjisë elektrike.

- Operatori ekonomik<sup>26</sup> menaxhon me kapacitete gjeneruese ekzistuese brenda zonës deri në dekomisionimin e tyre dhe implementon projekte në revitalizimin e hapësirave të degraduara (deponite e hirit dhe djerrinës),
- Ndërmarrja publike rajonale 'Kompania për Menaxhimin e Deponive Kosovare (KLMC) duhet të ngris nivelin e menaxhimit të deponisë sanitare ose të largoj atë nga lokacioni që gjendet në pjesën lindore të minierës së Mirashit.

### 5.1.6. RREGULLIMI DHE SHFRYTËZIMI I HAPËSIRËS

- Hapësira brenda kufirit evidentues të zonës me interes të veçantë ekonomik ka sipërfaqe prej 14.986 Ha (hektarëve).
- Hapësira brenda kufijve të mihjes së re në kuadër të basenit të Kosovës duhet ruajtur ekskluzivisht për aktivitetet minerare.
- Hapja e minierës së re duhet të zhvillohet në mënyrë graduale duke shpallur linjitetin e në të njëjtën kohë duke mbuluar hapësirat e shfrytëzuara.
- Në vendbanimet që duhet të zhvendosen, sipas avancimit të zhvillimeve bazuar në Planin Kryesor Minerar, autoritetet komunale marrin vendim mbi ndalimin e ndërtimeve të reja pas inventarizimit të pasurisë së paluajtshme.
- Ndërtimet e objekteve të reja të banimit, në periudhën pas marrjes së vendimit nga autoritetet komunale mbi ndalimin e ndërtimit tyre deri para fillimit të procesit të zhvendosjes, konsiderohen ndërtime ilegale dhe nuk kompensohet.
- Sipërfaqet e tokës së rregulluara, pas kryerjes së rehabilitimit të zonave të degraduar, kalojnë në pronësi të komunës për rikultivim dhe shfrytëzim të mëtejshëm si resurs bujqësor.
- Për shkak të potencialit rëshqitës të tokës në këtë zonë edhe pas procesit të rikthimit të tokave, nuk parashihet krijimi i vendbanimeve të reja mbi këto sipërfaqe si dhe mbi gropat e minierave Bardh, Mirash dhe Sitnicë pas mbushjes dhe rikthimit të tyre në hapësira të rrafshëta;

## 5.2. DISPOZITAT PËR KONSULTIME, BASHKËPUNIM DHE PJESËMARRJE

- Hartimi i këtij Plani është bazuar edhe në shfrytëzimin e të gjitha konsultimeve të gjertanishme hulumtuese shkencore dhe gjatë diskutimeve publike duke çmuar lartë bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në takimet që janë iniciuar dhe realizuar nga zyra e Projektit për Asistencë Teknike të Energjisë nga Linjiti (PATEL) për përgaditjen e raporteve të ndryshme të VSMS-së dhe për Plan Zhvillimor të FMR-së.
- Grupi Punues Ndërmnistror, i formuar që nga fillimi i procesit të hartimit të këtij Plani (vetëm nga dy ministritë më përgjegjëse MMPH dhe MEM), i cili shumë shpejt është zgjeruar me përfaqësues edhe nga ministritë tjera relevante dhe me interes, e që pak kohë më pas është plotësuar edhe me përfaqësues nga Komunitetët pjesëmarrës dhe KEK-u (Korporatës Energjetike të Kosovës, shoqëri aksionare).
- Ky grup punues (GPNM) duhet të mblidhet edhe kur kërkohet revidimi apo hartimi i planit të ri për shkak të përvojës dhe profesionalizimit të pjesëmarrësve.

<sup>26</sup> Me operator ekonomik definohet operatori aktual që është KEK-u s.h.a. apo pasardhësi i tij pas procesit të ristrukturimit apo privatizimit ...

- Pjesëmarrja në takime konsultative përbëhet nga pjesëmarrës të të gjitha grupeve të interesit.
- Komentet nga takimet publike (qofshin ato diskutime, konsultime apo shqyrtime publike), merren në konsideratë dhe i bashkëngjiten Planit.

### 5.3. DISPOZITAT MBI KRONOLOGJINË DHE ETAPAT E ZBATIMIT

- Avancimi i procesit të zhvillimit të termocentralit ri gjegjësisht kronologjisë së ndërtimit të vazhdueshëm të blloqeve të reja mund të zbatohet vetëm në bazë të vendimeve të KDP-së.
- Avancimi dhe kronologjia e zhvillimeve minerar te realizohet sipas Planit Kryesor Xehetar (PKX), të hartuar nga Ëatenfall europe dhe DMT, me pasqyrim kronologjik të fazave.
- Plani është mbështet në studim-hulumtimin e hartuar nga Ëatenfall dhe DMT.
- Avancimi dhe kronologjia e zhvillimit të procesit të zhvendosjes së vendbanimeve Hade dhe Shipitullë nga fusha e re minerare, duhet të realizohet konform zhvillimit të procesit të zhvillimit minerar.
- Rehabilitimi i zonave të degraduar duhet të filloj menjëherë dhe të vazhdoj pa shkëputje deri në përfundim të projekteve të hartuara.
- Mbjellja e menjëhershme e fidaneve në brezat mbrojtës gjelbërues duke shfrytëzuar aksionin 'një banor një fidan' sipas planit të përbashkët ZKM / MMPH / MBPZHR / MZHE (KEK-u)

### 5.4. UDHËZIME MBI HULUMTIMET E MËTUTJESHME

- Qeveria e Kosovës dhe Investitori të hartoj studimin, mbi ndikimin e ndotjes në shëndetin e njeriut, nga proceset dhe zhvillimet për prodhim të energjisë elektrike, gjatë kohës së kaluar, të tashme dhe të ardhme si dhe parashikimi i masave për mbrojtjen e shëndetit të banorëve në zonë;
- Përfundon procedurat e Shpalljes dhe obligon MMPH-në për hartimin e Planit Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik "Hidrocentralin e Zhurit";
- Përmes institucioneve kompetente harton studimet e fizibilitetit dhe zbaton projektet për ndërtimin e Hidrocentraleve tjera të vogla;
- Studion dhe realizon projektin e shndërrimit të 'Hidrocentralin e Ujmanit në hidrocentral reversibil;
- Përfundon dhe zbaton projekte konkrete për kyçe në rrjetin e gazit natyrorë;
- Harton projekte të bazuara mbi studimet e kryera paraprakisht për mundësinë e shfrytëzimit burimeve tjera alternative për prodhim të energjisë elektrike;
- Krijon kornizë të qëndrueshme ligjore, institucionale dhe ekonomike për energjinë alternative;
- Themelon Institucionin Qëndror për hulumtim dhe shfrytëzim të burimeve të ri-përtritshme;



**Qeveria e Republikës së Kosovës**  
**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**



**PLANI HAPËSINOR**

**Zona me Interes të Veçantë Ekonomik**

**"Fusha e Mihjes së Re 2010 - 2020+"**



**Instituti për Planifikim Hapësinor**

Prishtinë,

Mars, 2011

---

Dokument i hartuar nga  
Instituti për Planifikim Hapësinor  
në bashkëpunim me strukturat relevante  
të Qeverisë së Republikës së Kosovës





# SHTOJCAT

Në Planin Hapësinor për Z.I.V.E. "Fusha e Mihjes së Re" 2010 - 2020+

## SHTOJCA 1.

Lista e pjesës grafike në Planin Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik "Fusha e Mihjes së Re"

### Hartat

Harta 1.	Kufiri i propozuar i zonës me faktorët ndikues hapësinor (Sip.143 Km <sup>2</sup> ) : Burimi: PATEL / MEM..	15
Harta 2.	Kufiri i përcaktuar i zonës me faktorët ndikues hapësinor (sip. 150Km <sup>2</sup> ) : Burimi: IPH / MMPH....	16
Harta 3.	Kufiri i zonës së FMR-së me sipërfaqe prej 150km <sup>2</sup> - Burimi: IPH / MMPH.....	17
Harta 4.	Konteksti hapësinor: a) Baseneve të linjitet në Kosovë dhe b) Zona e FMR-së në Basenin Kosova Burimi: IPH / MMPH .....	25
Harta 5.	Shtirirja dhe konteksti territorial i zonës FMR me komunat - Burimi: MMPH /IPH .....	26
Harta 6.	Shtirirja e FMR-së në kuadër të basenit të thëngjillit Kosova. - Burimi: IPH / MPH.....	28
Harta 7.	Përbërja gjeologjike e Kosovës. Burimi: KPMM.....	29
Harta 8.	Përbërja hidrologjike e Kosovës. Burimi: KPMM.....	30
Harta 9.	Pozita e FMR-së, në zonën sizmike me intensitet 7° MSK sipas tërmeteëve të regjistruara, në Kosovë, Burimi: Instituti për sizmikë në MEM dhe IPH/MMPH.....	33
Hartat 10.	Shtirirja e vërshimit të lumenjve (majtas) dhe nivelet e erozionit (djathtas) në zonën FMR-së Burimi: IPH/MMPH sipas Atlasit Hidroekonomik të Kosovës.....	34
Harta 11.	Sipërfaqet në shfrytëzim dhe nën pronësi të KEK-ut. - Burimi: KEK / Divizioni Qymyrit.....	35
Harta 12.	Shfrytëzimit të tokës në zonën e FMR-së. - Burimi: IPH / MMPH.....	36
Harta 13.	Shtirirja e klasave të tokës bujqësore në zonën e FMR-së - Burimi: IPH / MMPH sipas UN FAO.....	37
Harta 14.	Vendbanimet në zonën e FMR-së - Burimi: IPH / MMPH.....	39
Harta 15.	Shtirirja e pikave për monitorim të ajrit në Kosovë - Burimi: IHMK.....	44
Harta 16.	Kategorizimi lumenjve sipas shkallës së ndotjes. Burimi: DU / MMPH.....	47
Harta 17.	Shtirirja e trashëgimisë natyore dhe kulturo-historike në dhe rreth zonës "FMR" Burimi: IPH / MMPH.....	54
Harta 18.	Raporti mes fushave minerare (në shfrytëzim, sipas PKX dhe asaj të licencuar sipas PPX Burimi: MEM / VSMS / Pricewaterhouse Coopers LLP.....	58
Harta 19.	Dendësia e popullsisë (b/km <sup>2</sup> ) nëpër zonat kadastrale të FMR-së - Burimi: IPH / MMPH 2009.....	60
Harta 20.	Objektet e infrastrukturës sociale dhe të shërbimeve në zonën e FMR-së - Burimi: IPH / MMPH....	64
Harta 21.	Shtirirja e infrastrukturës teknike në zonën e FMR-së - Burimi: IPH / MMPH / MTPT.....	69
Harta 22.	Rrjeti i bartjes së energjisë elektrike në dhe rreth zonës FMR - Burimi: PHK - IPH / MMPH.....	71
Harta 23.	Shtirirja e rrjetit të transmisionit energjisë elektrike në Kosovë dhe lidhjet me rajon Burimi: KOSTT marr nga PATEL/MEM.....	72
Harta 24.	Avancimi i paramenduar kohor i mihjes së re sipas skenarit "A" Burimi: IPH/MMPH nga VSMS 2008, zyra PATEL/MEM.....	116
Harta 25.	Strategjia e zhvillimeve të ardhshme sipas konceptit të zhvillimit hapësinor të FMR-së Burimi: IPH / MMPH.....	120
Harta 26.	Shfrytëzimi i parashikuar i tokës për në vitin 2020 - Burimi: IPH / MMPH.....	137
Harta 27.	Shpërndarja e gazrave SO <sub>2</sub> dhe NO <sub>x</sub> nga TC KR dhe Kosova B nën ndikimin e erës në zonën e FMR-së - Burimi: IPH / MMPH nga VSMS 2008, zyra PATEL/MEM.....	138
Harta 28.	Masat mbrojtëse ndaj erozionit dhe vërshimeve më të theksuara në zonën e FMR-së. Burimi: IPH/MMPH nga Atlasi Hidroekonomik i Kosovës 1976 .....	139

### Figurat

Figura 1.	Skema e gjithëpërfshirjes në procesin e hartimit të Planit - Burimi IPH / MMPH .....	18
Figura 2.	Skema e sistemit të planifikimit në Kosovë - Burimi: IPH / MMPH.....	22
Figura 3.	Skema e procesit të planifikimit (Procedura e hartimit të Planit) në Kosovë - Burimi: IPH / MMPH....	23
Figura 4.	Grafiku i luhatjes së temperaturave mujore - Burimi: Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, 2004.....	31

Figura 5.	Trëndafili Erës për Prishtinën - Burimi: IHMK, 2004.....	32
Figura 6.	Skema e shtrirjes së palosjeve të jashtme dhe minierës ekzistuese në zonës e FMR-së- Burimi: KEK.	39
Figura 7.	Grafiku i vlerave mesatare mujore të SO2 matur në IHMK 2005 - 2008 - Burimi: IHMK.....	44
Figura 8.	Grafiku i vlerave mesatare mujore të Blozës matur në IHMK 2005 -2008 - Burimi: IHMK.....	45
Figura 9.	Grafiku i vlerave mesatare vjetore të joneve sulfate, joneve klorure, pH-së dhe përçueshmërisë elektrike për 2007 dhe 2008 - Burimi: IHMK.....	45
Figura 10.	Krahasimi me minierat ndërkombëtare - Burimi: MEM/VSMS/PricewaterhouseCoopers LLP.....	56
Figura 11.	Fushat e mihjes së linjitet në Basenin Kosova - Burimi: MEM/VSMS/PricewaterhouseCoopers LLP...	57
Figura 12.	Grafiku i strukturës së popullsisë sipas moshës në FMR për vitin 2008, Burimi: IPH /MMPH 2009....	61
Figura 13.	Grafiku i të hyrave ndihmëse në ekonomitë familjare - Burimi: VSMS 2008, nga PATEL/MEM.....	67
Figura 14.	Skema e raportit në mes zonës së FMR-së, TZHEK-ut dhe Autoudhës nga PHK 2010-2020+, Burimi: IPH / MMPH .....	73
Figura 15.	Skema piramidale për arritjen e Vizionit - Burimi: IPH/MMPH.....	97
Figura 16.	Skema e konceptit "Detelinë dhe Helikë" për zhvillimin e ardhshëm të zonës së FMR-së Burimi: IPH / MMPH .....	101
Figura 17.	Skica e prerjes së bllokut në termocentralin me linjit, Burimi: Ligjërata trajnimi për VSMS nga PATEL .....	103
Figura 18.	Skemat e skenarëve "A, B, C dhe D" për përzgjedhje të lokacionit të termocentralit "Kosova e Re" - Burimi: IPH/MMPH .....	112
Figura 19.	Skemat e skenarëve të propozuar për zhvillimin të minierës së re Burimi: KEK "Plani Kryesor Xehetar" 2005 .....	115
Figura 20.	Parashikimet kohore afatgjate për zhvillimin e mihjes së re Burimi: VSMS 2008, zyra PATEL/MEM .....	117

### Tabelat

Tabela 1.	Sipërfaqet (në hektarë dhe %) të kontekstit FMR - Komuna pjesëmarrëse. - Burimi: MMPH /IPH ....	26
Tabela & grafiku 2.	Shfrytëzimi tokës në zonën e FMR-së. - Burimi: IPH / MMPH .....	37
Tabela 3.	Vlerat mesatare të emisioneve gjatë viteve 2002 - 2005 - Burimi: INKOS .....	42
Tabela 4.	Vlerat mesatare të emisioneve gjatë viteve 2006 - 2008 - Burimi: INKOS .....	43
Tabela 5.	Sasitë e hirit si produkt i punës në TC e Kosovës - Burimi: TIAM / KEK-u / MEM .....	50
Tabela 6.	Mbeturinat e larguara nga TC-Kosova B gjatë vitit 2004 dhe 2005 (majtas) dhe nga dy TC-të gjatë vitit 2006 (djathtas) - Burimi: KEK /MEM .....	50
Tabela 7.	Shkalla e zhurmës - Burimi: Carl Bro, 2002 .....	52
Tabela 8.	Trashëgimia kulturo-historike për zonën e FMR-së - Burimi: DTK / MKRS .....	55
Tabela 9.	Rezervat linjitet brenda FMR-së në Basenin e Kosovës - Burimi: MEM / KEK .....	57
Tabela 10.	Dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve - Burimi: IPH / MMPH .....	59
Tabela 11.	Kapacitetet gjeneruese në blloqet e termoelektraneve ekzistuese në Kosovë - Burimi: KEK, 2009 .....	75
Tabela 12.	Totali i shpenzimeve për sektorin e energjisë (në milion €) - Burimi: PATEL / MEM .....	83
Tabela 13.	Investimet e planifikuara për projektin "Mihja e Re e linjitet dhe Termocentrali Kosova Re" Burimi: PATEL / MEM, 2009.....	84
Tabela 14.	Kriteret për zgjedhjen e lokacionit për TCKR - Burimi: IPH /MMPH .....	112
Tabela 15.	Vlerësimi i strategjive për zonën e FMR-së sipas kriterëve standarde - Burimi: IPH / MMPH .....	136

### Fotot

Foto 1.	Pamje e Prishtinës me pluhurin e sjellur nën ndikim të erës - Burimi: IPH / MMPH .....	32
Foto 2.	Pamje nga miniera ekzistuese e Mirashit - Burimi: Divizioni i Qymyrit / KEK .....	40
Foto 3.	Pamje nga deponitë e hirit të TCA - Burimi: IKMM / MMPH .....	40
Foto 4.	Pamje e termocentralit Kosova B - Burimi: IPH/MMPH .....	41
Foto 5.	Pamje nga vërshimi i zonës në afërsi të TC Kosova A - Burimi: IPH / MMPH, 2005 .....	46
Foto 6.	Pamje të disa nga rezervarët me përmbajtje të nus produkteve, të mbetura nga procesi i gazifikimit Burimi: KEK / INKOS .....	51
Foto 7.	Pamje e Tyrbes së Sulltan Muratit të I-rë - Burimi: IPH / MMPH .....	53
Foto 8.	Pamje e fshatit Hade - Burimi: IPH /MMPH .....	64
Foto 9.	Pamje e tokës bujqesore ne zonen e Interesit. - Burimi: IPH / MMPH .....	78
Foto 10.	Pamje nga rehabilitimi i pjesshëm i deponisë së djerrinës - Burimi: IPH / MMPH .....	87
Foto 11.	Pamje nga mihjet ekzistuese - Burimi: IPH / MMPH .....	92
Foto 12.	Pamje e ftohësit hiperbolik dhe shtyllave të transmisionit - Burimi: Të ndryshme IPH/MMPH ....	97
Foto 13.	Pamje nga takimet punuese të GPNM-së - Burimi: IPH /MMPH .....	100

**SHTOJCA 2.****Vendimi i Qeverisë Nr. 02/57 për shpalljen e zonës me interes të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes së Re" me datë 13.03.2009.**

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/57  
Datë: 13.03.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12.2 të Ligjit Nr. 2003/14 mbi Planifikimin Hapësinor, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2009, mori

**V E N D I M**

1. Shpallet Zonë e Interesit të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes së Re" me një sipërfaqe prej 143,254 km<sup>2</sup>, sipas hartës bashkangjitur këtij vendimi.
2. Zona e Interesit të Veçantë përfshinë disa nga zonat kadastrale të komunave: Kastriot, Fushë Kosovë, Vushtrri dhe Drenas, e të cilat preken nga këto veprimtari:
  - a) Mihjet ekzistuese të Korporatës Energjetike të Kosovës (Bardh, Mirash, Sirmicë);
  - b) Mihjen e Re (pjesa veriore e basenit të linjit "Kosova");
  - c) Objektet ekzistuese të gjenerimit (TC Kosova A dhe TC Kosova B) me stabilimentet përcjellëse;
  - d) Palosjet e jashtme të djerrinës;
  - e) Deponitë e hirit (TC Kosova A dhe TC Kosova B);
  - f) Lokacionet e propozuara për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re; dhe
  - g) Zonën e paraparë me vendimin e Qeverisë Nr. 4/119 të datës 03 nëntor 2004.

3. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që të hartojë Planin Hapësinor për këtë zonë duke u bazuar në "Draft Planin Zhvillimor të fushës së Mihjes së Re" të përgatitur nga Projekti i Asistencës Teknike Energjia nga Linjiti i financuar nga Banka Botërore.
4. Vendimi Nr. 04/119 të datës 03 nëntor 2004 mbetet në fuqi deri në aprovimin e Planit Hapësinor për këtë zonë nga Kuvendi i Kosovës.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Kuvendit Komunal - Kastriot
- Kuvendit Komunal - Fushë Kosovë
- Kuvendit Komunal - Vushtrri
- Kuvendit Komunal - Drenas
- Arkivit të Qeverisë



**SHTOJCA 3.**

**Vendimi i Qeverisë Nr. 07/99 për rikonfigurimin e transaksionit për "TC KR" me datë 17.12.2009.**



**Republika e Kosovës**  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/99  
 Datë: 17.12.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7.2.2 dhe nenit 12.2.12 të Ligjit mbi Partneritet Publiko Private dhe Koncesionet në Infrastrukturë dhe Procedurat për Dhënie të Tyre Nr. 03/L - 090, Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L - 087, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me vendimin e Komitetit Drejtues të Projektit dhe me propozimin e Ministrisë së Energjisë dhe Minerave, në rambledhjen mbajtur më 17 dhjetor 2009, mori

**V E N D I M**

1. Duke u mbështetur në rekomandimin e Komitetit Drejtues të Projektit të Asistencës Teknike Energjia nga Linjiti, me përkrahje të komunitetit ndërkombëtar të donatorëve, rikonfigurohet transaksioni për termocentralin "Kosova e Re" ("TCKR") dhe Fusha e Linjtit në Sibovc. Transaksioni i ri do të ketë këta komponentë:
  - 1.1 Ndërtimi i centralit të ri për generimin e energjisë elektrike, "termocentrali Kosova e Re" ("TCKR") me kapacitet të instaluar fillestar prej 500 (pesëqind) megavat me mundësi të zgjerimit deri në 1.000 (njëmijë) megavat dhe stabiliteteve përkatëse (të limituara) të interkoneksionit;
  - 1.2 Zhvillimi i menjëhershëm i Fushës së Linjtit në Sibovc për të ofruar linjit për centralet ekzistuese në Kosovë për generimin e energjisë elektrike me djegie të linjtit (termocentrali Kosova A dhe termocentrali Kosova B) dhe njësitë e reja të termocentralit "Kosova e Re" (TCKR), kur ato të hyjnë në shërbim; dhe
  - 1.3 Participimi i sektorit privat në termocentralin Kosova B.
2. Ky transaksion i rikonfiguruar duhet të shpallet me publikimin e njoftimit në gazetën ndërkombëtare me reputacion, i cili njoftim do të adhëzon palët e interesuara tek Memorandumi i Para-Kualifikimit i cili përshkruan hollësitë e transaksionit, kriteret minimale për përzgjedhjen, konkurrencën dhe synimet e Qeverisë për këtë transaksion. Qeveria e Kosovës ka rishikuar këto dokumente dhe aprovon publikimin e tyre.
3. Është përgjegjësi e Ministrisë së Energjisë dhe Minerave, që në emër të Komitetit Drejtues të Projektit PATEL dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës që të zbatojë këtë vendim dhe të promovojë procesin e suksesshëm të transaksionit gjatë muajve në vijim, duke filluar me Konferencën e Investitorëve e cila do të mbahet më/ose rreth 20 janar 2010.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
 Hashim THACI  
 Kryeministri i Kosovës

Iu dërgohet:  
 - të gjitha ministrave (ministrave)  
 - Sekretariatit të Përbashkët të ZKM-ës  
 - Arkivit të Qeverisë

**SHTOJCA 4.**

**Vendimi i Kuvendit të Kosovës Nr. 03-V-272 për Miratimin e SEK 2009 – 2018 me datë 01.04.2010.**



Legjislatura III

Kuvendi,

Në mbështetje të nenit 65 (9) të Kushtetutit të Republikës së Kosovës dhe të Rregullës 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit, në seancën plenare të mbajtur më 01 prill 2010, pas shqyrtimit të Raportit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me Propozimin-strategjinë e Energjisë për periudhën 2009-2018, mori këtë

**V E N D I M**

I. Miratohet Strategjia e Energjisë për periudhën 2009-2018, me rekomandimet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si në vijim:

1. Resurset e ligjtit të vihen në dispozicion dhe shfrytëzim të pajtim me kapacitetet e reja gjeneruese të energjisë dhe në harmoni me interesat zhvillimore të Kosovës.
2. Të krijohet ambienti ligjor për konkurrencë dhe treg të lirë të fushës e sektorit të energjisë.
3. Në Strategjinë e energjisë, seksioni 11.2.5 Rivitalizimi i TC "Kosova II" me gjesëmarrjen e sektorit privat, ndryshohet fjalia e tretë e paragrafit të dytë dhe formulohet si vijon: "sektori privat do të përfshihet në kuadër të transaksionit "Kosova e re".
4. Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese të bëhet në bazë të interesit afatgjatë për Kosovën, në fazën e parë kapaciteti 1000 megavat me mundësi të ndërtimit të kapaciteteve të tjera, në harmoni me kërkesat dhe bilancin energjetik të vendit dhe të rajonit.
5. Qeveria e Kosovës obligohet ta harmonizojë Planin e veprimit me Strategjinë e energjisë të miratuar për periudhën 2009-2018.

Nr. 03-V- 272

Prishtinë, më 01 prill 2010.

Vendimi i dërgohet:

- Qeverisë së Kosovës,
- Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë... dhe
- Arkivit të Kuvendit.

Kryetari i Kuvendit  
Jakup KRASNIQI

**SHTOJCA 5. Plani i Veprimit Strategjik**
**Plani Veprimit Strategjik për PH të zonës me interes të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes Re 2010 - 2020+"**

Nr.Rendor	Synimi	Objektivi	Veprimi (masë / projekt / aktivitet)	Afat	Institucione Përgjegjëse	Institucionie Zbatuese	Buxheti në milion € / Investitori				Projektet Egzistuese	
							BK	Do nac	PPP	To tali		
<b>S1 SYNIMI 1. Prodhim dhe furnizim i sigurt i energjisë elektrike dhe të ngrohjes</b>												
<b>S1</b>	<b>O1 Objektivi 1. Ndërtimi i njërive të reja gjeneruese në TC Kosova e Re me teknologji më të avancuar me djegie të linjtit që nga viti 2011</b>											
1	S1	O1	V1	Vendimi për ndërtimin e kapaciteteve të reja të TC KR me teknologji të avancuar në vitin 2010	*	Kuvendi / Qeveria	Qeveria / Komiteti Drejtues i Proj.					I kryer
2	S1	O1	V2	Realizimi i objektivave të Strategjisë së Energjisë, shprehja e interesit, tenderimi, përzgjedhja Investitorit dhe nënshkrimi marrëveshjes në vitin 2010 për ndërtimin e TC KR dhe rehabilitim të TC Kosova B	*	Qeveria / KDP	KDP / Investitori					
3	S1	O1	V3	Realizimi i projektit të mihjes së re - Sibovcit Jug-Perëndim prej vitit 2010	*	Qeveria	KEK / Investitori					
4	S1	O1	V4	Dekomisionimi i TC Kosova A pas vitit 2017	***	Qeveria	MZHE / MMPH / Komuna / KEK					
5	S1	O1	V5	Hartimii projektit për largimin e hirit dhe pastrimin e terrenit në lokacionin e zonës industriale të Kosovës B për ndërtimin e TC KR më 2010 / 11	*	Qeveria	MZHE / KEK					
6a	S1	O1	V6	Zbatimi i projektit për largimin e hirit dhe pastrimin e terrenit në lokacionin e zonës industriale të Kosovës B për ndërtimin e TC KR më 2010 / 11	*	Qeveria	Investitori					
6b	S1	O1	V7	Hartimi dhe miratimi i Planit Rregullues Urban për Kompleksin TC "Kosova e Re" më 2011	*	MMPH/Komuna	Investitori					
7	S1	O1	V8	Faza e I-rë - Ndërtimi i blloqeve te para prej 600 (2 x 300) MW në vitin 2011 me hyrje në punë më 2015 dhe 2016	*	Qeveria / KDP	Investitori	600			600	



8	S1	O1	V9	Faza e II-të - Ndërtimi i blloqeve te dyta prej 600 (2 x 300) MW sipas kërkesës konsumit dhe bilancit me hyrje në punë para vitit 2020	***	Qeveria	Investitori	600			600	
9	S1	O1	V10	Faza e III-të - Ndërtimi në vazhdim i blloqeve tjera deri në 1000 MW me teknologji më të avancuar sipas kërkesës vendore dhe të rajonit (2020+)	p	Qeveria	Investitori	1,000			1,000	
10	S1	O1	V11	Zbatimi i vazhdueshëm i obligimeve të TKE (Traktatit të Komunitetit për Energji) dhe respektimi i Direktivave të BE-së me prioritet për sektorin e energjisë	p	Qeveria	Investitori					
<b>S1</b>	<b>O2</b>	<b>Objektivi 2. Furnizim, bartje dhe shpërndarje e sigurtë e energjisë elektrike në rrjetin vendor dhe në sistemin e interkoneksionit</b>										
11	S1	O2	V1	Hartimi i kornizës ligjore dhe zbatim i vazhdueshëm i "Acquis Communautaire" sipas kalendarit të reformave të kërkuara nga TKE-së si dhe asaj ekonomike për energjinë	p	Qeveria	Investitori					
12	S1	O2	V2	Sigurimi i marrëveshjes për bashkëpunim të sistemit elektro-energjetik të Kosovës në sistemin e interkoneksionit të rajonit (Shqipëri, Mali Zi, Serbi dhe Maqedoni) në 2010 -2011	*	Qeveria	MZHE / KOSTT					
13	S1	O2	V3	Optimizimi i punëve paralele në dy sistemet komplementare dhe realizimi i projektit të linjës 400 kV të interkoneksionit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë në periudhë afat-shurte (2010 - 2012)	*	Qeveria	MZHE / KOSTT					
14	S1	O2	V4	Operimi stabil dhe i vazhdueshëm i Sistemit Kosovar të bartjes së energjisë elektrike dhe integrimi saj në sistemin e interkoneksionit rajonal dhe të ENTSO-E deri më 2012	*	Qeveria	KOSTT					
15	S1	O2	V5	Rehabilitim i vazhdueshëm i linjave të vjetëruara dhe ngritja e atyre të reja në kuadër të sistemit të transmisionit (110 dhe 220 KV-she)	p	KOSTT	KOSTT					
16	S1	O2	V6	Minimizimi i humbjeve të energjisë elektrike	p	KOSTT / KEK	KOSTT / KEK					
<b>S1</b>	<b>O3</b>	<b>Objektivi 3. Iniciativa të vazhdueshme për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme për prodhimin e energjisë</b>										
17	S1	O3	V1	Hartimi i kornizës së qëndrueshme ligjore dhe ekonomike prej vitit 2010 deri më 2012 për energjinë alternative	*	Kuvendi / Qeveria	MZHE					
18	S1	O3	V2	Mbështetje shtetërore për përkrahje të iniciativave të Partneritetit Publik - Privat me Institucionet Financiare Ndërkombëtare prej 2010-tës	p	Kuvendi / Qeveria	MF					





19	S1	O3	V3	Hartimi i tarifave mbështetëse për shfrytëzimin e burimeve të ri-përtritshme (Feed-in-Tariffs)	p	ZRrE	ZRrE					
20	S1	O3	V4	Themelimi i Agjencisë së Kosovës për Eficiencë të Energjisë deri në vitin 2011	*	Kuvendi	MZHE					
21	S1	O3	V5	Hartimi i PH për zonën me interes të veçantë ekonomik HC (hidrocentralit) Zhur në vitet 2010/11 sipas vendimit të Kuvendit Nr.03-V-154 me datë 24 Korrik 2009	*	Kuvendit	MMPH / MZHE dhe sektorët tjerë Qeveritar					
22	S1	O3	V6	Realizimi i projekteve për ndërtimin e Hidrocentraleve tjera të vogla gjatë viteve 2010 - 2020;	***	MZHE	MZHE					
23	S1	O3	V7	Hartimi i studimit të parafizibilitetit për shëndrimin e HC të Ujmanit në hidrocentral reversibil bazuar në studimet paraprake 2010 - 2011	*	Qeveria	MZHE / HS "Ibër Lepenc"					
24	S1	O3	V8	Hartimi i projekteve konkrete gjatë viteve 2010 - 2014 për kyçje në rrjetin dhe shfrytëzim të gazit natyrorë	p	Qeveria	MZHE / ZRrE					
25	S1	O3	V9	Hartimi i projekteve të bazuara në rekomandimet e BE-së për shfrytëzimin e burimeve të ri-përtritshme për prodhim, kursim dhe efikasitet të energjisë elektrike	p	Qeveria	MZHE / AKEE					
26	S1	O3	V10	Realizimi i projekteve të bazuara në rekomandimet e BE-së për shfrytëzimin e burimeve të ri-përtritshme për prodhim, kursim dhe efikasitet të energjisë elektrike	p	Qeveria	MZHE / AKEE					
27	S1	O3	V11	Studime rreth potencialit dhe hartimi i projekteve për shfrytëzimin e biomasës për prodhim të energjisë elektrike që nga viti 2010	p	Qeveria	MZHE / AKEE					
<b>S1</b>	<b>O4</b>	<b>Objektivi 4. - Shfrytëzimi i ujit ose avullit të procesuar nga TC për ngrohje qendrore për Prishtinën, Obiliqin dhe F. Kosovën</b>										
28	S1	O4	V1	Zbatimi i Projektit të Ngrohjes së Prishtinës në dy faza: 1) Realizimi PNP, shtrirja e sistemit gypor nga kogjenerimi i TC Kosova B deri te këmbyesit afër Termokosit 2) Verifikim, rregullimi dhe zgjerimi i rrjetit të shpërndarjes	***	Qeveria / Komuna e Prishtinës	Termokosi / Investitori					BE & Q. Gjermane
29	S1	O4	V2	Hartimi dhe zbatimi i Projektit të Ngrohjes së Obiliqit në faza: 1) Ndërtimi i Stacionit Qendror të Këmbyesve 2) Shtrirja e sistemit gypor, nga kogjenerimi i TC Kosova B deri në Stacionin Qendror si dhe të rrjetit të shpërndarjes	***	Qeveria / Komuna e Obiliqit	"Kompania e Projektit" / Investitori					BE / PPP



Nr.Rendor	Synimi	Objektivi	Veprimi (masë / projekt / aktivitet)	Afa ti	Institucione Përgjegjëse	Institucione Zbatuese	Buxheti në milion € / Investitori				Projekt et Egzistuese
							B K	Do nac	PPP	To tali	
30	S1	O4	V3	Hartimi dhe zbatimi i Projektit të Ngrohjes së F. Kosovës në: 1) Ndërtimin e Stacionit Lokal të Këmbyesve 2) Shtrirja e sistemit gypor, nga Stacioni Qendror në Obiliq deri në St. Lokal si dhe të rrjetit komunal të shpërndarjes	***	Qeveria / Komuna e Fushë Kosovës	Kompania e Projektit / Investitori			BE / PPP	
<b>S2 Synimi 2. Planifikim dhe kontrollë e procesit të zhvendosjes dhe të zhvillimit të vendbanimeve brenda dhe jashtë FMR-së</b>											
S2		<b>O1 Objektivi 1. - Hartimi dhe miratimi në vitin 2010 si dhe zbatimi në faza i "Kornizës së Politikave për Zhvendosje"</b>									
31	S2	O1	V1	Hartimi dhe aprovimi i "Kornizës së Politikave për Zhvendosje" më 2010 / 11	*	Qeveria	MMPH			BB	Në proces
32	S2	O1	V2	Zbatimi i "Kornizës së Politikave për Zhvendosje" në faza sipas Planit Xehetar për Mihje dhe të bazuar në avancimin minerar	p	Qeveria	MMPH/Komuna				
S2		<b>O2 Objektivi 2. - Inventarizimi dhe vlerësimi i pronës dhe pasurisë së paluajtshme (gjatë viteve 2010/11 për F-I dhe 2018/19 për F-II)</b>									
33	S2	O2	V1	Hartim i procedurës, metodologjisë dhe ndarja e përgjegjësive me kritere të njëjta për të gjithë, në vlerësimin e paluajtshmërisë;	*	Qeveria	MF	-	-	-	-
34	S2	O2	V2	Inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë dhe paluajtshmërive për fazën e I-rë (pjesë të vendbanimeve Hade e Shipitullë dhe opcionale Dardhishtë) në vitin 2010 / 11	*	Qeveria	MF / KEK / Komuna	-	-	-	-
35	S2	O2	V3	Inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë dhe paluajtshmërive për fazën e II-të (vendbanimet Leshkoshiq/Lajthishtë e Siboc dhe opcionale pjesë e Palaj/Caravadicës) para vitit 2020	***	Investitori	Organi Shpronësues	-	-	-	-
36	S2	O2	V4	Përcaktimi i pranueshëm për vlerën, afatin dhe mënyrën e kompensimit të pasurive individuale: tokës, objekteve të banimit dhe objekteve tjera përcjellëse për F-I në 2011	*	Qeveria	MF / KEK / Komuna	-	-	-	-

37	S2	O2	V5	Përcaktimi i pranueshëm për vlerën, afatin dhe mënyrën e kompensimit të pasurive individuale: tokës, objekteve të banimit dhe objekteve tjera përcjellëse për F-II në 2019	***	Investitori	Organi Shpronësues / Komuniteti	-	-	-	-	-
38	S2	O2	V6	Vlerësime të përafërta të nevojave për infrastrukturë dhe shërbime teknike e sociale dhe religjioze rehabilitim ekonomik, organizime të trajnimeve etj	p	Investitori	Qeveria / Komuna / Komuniteti	-	-	-	-	-
<b>S2</b>		<b>O3</b>	<b>Objektivi 3. Shpronësimi i pronave më 2011/12 për F-I dhe 2019/20 për F-II</b>									
39	S2	O3	V1	Organizimi i konsultimeve paraprake për shpronësim me komunitetin që zhvendoset	*	Qeveria / Komuna	MMPH / MF					
40	S2	O3	V2	Arritja e pajtueshmërisë dhe realizimi i marrëveshjes së deklaruar të mirëkuptimit (mes Qeverisë dhe pronarëve) mbi mënyrën dhe afatin e kompensimit bazuar në legjislacionin në fuqi	*	Qeveria / Komuna	MMPH / MF dhe Investitori					
41	S2	O3	V3	Lëshimi dhe paisja e pronarëve me vendimet për shpronësim (me vleraën e arsyetuar, sipas specifikave të veçanta për llojet e ndryshme të pronave bazuar në marrëveshjen e arritur) për F-I në 2011	*	Qeveria / Komuna	Organi Shpronësues					
42	S2	O3	V4	Lëshimi dhe paisja e pronarëve me vendimet për shpronësim (me vleraën e arsyetuar, sipas specifikave të veçanta për llojet e ndryshme të pronave bazuar në marrëveshjen e arritur) për F-II në 2019	***	Qeveria / Komuna	Organi Shpronësues					
<b>S2</b>		<b>O4</b>	<b>Objektivi 4. Kompensim i pronës dhe pasurisë së paluajtshme në 2012/15 për F-I dhe 2020/23 për F-II</b>									
43	S2	O4	V1	Zbatimi i kompensimit individual (për njësi banimi dhe objekte përcjellëse, të tokës bujqësore, të hyrave nga të korrat brenda vitit dhe të biznesit apo tjetër nëse ekzistojnë) më 2012/13 për F-I	*	Qeveria / Komuna	MF / Investitori					
44	S2	O4	V2	Zbatimi i kompensimit individual (për njësi banimi dhe objekte përcjellëse, të tokës bujqësore, të hyrave nga të korrat brenda vitit dhe të biznesit apo tjetër nëse ekzistojnë) më 2020/21 për F-II	p	Investitori	Qeveria / Komuna					
45	S2	O4	V3	Zbatimi i kompensimit të përbashkët, të infrastrukturës dhe shërbimeve sociale e teknike, F-I deri më 2013/15	**	Qeveria / Komuna	Qeveria/Investitori					

46	S2	O4	V4	Zbatimi i kompensimit të përbashkët, të infrastrukturës dhe shërbimeve sociale e teknike, F-II deri më 2021/23	p	Investitori	Qeveria/Komuna						
<b>S2</b>		<b>O5</b>		<b>Objektivi 5. Zbatimi i procesit të pranueshëm për zhvendosje-rivendosje të komunitetit (2010/2016 dhe 2019/25)</b>									
47	S2	O5	V1	Sigurimi dhe përgatitja e lokacionit të përshtatshëm për hartimin e planeve rregulluese urbane për vendosjen e komunitetit (vitet 2010/11 për F I)	*	Komuna / Qeveria	Komuna / Qeveria						
48	S2	O5	V2	Sigurimi dhe përgatitja e lokacionit të përshtatshëm për hartimin e planeve rregulluese urbane për vendosjen e komunitetit (vitet 2019/20 për F II)	***	Investitori/Komuna / Qeveria	Komuna / Qeveria						
49	S2	O5	V3	Arritja e marrëveshjes mes Qeverisë dhe komunitetit për zhvendosje-rivendosje të bazuar në pajtueshmërinë e deklaruar (F-I në 2011)	*	Komuna / Qeveria	Komuniteti / Komuna / KEK						
50	S2	O5	V4	Arritja e marrëveshjes mes Qeverisë dhe komunitetit për zhvendosje-rivendosje të bazuar në pajtueshmërinë e deklaruar (F-II në 2020)	***	Investitori/Komuna / Qeveria	Komuniteti / Komuna / Investitori						
51	S2	O5	V5	Hartimi dhe aprovimi i Planit Detal të Veprimit për Zhvendosje-Rivendosje të komunitetit me dinamikën e zbatimit për fshatrat në fazën e parë, F-I: Hade dhe Shipitullë në 2011	*	Qeveria / Komuna	Qeveria / KEK						
52	S2	O5	V6	Hartimi dhe aprovimi i Planit Detal të Veprimit për Zhvendosje-Rivendosje të komunitetit me dinamikën e zbatimit për fshatrat në fazën e dytë, F-II: Lajthishtë/Leshkoshiq, Sibovc dhe një pjese të Caravadicës (Palaj) në 2021	***	Qeveria / Investitori	Qeveria / Investitori						
53	S2	O5	V7	Zbatimi i Planit të Veprimit për Zhvendosje-Rivendosje të komunitetit sipas dinamikës së planifikuar (për F-I më 2012/15)	**	Investitori/ Qeveria / Komuna	Qeveria / Komuniteti						
54	S2	O5	V8	Zbatimi i Planit të Veprimit për Zhvendosje-Rivendosje të komunitetit sipas dinamikës së planifikuar (për F-II më 2022/25)	p	Investitori/ Qeveria / Komuna	Qeveria / Investitori / Komuniteti						
<b>S2</b>		<b>O6</b>		<b>Objektivi 6. Arritje dhe zbatim të marrëveshjes me komunitetin për çështjen e varrezave</b>									
55	S2	O6	V1	Konsultim me komunitetin dhe bashkësitë fetare adekuate si dhe identifikimi i hapësirës së përshtatshme për zhvendosjen e varrezave deri më 2012 për F-I	*	Qeveria/ Komuna	Investori / Komuna/ Qeveria						



56	S2	O6	V2	Konsultim me komunitetin dhe bashkësitë fetare adekuatë si dhe identifikimi i hapësirës së përshtatshme për zhvendosjen e varrezave deri më 2020 për F-II	p	Investitori / Qeveria/ Komuna	Komuna/ Qeveria						
57	S2	O6	V3	Arritja e marrëveshjes së pranueshme me komunitetin për zhvendosjen-rivendosjen e varrezave para vitit 2013 /F-I	*	Qeveria/ Komuna	Qeveria/ Komuna / Investitori						
58	S2	O6	V4	Arritja e marrëveshjes së pranueshme me komunitetin për zhvendosjen-rivendosjen e varrezave para vitit 2021 / F-II	p	Investitori/ Qeveria/ Komuna	Qeveria/ Komuna /						
59	S2	O6	V5	Hartimi i Projektit për Zhvendosje-rivendosjen e Varrezave (F-I më 2013)	*	Qeveria/ Komuna	Qeveria/ Komuna						
60	S2	O6	V6	Hartimi i Projektit për Zhvendosje-rivendosjen e Varrezave (F-II)	p	Qeveria/ Komuna	Qeveria/ Komuna						
61	S2	O6	V7	Realizimi i Projektit për Zhvendosje-rivendosjen e Varrezave (F-I më 2014)	*	Investitori/ Qeveria/ Komuna	Qeveria/ Komuna						
62	S2	O6	V8	Realizimi i Projektit për Zhvendosje-rivendosjen e Varrezave (F-II)	p	Investitori/ Qeveria/ Komuna	Qeveria/ Komuna						
<b>S2</b>	<b>O7</b>	<b>Objektivi 7. Krijimi i fondit për zhvillim të komunitetit prej 10 milion Euro nga investitori</b>											
63	S2	O7	V1	Krijimi i zyrës Këshilldhënëse dhe për Menagjim të Fondit (ZKMF) në vitin 2011	*	Komunat dhe Qeveria	Investitori / Komunat / Komuniteti/OJ Q						
64	S2	O7	V2	Identifikimi i nevojave të komunitetit për përfitimet nga fondi për zhvillim prej 2011	*	Komunat	Investitori / ZKMF - FMR						
65	S2	O7	V3	Hartimi i Planit për Zhvillim të Komunitetit më 2011	*	Investitori/ Komunat / Qeveria	Investitori / ZKMF						
66	S2	O7	V4	Zyrtarizimi i marrëveshjes së mirëkuptimit për prioritetet dhe kriteret lehtësuese për banoret e zonës së FMR-së në: - Pagesë të energjisë, - Aftësi, trajnime profesionale dhe punësim në nënsektorët e sistemit energjetik të Kosovës - Mbrojtje të mjedisit dhe kontroleve shëndetsore - Realizim të projekteve të ose për nevoja të komunitetit, etj	*	Qeveria / Komunat / Investitori	Investitori / Komunat (ZKMF) / Qeveria						



S2		Objektivi 8. Planifikim dhe kontroll i zhvillimeve brenda dhe jashtë zonës së FMR-së											
67	S2	O8	V1	Hartimi i Planit Menagjues të Energjetikës së Kosovës, në mbrojtje të rezervave të linjitet me vendime Qeveritare, deri në vitin 2012	*	Qeveria / MZHE	MZHE						
68	S2	O8	V2	Harmonizimi i planeve lokale të komunave pjesëmarrëse (Obiliq, Fushë Kosovë, Vushtri dhe Drenas) me PH për zonën e interesit FMR	*	Komunat	Komunat / MMPH						
69	S2	O8	V3	Hartimi i planeve rregulluese urbane (me densifikim dhe zgjerim të lejuar të ndërtimeve në vendbanimet që nuk i nënshtrohen zhvendosjes) dhe monitorimi i zhvillimit në zonë të interesit FMR	p	Komunat	Komunat						
70	S2	O8	V4	Miratimi dhe zbatimi i planeve rregulluese me projektet konkrete për infrastrukturë dhe shërbime teknike e sociale me hapësirat të përbashkëta si dhe objekte banimi e tjera përcjellëse (F-I më 2012/14)	*	Komuna	Komunat						
71	S2	O8	V5	Miratimi dhe zbatimi i planeve rregulluese me projektet konkrete për infrastrukturë dhe shërbime teknike e sociale me hapësirat të përbashkëta si dhe objekte banimi e tjera përcjellëse (F-II më 2020/22)	** *	Komuna	Komunat						
72	S2	O8	V6	Zbatimi i plan-projekteve në ndërtimin dhe vendosjen e popullsisë në vendbanimet e reja për F-I më 2013/15	**	Qeveria / Komuna	Qeveria / Komuna						
73	S2	O8	V7	Zbatimi i plan-projekteve në ndërtimin dhe vendosjen e popullsisë në vendbanimet e reja për F-II më 2021/23	** *	Qeveria / Komuna	Qeveria / Komuna / Investitori						
74	S2	O8	V8	Zgjerimi dhe përmirësimi i rrjetit ekzistues të rrugëve dhe i qarkores për lidhje të vendbanimeve për rreth zonës minerare në FMR në periudhë afat-shkurte	*	Qeveria / Komunat	MTPT / Komunat						
75	S2	O8	V9	Përmirësimi i gjendjes në infrastrukturë dhe funksionalizim i rrjetit hekurudhor në përgjithsi e sidomos në zonën e FMR-së	p	Qeveria / Komunat	MTPT / Komunat /						
76	S2	O8	V10	Kyçja e të gjitha vendbanimeve në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit brenda zonës "FMR-së"	*	Qeveria / Komunat	Kompania Ujit dhe Kanalizimit						
77	S2	O8	V11	Kyçja e të gjitha vendbanimeve në rrjetin e telekomunikimeve brenda zonës "FMR-së;	*	Qeveria / MTPT	MTPT / Komunat						
78	S2	O8	V12	Hartimi Planit Hapësitor për zonën e interesit të TZHEK-ut (trekëndshit të zhvillimit ekonomik të Kosovës) deri në vitin 2012	*	Qeveria / Komunat	MMPH-IPH / MZHE / MTI / MF / MBPZHR						

79	S2	O8	V13	Harmonizimi i planeve lokale, të komunave pjesëmarrëse në Basenin e linjtit Kosova, me PH për zonën e interesit TZHEK, gjat viteve 2012/14	**	Qeveria / Komunat	Komunat						
80	S2	O8	V14	Hartimi planeve rregulluese urbane dhe monitorim i zhvillimeve të lejuara në vendbanimet në Basenin Kosova më 2011/ 2015	**	Qeveria	Komunat / DU / Kompani Hartuese						
81	S2	O8	V15	Themelimi i Njësisë Inspektuese, përgjegjëse për monitorim të zhvillimeve në zonat me rezerva të linjtit (sidomos Baseni Kosova), në vitin 2011	*	Qeveria	MMPH / MZHE						
Nr.Rendor	Synimi	Objektivi	Veprimi (masë / projekt / aktivitet)			Afati	Institucion e Përgjegjëse	Institucione Zbatuese	Buxheti në milion € / Investitori				Projektet Egzistuese
									BK	Donac	PPP	Totali	
<b>S3 Synimi 3. Menaxhim i qëndrueshëm i resurseve natyrore në FMR</b>													
<b>S3</b>		<b>O1 Objektivi 1. Shfrytëzim racional dhe efikas i resurseve të linjtit më 2010 - 2020+</b>											
82	S3	O1	V1	Shfrytëzim efikas i linjtit me teknologji të avancuar të djegies	p	Qeveria	KDP / MZHE / Investitori						
83	S3	O1	V2	Zbatimi i Planit Kryesor Xehetar të mihjes së re bazuar në dinamikën e zhvillimit kapaciteteve të reja gjeneruese për fazën e parë;	*	KDP	KEK						
84	S3	O1	V3	Zbatimi i Planit Kryesor Xehetar të mihjes së re bazuar në dinamikën e zhvillimit kapaciteteve të reja gjeneruese për fazën e dytë;	**	KDP / Investitori	Investitori						
85	S3	O1	V4	Koordinimi i aktiviteteve të shfrytëzimit të linjtit sipas dinamikës së planifikuar paralelisht me aktivitetet e rikultivimit	p	KDP / Komuna	KEK / Investitori						
<b>S3</b>		<b>O2 Objektivi 2. - Parandalimi i vet-djegies së linjtit në miniera (mihje sipërfaqësore) më 2010 - 2020+</b>											
86	S3	O2	V1	Hartimi i planit operativ për evitimin dhe parandalimin e zjarreve;	*	Operatori	KEK / Investitori						



87	S3	O2	V2	Krijimi i ekipit emergjent dhe trajnimin e personelit për evitimin, parandalimin dhe shuarjen e zjarreve;	*	Operatori	KEK / Investitori						
88	S3	O2	V3	Sigurimin e pajisjeve të nevojshme për evitimin dhe parandalimin e zjarreve për secilën minierë;	p	Operatori	KEK / Investitori						
<b>S3</b>	<b>O3</b>	<b>Objektivi 3. - Shfrytëzimi dhe menaxhimi racional i resurseve ujore më 2010 - 2020+</b>											
89	S3	O3	V1	Hartimi i strategjisë shtetërore për ujëra në pajtueshmëri me udhëzimet dhe politikat e specifikuar në Direktivën Kornizë të Ujit të BE-së;	*	MMPH / Komuna	MMPH						
90	S3	O3	V2	Hartimi i planit për menaxhimin e pellgut të lumit Ibër;	*	MMPH / Komuna	MMPH						
91	S3	O3	V3	Hartimi i projektit për rregullimin e shtratit të lumit Sitnicë;	*	MMPH / Komuna	MMPH					0.9	Segment i kryer (5 km) në FMR
92	S3	O3	V4	Hartimi i projektit për rregullimin e shtratit të lumit Drenicë;	*	MMPH / Komuna	MMPH						
93	S3	O3	V5	Hartimi i projektit për rregullimin e shtratit të lumit Llapit;	*	MMPH / Komuna	MMPH						
94	S3	O3	V6	Hartimi i projektit për inventarizimin e të gjitha burimeve natyrore brenda zonës, me mundësi të shfrytëzimit të tyre për ujë të pijshëm për banoret e zonës;	*	MMPH / Komuna	MMPH						
95	S3	O3	V7	Hulumtimi i ujërave nëntokësore në aluvionet e lumit Sitnicë, Drenicë dhe Llap	**	Qeveria / MMPH	MMPH						
96	S3	O3	V8	Hartimi i projektit për riparimin dhe rehabilitimin e kanalit të Hidro-sistemit Ibër -Lepenc në pjesët: Pridvoricë-Obiliq; Bivolak-Drenas (zvogëlimi të humbjes dhe shpenzimit ilegal të ujit)	*	MMPH / HS "I-L" / Komunitat	HS "Ibër - Lepenc"						
97	S3	O3	V9	Zbatimi i masave për ndalimin e shfrytëzimit të inerteve në lumenjtë Sitnicë, Drenicë dhe Llap;	p	MMPH / K Komunal	MMPH						



98	S3	O3	V10	Zbatimi i masave kundër kyçjeve ilegale në sistemin e kanalit Iber-Lepenc;	p	HS "Ibër - Lepenc"	HS "Ibër - Lepenc"						
99	S3	O3	V11	Aktualizimi, rishikimi dhe përgatitja e planeve për pjesën tjetër të projektit Ibër-Lepenc (pjesa e Lepencit);	*	HS "Ibër - Lepenc"	HS "Ibër - Lepenc"						
100	S3	O3	V12	Hartimi i studimit të fizibilitetit dhe ndërtimit të bazenit akumulues me qëllim të rritjes së sigurisë së furnizimit me ujë rezervë të TC-ve (Kosova Re dhe Kosova B)	*	Investitori	Investitori						
101	S3	O3	V13	Zvogëlimi i konsumit të ujit përmes riciklimit të ujërave të shkarkuara industriale;	p	Qeveria	KEK / Investitori						
Nr.Rendor	Synimi	Objektivi	Veprimi (masë / projekt / aktivitet)			Afa ti	Institucione Përgjegjëse	Institucione Zbatuese	Buxheti në milion € / Investitori				Projek tet Egzist uese
									B K	Do nac	PPP	To tali	
<b>S4</b> <b>Synimi 4. Përmirësimi i gjendjes mjedisore dhe përkujdesja ndaj trashëgimisë në zonën e FMR-së</b>													
<b>S4</b>		<b>O1</b> <b>Objektivi 1.Përmirësimi i performancës mjedisore në zonën e minierave dhe të TC-ve ekzistuese në pajtim me Direktivat e BE-së para vitit 2017</b>											
102	S4	O1	V1	Krijimi i barrierave përkatëse ndaj zërit për të zvogëluar pengesat e shkaktuara nga zhurmat	p	Qeveria	Investitori						
103	S4	O1	V2	Pyllëzimi i brezave gjelbërue në zonën e FMR-së: - Rreth minierave ekzistuese dhe të reja të mihjes, - Deponive të hirit, - TC- ve ekzistuese dhe të reja, dhe - Rreth zonës "FMR" deri në takim me malet e Çiçavicës	p	Investitori	Investitori						
104	S4	O1	V3	Hartimi i Planit për realizimin e projekteve në termocentralet ekzistuese, në: - Zvogëlimin e emetimeve të pluhurit, dhe - Shkarkimit të ujërave industrial	**	MMPH	KEK / Investitori						
105	S4	O1	V4	Përmirësimi i performancës mjedisore të TC "Kosova A" me investime shtesë në mirëmbajtje dhe mundësia e operimit të saj deri në fund të vitit 2017 (fillimi i procesit të mbylljes)	**	Qeveria	KEK / Investitori						



106	S4	O1	V5	Largimi i mbeturinave, dekomisionimi dhe demontimi i impianteve në kompleksin energjetiko-kimik në lokacionin "Kosova A" (gazifikimit, tertores, ngrohtores, deponive dhe reparacioneve të linjtit si dhe azotikut)	**	Qeveria	MMPH / KEK / Investitor						
107	S4	O1	V6	Riparimet kryesore në modernizim të pajisjeve të TC "Kosova B" përfshirë instalimin e FGD-ve ( Desulfurimin e gazit – denitrifikimin) në pajtim me Direktivat e BE-së	***	Qeveria / KDP MZHE	Investitori						
108	S4	O1	V7	Realizimi i objektivave të studimit të fizibilitetit për dekomisionimin e TC Kosova A pas vitit 2017 dhe hartimi planeve për demontim dhe rregullim të hapësirave të degraduara	***	Qeveria	Qeveria/ MZHE/ KEK						
109	S4	O1	V8	Ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave (industrial, të zeza, të kanalizimit, etj) në dalje nga objektet industriale	*	Qeveria	Investitori						
<b>S4</b>	<b>O2</b>	<b>Objektivi 2. Rehabilitimi dhe rikultivimi i vazhdueshëm i hapësirave të degraduara</b>											
110	S4	O2	V1	Realizimi i Projektit për Pastrimin dhe Rehabilitimin e Tokës (PPRT) në komponentën "Krijimi i Sistemit për Transportin Hidraulik të Hirit"	p	Qeveria / MZHE / MMPH	KEK						
111	S4	O2	V2	Realizimi i PPRT-së në "Rehabilitim, Formësim dhe Rikultivim të Deponisë Hirit të TC Kosova A"	*	Qeveria / KEK	KEK						
112	S4	O2	V3	Realizimi i PPRT-së në "Trajtim dhe Largim të Mbeturinave të Rrezikshme nga Zona e Impiantit të Gasifikimit në Obiliq"	**	Qeveria / KEK	KEK						
113	S4	O2	V4	Realizimi i PPRT-së në "Stabilizimi, Riformësimi dhe Rikultivimi i Palosjeve të Jashtme të Djerrinave", për: - Deponinë e Vasilevës sipas aktiviteteve më 2009, - Deponinë Jugore sipas dinamikës më 2010/12 - Deponinë Kalaja dhe Lugu i Thellë më 2010/12 dhe - Deponinë e hirit dhe të djerrinës Dragodan më 2009/11	*	Qeveria / KEK	KEK						Në proces
114	S4	O2	V5	Riparimi dhe rikultivimi i zonave të vjetra ndaj emetimeve të partikulatave nga termocentralet, minierat dhe deponitë e hirit	*	Qeveria / KEK	KEK / Investitori						
115	S4	O2	V6	Identifikimi dhe inventarizimi i zonave aktuale erozive, brenda zonës së FMR-së	*	Qeveria / Komunitat	KEK / Investitori						

116	S4	O2	V7	Hartimi dhe zbatimi i projektit me masat kundër erozionit: - Masat biologjike - me pyllëzim, dhe - Masat teknike - gabioneve, kaskadave dhe pritave	**	Qeveria / Komunat	KEK / Investitori						
117	S4	O2	V8	Identifikimi dhe inventarizimi i zonave që përmythen (nën vërshime) brenda zones së FMR-së	*	Qeveria / Komunat	KEK / Investitori						
118	S4	O2	V9	Hartimi dhe realizimi i projektit me masat mbrojtëse ndaj përmytjeve: - Me masat parandaluese - mbrojtëse, dhe - Me masat përmes zgjerimit të shtratit dhe ndërtimit të argjinaturave të lumenjëve (Sitnicë, Drenicë dhe Llap)	**	Qeveria / Komunat	KEK / Investitori						
<b>S4</b>		<b>O3</b>	<b>Objektivi 3. Monitorimi dhe kontrolli i rregullt ndaj elementëve mjedisor që nga 2010-ta</b>										
119	S4	O3	V1	Zgjedhja e lokacionit të përshtatshëm për vendosjen e stacioneve monitorues varësish nga shpërndarja e gazrave dhe grimcave të pluhurit	*	Qeveria / KEK	MMPH / KEK / Investitor						
120	S4	O3	V2	Vendosja e sistemeve matëse dhe të monitorimit të emetimeve në blloqet e termocentraleve		Qeveria / KEK	MMPH / KEK / Investitor						
121	S4	O3	V3	Vendosja e sistemit monitorues mbi kualitetin e ajrit, ujit dhe tokës në zonën e ndikimit dhe jashtë saj nga objektet energjetike	*	Qeveria / MMPH / Komunat	IHMK						
122	S4	O3	V4	Ngritja e kapaciteteve institucionale për monitorim dhe menaxhim të sistemit	*	Qeveria / MMPH	AMMK / IHMK / Komunat						
123	S4	O3	V5	Ndërtimi i bazës së të dhënave mbi monitorimin e kualitetit të ajrit, ujit dhe tokës brenda zonës së FMR-së;	*	Qeveria / MMPH	AMMK / IHMK						
124	S4	O3	V6	Mbledhja dhe procedimi i të dhënave nga stacionet monitoruese dhe integrimi i tyre në Qendrën Monitoruese brenda AKMM-së si dhe publikimi tyre;	p	MMPH / AKMM	AKMM / IHMK						
125	S4	O3	V7	Analizimi i të dhënave mbi kualitetin (cilësinë) e ajrit, tokës dhe llojllojshmërisë biologjike (biodiversitetit);	p	MMPH / AKMM	MMPH / AKMM						
126	S4	O3	V8	Studimi dhe analizimi i të dhënave mbi nivelin e zhurmës dhe të radioaktivitetit	p	MMPH / AKMM	MMPH / AKMM						



127	S4	O3	V9	Hartimi dhe publikimi i raportit vjetor, nga AKMM, me vlerat minimale e maksimale të gjendjes dhe nivelin e lejueshmërisë të elementëve mjedisorë	p	MMPH / AKMM	MMPH / AKMM						
128	S4	O3	V10	Hartimi i projekteve detale për ndërtimin dhe kontrollin e impianteve për trajtimiti i ujërave të zeza para shkarkimit në lumenj nga TC-të, mihjet, industria dhe amvisëritë	p	MMPH / Komunat	Investitori						
<b>S4</b>	<b>O4</b>	<b>Objektivi 4 Menaxhim i qëndrueshëm i 'Deponisë Rajonale' ne Mirash (2010 - 2020)</b>											
129	S4	O4	V1	Hartimi i Planit për Menaxhim të Mbeturinave (PMM për periudhën deri në vitin 2020) më 2011	*	Qeveria / MMPH / MF	Komp. për Menagjim të Mbeturinave						
130	S4	O4	V2	Ndermarrja e masave urgjente per zvogëlimin e ndikimit në rrethinë	*	MMPH /	Komp. për Menagjim të Mbeturinave						
131	S4	O4	V3	Menaxhimi dhe mirëmbajtja e deponisë rajonale sipas projektit	p	MMPH /	MMPH / Komunat						
132	S4	O4	V4	Riciklimi i mbeturinave organike nga ato inorganike	p	MMPH /	MMPH / Komunat						
133	S4	O4	V5	Shfrytëzimi i biomasës për fitimin e energjisë nga djegia e saj	p	MMPH /	MMPH / Komunat						
134	S4	O4	V6	Mbyllja e deponisë në vitin 2020 dhe rregullimi terrenit	***	MMPH / Komunat	Komp. / MMPH / MF / Komuna						





135	S4	O4	V7	Rishikimi projektit të "Deponisë Rajonale", për mundësinë e selektimit, reciklimit, përpunimit të mbeturinave dhe trajtimit të ujrave të zeza sipas Direktivave të BE-së, deri në fund të vitit 2011	*	Qeveria / Komunitat	MMPH / MF / Komp. për Menagjim të Mbeturinave						
<b>S4</b>		<b>O5</b>	<b>Objektivi 5. Menaxhimi dhe shfrytëzimi i hirit të freskët për nevoja në ndërtimtari (2010 - 2020+)</b>										
136	S4	O5	V1	Rishqyrtimi i studimeve dhe aktualizimi i tyre mbi kualitetin e hirit dhe shfrytëzimin e tij për prodhime të produkteve ndërtimore më 2010/11	**	MZHE	MZHE						
137	S4	O5	V2	Organizimi i një konference ndërkombëtare për mundësitë e shfrytëzimit dhe promovimit të hirit në vitin 2010	*	MZHE	MZHE / MMPH						
138	S4	O5	V3	Hulumtimi i përvojave të mira, për shfrytëzim të hirit të freskët, për produkte ndërtimore, për përfitimin e çimentos dhe betonit në ndërtimin e rrugëve, prodhimin e tjegullave, pllakave të qeramikës – 'klinker' etj në vitin 2010	**	MZHE	MZHE / MMPH						
139	S4	O5	V4	Ndërtimi i fabrikës viteve 2011/13, për prodhim të materialit ndërtimor nga përpunimi i hirit të freskët, si material përforcues dhe izolues në përzierje të Çimentos dhe Betonit, pllaka klinker dhe shamote me argjilë etj.	**	Investitori	Investitor						
<b>S4</b>		<b>O6</b>	<b>Objektivi 6. Përkujdesje efikase për biodiversitetin dhe trashëgiminë natyrore, kulturore, historike e industriale në zonën e FMR-së</b>										
140	S4	O6	V1	Hartimi i studimit gjithpërfshirës të ndikimit të TC-ve gjatë operimit në habitatet e llojeve të rralla biologjike në zonën e FMR-së dhe rreth saj në 2011/12	*	MMPH / DMM / AKMM	MMPH / DMM / AKMM						
141	S4	O6	V2	Hartimi i projektit me masat mbrojtëse, që ka për qëllim ruajtjen e zogjve të egër, nga veprimi i rrezikshëm i energjisë elektrike më 2011/12	*	MMPH	MMPH / DMM / AKMM						
142	S4	O6	V3	Hartimi i projektit për shfrytëzimin e ndonjë objekti nga kompleksi industrial i TC Kosova A, në kuadër të konservimit të integruar, për muze industrial, galeri artesh, etj deri më 2015	**	MKRS / MF / MTI / MMPH	MKRS / MF / MTI / MMPH						



143	S4	O6	V4	Hartimi i planit për përkujdesje ndaj objekteve dhe lokaliteteve të evidentuara dhe me statusin e mbrojtjes (tyrbja e Sulltan Muratit në Mazgit dhe kalaja e Bellaqevcit në Bardh të Madh) për zhvillimin e turizmit deri më 2012	*	MKRS / MTI	MKRS / MTI						
144	S4	O6	V5	Inventarizimi, procedimi, kategorizimi, mbrojtja me ligj dhe përkujdesja efikase ndaj objekteve dhe tërësive arkitektonike e arkeologjike të evidentuara deri më 2012	*	MKRS / Komuna	MKRS / Komuna						
145	S4	O6	V6	Hulumtimi, inventarizimi dhe sistemimi i objekteve apo tërësive kulturore dhe historike të panjohura deri tani gjatë periudhës 2010/20	***	MKRS / Komuna	MKRS / Komuna						
146	S4	O6	V7	Hartimi i kriterëve dhe masave për zbatim, në rast të gjetjeve të eksponateve, në lokalitetet arkeologjike brenda dhe jashtë zonës së interesit FMR në vitin 2010	**	MKRS	MKRS / DTK						
147	S4	O6	V8	Hartimi i rregullores së veçantë mbi trajtim të peizazheve dhe të lokaliteteve me trashëgimi natyrore, kulturore dhe historike më 2011	*	MKRS / MMPH	MKRS / MMPH						
148	S4	O6	V9	Hartimi i broshurës dhe udhëzuesit (guidës) për vlerat e trashëgimisë (natyrore, kulturore historike dhe industriale) për zonën e interesit FMR më 2011	*	MKRS/ MTI / Komunitat	MKRS/ MTI / Komunitat						

(\* Afat-Shkurtë-deri 3 vjet, (\*\* Afat-Mesëm 3 - 6 vjet, (\*\*\*) Afat-Gjatë - deri 10 vjet dhe (p) Proces në vazhdimësi dhe mbi 10 vjet



# PLANI HAPËSINOR

## Zona me Interes të Veçantë Ekonomik “Fusha e Mihjes së Re 2010 - 2020+”



**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**

Instituti për Planifikim Hapësinor



Prishtinë,  
Mars, 2011

